



Ludwig Boltzmann Institut für Menschenrechte  
Ludwig Boltzmann Institute of Human Rights

**STUDIM PËR VARFËRINË DHE Ç'KYÇJEN SOCIALE NË  
REPUBLIKËN E MAQEDONSIË:  
Probleme dhe nevoja sociale në nivel lokal**

*Shkup, Mars 2011*

**Botues**  
**Instituti për të drejtat e njeriut “Lludvig Bolltman” – BIM-FV, Shkup**

**Përgatitja dhe botimi i i këtij studimi financiarisht janë përkrahur nga ana e  
Bashkëpunimit austriak për zhvillim (ADC)**

**Përgatitur nga**  
Shoqata qytetare “Mozaik”

**Autorë**  
Prof. d-r Maria Donevska  
Doc. d-r Suzana Bornarova  
Doc. d-r Natasha Bogoevska  
Doc. d-r Svetllana Trbokeviq

**Realizim i hulumtimit terrenik**  
Marten Board - Shkup

**Projekt**  
**Të drejtat e njeriut dhe përfshirja sociale në Maqedoni**  
Institut për të drejtat e njeriut “Lludvig Bolltman” – BIM-FV, Shkup  
rr. “Velko Vlahoviq” nr. 1 A-1/4 1000 Shkup  
tel.: +389 (0)2 3216 956  
faks: +389 (0)2 3216 982

**Skudra për përkrahje në BIM-FV, Shkup**  
Petranka Delova Milladinova – Projekt menaxher  
Stojan Mishev – Këshilltar për të drejtat e njeriut  
Ninosllav Mlladenoviq – Këshilltar për të drejtat e njeriut  
Jagoda Iljov – Asistent administrativ

**Person për përkrahje në Ministrinë për punë dhe politikë sociale**  
Irena Todoroska – Udhëheqëse e Njësisë për përfshirje sociale

**Përkthyer prej maqedonisht në shqip**  
Mirije Sulmati

*Qëndrimet e shprehura këtu, si dhe ato të autorëve, jo gjithmonë e paraqesin pozitën zyrtare të Institutit për të drejtat e njeriut “Lludvig Bolltman” (BIM-FV) dhe të Bashkëpunimit austriak për zhvillim (ADC).*

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që ta shpreh kënaqësinë time tepër të madhe nga *Studimi për varfërinë dhe ç'kyçjen sociale*, i cili thjeshtë i kompletton përpjekjet tona për ndërtimin e një shoqërie përfshirëse dhe kohezive, në suazat e procesit të integritimeve euro-atlantike sa më të shpejta.

Në këtë drejtim, i falemnderohem Institutit për të drejtat e njeriut “Lludvig Bolltman” dhe Agjencisë austriake për zhvillim, për përpjekjet e përbashkëta për një përmirësim dhe përsosmëri të politikave nga sfera e mbrojtje sociale dhe përfshirjes sociale, duke e respektuar parimin e bazuar në të drejtat e njeriut.

Gjendjet aktuale të paraqitura në këtë studim, janë mundësi për krijimin e një mjedisi i cili do të gjenerojë zhvillim dhe kohezion shoqëror.

Qëllimi ynë edhe më tej do të jetë mirëmbajtja e dialogut dhe bashkëpunimit mes të gjitha palëve relevante në nivel kombëtar dhe lokal, si një proces kyç për krijimin e një shoqërie në të cilën lidhja mes individit dhe sistemit shoqëror, do të thotë mundësi dhe shanse të barabarta për të gjithë.

**Своерачен потпис!!!**

Xhelal Bajrami  
Ministër për punë dhe politikë sociale

## PËRMBAJTJE

I. KORNIZA METODOLOGJIKE	4
1. HYRJE	4
2. TERMINOLOGJIA KRYESORE NË HULUMTIM	5
3. QËLLIME TË HULUMTIMIT	6
4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	7
4.1. Metodologjia kualitative	7
4.2. Metodologjia kuantitative	7
4.2.1. Lokacioni i hulumtimimit kuantitativ	8
4.2.2. Struktura bazike e shembullit	8
4.2.3. Karakteristika shtesë të strukturës së shembullit	10
4.3. Sfida hulumtuese	12
II. REZULTATE NGA HULUMTIMI	13
KOMUNA E BEROVËS	13
KOMUNA E LIKOVËS	35
KOMUNA E RADOVISHIT	60
KOMUNA E ÇASHKËS	83
KOMUNA E PEHÇEVËS	106
KOMUNA E KONÇES	133
KOMUNA E NEGOTINËS	157
KOMUNA E STUDENIÇANIT	179
III. ANALIZA PËRMBLEDHËSE, PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	199
1. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI ANKETUES NË KOMUNAT	199
1.1. Punësim	199
1.2. Standardi jetësor	199
1.3. Probleme sociale dhe mbrojtja sociale	201
1.4. Shëndetësia dhe të ushqyerit	201
1.5. Arsim	203
1.6. Sport, argëtim, kulturë	203
2. PËRFUNDIME	204
3. REKOMANDIME	207
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	212
Shtojca 1: Pyetësor – hulumtimi i gjendjes sociale të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë	221

## **LISTA E SHKURTESAVE**

**NNJP** – Ndihmë e njëhershme në para

**MPPS** – Ministria për punë dhe politikë sociale

**OJQ** – Organizatë joqeveritare

**NPP** – Ndihmë e përhershme në para

**NSP** – Ndihmë sociale në para

**KNH** – Kujdes dhe ndihmë e huaj

**QP** – Qendër për punësim

**QPS** – Qendër për punë sociale

# I. KORNIZA METODOLOGJIKE

## 1. HYRJE

Pavarësia e Republikës së Maqedonisë, si dhe kalimi prej në ekonomi planore, në atë tregtare në vitin 1991, e shënoi fillimin e tranzicionit të gjatë dhe socialisht të vështirë. Procesi i tranzicionit u ndoq me privatizim, restrukturim të ndërmarrjeve dhe mbylljen e një numri të madh të kapaciteteve industriale joprofitabile. Si rezultat, një pjesë e madhe e fuqisë punëtore në Republikën e Maqedonisë u transformua në tepriçë teknologjike, shkalla e papunësisë dhe varfërisë u rrit me ashpërsi, ndërsa standardi jetësor u keqësua. Në një situatë të tillë, varfëria dhe ç'kyçja sociale, si probleme komplekse dhe multidimensionale, u ndoqën me mohimin e të drejtave të njeriut për shkak të faktit se grupet e prekshme të popullatës nuk kishën mundësi që ti përmbushin as edhe nevojat bazike jetësore. Për seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e këtij problemi tregon edhe shkalla aktuale e varfërisë relative në Maqedoni, e cila ende është shumë e lartë, megjithatë është 28.7%.<sup>1</sup>

Në kontekstin e tillë shoqëror, sistemi i mbrojtjes sociale në Maqedoni u ballafaqua me sfidën për t'ju përgjigjur numrit më të madh të qytetarëve të varfër dhe socialisht të ç'kyçur. Një nga treguesit relevant për varfërimin e qytetarëve maqedonas është numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para i personave të aftë për punë, materialisht të pasiguruar (ndërsa i jepet amvisërisë). Në dhjetor të vitit 2009, nga numri i përgjithshëm i amvisërive në Maqedoni (564.296), gati 9.4% (53.105 amvisëri) ishin shfrytëzues të ndihmës sociale në para<sup>2</sup>. Edhe përpos të përpjekjeve të krijuesve të politikave për ulje të shpenzimeve për ndihmë sociale dhe përfshije të grupeve të prekshme të qytetarëve në vijimet shoqërore, numri i shfrytëzuesve nuk u zvoglua shumë në dy dekadat e fundit. Për të arritur përfshirje më të madhe sociale të qytetarëve, në periudhën pas vitit 2004, fokus më intenziv u vendos mbi decentralizimin e mbrojtjes sociale. Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtje sociale të vitit 2004<sup>3</sup>, të cilat u miratuan në pako me ligjet për decentralizim, komunat fituan mundësia dhe përgjegjisi që ti zhvillojnë funksionet sociale në nivel lokal dhe të krijojnë programe për përmbushjen e nevojave të grupeve në rrezik social. Ligji parashihte mundësi që komunat të krijojnë forma jointucionale të mbrojtjes, përmes krijimit dhe organizimit të qendrave për kujdes ditor dhe të përkohshëm të qytetarëve në varësi të nevojave të tyre, si dhe të organizojnë dhe të zbatojnë mbrojtje sociale të qytetarëve në territorin e tyre përmes miratimit të programeve të tyre zhvillimore, në pajtim me nevojat specifike. Beneficionet në para, të cilat edhe pse nuk i përfshijnë të gjitha grupet e prekshme dhe janë shumë të vogla për të ndikuar mbi uljen e varfërisë dhe ç'kyçjes sociale, mbetën të centralizuara. Megjithatë, edhe përpos të ndryshimeve ligjore, funksionet komunale në sferën e mbrojtjes sociale mbetën jo mjaft të zhvilluara mu për shkak të decentralizimit fiskal të pambaruar në një pjesë të madhe të tyre, iniciativave lokale të pamjaftueshme dhe mungesës së elementeve detyruese në rregullativën ligjore, të cilat elemente do t'i referohen angazhimit të komunave në krijimin e programeve lokale sociale.

<sup>1</sup> www.stat.gov.mk

<sup>2</sup> www.mtsp.gov.mk

<sup>3</sup> Ligji për mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 50/97, 16/2000, 17/2003, 65/2004).

Me Ligjin për mbrojtje sociale të vitit 2009<sup>4</sup>, u fut edhe elementi kushtëzues sipas të cilit komuna është e detyruar që programet zhvillimore të cilat i përgatit, ti përputhi me programet strategjike të Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe të njejtat ti japë për mendim dhe pritet që në periudhën vijuese të intenzivohen aktivitetet e komunave në sferën e mbrojtjes sociale.

Pasojë e gjendjes së tillë është një rrjet i varfër i shërbime sociale në komunat e Maqedonisë. Qasja deri tek disa shërbime të caktuara sociale është e mundur vetëm përmes kornizës ligjore, përderisa tek disa të tjera është e pamundur për shkak të pengesave ligjore ose administrative. Në të njejtën kohë, shërbimet sociale në nivel lokal shpesh krijohen pa analizë paraprake dhe të përshtatshme të situatës, të problemeve sociale lokale dhe pa vlerësim të nevojave. Si rezultat, nga njëra anë, shfrytëzuesit e beneficioneve sociale ende janë vetëm shfrytëzues pasiv në sistemin e mbrojtjes (në veçanti shfrytëzuesit e kompenzimeve në para), ndërsa nga ana tjetër, disa grupeve të popullatës të cilat janë të prekura nga probleme të shumfishta sociale ju mungon qasja deri tek shërbimet ekzistuese për shkak të ç'kyçjes sociale.

Të gjeturat e përgjithshme tregojnë se ka analizë të pamjaftueshme të varfërisë, ç'kyçjes sociale, problemeve dhe nevojave sociale në nivel lokal. Prandaj pritet që rezultatet e këtij hulumtimi të kontribuojnë në zvoglimin e zbrastirës dhe furnizimit të komunave të cilat janë të përfshira në hulumtim me të dhëna relevante, të cilat janë të nevojshme për procesin e planifikimit strategjik që të zgjidhjet varfëria dhe ç'kyçja sociale.

## 2. TERMINOLOGJIA KRYESORE NË HULUMTIM

**Varfëri:** Si të varfër llogariten persona, familje dhe grupe të personave resurset (materiale, kulturore dhe sociale) e të cilëve janë në atë nivel i cili i ç'kyç ato nga niveli minimal i jetesës i cili është i pranueshëm në shtetin në të cilin jetojnë.<sup>5</sup>

**Ç'kyçje sociale:** Për dallim të varfërisë e cila fokusohet mbi individë ose mbi amvisëritë, ç'kyçja sociale parimisht i përfshin marrëdhëniet mes individit dhe shoqërisë, si dhe dinamikën e atyre marrëdhënieve.<sup>6</sup> Ç'kyçja sociale do të thotë pamundësi që efektivisht të participohet në jetën ekonomike, kulturore dhe sociale, si dhe në një mënyrë të caktuar paraqet edhe tjetërsim dhe distancim nga rrjedhat normale të shoqërisë.

**Nevoja sociale:** Nevojat e njeriut si individ, të cilat janë parakusht për ekzistencën e tij si qenie njerëzore, si dhe nevojat të cilat individi i përmbush në bashkësi.<sup>7</sup>

**Probleme sociale:** Gjendje të cilat ndikojnë tek një numër i madh i njerëzve si dukuri të padëshirueshme, të cilat duke e pasur parasyshtë shpërndarjen e tyre, llogariten si burim i vështirësive dhe pakënaqësive, ndërsa të cilat mund të parandalohen, ose po veprimi i tyre të zbutet me një veprim të organizuar shoqëror.<sup>8</sup>

<sup>4</sup> Ligji për mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 79/09).

<sup>5</sup> <http://epp.eurostat.ec.europa.eu>

<sup>6</sup> <http://www1.oecd.org/cer/obj5/docs.htm>

<sup>7</sup> Пејановиќ, С. (1995). Појам потреба и социјалне потребе. Социјална мисао. Nr. 5-6. Beograd.

<sup>8</sup> Сулејманов, З., Стојановски, Н. (2002). Социјална патологија. F. 21. Shkup.

**Mbrojtje sociale:** Kompenzime në para dhe shërbime sociale personale, të siguruar për persona të cilët nuk bëjnë pjesë në asnjërën nga skemat e sigurimit social, ndërsa të cilët janë pa mjete të mjaftueshme për jetesë për veten dhe për familjen.<sup>9</sup>

### 3. QËLLIME TË HULUMTIMIT

**Qëllimi i përgjithshëm.** Qëllimi i përgjithshëm i hulumtimit të varfërisë dhe ç'kyçjes sociale është vlerësimi i nevojave dhe problemeve sociale të grupeve të varfëra dhe socialisht të ç'kyçura të qytetarëve në tetë komuna të përzgjedhura në Maqedoni: Likovë, Çashkë, Studeniçan, Negotinë, Radovish, Konçe, Berovë, Pehçevë.

#### **Qëllime të posaçme:**

- Identifikim i llojeve të problemeve dhe nevojave sociale të qytetarëve socialisht të ç'kyçur.
- Përcaktim i varfërisë dhe standardit jetësor të qytetarëve të përfshirë në hulumtim.
- Sigurimi i informatave për kushtet e jetesës dhe problemin e marginalizimit, si dhe pjesëmarrjen në bashkësinë lokale.
- Identifikim i formave të ç'kyçjes të qytetarëve të varfër dhe socialisht të ç'kyçur në komunat e përzgjedhura.
- Analizë e llojeve të beneficioneve dhe shërbimeve nga mbrojtja sociale të cilat shfrytëzohen, si dhe pengesat për qasje në të njejtat.
- Përcaktim i shkaqeve për qasjen e kufizuar eventuale tek shërbimet sociale për grupet e prekshme të qytetarëve.
- Prezantim i rrjeteve lokale për shërbimet ekzistuese sociale dhe disponueshmëria e tyre (komuna, qendra për punë sociale – QPS, institucione sociale, shëndetësore dhe arsimore, organizata joqeveritare dhe aktorë të tjerë relevant).
- Identifikim i shërbimeve sociale të cilat janë të nevojshme mirëpo mungojnë në komunë dhe identifikim i pengesave në sigurimin e shërbimeve ekzistuese në nivel lokal.
- Dhënia e rekomandimeve për tejkalimin e problemeve të identifikuara sociale.
- Sigurimi i të dhënave të cilat do të mund të shfrytëzohen gjatë përgatitjes së dokumenteve strategjike për luftë kundër ç'kyçjes sociale dhe varfërisë në komunat e përfshira.

### 4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në hulumtim u zbatua metodologjia e kombinuar kualitativo-kuantitative.

#### **4.1. Metodologjia kualitative**

Në kornizat e metodologjisë kualitative u shfrytëzuan **teknikat** e ardhshme:

---

<sup>9</sup> Амицис, Г. (2004). Систем на социјална заштита во Република Македонија. Ф. 11-12. Shkup.

- *Analizë e përmbajtjes* së hulumtimeve paraprake, baza statistikore të të dhënave dhe rregullativa relevante ligjore.
- *Intervista me ekspertë* u zbatuan me nga një pjesëmarrës nga komunat, QPS dhe qendrat për punësim: në përgjithësi u realizuan 24 intervista me ekspertë (nga 3 në secilën prej tetë komunave: Likovë, Çashkë, Studeniçan, Negotinë, Radovish, Konçe, Berovë dhe Pehçevë).
- *Diskutim me fokus grupe* u organizuan në të gjitha komunat: janë realizuar gjithsej 8 diskutime të tilla në të cilat kishte gjithsej 76 pjesëmarrës: 58 shfrytëzues të mbrojtjes sociale dhe 18 joshfrytëzues – banorë të komunave (Shih tabelën 1 më poshtë).

Tabela 1. Struktura e pjesëmarrësve në fokus grupe

Komuna	Shfrytëzues të MS		Joshfrytëzues të MS		Gjithsej
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
Likovë	7	/	2	/	9
Çashkë	9	2	3	/	14
Studeniçan	6	/	4	/	10
Negotinë	5	4	1	/	10
Radovish	4	1	1	1	7
Konçe	3	1	1	/	5
Berovë	7	/	3	/	10
Pehçevë	8	1	2	/	11
<b>Gjithsej:</b>	<b>49</b>	<b>9</b>	<b>17</b>	<b>1</b>	<b>76</b>

Për zbatimin e pjesës kualitative të hulumtimit u krijuan dhe përdorën këto **instrumente**: plane për intervistat me ekspertët (3) dhe lista kontrolluese për diskutim në fokus grupet.

#### 4.2. Metodologjia kuantitative

Në pjesën kuantitative të hulumtimit u shfrytëzua **teknika** - anketë e amvisërisë. Për qëllime të anketës u krijuan pyetësor me 41 pyetje të llojit të mbyllur dhe gjysëm të mbyllur, të ndara në 8 kapituj: 1) informata bazike për kokën në amvisëri; 2) informata për amvisërinë; 3) standardi jetësor; 4) shëndetësi dhe të ushqyerit; 5) arsim; 6) probleme sociale dhe mbrojtje sociale; 7) sport, zbavitje dhe kulturë; dhe 8) banim.

##### 4.2.1. Lokacioni i hulumtimit kuantitativ

Hulumtimi empirik u zbatua në 8 komuna në Maqedoni, gjegjësisht 4 urbane dhe 4 rurale: a) urbane: Berovë, Pehçevë, Negotinë dhe Radovish; dhe b) rurale: Likovë, Çashkë, Studeniçan dhe Konçe. Anketimi i zbatua gjatë muajve tetor-nëntor 2010. Në këtë hulumtim u përfshinë komuna sipas preferencës së porositësit të hulumtimit.

Tabela 2. Vendbanime në të cilat u zbatua hulumtimi anketues

Komuna	Vendbanim	Urban	Rural
Berovë	Q. Berovë	50	
	F. Vladimirovo		50
Likovë	F. Likovë		100
Radovish	Q. Radovish	65	
	F. Raklish		35

Çashkë	F. Çashkë		100
Pehçevë	Q. Pehçevë	63	
	F. Umlen		27
	F. Çiflig		10
Konçe	F. Konçe		100
Negotinë	Q. Negotinë	70	
	F. Dollni Disan		19
	F. Tamjanik		8
	F. Tremnik		3
Studenican	F. Studenican		100
<b>Gjithsej</b>		248	552

\*Q- Qytet \*F- Fshat

#### 4.2.2. Struktura bazike e pyetësorit

Me hulumtimin empirik u përfshinë 800 amvisëri, gjegjësisht nga 100 amvisëri në secilën nga 8 komunat e përzgjedhura. Përgjigjet e pyetjeve anketuese u dhanë nga koka e familjes (kur takohet gjatë anketimit) ose në rast të mungesës së tij/saj, përgjigjet në emër të tij jepen nga anëtari në moshë madhore. Bëhet fjalë për pyetësor të përshtatshëm, representativ sipas disa treguesve të caktuar:

- *Përkatsi rurale - urbane:* nga aspekti i këtij kriteri, pjesëmarrja e amvisërive nga vendet rurale dhe urbane në pyetësorin është proporcionale me strukturën reale të popullatës sipas përkatësisë rurale-urbane në komunat e përfshira. Të anketuarit janë 248 (31%) amvisëri nga vendet urbane, 532 (66.5%) amvisëri nga vendet rurale dhe 20 (2.5%) amvisëri në periferi të qyteteve.
- *Shfrytëzues të ndihmës sociale - joshfrytëzues:* Për qëllim të përfshirjes dhe analizimit të gjendjes sociale të amvisërive socialisht të prekshme, të cilat kanë realizuar qasje tek sistemi i mbrojtjes sociale (ndihma sociale), mirëpo edhe ato të cilët nuk janë shfrytëzues të këtij lloji të beneficioneve, si dhe për shkak të nevojës të krahasimit të standardit jetësor dhe problemeve mes këtyre dy grupe të amvisërive, në secilën komunë u zgjodh përafërsisht numër i njëjtë i amvisërive nga të dy grupet (në korelacion 50%-50%). U anketuan 381 (47.6%) amvisëri shfrytëzues të ndihmës sociale dhe 418 (52.3%) amvisëri të cilat nuk janë shfrytëzues të ndihmës sociale.
- *Përkatësia etnike:* Pjesëmarrja e amvisërive nga aspekti i përkatësisë etnike është përafërsisht proporcionale me strukturën etnike ekzistuese të popullatës në komunat e përfshira (për strukturën e pyetësorit më detalisht mund të shihet në tabelat 3 dhe 4 në vijim).

Tabela 3. Struktura e pyetësorit sipas përkatësisë etnike

Komuna		Përkatësia etnike e kokës në anvisëri:						Rrefuzon të	Gjithsej
		Maqedonas/e	Shqiptar/e	Rom/e	Turk/e	Serb/e	Bosnjak/e		
Radovish	Count	88	0	4	7	0	0	1	100
	% of Total	11,0%	0,0	0,5%	0,9%	0,0%	0,0%	0,1%	12,5%
Negotinë	Count	96	0	2	1	0	0	1	100
	% of Total	12,0%	0,0	0,3%	0,1%	0,0%	0,0%	0,1%	12,5%
Berovë	Count	84	0	16	0	0	0	0	100
	% of Total	10,5%	0,0	2,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	12,5%
Pehçevë	Count	92	0	7	0	1	0	0	100
	% of Total	11,5%	0,0	0,9%	0,0%	0,1%	0,0%	0,0%	12,5%
Konçe	Count	96	1	0	1	2	0	0	100
	% of Total	12,0%	0,1	0,0%	0,1%	0,3%	0,0%	0,0%	12,5%
Likovë	Count	0	100	0	0	0	0	0	100
	% of Total	0,0%	12,5%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	12,5%
Studenican	Count	0	96	0	2	0	1	1	100
	% of Total	0,0%	12,0%	0,0%	0,3%	0,0%	0,1%	0,1%	12,5%
Çashkë	Count	96	1	0	1	2	0	0	100
	% of Total	12,0%	0,1	0,0%	0,1%	0,3%	0,0%	0,0%	12,5%
	Count	552	198	29	12	5	1	3	800
	% of Total	69,0%	24,8%	3,6%	1,5%	0,6%	0,1%	0,4%	100,0%

Tabela 4. Struktura e pyetësorit sipas përkatësisë rurale-urbane dhe jo/shfrytëzues të ndihmës sociale

Komuna:			Lloji i vendbanimit:			Gjithsej
			Urban	Rural	Periferi	
Radovish	Shfrytëzues	Count	31	19		50
		% of Total	31%	19%		50%
	Joshfrytëzue	Count	34	16		50
		% of Total	34%	16%		50%
	Gjithsej	Count	65	35		100
		% of Total	65%	35%		100%
Negotinë	Shfrytëzues	Count	30	20		50
		% of Total	30%	20%		50%
	Joshfrytëzue	Count	40	10		50
		% of Total	40%	10%		50%
	Gjithsej	Count	70	30		100
		% of Total	70%	30%		100%
Berovë	Shfrytëzues	Count	19	23		42
		% of Total	19%	23%		42%
	Joshfrytëzue	Count	31	27		58
		% of Total	31%	27%		58%
	Gjithsej	Count	50	50		100
		% of Total	50%	50%		100%
Pehçevë	Shfrytëzues	Count	24	21		45
		% of Total	24%	21%		45%
	Joshfrytëzue	Count	38	16		54
		% of Total	38%	16%		54%
	Rrefuzon të përgjigjet	Count	1	0		1
		% of Total	1%	0%		1%
Gjithsej	Count	63	37		100	
	% of Total	63%	37%		100%	
Konçe	Shfrytëzues	Count		47		47
		% of Total		47%		47%
	Joshfrytëzue	Count		53		53
		% of Total		53%		53%
	Gjithsej	Count		100		100
		% of Total		100%		100%
Likovë	Shfrytëzues	Count		50		50
		% of Total		50%		50%
	Joshfrytëzue	Count		50		50
		% of Total		50%		50%
	Gjithsej	Count		100		100
		% of Total		100%		100%
Studenican	Shfrytëzues	Count		50		50
		% of Total		50%		50%
	Joshfrytëzue	Count		50		50
		% of Total		50%		50%
	Gjithsej	Count		100		100
		% of Total		100%		100%
Çashkë	Shfrytëzues	Count		38	9	47
		% of Total		38%		9
	Joshfrytëzues	Count		42	11	53
		% of Total		42%	11%	53%
	Gjithsej	Count		80	20	100
		% of Total		80%	20%	100%

\* Struktura reale sipas përkatësisë rurale-urbane në komnat e synuara është: Likovë (100% rurale), Çashkë (100% rurale), Studenican (100% rurale), Konçe (100% rurale), Radovish (66.14% urbane, 33.86% rurale), Pehçevë (58.67% urbane, 41.33% rurale), Berovë (50.23% urbane, 49.77% rurale) dhe Negotinë (69.14% urbane, 30.86% rurale).

#### 4.2.3. Karakteristika shitesë të strukturës së pyetësorit

Nga aspekti i shpërndarjes **gjinore** të kokës në amvisëri, nga gjithsej 800 amvisëri të anketuara, në pjesën më të madhe të tyre, gjegjësisht në 694 (86.8%) koka e amvisërisë është mashkull, ndërsa në 99 (12.4%) amvisëri është femër. Numri më i madh i amvisërive në të cilat koka është femër janë të vendosura në komunat urbane të Negotinës (29.3%) dhe Berovës (20.2%) (Tabela 1).

Tabela 1. Gjinia e kokës në amvisëri nëpër komuna

Komuna	Gjinia e kokës në amvisëri:			Gjithsej	
	Meshkuj	Femra	Rrefuzon të përgjigjet		
Radovish	Count	94	5	1	100
	% of Total	11,8%	0,6%	0,1%	12,5%
Negotinë	Count	71	29	0	100
	% of Total	8,9%	3,6%	0,0%	12,5%
Berovë	Count	80	20	0	100
	% of Total	10,0%	2,5%	0,0%	12,5%
Pehçevë	Count	92	7	1	100
	% of Total	11,5%	0,9%	0,1%	12,5%
Konçe	Count	90	10	0	100
	% of Total	11,3%	1,3%	0,0%	12,5%
Likovë	Count	92	8	0	100
	% of Total	11,5%	1,0%	0,0%	12,5%
Studenica	Count	85	10	5	100
	% of Total	10,6%	1,3%	0,6%	12,5%
Çashkë	Count	90	10	0	100
	% of Total	11,3%	1,3%	0,0%	12,5%
	Count	694	99	7	800
	% of Total	86,8%	12,4%	0,9%	100,0%

Nga aspekti i **moshës**, shumica e kokave të amvisërive janë në moshë mbi 40 vjeç (613 ose 76.6%). Koka të amvisërive në moshë mes 40-49 vjeç ka në 220 ose 27.5% nga numri i përgjithshëm i amvisërive, përderisa gjithashtu i madh është edhe numri i amvisërive me kokë në moshë prej 50-59 vjeç (208 ose 26%) dhe më tepër se 60 vjeç (185 ose 23.1%).

Sipas **statusit martesor** shumica e kokave në familje janë të martuar (662 ose 82.8%), 59 (7.4%) janë të vejë (kryesisht gra nga të cilat pjesa më e madhe (33) jetojnë në komuna rurale), 58 (7.3%) janë të pamartuar, ndërsa 17 (2.1%) janë të divorcuar (pjesa më e madhe nga ato, ose 13 janë në komuna urbane).

Analiza lidhur me **madhësinë e amvisërive** tregon se nga gjithsej 800 amvisëri të anketuara, 280 (35%) janë deri më 3 anëtarë, ndërsa 221 ose 27.6% janë amvisëri katër anëtarëshe. I madh është edhe numri i amvisërive me më tepër se katër anëtarë. Me 5-7 anëtarë janë 258 (32.2%) të amvisërive, ndërsa 38 (4.7%) me 8 ose më tepër anëtarë. Pjesa më e madhe e amvisërive me 5 dhe më tepër anëtarë janë të koncentruara në komunat rurale Likovë dhe Studenica, ku dominon popullata shqiptare (Tabela 2).

Tabela 2. Numri i anëtarëve në amvisëri nëpër komuna

Komuna	Numri i anëtarëve në amvisëri:															Refuzon të përgjigjet	Gjithsej	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	13	14	15				
Radovish	Count	1	25	2	35	11	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	100
	% of Total	0,1%	3,1%	2,8%	4,4%	1,4%	0,6%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,1%	12,5%
Negotinë	Count	3	16	2	31	20	6	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	100
	% of Total	0,4%	2,0%	2,8%	3,9%	2,5%	0,8%	0,0%	0,1%	0,0%	0,1%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	12,5%
Berovë	Count	16	25	1	31	8	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	100
	% of Total	2,0%	3,1%	2,4%	3,9%	1,0%	0,1%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	12,5%
Pehçevë	Count	4	17	2	35	13	7	2	0	0	0	0	0	0	0	0	2	100
	% of Total	0,5%	2,1%	2,5%	4,4%	1,6%	0,9%	0,3%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,3%	12,5%
Konçe	Count	6	17	1	33	17	12	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	100
	% of Total	0,8%	2,1%	1,9%	4,1%	2,1%	1,5%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	12,5%
Likovë	Count	2	0	6	10	28	18	11	12	6	4	1	1	0	1	0	0	100
	% of Total	0,3%	0,0%	0,8%	1,3%	3,5%	2,3%	1,4%	1,5%	0,8%	0,5%	0,1%	0,1%	0,0%	0,1%	0,0%	0,0%	12,5%
Studenica	Count	1	3	2	13	35	24	11	8	1	0	1	0	1	0	0	0	100
	% of Total	0,1%	0,4%	0,3%	1,6%	4,4%	3,0%	1,4%	1,0%	0,1%	0,0%	0,1%	0,0%	0,1%	0,0%	0,0%	0,0%	12,5%
Çashkë	Count	6	1	15	33	17	12	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	100
	% of Total	0,8%	2,1%	1,9%	4,1%	2,1%	1,5%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	12,5%
	Count	39	120	121	221	149	85	24	21	7	5	2	1	1	1	3	0	800
	% of Total	4,9%	15,0%	15,1%	27,6%	18,6%	10,6%	3,0%	2,6%	0,9%	0,6%	0,3%	0,1%	0,1%	0,1%	0,4%	0,0%	100,0%

Struktura e amvisërive sipas numrit të anëtarëve, tregon praktikën ende ekzistuese të bashkjetesës së më shumë gjeneratave në një amvisëri të përbashkët dhe të natalitetit ende të lartë, në veçanti tek amvisëritë shqiptare.

Në pajtim me **statusin arsimor** të kokës në amvisëri, prej 800 amvisërive, në 780 (97.5%) koka e familjes është e arsimuar, gjegjësisht di të shkruaj dhe të lexojë, ndërsa vetëm në 10 amvisëri (1.3%) koka e familjes është analfabete (10 ose 1.3% nga personat e anketuar nuk janë shprehur sa i takon shkrim-leximit të kokës në amvisëri). Fakt i cili duhet të theksohet është se shumica e kokave në amvisëri - 297 (37.1%) janë vetëm me arsim fillor, ndërsa 69 (8.6%) janë pa arsim ose me arsim fillor të pambaruar. Pjesa më e madhe e atyre që kanë kryer arsimin fillor janë të koncentruar në komunat rurale Konçe dhe Çashkë, por gjithashtu edhe në Berovë – kryesisht mes të anketuarve nga grupi etnik rom (Tabela 3).

Tabela 3. Arsimi formal i kokës në amvisëri nëpër komuna

Komuna	Shkalla e arsimit formal të kokës në amvisëri:										Gjithsej
	Pa arsim	Arsim fillor i pambaruar	Arsim fillor	Arsim i mesëm teknik	Gjimna	Arsim i lartë	Arsim universitar (diplomë)	Nivel pasuniversitar (Doktorat, specializim)	Nuk e di		
Radovish	Count	0	11	32	34	8	7	7	0	1	100
	% of Total	,0%	1,4%	4,0%	4,3%	1,0%	,9%	,9%	,0%	,1%	12,5%
Negotinë	Count	1	4	14	43	25	8	5	0	0	100
	% of Total	,1%	,5%	1,8%	5,4%	3,1%	1,0%	,6%	,0%	,0%	12,5%
Berovë	Count	0	12	34	29	10	3	11	0	1	100
	% of Total	,0%	1,5%	4,3%	3,6%	1,3%	,4%	1,4%	,0%	,1%	12,5%
Pehçevë	Count	1	1	27	39	17	6	9	0	0	100
	% of Total	,1%	,1%	3,4%	4,9%	2,1%	,8%	1,1%	,0%	,0%	12,5%
Konçe	Count	1	14	38	39	3	3	2	0	0	100
	% of Total	,1%	1,8%	4,8%	4,9%	,4%	,4%	,3%	,0%	,0%	12,5%
Likovë	Count	0	4	62	9	13	6	4	1	1	100
	% of Total	,0%	,5%	7,8%	1,1%	1,6%	,8%	,5%	,1%	,1%	12,5%
Studenica	Count	0	5	52	18	19	4	2	0	0	100
	% of Total	,0%	,6%	6,5%	2,3%	2,4%	,5%	,3%	,0%	,0%	12,5%
Çashkë	Count	1	14	38	39	3	3	2	0	0	100
	% of Total	,1%	1,8%	4,8%	4,9%	,4%	,4%	,3%	,0%	,0%	12,5%
	Count	4	65	297	250	98	40	42	1	3	800
	% of Total	,5%	8,1%	37,1%	31,3%	12,3%	5,0%	5,3%	,1%	,4%	100,0%

Nga aspekti i **profesionit** të kokës në amvisëri, pjesa më e madhe e amvisërive të anketuara janë me kokë amvisërie e cila është punëtore (277 ose 34.5%), pastaj pensioner (134 ose 16.8%) dhe bujk<sup>10</sup> (105 ose 13.1%).

Sa i takon **llojit të amvisërisë**, nga 800 amvisëri të anketuara, pjesa më e madhe, gjegjësisht 340 (42.5%) janë jobujqësore, 266 (33.3%) janë të përziera, ndërsa 149 (18.6%) janë amvisëri bujqësore (45 amvisëri nuk e kanë shprehur përcaktimin sa i takon kësaj pyetje, ose 3.8%).

### 4.3. Sfida hulumtuese

Skuadra hulumtuese gjatë hulumtimit u ballafaqua me disa sfida:

- Në pjesën e *hulumtimit kualitativ* pa vështirësi u zbatuan intervistat ekspertuese me më tepër komuna dhe qendra për punë sociale dhe u organizuan fokus grupe. Megjithatë, në kontaktet me qendrat për punësim u ballafaquan me pagatishmëri për bashkëpunim dhe rezistencë në sigurimin e qasjes deri në të dhënat për papunësinë dhe karakteristikat e saj në komunat e synuara. Kjo vështirësi u tejkalua në atë mënyrë që të dhënat u siguruan nga Agjencia për punësim në Shkup e cila disponon me bazë qendrore të të dhënave për të gjitha komunat (numri dhe karakteristikat e personave të papunësuar dhe profesionet deficitare në komunë).
- Në pjesën e *hulumtimit kuantitativ* ndjeshmëria e një pjese të pyetjeve lidhur me jetën private të amvisërive, rezultoi në një rezistencë të caktuar tek kokat e anketuara në amvisëri që ti japin informatat e kërkuara. Megjithatë, pjesëmarrja procentuale e përgjigjeve nga kategorija “rrefuzon të përgjigjet” është statistikisht e parëndësishme dhe prej këtu nuk e pengon gjeneralizimin e të dhënave të fituara nga hulumtimi.
- Në hulumtim nuk kishte mundësi që të sigurohet barazpesha e nevojshme gjinore nga aspekti i përfaqësimit të femrave në fokus grupet dhe si koka nga amvisëritë e anketuara, para së gjithash për shkak të traditës në Republikën e Maqedonisë që koka e amvisërisë të jetë mashkull.

---

<sup>10</sup> Bujku është punëtor i cili merret me agrikulturë. Ai/ajo është kokë e amvisërisë bujqësore.

## II. REZULTATE NGA HULUMTIMI



# KOMUNA E BEROVËS

## **1. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHËSHME TË KOMUNËS SË BEROVËS**

Komuna e Berovës gjendet në një lartësi mesatare mbidetare prej 800m dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 579 km<sup>2</sup>. Konfiguracioni gjeografik i terrenit është kryesisht kodrino-malor, ndërsa terrene të rrafshta ka vetëm rreth shtratit të lumit Bregallnicë. Malet e Maleshevës janë të vendosura në mes të komunës. Komuna përfshin një qytet dhe tetë fshatra, të cilat janë përcaktuar për të qenë si bashkësi lokale. Vendbanimet në komunë janë të llojit të dendur me largësi prej 3 deri më 15 km nga qendra komunale, përveç fshatit Dvorishte i cili gjendet në afërsi të kufirit mes Maqedonisë dhe Bullgarisë dhe është 21 km larg Berovës.

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë më vitin 2002, në komunë ka gjithsej 13.941 banorë. Numri i banorëve vazhdimisht është rritur nga viti 1921 deri më 1991, ndërsa pastaj fillon të bie me një shkallë mesatare vjetore prej 0.4%. Në krahasim me regjistrimin paraprak të vitit 1994, numri i banorëve është zvogluar për 238 persona, gjegjësisht 1.7%. Vetëm në qytetin e Berovës, në periudhën mes regjistrimeve, numri i banorëve është rritur për 250 persona (3.6%), gjë e cila më së shumti ka të bëjë me migrimin fshat-qytet. Në të gjitha vendbanimet tjera vërehet ulje e numrit, ku rënia më e madhe vërehet në Vlladimirovo, 22.5%. Me 23.4 banorë në një kilometër, komuna numërohet mes komunave me dendësi të ulët në Maqedoni. Nga numri i përgjithshëm i banorëve 50.4% janë meshkuj, ndërsa 49.6% janë femra. Sa i takon strukturës etnike të popullsisë, 13.335 (95.65%) janë deklaruar si maqedonas, 459 (3.29%) si rom, 91 (0.65) si turq dhe të tjerë. Gjysma e popullatës jeton në vendbanime urbane, ndërsa gjysma në vendbanime rurale. Vjetërsia mesatare e popullatës është 36.3 vjeç. Struktura moshore e popullatës tregon tendencën e plakjes së popullsisë në komunë. Sipas të dhënave nga regjistrimi i vitit 2002, 3553 (23.6%) e banorëve janë në moshë prej 0-19 vjeç, 8405 (55.2%) janë në moshë prej 20 deri më 65 vjeç, ndërsa 1978 (19.2%) janë në moshë mbi 65 vjeçare.

Komuna disponon me resurse të pasura natyrore. Në veçanti ceket potenciali malor dhe liqenor. Më të përfaqësuara janë malet dushkore dhe ahore. Sipërfaqja e përgjithshme pjellore është 68.226 ha, prej të cilave tokë bujqësore është 57%, ndërsa pyllore 43%. Nga toka bujqësore përpunohet 67%, nga të cilat 21% janë ara dhe kopshte, 2.2% pemishte dhe 9.5% livadhe.

Për zhvillimin e komunës në veçanti janë të rëndësishme lëndët e para minerale dhe xehet. Në komunë funksionon minierë për qymyr, e cila është në eksploatim. Ende nuk janë mjaft të hulumtuara potencialet e komunës për kristalet silice. E njëjta vlen edhe për argjilin i cili është i mirë për prodhimin e keramikës dhe materialeve rezistuese ndaj zjarrit. Më tej, kuarci i cili përdoret për krijimin e materialeve rezistuese ndaj zjarrit, qymyri, hekuri dhe forma të tjera xehesh, të cilat janë parcialisht aktive, ndërsa në pjesën më të madhe janë ende vetëm resurse atraktive potenciale për hulumtim dhe eksploatim të mëtutjeshëm. Potencialet për zhvillim kryesisht shihen në zhvillimin e turizmit, industrisë së vogël, të lehtë dhe jo-ndotëse dhe shfrytëzimin e planifikuar të resurseve pyllore.

## **2. KAPACITETE INSTITUCIONALE**

**Arsim:** Në komunën e Berovës ka dy shkolla qendrore për arsim fillor dhe atë në qytetin e Berovës dhe fshatin Rusinovo. Shkolla fillore në Berovë ka degë në shtatë bashkësi lokale. Në qytetin e Berovës ka një shkollë për arsim të mesëm, dhe atë gjimnaz dhe me arsim teknik, si dhe ka klasa të shpërndara në Pehçevë. Shkolla të posaçme nuk ka. Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm tregon tendencë të uljes së tyre.

**Shëndetësi:** Mbrojtja primare shëndetësore në komunën e Berovës sigurohet në shtëpinë shëndetësore të vendosur në qytetin e Berovës dhe në 8 ordianca private me mjekë amë të medicinës së përgjithshme. Aktive janë pesë ordianca stomatologjike, të cilat janë privatizuar me reformat për privatizim të veprimit stomatologjik. Në territorin e komunës së Berovës ka tre barnatore private. Nuk ka ordiancë private gjinekologjike. Në moment ka punkt të mjekut specialist në komunën fqinje. Në fshatrat më të mëdhenj (Rusinovo dhe Dvorishte) ka organizata shëndetësore në të cilat sigurohen shërbimet bazike shëndetësore. Ato me vendim janë shpallur si vende rurale dhe ka dy mjekë të medicinës së përgjithshme. Ka shërbim për ndihmë të shpejtë, mirëpo i njëjti nuk disponon me veturë të përshtatshme. Shërbimi ka një veturë të thjeshtë e cila është në gjendje të mirë. Në territorin e komunës së Berovës ka protetike stomatologjike, labaratori speciale, specialistë për oftalmologji, medicinë interne dhe radiologji. Sa i takon shëndetësisë primare, ka medicinë të shpërndarë shkollore dhe stomatologji preventive. Në komunën e Berovës nuk ka poliklinikë as klinikë speciale, ndërsa banorët në rast të nevojës drejtohen në Koçan, Shtip ose Shkup.

**Institucione sociale:** Për edukim dhe arsim parashkollor kujdeset institucioni publik komunal për fëmijë, Kopshti fëmënor “23 avgust”. Në kopshtin fëmënor të Berovës qëndrojnë 180 fëmijë dhe së bashku me klonet<sup>11</sup> në tri fshatra më të mëdhenj përfshihen gjithsej 248 fëmijë. Kopsht fëmënor privat nuk ka. Në komunën e Berovës nuk ka shtëpi për persona të moshuar, as publike as private.

**Institucione kulturore:** Shtëpia e kulturës “Dimitar Berovski” është institucioni i vetëm nga sfera e jetës kulturore në komunën e Berovës. Në suazat e shtëpisë funksionon një bibliotekë, muze dhe kinemaja e qytetit, e cila në periudhën e fundit është jashtë funksionimit.

**Objekte sportive:** Në komunën e Berovës ka dy salla sportive, tre terrene sportive në qytetin e Berovës dhe shtatë në të gjitha fshatrat në territorin e komunës së Berovës.

**Media:** Në komunën e Berovës ka një radio lokale private, një televizion lokal privat i cili transmeton vetëm program zbavitës dhe një gazetë e cila botohet në formë elektronike.

**Shoqata qytetare:** Në komunën e Berovës janë regjistruar 60-80 shoqata të qytetarëve, mirëpo aktive janë vetëm dhjetë nga to.

**Subjekte afariste:** Në territorin e komunës së Berovës më e zhvilluar është industria tekstile, e cila punëson numrin më të madh të banorëve në komunë. Në secilin sektor janë regjistruar rreth 5-6 firma të cilat

---

<sup>11</sup> Në sistemin parashkollor maqedonas, klonet janë degë regjionale të kopshteve fëmënore qendrore

punësojnë 450-500 njerëz. Nga të njëjshmet 4-5 kapacitete të mëdhaja të cilat punësonin mbi 1200 njerëz, vetëm dy me sukses e përfunduan procesin e privatizimit, përderisa të tjerët shkuan në falimentim ose likuidim.

### 3. PROBLEME DOMINUESE NË KOMUNË

**Probleme sociale:** Probleme dominuese sociale në komunë janë varfëria dhe papunësia. Shkalla e papunësisë është 41.5%, ndërsa pjesa më e madhe e popullsisë punon në industri (43.1%); sektori i shërbimeve është gjithashtu shumë i rëndësishëm, i cili përfshin 36.7% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve; ndërsa pastaj vjen bujqësia, si sektori i tretë në të cilin angazhohen 20% nga të punësuarit. Shumica e personave të punësuar janë në qytet, për shkak të pozicionimit të kapaciteteve të industrisë dhe institucioneve publike. Shkalla e papunësisë në Berovë është 31.9%. Nga gjithsej 2681 persona të papunësuar, 1114 (41.6%) janë femra. Papunësia e popullatës së re në moshë prej 15-24 vjeç është 67.3%. Regjioni lindor i të cilit komuna vshtë pjesë është me shkallë më të ulët të papunësisë tek popullata e re në krahasim me regjionet e tjera në Republikën e Maqedonisë. Tjetër karakteristikë e papunësisë është papunësia afatgjate. Pjesa më e madhe e personave të papunësuar janë punëtorë të pakualifikuar (41.4%), me arsim të mesëm teknik janë 26.9% ndërsa pjesa më e vogël (9.7%) janë persona me arsim të lartë dhe universitar. Analiza e shkallës së papunësisë sipas grupeve moshore tregon shpërndarje relativisht të barabartë, gjegjësisht në moshë prej 20-29 vjeç të papunësuar janë 575 (21.4%), në moshë prej 30-39 vjeç janë 644 (24%), në moshë prej 40-49 vjeç të papunësuar janë 617 (23%), në moshë prej 50-59 vjeç të papunësuar janë 599 persona (22.3%) nga numri i përgjithshëm i të punësuarve. Në moshë mbi 60 vjeç të papunësuar janë 193 persona, ose 7.2% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve. Në Berovë ekonomia e zezë nuk është shumë e përfaqësuar.

Në Qendrën për punësim në Berovë, si institucion përgjegjës për ndërmarrjen e masave për ulje të papunësisë ka nëntë persona të punësuar, nga të cilët pesë me arsim universitar: avokat, ekonomist, psikolog, sociolog dhe arsim teknik. Qendra realizon aktivitete dhe programe për vetëpunësim, program për përkrahje për formalizim të bizneseve ekzistuese, punësim të subvencionuar (prindër të vetëm, çifte bashkëshortore me tre dhe më tepër fëmijë, persona të cilët kanë mbetur pa punë për shkak të falimentimit, likudimit ose si tepricë teknologjike, persona më të moshuar se 55 vjeç dhe persona të rinj deri më 27 vjeç). Qendra për punësim në vitin 2009 ka realizuar edukime për fillimin e biznesit dhe krijimin e biznes planeve, trajnim për përforsim ekonomik të grave viktime të dhunës familjare, si dhe anketë për aftësitë dhe dijenitë e nevojshme për tregun e punës në komunën e Berovës. Në vitin 2010, në komunën e Berovës nuk janë angazhuar shfrytëzues të ndihmës sociale në para për të kryer punë publike, edhe pse në vitet paraprake janë realizuar aktivitete të tilla.

Sipas vlerësimeve të Qendrës lokale për punësim, si kategori më e rrezikuar e qytetarve në aspekt të punësimit, janë personat të cilët kanë kryer arsim universitar. Të njëjtit pajtohen dhe shprehin interes për tu punësuar edhe në vende pune për të cilat është paraparë shkallë më e ulët e arsimit dhe për punë të cilat paguhet më pak. Sa u takon shfrytëzuesve të shërbimeve nga mbrojtja sociale duhet të shqyrtohen

mundësitë për stimulimin e punësimit të tyre përmes masave ligjore për kushte të volitshme dhe përkrahje të drejtëpërdrejtë (pagimi i kontributeve për një periudhë më të gjatë kohore).

Kërkesa për fuqi punëtore është e vogël dhe nuk mund të kontribuojë në uljen e madhe të papunësisë. Në përgjithësi janë prezente të gjitha profesionet dhe kuadrot për të cilat punëdhënësit kanë shfaqur nevojë. Megjithatë, është e papërshtatshme struktura moshore (për shkak të prezencës më të madhe të fuqisë punëtore më të moshuar), si dhe struktura gjinore (më i madh është numri i meshkujve të papunësuar, ndërsa kërkesa për fuqi punëtore femrore është më e madhe).

Në një masë më të vogël janë prezente edhe probleme të tjera sociale, siqë është alkoolizmi dhe dhuna familjare. Në kohën e fundit, paraqitet edhe problemi me shfrytëzimin e drogave nga ana e personave të mitur.

Si grup socialisht më i rrezikuar në komunë dallohet popullsia e përkatësisë etnike rome. Në periudhën e fundit keqësohet gjendja e popullsisë rome, dallohet problemi i getoizimit dhe lëvizjes në grupe. Popullsia më e rrezikuar sipas kategorisë së problemit është popullsia e varfër, ndërsa sipas kufirit moshor popullsia mbi 50 vjeç.

**Probleme infratsukurale:** Infrastruktura në komunën e Berovës është në një gjendje të volitshme. Në 95% të komunës ka rrjet ujësjellës me gypa pjesërisht të ndryshuar, ndërsa në pjesën tjetër me ujë furnizohen përmes puseve dhe hidroforeve. Është ndërtuar stacion i ri për pastrimin e ujit të pishëm dhe stacion për pastrimin e ujërave fekale me mjete prej 11 milion euro, të sigurara përmes donacionit zviceran. Rrjet kanalizues ka në qytet dhe një pjesë të fshatrave. Lidhshmëria transportuese në përgjithësi është e mirë dhe ka rrugë të asfaltuara deri tek të gjitha vendbanimet. Megjithatë, kualiteti i asfaltit është në gjendje të keqe, ndërsa brenda fshatrave ka rrugë të paasfaltuara tokësore.

**Probleme ekologjike:** Në komunën e Berovës nuk ka probleme më të mëdha ekologjike dhe si më të rëndësishme përmenden deponia e paurbanizuar dhe probleme të ndërlidhura me zjarret.

#### 4. MBROJTJA SOCIALE NË KOMUNË

**Administrata komunale:** Në suazat e administratës komunale nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale, ndërsa kompetencat realizohen nga ana e Njësisë për zhvillim lokal, bashkëpunim ndërkombëtar dhe punë publike. Nga numri i përgjithshëm i personave të punësuar në administratën publike, 29 kanë statusin e nëpunësve shtetëror. Nuk ka punonjës social të punësuar. Komuna nuk ka përgatitur plan veprues ose strategji për zhvillim social. Këshilli i komunës së Berovës miratoi Rregullore për birësimin e të pashtëpive dhe parashikoi mjete nga buxheti komunal për këtë kategori të qytetarëve. Bashkëpunimi me qytetarët më së shpeshti zhvillohet përmes forumeve, mirëpo deri tani nuk ka pasur iniciativa qytetare, tubime të qytetarëve, as po referendum lokal. Si formë e ndihmës për popullsinë socialisht të rrezikuar, komuna jep ndihmë të njehershme në para, për dhënien e të cilës vendosin këshilli dhe kryetari i komunës. Buxheti i kryetarit për dhënien e mjeteve në bazë të kërkesës, nën të cilën bien edhe kërkesat për ndihmë është 300.000 mkd, ndërsa për një vendim/rast mund të jepen maksimum 50.000 denarë.

Rrjetin e shërbimeve sociale në komunë e përbëjnë qendra për punë sociale, qendra ditore për persona me nevoja të posaçme, shtëpia e vogël grupore dhe kuzhina popullore.

**Qendra për punë sociale:** Qendra për punë sociale është kompetente për të vepruar në territorin e dy komunave, Berovë dhe Pehçevë. Numri i të punësuarve në qendër është 29, nga të cilët shtatë punonjës social, tre pedagogë, dy psikologë, dy avokatë, dy defektologë, një socialog, një mësues, dy ekonomistë, tre motra medicinale dhe personel ndihmës. Kapacitetet e zyrave dhe ato teknike të qendrës nuk janë në një nivel të kënaqshëm. Qendra disponon me dy vetura të cilat nuk janë në gjendje të mirë. Në Berovë, qendra ka në disponim shtatë zyra dhe 17 kompjuterë.

Qendra për punë sociale bashkëpunon me sektorin joqeveritar, para së gjithash në realizimin e projektit për familjet strehuese; me komunën në aspekt të funksionimit të kuzhinës popullore dhe angazhimit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para për zbatimin e punëve publike; me shkollën kur bëhet fjalë për fëmijët në rrezik; si dhe me institucionet shëndetësore kur shfaqet nevoja. Në suazat e fokus grupeve u theksua se në kryerjen e punëve publike angazhohen selektivisht shfrytëzues të ndihmës sociale në para: *"Kur jepen para anagazhohen persona të cilët janë të ndonjë partie të caktuar, ndërsa kur duhet të punohet pa para atëherë angazhohemi vetëm ne romët"*.

Si probleme më të rëndësishme për funksionimin e Qendrës për punë sociale dallohen problemet me veturat dhe mungesa e benzinës, si dhe probleme në koordinimin e skuadrave. Problemi më i madh për punë është rregullimi i marrëdhënieve prindër-fëmijë, dhuna familjare dhe dhuna seksuale ndaj fëmijëve.

**Numri dhe struktura e shfrytëzuesve të masave dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale:** Analiza e strukturës së shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale në territorin e komunës së Berovës tregon se 182 amvisëri janë shfrytëzues të ndihmës sociale në para, 25 familje shfrytëzojnë ndihmë të përhershme në para, 344 persona paraqiten si shfrytëzues të ndihmës dhe kujdesit nga personi i huaj. Në vitin e fundit rreth 20 persona janë regjistruar si shfrytëzues të ndihmës së njëhershme në para. E drejta e realizimit të ndihmës në para nga mbrojtja sociale më së shpeshti nuk realizohet si rezultat i posedimit të tokës bujqësore. Nga format e mbrojtjes jo-institucionale në territorin e komunës së Berovës, funksionon Qendra ditore për personat me pengesa në zhvillim, e cila tërësisht financohet nga Ministria për punë dhe politikë sociale. Komuna siguron zyrat, ndërsa qendra menaxhohet nga OJQ Poraka. Në Berovë është hapur shtëpia e parë grupore e vogël, në të cilën janë vendosur pesë fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror. Për ta kujdesen tre edukatore. Në Berovë gjithashtu funksionon kuzhina popullore përmes angazhimit të përbashkët të MPPS, Qendrës për punë sociale dhe komunës. Institucionalisht janë strehuar 14 persona, nga të cilët dy në Shtëpinë për fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror "11 Oktomvri" Shkup, nëntë në SOS Detsko sello në Shkup, dy në Banja BANSKO dhe një në Demir Kapi. Në rrjetin e shërbimeve publike nga mbrojtja sociale mungojnë familje strehuese dhe qendra për persona të moshuar.

## 5. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS ME AKTORËT LOKAL

Komuna ka bashkëpunim të mirë me BNJVL<sup>12</sup>, mirëpo ai nuk ka të bëjë me çështje nga sfera sociale. Në periudhën e fundit zvoglohet intensiteti i këtij bashkëpunimi dhe kryesisht është bashkëpunim protokolar.

Bashkëpunimi i komunës me Agjencinë për punësim realizohet përmes krijimit të Planit veprues lokal për punësim në Berovë dhe Pehçevë 2009-2011, si dhe gjatë angazhimit të shfrytëzuesve në zbatimin e punëve publike.

Komuna me shoqatat qytetare më së shpeshti bashkëpunon përmes konsultimeve, konsultimit të detyrueshëm gjatë planifikimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, si dhe gjatë kofinancimit të disa projekteve të catuara të OJQve.

Bashkëpunimi me sektorin privat nuk është mjaft i zhvilluar, mirëpo theksohet se është duke u përforcuar përgjegjësia sociale e firmave private. Disa prej tyre kanë dhuruar mjete për hapjen e Qendrës ditore për persona me nevoja të posaçme.

Bashkëpunimi në nivel qendror dhe lokal zhvillohet përmes projekteve të përbashkëta, siqë janë kuzhina popullore dhe funksionimi i qendrës ditore.

Në komunë është krijuar në baza vullnetare grup lokal qytetarë, në të cilin marrin pjesë të gjithë aktorët relevant në nivel lokal, si dhe pjesëmarrës nga bashkësia fetare krishtere dhe islame, me qëllim që të parandalohen problemet sociale.

## **6. REZULTATE NGA HULUMTIMI ANKETUES I AMVISËRIVE NË KOMUNËN E BEROVËS**

### **6.1. Të dhëna të përgjithshme për amvisëritë e anketuara**

Në komunën e Berovës u anketuan gjithsej 100 amvisëri nga të cilat 50 në mjedise urbane dhe 50 në mjedise rurale. Struktura e amvisërive të anketuara sipas llojit të amvisërisë tregon se numri më i madh janë jobujqësore (58%), pastaj bujqësore (25%) dhe të përziera (17%). Shpërndarja e amvisërive sipas strukturës etnike tregon se 84 amvisëri janë deklaruar si maqedonase, ndërsa 16 amvisëri janë deklaruar si rome. Në 80 amvisëri koka e familjes është mashkull, ndërsa në 20 femër. Në shumicën e rasteve të amvisërive një anëtarëshe të anketuara (62.5%), koka e amvisërisë është femër. Në një numër më të vogël të rasteve gruaja paraqitet si kokë e amvisërive dy anëtarëshe (28%) dhe amvisërive tre anëtarëshe (10.5%).

Grafiku 1.

Grafiku 2.

---

<sup>12</sup> Bashkësia e njësisve të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë



Nacionaliteti i kokës në amvisëri


Maqedonas/e  
Rom/e

Numri i anëtarëve të amvisërisë sipas gjinisë së kokës në amvisëri  
meshkuj  
femra

Gati në të gjithë amvisëritë me numër më të madh të anëtarëve, si kokë e amvisërisë përcaktohet mashkulli. Në shumicën e rasteve koka e amvisërisë është në bashkësi martesore (76%), në 8% prej rasteve bëhet fjalë për persona të cilët janë të pamartuar/a dhe në 16% të rasteve bëhet fjalë për të vejë. Edhe pse, 99% nga personat e anketuar janë të arsimuar, një pjesë e madhe, gjegjësisht 12% janë me rasim fillor jo të plotë, 34% janë me arsim fillor, 39% me arsim të mesëm dhe 14% janë me arsim të lartë dhe universitar. Në pjesën më të madhe të amvisërive koka e amvisërisë është pensioner (25%), pastaj punëtor (23%), bujk (21%), nëpunës (6%), ndërsa 12% nga të anketuarit kanë rrefuzuar që të përgjigjen në këtë pyetje. Si shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale janë deklaruar 42 të anketuar, ku për tu cekur është ajo se tek të gjitha 42 amvisëritë nuk ka asnjë të punësuar. Sipas llojit të amvisërive, ka shpërndarje relativisht të barabartë të shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, ku amvisërive të llojit bujqësore u takojnë 21% dhe jobujqësore 19% nga amvisëritë.

Grafiku 3.

Grafiku 4.



Lloji i amvisërisë

Statusi martesor i kokës së amvisërisë

Bujqësore

i/e pamartuar

Jobujqësire

i/e martuar

E përzier

i/e vejë

### 6.2. Punësim

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të anketuara, në 59% nuk ka asnjë të punësuar. Nga të cilat 76.3% amvisëri janë maqedonase, ndërsa 23.7% janë rome. Brengosëse është shkalla e lartë e papunësisë mes personave të anketuar të grupit etnik rom, të cilët në 87.5% të rasteve kanë deklaruar se nuk kanë asnjë të punësuar në amvisëri. Në 25 amvisëri janë evidentuar nga një i punësuar, në 16 amvisëri janë evidentuar dy persona të punësuar, nga të cilët pjesa më e madhe janë të përkatësisë etnike maqedonase.

### 6.3. Standardi jetësor

Analiza e zbatuar mbi të dhënat e fituara tregon se 58 amvisëri nuk kanë realizuar kurrëfar të ardhura nga marrëdhëniet e rregullta të punës në 12 muajt e fundit. Edhe këtu vërtetohet e njejta tendencë, gjegjësisht pjesa më e madhe e familjeve rome të anketuara (87.5%), jetojnë pa të ardhura personale. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 30% tregojnë se në amvisëri janë realizuar të ardhura nga pensioni, ndërsa 40% nga të anketuarit kanë realizuar të ardhura nga bujqësia. Duhet të theksohet se asnjë amvisëri rome nuk ka realizuar të ardhura nga pensionet ose bujqësia. Vetëm 2% nga të anketuarit kanë marrë të ardhura nga prona (qira ose shitje). Vetëm pesë nga personat e anketuar, të gjithë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, kanë theksuar se kanë marrë ndihmë financiare nga ndonjë familjar më i afërt. Shkallë më e lartë e solidaritetit evidentohet në suazat e bashkësisë rome, ku kjo dukuri është prezente në 18.8% nga rastet. Të ardhurat e llojeve të tjera kanë kontribut jo shumë të rëndësishëm në buxhetin e përgjithshëm të amvisërive.

Grafiku 5.



Të ardhurat e realizuara në 12 muajt e fundit

Po  
Jo

Marrëdhënie të çrregullta pune

Pensione

Bujqësi

Qira/shitje e pronës

Ndihmë nga familjarë

Pjesa më e madhe e amvisërive (33%), në muajin e fundit kanë realizuar të ardhura prej 5000 mkd, ku pjesa më e madhe e tyre janë amvisëri shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, ndërsa 21.2% nuk janë shfrytëzuese. Shuma e njejtë e të ardhurave paraqitet në numrin e përgjithshëm të shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, gjegjësisht nga 42 shfrytëzues të ndihmës sociale, 26 kanë theksuar se në muajin paraprak kanë realizuar të ardhura prej 5000 mkd. Në 28% prej amvisërive shuma mujore e të ardhurave është prej 5001 deri më 10.000 mkd, ku si grup më i përfaqësuar i cili realizon të ardhura në këtë shumë, janë amvisëritë të cilat nuk shfrytëzojnë asnjë lloj të ndihmës në para nga mbrojtja sociale (71.4%). Vetëm tetë përqind nga të anketuarit realizojnë mbi 23.000 mkd.

Grafiku 6.



Shuma e të ardhurave të realizuara në amvisëri në muajin e fundit

deri më 5.000 mkd

mbi 30.001 mkd


Rrefuzon të përgjigjet

Është e rëndësishme të përmendet se 54.8% të shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, kanë realizuar të ardhura nga bujqësia. Një e treta e të anketuarve të cilët nuk janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale nuk kanë realizuar të ardhura nga bujqësia.

Sa i takon pyetjes për konsumimin e ushqimit të ngrohtë me mish, dominante janë amvisëritë në të cilat gatuhet dy herë në javë (33%), pastaj janë amvisëritë në të cilat përgatitet ushqim i ngrohtë me mish një herë në javë (22%), ndërsa tek 11% nga rastet gatuhet me tepër herë gjatë javës. Është e rëndësishme të përmendet përqindja e lartë e amvisërive (215) në të cilat nuk konsumohet ushqim i ngrohtë me mish aspak brenda javës. Në këtë kategori të amvisërive bien 62.5% nga amvisëritë e anketuara rrome. Në suazat e kategorisë së shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, 33.3% nga të anketuarit nuk përgatisin ushqim të ngrohtë me mish aspak gjatë javës, 26.2% konsumojnë dy herë në javë, ndërsa 21.4% një herë në javë. Në 19% të rasteve përgatitet më tepër se dy herë në javë. Nga personat të cilët kanë deklaruar se anjëherë gjatë javës nuk konsumojnë ushqim të ngrohtë me mish dallohen pensionerët, si grup më dominant (28.6%), pastaj amvisëritë punëtore (14.3%) dhe ato bujqësore (9.5%). Në amvisëritë në të cilat koka e amvisërisë është nëpunës, ushqim i ngrohtë me mish në shumicën e rasteve (50%) konsumohet dy herë në javë, ndërsa në 33.3% nga rastet konsumohet shtatë herë gjatë javës.

Grafiku 7.

### Консумирање на топол оброк според занимање на глава на домаќинството



Консумим i ushqimit të ngrohtë sipas profesionit të kokës në amvisëri

Gjashtë herë

Katër herë

Dy herë

Asnjëherë

Bujk

Afarist

Tjetër/i papunësuar

Punëtor

Profesion i lirë

Nuk e di

Nëpunës

Pensioner

Rrefuzon të përgjigjet


Udhëheqës

Amvis/e

Shpërndarja e përgjigjeve sa u takon gjinive të kokave në amvisëri tregon tendencë të ngjajshme, ku numri më i madh i amvisërive në të cilat koka është mashkull konsumohet ushqim i ngrohtë dy herë në javë (35%), ndërsa tek amvisëritë tek të cilat femra është koka e amvisërisë, ushqim i ngrohtë konsumohet në 25% të rasteve. Vërehet një përqindje e lartë e amvisërive (25%) në të cilat gruaja është kokë e amvisërisë, ndërsa ku asnjëherë në javë nuk përgatitet ushqim i ngrohtë me mish.

Numri më i madh i të anketuarve (81) kanë çekur se para u munojnë më së shumti për mbulimin e shpenzimeve të regjisë (banim, ujë, rrymë, karburantë), ushqim dhe pije joalkoolike (68) dhe veshje dhe këpucë (58). Në një numër më të vogël të rasteve, të anketuarit kanë theksuar se u mungojnë para për orendi shtëpiake dhe mobilje (35), komunikime (23), ndërsa një numër i njejtë i të anketuarve (24) tregojnë se ju mungojnë para për përmbushjen e nevojave higjienike dhe shëndetësore, si dhe nevoja reaktive dhe kulturore. Vetëm nëntë të anketuar janë shprehur se ju mungojnë para për arsim. Analiza e përgjigjeve nga ana e shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale tregon tendencë të njejtë. Gjegjësisht, 90.5% prej tyre kanë thënë se ju mungojnë para për shpenzime të regjisë, 83.3% për ushqim dhe pije joalkoolike, ndërsa 4.8% kanë thënë se ju mungojnë para për blerjen e pijeve alkoolike dhe duhanit. Numri i njejtë i të anketuarve rom (15), kanë deklaruar se ju mungojnë para për blerjen e ushqimit dhe mbulimin e shpenzimeve të regjisë. Për dallim të tyre, tek të anketuarit maqedonas më i madh është numri i atyre që ju mungojnë para për shpenzime të regjisë (66), për dallim të anketuarve të të cilët thonë se ju mungojnë para për ushqim dhe pije joalkoolike (53).

Grafiku 8.




Frekuenca e përgjigjeve të dhëna lidhur me mungesën e mjeteve financiare

- Ushqim dhe pije joalkoolike
- Pije alkoolike dhe duhan
- Veshje dhe këpucë

Shpenzime të regjisë  
 Orendi shtëpiake dhe mobilje  
 Higjienë dhe shëndetësi  
 Transport  
 Komunikim  
 Rekreim dhe kulturë  
 Arsim

Pjesa më e madhe e të anketuarve jetojnë në banesë dy dhomëshe (50%), një pjesë më e vogël në tre dhomëshe (29%), 12 % në banesë një dhomëshe dhe vetëm 8% në katër dhomëshe. Analiza e kushteve banuese krahasuar me numrin e anëtarëve të amvisërisë, tregon se numri më i madh i amvisërive një anëtarëshe jetojnë në banesa dy dhomëshe dhe tre dhomëshe. Brengos fakti që 12.5% nga amvisëritë pesë anëtarëshe jetojnë në banesë një dhomëshe dhe 100% nga të anketuarat amvisëri gjashtë anëtarëshe jetojnë në banesë dy dhomëshe.

Grafiku 9.



Grafiku 10.



9. Numri i anëtarëve në amvisëri krahasuar me madhësinë e banimit

- Një dhomë
- Dy dhoma
- Tre dhoma
- Katër dhoma

10. Numri i dhomave të cilat ngrohen në amvisëri

- Një
- Dy
- Tre
- Katër

Sa i takon mënyrës se si amvisëritë e ngrohin banesë është evidentuar një përqindje e madhe e shfrytëzimit të koftorit me karburantë të ngurtë, dru (92), ndërsa një numër i vogël e ngrohin shtëpinë me nxemje me avull (3), me koftor me rrymë (3) dhe me karburantë të lëngshëm (2). Të dhënat për atë se sa është numri i dhomave të cilat ngrohen, tregojn se kapaciteti i jetesës zvoglohet gjatë periudhës dimrore. Gjegjesisht, numri më i madh i amvisërive, 49%, ngrohin vetëm një dhomë në shtëpi, 40% dy dhoma, ndërsa tre dhe më tepër dhoma 11%.

Pjesa më e madhe e amvisërive (98) janë të kyçur në rrjetin kanalizues. Tendenca e njejtë vërehet edhe tek shfrytëzuesit e ndihmës në para nga mbrojtja sociale, gjegjesisht vetëm dy amvisëri kanë gropë septike. Tek 76 amvisëri në shtëpi ka tualet me banjo, tualet në oborr kanë 37 amvisëri, ndërsa tualet në banesë kanë 20 amvisëri. Rezultatet tregojnë se një pjesë e madhe e amvisërive janë të kyçura në rrjetin ujësjellës, gjegjesisht çeshme në banesë kanë 94 amvisëri.

Grafiku 11.



Numri i amvisërive të cilat nuk kanë nevojë ose nuk mund të blejnë aparat për amvisëri

- Shporet elektrik
- Furrë
- Ngrohës uji
- Frigorifer
- Frigorifer ngrirës
- Makinë për larje të teshave
- Makinë për larje të enëve
- Thithëse pluhuri
- Klimë
- Televizor

Kompjuter  
Telefon  
Celularë  
Automobil  
Traktor

Nuk ka nevojë  
Nuk mund ta blejë

Është evidentuar se 18 amvisëri nuk kanë ngrohës uji me korrent, nga të cilat gjashtë janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Një pjesë e familjeve të anketuara kanë mungesë të aparateve bazike për amvisëri siqë është shporeti elektrik (13), frigoriferi (4) dhe frigoriferi-ngrirës (13). Më tepër se gjysma e amvisërive (64) nuk kanë kompjuter, nga të cilat 46 nuk mund të blejnë, ndërsa 18 nuk kanë nevojë. Një pjesë e madhe e shfrytëzuesve (42.6%) nuk mund të blejnë kompjuter. Automobil nuk kanë 61 amvisëri, nga të cilat 37 nuk mund të blejnë; ndërsa traktor nuk kanë 66 amvisëri, nga të cilat 20 amvisëri nuk mund të blejnë.

#### 6.4. Probleme sociale dhe mbrojtja sociale

Sa u takon problemeve lidhur me zhvillimin social, si më të përfaqësuara theksohen papunësia (74%) dhe varfëria (69%). Në 26% të rasteve, si problem relevant ceket smundja e një anëtarit të amvisërisë, ku vetëm në një rast veçohet invaliditeti si problem serioz. Problemet sociale të ndërlidhura me devijimet sociale dhe grupi i tretë i problemeve që kanë të bëjnë me proceset natyrore ekologjike, nuk llogariten për të qenë të rëndësishme nga ana e të anketuarve.

Grafiku 12.




Probleme të ndërlidhura me zhvillimin social

Papunësi  
Varfëri  
Sëmundje

Amvisëritë e anketuara tregojnë se nuk kanë shfrytëzuar asnjë formë të mbrojtjes sociale jo-institucionale dhe institucionale. Sa i takon ndihmës në para nga mbrojtja sociale, si formë më prezente paraqitet mbrojtja sociale në para, gjegjësisht 44 amvisëri në të kaluarën ose tani kanë qenë/janë shfrytëzues të ndihmës sociale në para, ndërsa vetëm në një rast bëhet fjalë për shfrytëzim të ndihmës së përhershme në para. Mes shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para 68.2% janë maqedonas, ndërsa 31.8% janë romë.

Grafiku 13.



Amvisëri të cilat ndonjëherë kanë shfrytëzuar ndihmë sociale në para sipas profesionit të kokës në amvisëri

Bujk  
Artist i lirë  
Afarist privat  
Udhëheqës  
Pensioner  
Amvis/e  
Tjetër – i papunësuar  
Rrefuzon të përgjigjet

Nuk e di

Si formë më prezente e mbrojtjes fëmimore paraqitet shtesa fëmimore, gjegjësisht 34 të anketuar kanë theksuar se kanë shfrytëzuar shtesë fëmimore, ndërsa vetëm një i anketuar ka theksuar se ka shfrytëzuar shtesë të posaçme fëmimore. Shkalla e shfrytëzuesve të shtesës fëmimore nga bashkësia etnike rome është pak më e madhe. E drejta e shtesës fëmimore realizohet në pesë amvisëri, nga të cilat katër janë maqedonase dhe një rome.

Të anketuarit tregojnë se deri tani nuk kanë marrë kurrëfar lloj ndihme nga organizatat joqeveritare, nga komuna, nga organizatat fetare dhe humanitare, ose po nga persona të tjerë juridik.

Analiza e shkaqeve për shkak të cilave nuk shfrytëzohen të drejtat e ndihmës në para nga mbrojtja sociale tregon nevojën për një analizë të posaçme tek bashkësia etnike maqedonase dhe ajo rome. Kjo për shkak të faktit që pjesa më e madhe e amvisërive rome (87.5%) realizojnë të drejtën e ndihmës në para, gjegjësisht në hulumtim janë përfshirë vetëm dy familje rome të cilat nuk shfrytëzojnë këtë lloj të ndihmës (në njërin rast kanë qenë të rrefuzuar, ndërsa në rastin tjetër kanë cekur se nuk kanë nevojë për këtë lloj ndihme). Nga kjo, relevante për analizë mbetet gjendja e amvisërive të bashkësisë etnike maqedonase, ku pjesa më e madhe e të anketuarve (42.9%) theksojnë se nuk kanë pasur nevojë për realizimin e kësaj të drejte, ndërsa 14.3% kanë qenë të rrefuzuar. Një numër i vogël i të anketuarve theksojnë se shkaqe për mos shfrytëzimin e kësaj të drejte janë joinformimi i tyre (3.6%), joposidimi i dokumentacionit të plotë (2.4%) dhe turpi nga rrethina (1.2%).

Grafiku 14.



Për cilat shkaqe nuk është shfrytëzuar e drejta e ndihmës në para nga mbrojtja sociale tek të anketuarit maqedonas

Nuk kemi nevojë

Për shkak të turpit

Kishëm dokumentacion të pakompletuar/jo në rregull

Sa i takon shfrytëzimit të drejtës nga mbrojtja fëmimore, analiza tregon gjendje të ndryshme. Bashkësia rome në një masë të madhe është rrefuzuar që ti shfrytëzojë këto të drejta nga ana e administratës (43.8%), ndërsa 25% nuk e kanë realizuar këtë të drejtë për shkak të joinformimit. Tek bashkësia etnike maqedonase shfaqet një shkallë e lartë e mospasjes nevojë për këtë të drejtë (29.8%), shkallë e lartë e rrefuzimit (21.4%), joinformimit (2.4%) dhe turpit (1.2%).

Sa i takon shfrytëzimit të formave të mbrojtjes joinstitucionale dhe institucionale, pjesa më e madhe e të anketuarve nuk kanë pasur nevojë (49%), kanë qenë të rrefuzuar (26%), jo të informuar (16%), dokumentacion jo të kompletuar (7%) dhe turp (2%). Duhet të theksohet edhe shkalla e lartë e kërkesave të rrefuzuara (43.8%) për realizimin e të drejtës për mbrojtje joinstitucionale dhe institucionale, në veçanti tek popullata rome.

### 6.5. Shëndetësi dhe të ushqyerit

Në shumicën e rasteve (88%), të anketuarit kanë theksuar se të gjithë anëtarët e familjes kanë sigurim shëndetësor, edhe pse kjo përqindje është shumë pak më e vogël tek popullata rome (81.3%). Brengos fakti që në pesë amvisëri (tre maqedonase dhe dy rome) jo të gjithë anëtarët kanë sigurim shëndetësor, ndërsa në katër amvisëri (tre maqedonase dhe një rome), të gjithë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, sigurim shëndetësor nuk ka asnjë anëtarë në amvisëri. Analiza e të dhënave tregon se numri më i madh i personave të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor janë anëtarë të familjeve bujqësore dhe punëtore.

Grafiku 15.



## Sigurimi shëndetësor i shfrytëzuesve sipas përkatësisë etnike

Rom/e

Maqedonas/e

Po – të gjithë kanë sigurim

Asnjë nuk ka sigurim

Pjesërisht – jo të gjithë kanë sigurim


Nuk e di

Nga numri i përgjithshëm, pjesa më e madhe (85%) në rast të sëmundjes shfrytëzojnë shërbime shëndetësore publike (shërbime nga institucionet shëndetësore publike dhe blejnë barna nga lista pozitive). Një numër i vogël i të anketuarve (5%), anëtarë të amvisërive ku koka e familjes është punëtor (3%) dhe nëpunës (2%), blejnë barna të cilat nuk janë në listën pozitive. Vetëm 3% nga amvisëritë mjekohen në mjek privat, nga të cilat 2% janë amvisëri bujqësore. Të gjitha amvisëritë të cilat shfrytëzojnë shërbime të mjekëve privat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. E rëndësishme është që të theksohet se 4% nga të anketuarit nuk vizitojnë mjek dhe shfrytëzojnë mënyra alternative të mjekimit. Shpërndarja e përgjigjeve sipas përkatësisë etnike tregon se 12.5% nga romët, për dallim të 2.4% nga maqedonasit shfrytëzojnë mënyra alternative të mjekimit. Në suazat e kësaj kategorie të personave të cilat nuk shfrytëzojnë shërbimet e mejkut por mjekohen në kushte shtëpiake, 50% janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Numri më i madh i të anketuarve (66%) janë të larguar jo më shumë se 15 minuta ecje në këmbë nga shtëpia më e afërt shëndetësore, 30% e të anketuarve kanë nevojë për 15-30 minuta, ndërsa vetëm një amvisëri e nacionalitetit maqedonas ka nevojë për më tepër se 30 minuta që të arrij deri tek shtëpia më e afërt shëndetësore.

### 6.6. Arsim

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të përfshira në hulumtim, 42 amvisëri kanë fëmijë të cilët janë gjashtë dhe më tepër vjeç, gjegjësisht fëmijë të cilët janë të përfshirë në procesin arsimor. Prej tyre 34 amvisëri janë me përkatësi etnike maqedonase, ndërsa tetë me përkatësi etnike rome. Në suazat e amvisërive me përkatësi etnike maqedonase, 11 amvisëri kanë një fëmijë me arsim fillor, shtatë amvisëri kanë dy fëmijë të cilët ndjekin arsim fillor; nëntë amvisëri kanë një fëmijë në shkollë të mesme, dy amvisëri kanë dy fëmijë në shkollë të mesme; 10 amvisëri kanë një fëmijë në fakultet, ndërsa katër amvisëri kanë dy fëmijë të kyçur në arsimin e lartë.

Grafiku 16.



Amvisëritë fëmijët e të cilave janë të përfshirë në procesin arsimor

Arsim universitar  
 Arsim i mesëm  
 Arsim fillor

Një fëmijë  
 Dy fëmijë  
 Tre fëmijë

Në suazat e amvisërive të përkatësisë etnike rome, tre amvisëri kanë një fëmijë në arsim fillor, katër amvisëri kanë dy fëmijë dhe një ka tre fëmijë të cilët ndjekin arsim fillor. Dy amvisëri kanë një fëmijë në arsim të mesëm, ndërsa vetëm një amvisëri rome ka dy fëmijë në fakultet. Në asnjërën nga amvisëritë e anketuara nuk është evidentuar ndonjë fëmijë i cili është në moshë shkollore dhe nuk është përfshirë në proceset e rregullta arsimore. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të cilat kanë fëmijë në moshë shkollore, 22 amvisëri marrin ndihmë në para nga mbrojtja sociale. Prej tyre 17 amvisëri kanë fëmijë në arsimin fillor, gjashtë amvisëri kanë fëmijë në arsimin e mesëm, ndërsa pesë amvisëri kanë fëmijë në fakultet. Shpërndarja e përgjigjeve sipas profesionit të kokës në amvisëri tregon se fëmijë të përfshirë në procesin arsimor kanë 57.1% nga amvisëritë bujqësore, 52.2% nga amvisëritë punëtore, 66.7% nga amvisëritë ku koka e familjes është nëpunës, gjegjësisht person menaxhues.

Në shumicën e rasteve, amvisëritë me fëmijë të cilët ndjekin arsim fillor jetojnë në një largësi më të vogël se 1km (73.1%) nga shkolla fillore, ndërsa në një numër më të vogël janë familjet të cilat janë të larguara 1-2 km (11.5%) ose 2-3km (11.5%). Vetëm në rastin e një familje bujqësore distanca është më e madhe se 4 km. Pjesa më e madhe e amvisërive të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale jetojnë në afërsi të shkollës fillore (70.6%), 17.6% janë të larguar 1-2km, ndërsa në dy raste kemi amvisëri të cilat janë të larguara më tepër se 2km dhe më tepër se 4km.

Analiza e të dhënave tregon se të gjithë fëmijët e kyçur në arsimin fillor dhe të mesëm rregullisht e ndjekin shkollën dhe mësimin.

Amvisëritë me fëmijë të cilët ndjekin arsim fillor dhe të mesëm nuk kanë shfrytëzuar kurrëfar forma të ndihmës për arsim, përveç transportit falas, dhe atë pesë amvisëri për fëmijë të shkollës fillore dhe tre amvisëri për fëmijë të shkollës së mesme. Shpërndarja e përgjigjeve tregon se tre amvisëri shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale e kanë shfrytëzuar të drejtën e transportit falas për arsim fillor, një për arsim të mesëm. Sa u takon amvisërive në të cilat ka anëtarë të cilët janë studentë në institucionet për arsim të lartë, si formë e ndihmës ceken bursat (dy amvisëri) dhe kreditë (tre amvisëri). Asnjë amvisëri, shfrytëzuese e ndihmës nga mbrojtja sociale, nuk ka shfrytëzuar bursë, ndërsa vetëm një amvisëri ka anëtarë i cili shfrytëzon kredi si formë ndihme për arsim të lartë. Të gjitha amvisëritë të cilat i shfrytëzojnë format e ndihmës për arsim janë të përkatësisë etnike maqedonase.

### 6.7. Sport, argëtim, kulturë

Të anketuarit nga komuna e Berovës kanë theksuar se në shumicën e vendbanimeve ka lokale, kafebare dhe markete. Gjysma e të anketuarve kanë thënë se në vendbanimin e tyre ka sallë kinemaje, bibliotekë, terren sportiv, shesh lojërash, restorant, internet kafene dhe bastore sportive. Pjesa më e madhe e të anketuarve (72 amvisëri), kanë theksuar se asnjë anëtarë i amvisërisë së tyre nuk shfrytëzon internet. Në 25% të rasteve ku shfrytëzohet internet, të anketuarit kanë shfrytëzuar kompjuter shtëpiak, ndërsa vetëm në një rast kanë shfrytëzuar internet nga internet kafeneja.

## 7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 7.1. Përfundime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	GJENDJA/PROBLEMET
<b>1. Veprime dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Bujqësi</li> <li><input type="checkbox"/> Blegtori</li> <li><input type="checkbox"/> Industri tekstile</li> <li><input type="checkbox"/> Turizëm</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> 2 SHF</li> <li><input type="checkbox"/> 7 shkolla rajonale</li> <li><input type="checkbox"/> Një shkollë e mesme (gjimnaz dhe arsim profesional)</li> </ul>
	<i>Shëndetësi:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Shtëpi shëndetësore</li> <li><input type="checkbox"/> 8 ordianca të mjekësisë së përgjithshme</li> <li><input type="checkbox"/> 5 ordianca stomatologjike</li> <li><input type="checkbox"/> Ordinancë gjinekologjike nuk ka</li> <li><input type="checkbox"/> Ambulanca në fshatra</li> <li><input type="checkbox"/> Tre barnatore</li> </ul>
	<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Qendër për punë sociale</li> <li><input type="checkbox"/> Qendër ditore për persona me nevoja të posaçme</li> </ul>

<i>Kulturë/ Sport/ Argëtim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Një kopsht fëminor me degë në tre fshatra</li> <li>□ Nuk ka shtëpi për persona të moshuar</li> <li>□ Një kuzhinë popullore</li> <li>□ Shtëpi e vogël grupore</li> <li>□ Shtëpi e kulturës</li> <li>□ Kinema e cila është jashtë funksionimit</li> <li>□ Bibliotekë</li> <li>□ Muze</li> <li>□ Teatër nuk ka</li> <li>□ Televizion lokal, radio dhe gazetë në formë elektronike</li> <li>□ Dy salla sportive dhe dhjetë terrene sportive</li> </ul>
<i>Subjekte ekonomike:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Industri tekstile e cila punëson numrin më të madh të banorëve në komunë. Në këtë sektor janë regjistruar 5-6 firma të cilat punësojnë 400-500 njerëz.</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Më të theksuara: papunësia dhe varfëria</li> <li>□ Shkalla e papunësisë është 31.9%</li> <li>□ Papunësia e popullatës së re në moshë prej 15-24 vjeç është 67.3%</li> <li>□ Pjesa më e madhe e personave të papunësuar janë të pakualifikuar (41.4%)</li> <li>□ Papunësia afatgjate, gjegjësisht nga numri i përgjithshëm i personave të papunësuar, 31.5% presin që të punësohen për tetë dhe më tepër vite.</li> <li>□ Shkalla e papunësisë sipas intervaleve moshore tregon një shpërndarje relativisht të barabartë</li> <li>□ Alkoolizëm dhe dhunë familjare</li> <li>□ Shfrytëzimi i drogës nga personat e mitur</li> <li>□ Persona të varfër</li> <li>□ Persona të moshuar</li> <li>□ Rom</li> </ul>
<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li><i>Rrugë:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rrugë të asfaltuara deri tek të gjitha vendbanimet</li> <li>□ Kualiteti i asfaltit është në gjendje të keqe</li> <li>□ Rrugë të paasfaltuara/tokësore në fshatra</li> </ul> </li> <li><i>Ujësjellës:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rrjet ujësjellë në 95% të komunës</li> <li>□ Është ndërtuar një stacion pastrues i ujit të pishëm dhe një stacion pastrues për ujërat e zeza në lumin Bregallnica</li> </ul> </li> <li><i>Kanalizim:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rrjet kanalizues ka në qytet dhe një pjesë të fshatrave</li> <li>□ Një pjesë e vendbanimeve nuk janë përfshirë me stacionin kryesor pastrues</li> </ul> </li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Problem me deponinë e paurbanizuar</li> <li>□ Probleme lidhur me zjarre</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Bashkëpunimi i komunës me të gjitha aktorët relevant vlerësohet si relativisht i mirë, përveç me sektori privat i cili vlerësohet si dobët i</li> </ul>

<b>ndërinstitucio nal në komunë</b>	zhvilluar
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<p><i>Nga komuna:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale, ndërsa kompetencat realizohen nga ana e Njësisë për zhvillim lokal, bashkëpunim ndërkombëtar dhe punë publike</li> <li>□ Nuk ka punonjës social të punësuar</li> <li>□ Nuk ka plan veprues ose strategji për zhvillim social</li> <li>□ Është përgatitur Plan për veprim lokal për punësim në Berovë dhe Pehçevë 2009-2011</li> <li>□ Është përgatitur Rregullore për strehimin e të pastrehëve</li> <li>□ Shuma maksimale e ndihmës së njëhershme në para është 50.000 denarë, ndërsa në buxhet janë paraparë 300.000 denarë</li> </ul> <p><i>Nga QPS:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Shfrytëzues të NSP: 182 amvisëri</li> <li>□ Shfrytëzues të NPP: 25 familje</li> <li>□ Shfrytëzues të KNH: 344 persona</li> <li>□ Shfrytëzues të NNJP: 20 persona</li> <li>□ Mbrojtje jashtë institucionale: 15 shfrytëzues të Qendrës ditore për persona me nevoja të posaçme; 5 shfrytëzues në shtëpinë e vogël grupore; kuzhina popullore në Berovë</li> <li>□ Mbrojtje institucionale: 14 shfrytëzues (2 - 11 Oktomvri; 9 – SOS Detsko sello; 2 – Banja Bansko; 1 – Demir Kapi)</li> </ul>

## 7.2. Rekomandime

<b>SFERA</b>	<b>Sfera më e ngushtë</b>	<b>REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E PROBLEMEVE DHE PËRMIRËSIMIN E GJENDJEVE</b>
<b>1. Veprime dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Potencialet për zhvillim kryesisht shihen në zhvillimin e turizmit, industrinë ushqimore të vogël, lehtë dhe jondotëse, si dhe shfrytëzim të planifikuar të resurseve malore. Ekzistojnë mundësi për shfrytëzimin e pasurive natyrore me të cilat komunë është e pasur (argjili kaolin, kuarci, qymyri, hekuri dhe xehe të tjera).</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i kushteve për zhvillimin e mësimdhënies në ndërtesat shkollore</li> <li>□ Ndërtimi i objekteve energjetikisht efikase në sektorin publik</li> </ul>
	<i>Shëndetësi:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i kushteve për funksionimin e ndihmës së shpejtë</li> <li>□ Hapja e ambulancave në të gjitha fshatrat</li> </ul>
	<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të pasurohet rrjeti i institucioneve sociale në komunë</li> <li>□ Të përmirësohen mundësitë teknike për funksionimin e Qendrës për punë sociale</li> <li>□ Të analizohen nevojat për hapjen e qendrave për strehim ditor të kategorive të ndryshme të shfrytëzuesve</li> </ul>

<i>Kulturë/Sport /Argëtim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të hapen qendra dhe shtëpi për persona të moshuar</li> <li>□ Kinemaja të bëhet funksionale</li> <li>□ Të promovohet zhvillimi i sektorit joqeveritar</li> <li>□ Të ndërtohet teatër</li> <li>□ Të promovohet zhvillimi i mediave në komunë</li> </ul>
<i>Subjekte ekonomike:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të stimulohet zhvillimi i kapaciteteve më të mëdha ekonomike të cilat do të mund të absorbojnë fuqi më të madhe punëtore</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të promovohen programe për punësimin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale</li> <li>□ Të shqyrtohen mundësitë për stimulimin e punësimit të shfrytëzuesve të shërbimeve nga mbrojtja sociale përmes masave ligjore për kushte të volitshme dhe ndihmë të drejtëpërdrejtë (pagesa e kontributeve për një periudhë më të gjatë kohore)</li> <li>□ Të përmirësohet shënjestra e masave aktive kah të papunësuarit në një afat më të gjatë dhe efikasiteti i tyre në aspekt të punësimit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale</li> <li>□ Të realizohen programe për parandalimin e dukurisë së dhunës familjare, si dhe shfrytëzimit të drogës</li> <li>□ Të përforcohet puna profesionale dhe këshillëdhënëse me amvisëritë të cilat janë të prekura nga këto kategori të problemeve</li> <li>□ Të pasurohet rrejtja e shërbimeve sociale për personat e moshuar: të analizohen mundësitë për hapjen e shërbimeve sociale për ndihmë në kushte shtëpiake, qendra ditore</li> <li>□ Të shqyrtohet mundësia për zhvillimin e formës së familjeve strehuese</li> <li>□ Të shqyrtohen mundësitë për krijimin e shërbimeve për ndihmë në kushte shtëpiake</li> </ul>
<i>Grupet e popullatës socialisht të prekshme:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të pasurohet rrejtja e shërbimeve sociale për personat e moshuar: të analizohen mundësitë për hapjen e shërbimeve sociale për ndihmë në kushte shtëpiake, qendra ditore</li> <li>□ Të shqyrtohet mundësia për zhvillimin e formës së familjeve strehuese</li> <li>□ Të shqyrtohen mundësitë për krijimin e shërbimeve për ndihmë në kushte shtëpiake</li> </ul>
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të përmirësohet infrastruktura rrugore lokale (asfaltimi i rrugëve lokale)</li> </ul>
<i>Ujësjellës: Kanalimizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ /</li> <li>□ Të vendoset kanalizim në të gjitha vendbanimet</li> <li>□ Të ndërtohet kolektor dhe stacione pastruese në vendbanimet të cilat nuk janë të përfshira me stacionin kryesor pastrues</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të gjendet zgjidhje për trajtim të organizuar të mbeturinave të forta me çfarë do të zgjidhet problemi me deponitë ilegale</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërinstitucional në komunë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës së Berovës me komunat fqinje</li> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit mes komunës, QPS dhe Qendrës për punësim, përmes intenzivimit dhe zbatimit më efikas të punëve publike, masave aktive për punësim të shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale, anëtarësimit në organe të përbashkëta, edukim për mundësitë dhe format e bashkëpunimit të tyre në sferën e mbrojtjes</li> </ul>

	<p>sociale, si dhe zbatim praktik i projekteve të përbashkëta</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës me sektorin privat dhe organizatat fetare përmes përfshirjes së tyre si partnerë në realizimin e programeve nga sfera e mbrojtjes sociale</li> </ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<p><i>Nga komuna:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Punësimi i një punonjësi social në komunë</li> <li>□ Edukim i të punësuarve të njësisë për mundësitë dhe format e zhvillimit të funksioneve socialo-mbrojtëse të komunës</li> <li>□ Edukim për planifikim strategjik dhe krijim të programeve nga sfera e mbrojtjes sociale</li> <li>□ Zgjerim i formave të mbrojtjes sociale të cilat i realizon komuna (kryesisht ndihmë financiare) me forma të reja të shërbimeve sociale</li> <li>□ Rritje e buxhetit i cili ndahet për mbrojtje sociale dhe planifikim më i detajuar dhe më sistematik i atyre mjeteve buxhetore</li> <li>□ Zhvillim i rrjetit të shërbimeve lokale sociale përmes bashkëpunimit privato-publik</li> <li>□ Inicim i përgjegjësisë sociale tek sektori privat</li> </ul> <p><i>Nga QPS:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Zvoglim i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para përmes intenzivimit të aktiviteteve për punësimin e tyre në bashkëpunim me Qendrën për punësim</li> <li>□ Analizë e mundësive për zgjerim të përfshirjes së amvisërive shfrytëzuese të ndihmës sociale me shërbimet e kuzhinës popullore</li> <li>□ Zvillim i rrjetit të mbrojtjes institucionale dhe joinstitucionale në komunë.</li> </ul>



# KOMUNA E LIKOVËS

## 1. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË KOMUNËS SË LIKOVËS

Komuna e Likovës bën pjesë në grupin e komunave rurale mesatarisht të vogla në Republikën e Maqedonisë. Ajo shtrihet në pjesën veriore të vendit, në një sipërfaqe prej 270 km<sup>2</sup>. Konfiguracioni gjeografik i terrenit është kryesisht luginoro-malor, ndërsa një pjesë e madhe e territorit i takon legenit të lumit Likovë, Llojan dhe Vaksincë. Në veri kufizohet me Kosovën dhe Sërbinë, në lindje me Kumanovën, në jug me Haraçinën, ndërsa në perendim me Shkupin. Komuna përfshin 22 vendbanime, ku të gjitha janë bashkësi rurale. Ato shtrihen në një lartësi mbidetare prej 365m, që është nën mesataren e shtetit. Dendësia mesatare e popullsisë është 110 banorë në 1km<sup>2</sup>. Dendësia është më e madhe në vendet rrafshinore për dallim të vendbanimeve kodrinore-malore të cilat kanë territor më të madh, mirëpo numër më të vogël të banorëve. Qendër administrative e komunës është fshati Likovë me 2644 banorë, kah i cili gravitojnë fshatrat tjerat. Vendbanimi më i madh i komunës është fshati Sllupçan me 3789 banorë.

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë më vitin 2002, në komunën e Likovës jetojnë gjithsej 27.058 banorë. Numri i banorëve vazhdimisht është rritur që nga viti 1948, kur është bërë edhe rregjistrimi i parë zyrtar i popullsisë. Sa i takon regjistrimit paraparak nga viti 1994, numri i banorëve është rritur për 2801 persona. Megjithatë, në vendbanimet malore vërehet tendencë e mërgimit, në përgjithësi në fshatrat e rrafshita të këtij vendi, mirëpo edhe në qytetet e Shkupit dhe Kumanovës. Një numër i madh i banorëve kanë emigruar në Turqi. Në komunë ka 3599 amvisëri dhe 5790 banesa. Në amvisëri mesatarisht jetojnë 6.4 anëtarë. Nga numri i përgjithshëm i banorëve, 13701 (52%) janë burra, ndërsa 13358 (48%) janë gra. Sa i takon strukturës etnike të popullsisë 26360 (96.13%) janë deklaruar si shqiptarë, 370 (1.77%) serb, 169 maqedonas (0.62%) dhe të tjerë.

Komuna disponon me resurse të pasura natyrore. Në veçanti theksohet potenciali pyllor dhe liqenor. Veprimtaria kryesore ekonomike është agrikultura, në të cilën është e angazhuar 95% nga popullata. Agrikultura praktikohet në sipërfaqe prej 22.599ha, nga të cilat 8256ha ose 36.5%, bien në tokën bujqësore, e cila parcialisht ujitet në hidrosistemin e Likovës. Livadhet kapin një sipërfaqe prej 4375ha, ndërsa malet janë të shtrira në një sipërfaqe prej 9968ha. Një nga karakteristikat kryesore të kësaj komune janë të dy liqenet artificiale, gjegjësisht liqeni i Likovës i cili përdoret për ujitje dhe paisje me ujë të pishëm për banorët e komunës së Kumanovës dhe liqeni Gllazhnjen i cili në përgjithësi përdoret për ujitje dhe peshkatari.

Për zhvillimin e komunës janë të rëndësishme minerale dhe xehet. Komuna disponon me antimon dhe arsen nga miniera e Llojane, si dhe me mermer dhe granit nga vendbanimet Matec dhe Nikushtak. Potencialet për zhvillim kryesisht shihen në zhvillimin e turizmit, shfrytëzimit të tokës pjellore (bujqësi dhe blegtori) dhe eksploatim racional të pasurive minerale.

## 2. KAPACITETE INSTITUCIONALE

**Arsim:** Arsimi fillor organizohet në gjashtë shkolla qendrore dhe shtatë rajonale nga arsimi i rregulltë, i detyrueshëm. Dy prej tyre ngrohen me nxemje qendrore me avull. Relativisht e mirë është gjendja e shkollave në vendbanimet kodrinore, ndërsa e keqe në ato malore. Është ndërtuar ndërtesë e re shkolllore në Nikushtak. Në komunën e Likovës ka një shkollë për arsim të mesëm, e cila gjendet në qendrën komunale të

Likovës. Nuk ka shkolla të mesme profesionale, e as të posaçme. Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm shënon tendenca të rritjes.

**Shëndetësi:** Shërbimet shëndetësore në territorin e komunës sigurohen përmes institucioneve shëndetësore private: 11 ordinanca private me mjekë amë nga mjekësia e përgjithshme dhe një ordinancë stomatologjike. Me vendim të qeverisë së Republikës së Maqedonisë është paraparë formimi i stacionit shëndetësor për çfarë dhe janë ndarë edhe mjete financiare. Në territorin e komunës së Likovës ka dy barnatore. Nuk ka ordinancë gjinekologjike private. Në fshatrat më të mëdha kodrinore ka ambulanca në të cilat sigurohen shërbimet bazike shëndetësore. Ambulanca mungojnë në fshatrat më të larta malor. Nuk ka shërbim për ndihmë të shpejtë. Në komunën e Likovës nuk ka poliklinikë, as klinikë speciale, ndërsa banorët në rast nevojë drejtohen në Kumanovë dhe Shkup.

**Institucione sociale:** Në komunën e Likovës nuk ka institucion për arsim dhe edukim parashkollor të fëmijëve (kopsht fëmijor). Gjithashtu nuk ka shtëpi publike e as private për persona të moshuar.

**Institucione kulturore:** Në komunën e Likovës mungojnë institucione për përmbushjen e nevojave kulturore të qytetarëve. Rrjeti i institucioneve kulturore në nivel lokal nuk është aspak i zhvilluar. Nuk ka teatër, kinema dhe muze. Një pjesë e shkollave fillore qendrore disponojnë me bibliotekë, mirëpo mungon biblioteka qendrore komunale. Kishte shtëpi të kulturës në Matec, mirëpo pas konfliktit në vitin 2001, krejtësisht është shkatërruar. Në vijim është procedura për ndërtimin e shtëpisë së re kulturore për të cilën janë ndarë mjete nga Ministria për kulturë.

**Objekte sportive:** Në komunën e Likovës ka një sallë sportive në fshatin Sllupçan dhe gjashtë terrene sportive. Ka gjashtë klube sportive, nga të cilat më aktiv është një klub futbollistik.

**Media:** Në komunën e Likovës nuk ka radio lokale, televizion lokal dhe as gazetë lokale.

**Organizata qytetare:** Në komunën e Likovës janë regjistruar dhjetë shoqata të qytetarëve, mirëpo aktive janë vetëm disa prej tyre: SHE “Natyra”, “Unioni i gruas shqiptare” – dega në Likovë, Shoqata “Baran” dhe Shoqata e gruas intelektuale shqiptare. Në përgjithësi këto merren me mbrojtjen e të drejtave njerëzore, emancipim dhe ekologji.

**Subjekte ekonomike:** Në regjistrin e subjekteve ekonomike janë regjistruar rreth 900 subjekte ekonomike me seli në territorin e komunës së Likovës, mirëpo rreth 400 janë aktive. Prej tyre, 37% janë ndërmarrje, 56% janë shoqëri tregtare dhe 7% të tjerë. Dega më të rëndësishme ekonomike të zhvilluara janë industria e mullirit, industria për prodhim të mobiljeve dhe zdruktaria. Shumica e kapaciteteve të industrisë të cilat punësojnë një numër të madh të banorëve në komunë (një pjesë nga komuna fqinje Kumanovë) janë në likuidim ose falimentim: Çik Kumanovë, Kozhara, Kombinati i duhanit- Kumanovë, koperativa bujqësore Nikushtak etj.

Në komunën e Likovës degë ekonomike tradicionale është bujqësia, për shkak se ekzistojnë kushte të shkëlqyeshme agroteknike për zhvillim, ndërsa pjesa më e madhe e territorit është sipërfaqe përpunuese, e cila ujitet nga ujërat e sistemit të Likovës. Sipas të dhënave nga Enti shtetëror statistikor i Republikës së

Maqedonisë, nga regjistrimi i bujqësisë, në komunën e Likovës ka dy ekonomi bujqësore dhe 3450 bujq individual, të cilët disponojnë me një sipërfaqe prej gjithsej 8256 ha.

### 3. PROBLEME DOMINUESË NË KOMUNË

**Probleme sociale:** Si probleme më të rëndësishme në komunë janë problemet sociale lidhur me zhvillimin social: papunësia, varfëria dhe ç'kyçja sociale. Shkalla e punësimit në territorin e komunës së Likovës është 11%. Sa u takon subjekteve ekonomike, numri më i madh i personave janë të punësuar në subjektet ekonomike me mbi 25 të punësuar, ndërsa numri më i vogël në subjektet ekonomike me 6-10 të punësuar. Një pjesë e madhe janë të punësuar në administratën publike dhe shtetërore, para së gjithash në sektorin e arsimit. Është prezente edhe ekonomia e zezë. Sipas të dhënave nga Agjencia për punësim në territorin e komunës së Likovës janë regjistruar 4702 persona të papunësuar, prej tyre 1675, gjegjësisht 35.6% janë gra. Analiza e numrit të papunësuarve sipas shkallës së arsimit tregon se pjesa më e madhe (73.8%), gjegjësisht 3742 persona janë jo të kualifikuar, ndërsa vetëm një pjesë e vogël (2.1%) janë persona me arsim të lartë dhe universitar. Edhe pse nuk ka dallim të madh në numrin e të papunësuarve sipas grupit moshor, megjithatë numri më i madh i personave të papunësuar janë në moshë prej 20-24 vjeç (798) dhe në moshë 25-29 vjeç (613 persona), që paraqet 30% nga numri i përgjithshëm i personave të papunësuar. Një e treta e personave janë të papunësuar për tetë dhe më tepër se tetë vite. Më të rrezikuar në aspekti i punësimit janë personat me shkallë më të ulët të arsimit.

Qendra për punësim, përgjegjëse për Likovën është e bazuar në Kumanovë. Në qendër janë të punësuar 27 persona, nga të cilët 18 me arsim të lartë, shtatë me arsim të mesëm dhe dy persona me arsim fillor. Nga ana e Qendrës, si institucion përgjegjës për veprim në rast papunësie, zbatohen masa aktive për uljen e papunësisë, dhe atë: subvencionim gjatë punësimit, vetëpunësim, punësim i personave invalidë dhe personave që ju takojnë disa grupeve të caktuara. Në klubet punuese organizohet trajnim për gjuhë të huaja dhe orientim profesional të personave të papunësuar. Shfrytëzues të ndihmës sociale në para për zbatimin e punëve publike në komunë janë angazhuar vetëm një herë.

Në territorin e komunës së Likovës në një masë më të vogël janë prezente edhe probleme të tjera sociale, siqë është shfrytëzimi i drogës dhe substancat e tjera psikotropike, sjellja asociale e fëmijëve.

Si grup socialisht më i rrezikuar në komunë është popullata e cila jeton në vendet e larta malore të komunës. Duke e pasur parasysh lidhshmërinë e dobët në komunikacion dhe mungesa e rrejtit të institucioneve të nevojshme për përmbushjen e nevojave bazike njerëzore, banorët e këtyre komunave janë krejtësisht të ç'kyçur nga aktivitetet kryesore shoqërore. Në komunën e Likovës paraqitet një kategori e qytetarëve të cilët nuk janë të regjistruar në librin amë të të lindurve, për shkak të cilës edhe nuk posedojnë dokumente dhe nuk janë në gjendje të shfrytëzojnë beneficionet sociale dhe beneficione të tjera. Në territorin e komunës së Likovës gjithashtu paraqitet një grup i madh i qytetarëve të cilët pas liberalizimit të vizave nga Bashkimi Evropian shkuan të kërkojnë azil tek shtetet evropiane.

**Probleme infrastrukturale:** Komuna e Likovës ballafaqohet me probleme të mëdha infrastrukturale. Një nga problemet më serioze është mungesa e ujit të pishëm kualitativ. Sistem për furnizim

me ujë gati edhe ska. Asnjë fshat nuk ka rrjet ujësjellës, ndërsa më shpesh furnizohet me ujë përmes puseve individuale dhe burimeve nga vendet kodrinoro-malore. Ky problem në veçanti u theksua nga përfaqësuesit e fokus grupeve: *“Penda është në territorin e komunës sonë, ndërsa ujësjellësi kalon rreth nesh dhe na anëshkalon...”* Disa vendbanime (por jo fshatra) brenda pesë fshatra në pjesën rrafshinore të Likovës kanë rrjete parciale të përkohshme dhe ujë me kualitet të dobët. Sistem kanalizues ka vetëm në dy fshatra, gjegjësisht pjesa më e madhe e fshatrave nuk janë të mbuluara me rrjetin kanalizues dhe shfrytëzojnë gropa septike. Për shkak të kësaj, problem i rëndësishëm janë ujërat e zeza, të cilat i ndotin ujërat nëntokësore, gjegjësisht burimet individuale (puset), tokat, oborret etj. Vendbanimet rrafshinore janë të ndërlidhura kryesisht me rrugë të asfaltuara, ndërsa arteria kryesore rrugore është relacioni Likovë-Kumanovë. Problem të madh paraqet qasja deri tek fshatrat malore, posaçërisht në periudhën e dimrit. Brenda fshatrave ka rrugë të paasfaltuara me baltë.

**Probleme ekologjike:** Si problem më i madh ekologjik në komunën e Likovës është kualiteti i ujit të pishëm. Posaçërisht, problemi me ujin e pishëm në vendet rrafshinore, për shkak se janë të ndotura me arsen, koncentrat antimoni dhe hromi, dhe metale të tjera të rënda, pastaj nga ujërat fekale etj. Ato ujëra nuk kontrollohen nga institucionet sanitare dhe shëndetësore. Në Likovë paraqitet edhe problemi me deponinë ilegale të paurbanizuar. Ndërmarrja komunale, me gjithsej dhjetë të punësuar, shërben vetëm 11 fshatra kodrinore.

#### 4. MBROJTJA SOCIALE

**Administrata komunale:** Në suazat e administratës komunale nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale dhe kompetencat realizohen nga ana e një të punësuarit në Njësinë për çështje normativo-juridike dhe publike. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në administratën publike, 19 kanë statusin e nëpunësve shtetëror. Nuk ka të punësuar punonjës social. Dokument më i rëndësishëm i përgatitur nga ana e komunës është Strategjia për zhvillim lokal 2009-2011, në të cilën zhvillimi social përcaktohet për të qenë një nga shtyllat kryesore të zhvillimit lokal. Si qëllime strategjike sociale janë: përforcimi i kapaciteteve të banorëve përmes kurseve dhe trajnimeve të ndryshme, përforcimi i kapaciteteve të OJQ-ve lokale, ndërtimi i banesave sociale dhe aktivitete për përmirësimin e mirëqenies feminare. Bashkëpunimi me qytetarët më së shpeshti zhvillohet përmes tubimeve të qytetarëve, lajmërimit përmes televizioneve lokale në komunën fqinje të Kumanovës dhe përmes qendrave informative në ndërtesën komunale. Si formë ndihme për popullatën e cila është socialisht e rrezikuar, komuna jep ndihmë të njëhershme në para, për dhënien e të cilës vendos kryetari i komunës. Buxheti i përgjithshëm i komunës është 270.000 EU (pa dotacionet e dedikuara nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ndërsa buxheti vjetor i kryetarit të komunës për dhënien e mjeteve në bazë të kërkesës, nën të cilën bien edhe kërkesat për ndihmë është 3000-4000 EU).

**Qendra për punë sociale:** Qendra për punë sociale e cila është e vendosur në Kumanovë është përgjegjëse për banorët e Likovës. Në Likovë ka vetëm një zyrë për të dhëna materiale në të cilën mund të realizohen format e ndihmës sociale në para, ndihma e përhershme në para dhe ndihma e njëhershme në para. Numri i profesionistëve të punësuar në zyrën e QPS është katër dhe atë: sociolog, jurist, pedagog dhe gjuhëtar. Zyra është adekuate mirëpo kapacitetet teknike janë të këqija. Edhe përpos asaj që ka kompjutera,

nuk ka internet. Zyra nuk ka veturë dhe në rast nevojë vetura dërgohen prej Kumanovë, mirëpo edhe ato janë në një qendje të keqe.

Zyra për të dhëna materiale në përgjithësi ka bashkëpunim të dobët me sektorin joqeveritar, organizatat fetare dhe sektorin privat. Me komunën janë të përfshira në aktivitete të përbashkëta dhe bashkëpunimi vlerësohet si i mirë. Duke pasur parasysh se zyra është kompetente për veprim administrativ kur realizohen të drejtat lidhur me paratë, ajo bashkëpunon me shkollat dhe institucionet shëndetësore. Bashkëpunimi me Qendrën lokale për punësim vlerësohet si i pamjaftueshëm, për shkak të ndashmërisë fizike.

Si **probleme më të rëndësishme** për funksionimin e zyrës janë mospasja e veturave, mungesa e mjeteve për punë, barrë e madhe e punonjësve profesional me numrin e madh të banorëve. Problemet më të mëdha në punë paraqiten si rezultat i mungesës së dokumentacionit për realizimin e ndonjë të drejte të caktuar të ndonjë kategorie të caktuar të qytetarëve, të cilët nuk janë të regjistruar në librin amë të të lindurve.

Në komunën e Likovës theksohet nevoja për hapjen e Qendrës për punë sociale ose më së paku zgjerim i kompetencave të zyrës ekzistuese për të dhëna materiale, me çfarë do të lehtësohet realizimi i të drejtave nga mbrojtja sociale. Situata e tillë e imponon nevojën që qytetarët e komunës së Likovës në rast të nevojës për realizimin e ndonjë të drejte nga mbrojtja institucionale ose jashtë institucionale, si dhe një pjesë të drejtave nga ndihma në para nga mbrojtja sociale të cilat nuk realizohen në zyrën për të dhëna materiale, të udhëtojnë në komunën fqinje të Kumanovës.

**Numri dhe struktura e shfrytëzuesve të masave dhe shërbimeve nga mbrojtja sociale:** Analiza e strukturës të shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale në territorin e komunës së Likovës tregon se 2300 amvisëri janë bartëse të drejtës së ndihmës sociale në para dhe rreth 80 familje shfrytëzojnë ndihmë të përhershme në para. Ndihma e njëhershme në para më së shpeshti miratohet për mbulimin e shpenzimeve për shërbime shëndetësore, mirëpo e njejta nuk paguhet aspak që nga muaji mars i këtij viti.<sup>13</sup> E drejta e ndihmës në para më së shpeshti nuk realizohet si rezultat i posedimit të automjetit. Gjithashtu, procedura vështirësohet për shkak të dokumentacionit të komplikuar i cili kërkohet për realizimin e ndonjë të drejte të caktuar, dhe si gjë e parë duhet të ndërmerren masa për thjeshtëzimin e formulave dhe lehtësimin e procedurës. Në këtë aspekt, nëpunësi i punësuar në zyrë cek *"Që të mund shfrytëzuesi ta realizojë të drejtën e ndihmës në para nga mbrojtja sociale, në shtatë vende duhet ta shënojë numrin e amzës..."*

Në komunën e Likovës nuk ka rrjet të zhvilluar të shërbimeve sociale. Nga format e mbrojtjes jo-institucionale, nuk ka qendër për vendosje ditore apo të përkohshme të shfrytëzuesve, familje strehuese dhe as shtëpi të vogël grupore. Nuk ka kuzhinë popullore dhe asnjë institucion për mbrojtje institucionale.

---

<sup>13</sup> E njejta gjendje u konstatua në të gjitha komunat ku u realizua hulumtimi.

## **5. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS ME AKTORËT LOKAL**

Komuna ka bashkëpunim të mirë me BNJVL. Më tepër është në formë të konsultimeve përpara miratimit të ligjeve, të cilat kanë të bëjnë me komunat dhe për ndihmë teknike.

Bashkëpunimi me pushtetin qendror rrjedh pa probleme sa i takon realizimit të projekteve të përbashkëta. Bashkëpunimi i komunës me Agjencinë për punësim në përgjithësi vlerësohet si i mirë. Nuk ka bashkëpunim të vazhdueshëm mirëpo i njëjti realizohet në bazë projektore. Gati dy vite qytetarët shfrytëzues të ndihmës sociale në para nuk angazhohen për kryerjen e punëve publike në komunë.

Komuna bashkëpunon me shoqatat qytetare më së shpeshti për koordinimin e aktiviteteve. Bashkëpunimi me organizatat fetare është joformal.

Bashkëpunimi me sektorin privat nuk është mjaft i zhvilluar, mirëpo theksohet se përforcohet përgjegjësia sociale e firmave private. Firma e cila e fitoi koncesionin për guroren, asfaltoi një pjesë të rrugëve në atë pjesë të komunës.

## **6. REZULTATE NGA HULUMTIMI ANKETUES I AMVISËRIVE NË KOMUNËN E LIKOVËS**

Në komunën e Likovës u anketuan gjithsej 100 amvisëri, popullatë rurale të gjithë të bashkësisë etnike shqiptare. Struktura e amvisërive të anketuara sipas llojit të amvisërisë tregon se numri më i madh i të anketuarve janë jobujqësore (26%), pastaj bujqësore (13%), të përziera (57%), ndërsa 4% nga të anketuarit nuk janë shprehur sa i takon llojit të amvisërisë. Sipas strukturës moshore në pjesën më të madhe të amvisërive koka e amvisërisë është në moshë mes 50-59 vjeç (46%), tek 36% të amvisërive koka e familjes është në moshë prej 40-49 vjeç, tek 14% ai/ajo është më i moshuar se 60 vjeç, ndërsa në 4% është në moshë 30 -39 vjeç. Më e madhe është përfaqësueshmëria e amvisërive pesë anëtarëshe (28%) dhe gjashtë anëtarëshe (18%). Në 92 amvisëri koka e familjes është mashkull, ndërsa në 8 është femër.

Grafiku 1.



Numri i anëtarëve në amvisëri

- Një
- Dy
- Tre
- Katër
- Pesë
- Gjashtë
- Shtatë
- Tetë
- Nëntë
- Dhjetë
- Njëmbëdhjetë
- Trembëdhjetë

Sipas numrit të anëtarëve në amvisëri, familjet ku kokë e amvisërisë është femra më së shpeshti janë tetë anëtarëshe (37.5%) dhe amvisëri pesë anëtarëshe (25%). Në shumicën e rasteve koka e amvisërisë është në bashkësi martesore (94%), në 3% të rasteve bëhet fjalë për person i cili është i/e pamartuar dhe në 3% të rasteve bëhet fjalë për person të vejë.

Grafiku 2.

Grafiku 3.



Lloji i amvisërisë

Struktura moshore e kokës në amvisëri

Bujqësore  
Jobujqësore  
E përzier  
Nuk e di

65 dhe më shumë

Edhe pse, 96% nga të anketuarit dinë shkrim-lexim, një pjesë e madhe (4%) janë me arsim jo të plotë fillor, 62% janë me arsim fillor, 22% me arsim të mesëm, vetëm 6% me arsim të lartë, 4% janë me arsim universitar dhe 1% me arsim pasuniversitar. Në pjesën më të madhe të amvisërive koka e amvisërisë është punëtor (53%), pastaj bujk (14%), teknik (5%), udhëheqës (2%), ndërsa 6% bien në profesionet e nëpunësit, afaristit privat, pensionerit dhe amvises.

Grafiku 4.




Profesioni aktual i kokës në amvisëri

- Bujk
- Punëtor
- Nëpunës
- Teknik
- Udhëheqës
- Afarist privat
- Profesion i lirë
- Pensioner
- Amvis/e
- Tjetër – i papunësuar

Si shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale janë deklaruar më tepër se gjysma e të anketuarve (51). Duhet të theksohet se tek 47 amvisëri nuk ka asnjë të punësuar, ndërsa tek 15 amvisëri është i punësuar vetëm një anëtarë. Sipas llojit të amvisërisë ka një shpërndarje relativisht të barabartë të shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, ku ne llojin e amvisërive bujqësore bien 24%, në jobujqësore bien 14%, ndërsa të përziera janë 58% nga amvisëritë.

Grafiku 5.

Grafiku 6.



Shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale sipas llojit të amvisërisë

bujqësore  
Jobujqësore  
E përzier  
Nuk e di

Shfrytëzues të ndihmës në para sipas llojit të amvisërisë


Po  
Bujqësore  
Jobujqësore  
E përzier  
Nuk e di

## 6.2. Punësim

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të anketuara, në 47% të rasteve nu ka asnjë të punësuar. Pastaj, në 31 amvisëri ka vetëm nga një anëtarë të papunësuar, nga të cilët 17 meshkuj, ndërsa 14 të gjinisë femrore, ndërsa në 23 amvisëri ka nga dy persona të papunësuar, nga të cilët 10 meshkuj dhe 13 të gjinisë femrore. Paraqiten edhe tre familje me nga tre persona të papunësuar (një i gjinisë mashkullore dhe dy të gjinisë femrore). Në 47 amvisëri evidentohet nga një i punësuar, në 16 amvisëri evidentohen nga dy persona të punësuar dhe në 12 amvisëri evidentohen nga tre të punësuar. Megjithatë, brengosin të dhënat sipas të cilave nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 95 persona janë të gjinisë mashkullore dhe vetëm 10 të gjinisë femrore.

Grafiku 7.

Grafiku 8.



Numri i personave të punësuar në amvisëri sipas gjinisë

Numri i personave të papunësuar në amvisëri sipas gjinisë

- Një
- Dy
- Tre
- Katër
- Gjashtë


- Meshkuj
- Femra

### 6.3. Standardi jetësor


Analiza e zbatuar mbi të dhënat e fituara tregon se 30 amvisëri nuk kanë realizuar kurrëfar të ardhura nga marrëdhënie të rregullta pune në 12 muajt e kaluara. Pjesa më e madhe e amvisërive të cilat kanë realizuar të ardhura nga marrëdhëniet e rregullta të punës janë familje punëtorësh (64.3%), pastaj vijnë nëpunësit, afaristët privat dhe teknikët me nga 7.1%, 4.3% amvis/e, nga 2.9% udhëheqës dhe bujk dhe nga 1.4% pensioner, profesion i lirë dhe i papunësuar. Nga gjithsej 50 amvisëri të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, 22 familje kanë realizuar të ardhura nga marrëdhënie të rregullta pune në 12 muajt e fundit. Tërheq vëmendje fakti se në komunën e Likovës paraqiten 68% amvisëri shfrytëzuese të ndihmës sociale në para të cilat kanë realizuar të ardhura nga marrëdhënie të çrregullta pune. Prej tyre, 49.2% janë familje punëtore, 20.3% bujqësore, 8.5% ku koka e amvisërisë është pensionist njejtë si edhe tek amvisëritë ku koka e amvisërisë është afarist privat, nga 5.1% nëpunës dhe amvis/e dhe nga 1.7% profesionistë dhe person i papunësuar i cili është kokë e familjes. Dy të tretat e amvisërive (68%)

shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale kanë realizuar të ardhura nga marrëdhëniet e çrregullta pune.

Grafiku 9.



Grafiku 10.



Sipas cilës baze janë realizuar të ardhurat në 12 muajt e fundit

- marrëdhënie të rregullta pune
- marrëdhënie të çrregullta pune
- pensione
- të ardhura nga jashtë
- bujqësi
- qira/shitje e pronës
- hua
- ndihmë nga familjarët

Të ardhura të realizuara nga marrëdhënie të çrregullta pune sipas profesionit të kokës në amvisëri

- bujk
- punëtorë
- nëpunës
- teknik
- afarist privat
- pensioner
- amvis/e
- i papunësuar

Është interesant të theksohet se 40% nga shfrytëzuesit e ndihmës sociale në para nga mbrojtja sociale kanë realizuar të ardhura nga veprimtaria bujqësore. Duhet gjithashtu të theksohet se nga 33 amvisëri të cilat kanë realizuar të ardhura nga jashtë, 51.5% janë amvisëri ku koka e amvisërisë është punëtor, ndërsa 12.1% janë amvisëri bujqësore. Pjesa më e madhe e amvisërive (24%) në muajin e fundit kanë realizuar të ardhura mbi 30001 mkd, nga të cilat 45% janë familje ku koka është punëtorë, nga 12.5% bien në amvisëritë e nëpunësitë, afaristit privat, amvises dhe teknikut, dhe në 4.2% koka e amvisërisë merret me profesion të lirë. Brengos fakti që 15% prej amvisërive kanë realizuar të ardhura deri më 5000 mkd, nga të cilat 73.3% janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Shpërndarja e përgjigjeve në intervalin e të ardhurave deri më 5000 denarë tregon se ka 9 amvisëri ku koka e familjes është punëtor, 5 janë bujqësore dhe një ku koka është amvis/e. Gjithashtu, në suazat e kësaj kategorie të amvisërive janë identifikuar katër amvisëri të

cilat nuk janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Dy të tretat nga shfrytëzuesit e ndihmës nga mbrojtja sociale realizojnë të ardhura nga 5001 deri më 10000 mkd, gjegjësisht 12% nga amvisëritë e anketuara bëjnë pjesë në këtë interval.

Grafiku 11.



Shuma e të ardhurave në amvisëri në muajin e fundit

Deri më 5.000 mkd

mkd

Mbi 30.001 mkd

Nuk e di

Rrefuzon të përgjigjet

Të ardhura në shumë prej 14001 deri më 18000 mkd kanë realizuar 8% nga amvisëritë, ndërsa 15% kanë realizuar të ardhura prej 18001 deri më 23000 mkd.

Grafiku 12.



Shuma e parave të cilën amvisëria e ka realizuar në muajin e fundit sipas gjinisë

Deri më 5.000 mkd  
mkd

Mbi 30.001 mkd

Nuk e di

Rrefuzon të përgjigjet

Meshkuj

Femra

Analiza e të dhënave lidhur me amvisëritë ku koka është i/e pamartuar dhe i/e vejë tregon se 33% prej tyre kanë realizuar të ardhura më të ulta se 5000 mkd.

Sa i takon pyetjes për konsumimin e ushqimit të ngrohtë me mish, dominuese janë amvisëritë në të cilat përgatitet një herë në javë (19%), pastaj vijojnë amvisëritë në të cilat përgatitet ushqim i ngrohtë me mish dy herë në javë (17%), tre herë në javë (15%) dhe katër herë në javë (15%). Pesë dhe më tepër herë në javë gatujnë 28% të amvisërive. Është e rëndësishme të theksohet se në 6% të amvisërive, nga të cilat të gjitha janë amvisëri bujqësore, nuk konsumohet ushqim i ngrohtë me mish aspak gjatë javës.

Grafiku 13.



Konsumimi i ushqimit të ngrohtë gjatë javës sipas profesionit të kokës në amvisëri

Amvis/e

Profesion i lirë

Udhëheqës

Nëpunës

Bujk

Asnjëherë

Tre herë

Gjashtë herë

Një herë

Katër herë

Çdo ditë (shtatë herë)


Dy herë

Pesë herë

Në suazat e kategorisë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale 12% nga të anketuarit theksojnë se gjatë javës asnjëherë nuk përgatisin ushqim të ngrohtë me mish, 28% konsumojnë një herë, 24% dy herë në javë dhe 10% tre herë në javë. Befason fakti që gati 26% nga shfrytëzuesit konsumojnë ushqim të ngrohtë me mish më tepër se tre herë në javë. Shpërndarja e përgjigjeve lidhur me gjinin e kokës në amvisëri tregon një tendencë të ngjajshme, ku numri më i madh i amvisërive në të cilat koka e amvisërisë

është mashkull konsumohet ushqim i ngrohtë një herë në javë (20,7%), ndërsa tek amvisëritë ku koka e amvisërisë është femër, gjegjësisht në 37,5% konsumohet tre herë në javë dhe përqindja e njëjtë është edhe për ato që konsumojnë shtatë ditë në javë.

Grafiku 14.



Frekuenca e përgjigjeve të dhëna për mungesën e parave


- Ushqim dhe pije joalkoolike
- Pije joalkoolike dhe duhan
- Veshje dhe këpucë
- Shpenzime të regjisë
- Orendi shtëpiake dhe mobilje
- Higjienë dhe shëndetësi
- Komunikacion
- Komunikim
- Rekreim dhe kulturë
- Arsim

Pjesa më e madhe e të anketuarve ka deklaruar se ju mungojnë para për mbulimin e shpenzimeve për komunikacion (69) dhe shpenzime të regjisë (64), për arsim (47), higjienë dhe shëndetësi (46), si dhe për orendi shtëpiake dhe rekreim (nga 33 për secilën). Relativisht më i vogël është numri i përgjigjeve ku theksohet mungesa e parave për ushqim dhe pije joalkoolike (27), si dhe për komunikim (15). Vetëm dy të anketuar kanë theksuar se ju mungojnë para për alkool dhe duhan. Analiza tregon se 62.5% nga të anketuarit të cilët kanë theksuar se ju mungojnë para për shpenzimet e regjisë, janë shfrytëzues të ndihmë në para nga


mbrojtja sociale. Proporcioni i njejtë është edhe në shpërndarjen e përgjigjeve sa i takon mundësisë së mjeteve për komunikacion (60.9%), higjienë dhe shëndetësi (65.2%) dhe arsim (61.7%). Pjesa më e madhe e të anketuarve (42) të cilët janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale theksojnë se ju mungojnë mjete për transport. Duhet të theksohet se gati tek 40 shfrytëzues të anketuar është cekur mundësia e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të regjisë.

Numri më i madh (99) i amvisërive jetojnë në banesa me ndërtim të fortë, ndërsa vetëm një jeton në banesë me ndërtim të dobët/montazhë. Numri më i madh i familjeve jetojnë në banesë me katër dhoma (44%) dhe më shumë (35%), në banesë me tre dhoma jetojnë (17%), ndërsa një pjesë më e vogël në dy dhoma (2%). Bëhet fjalë për amvisëri të cilat jetojnë në banesa të cilat në shumicën e rasteve (38) janë më të mëdha se 100 m2, ndërsa në 36 raste janë prej 80 deri më 100 m2

Grafiku 15.



Grafiku 16.



Madhësia e banesës

m2

Mbi

Nuk e di

Rrefuzon të përgjigjet

Numri i anëtarëve në amvisvri krahasuar me madhësinë e banesës në të cilën jetojnë

pesëmbëdhjetë


trembëdhjetë

njëmbëdhjetë  
dhjetë  
nëntë  
tetë  
shtatë  
gjashtë  
pesë  
katër  
tre  
një

dy dhoma  
tre dhoma  
katër dhoma  
banesë më e madhe  
rrefuzon të përgjigjet

Sa i takon mënyrës se si amvisëritë e ngrohin banesën është evidentuar përqindje e lartë e shfrytëzimit të kofitorëve me lëndë djegëse të ngurta, dru (90), ndërsa një numër i vogël ngrohen me nxemje me avull vetanake (6) dhe nga dy me nxemje qendrore me avull dhe me kofitor me rrymë. Të dhënat për atë se sa është numri i dhomave të cilat ngrohen, tregojnë se ka kualitet të zvogluar të jetesës gjatë periudhës së dimrit. Gjegjësisht, numri më i madh i amvisërive (41%) ngrohin vetëm një dhomë, 30% dy dhoma, ndërsa 26% të amvisërive nga tre dhe më shumë dhoma.

Grafiku 16.



Numri i dhomave të cilat ngrohen në banesë  
Një

Dy  
Tre  
Katër dhe më shumë

Pjesa më e madhe e amvisërive (99), janë të kyçura në rrjetin kanalizues. E njejta tendencë vërehet edhe tek shfrytëzuesit e ndihmës në para nga mbrojtja sociale.<sup>14</sup> I lartë është numri i amvisërive (92) të cilat në shtëpi kanë tualet me banjo, pastaj tualet në oborr kanë 23 amvisëri, ndërsa tualet në banesë kanë vetëm 4 amvisëri. Rezultatet tregojnë se një pjesë e madhe e amvisërive (95) kanë çeshme në shtëpi, ndërsa 97 amvisëri kanë çeshme edhe në oborr. Tre amvisëri nuk kanë ngrohës uji, ndërsa një pjesë e amvisërive të anketuara kanë mungesë të aparateve bazike për amvisëri, siç është frigoriferi për ngrirje të thellë (13). Kompjuter nuk kanë 38 amvisëri, nga të cilat 22 nuk mund të blejnë, ndërsa 16 nuk kanë nevojë. Një pjesë e madhe e shfrytëzuesve (72), nuk mund të blejnë klimë. Automobil nuk kanë 37 amvisëri, nga të cilat 25 nuk mund të blejnë.

Grafiku 17.



Numri i amvisërive të cilat nuk kanë nevojë ose nuk mund të blejnë aparat për amvisëri

Shporet elektrik

Furrë

Ngrohës uji

Frigorifer

Frigorifer me ngrirje të thellë

<sup>14</sup> Këto të dhëna janë rezultat i faktit se hulumtimi i anketues është zbatuar në qendrën komunale Likovë ku ka rrjet kanalizues.

Makinë për larje të teshave  
Makinë për larje të enëve  
Thithëse pluhuri  
Klimë  
Televizor  
Kompjuter  
Telefon  
Celularë

Nuk kam nevojë  
Nuk mund ta blejë  
Rrefuzon të përgjigjet

#### 6.4. Probleme sociale dhe mbrojtja sociale

Analiza e të dhënave lidhur me problemet sociale tregon se probleme më të rëndësishme janë ato të ndërlidhura me zhvillimin social edhe atë papunësia (38), varfëria (43) dhe sëmundja (40). Gjithashtu, nga të anketuarit, si probleme të rëndësishme cekën edhe marrëdhëniet problematike familjare (4), invaliditeti (14), si dhe vërehet një rast i fëmijës pa prindër dhe kujdes prindëror. Tek 38% nga të anketurit janë cekur probleme të ndërlidhura me proceset natyrore ekologjike, siç është tërmeti, 27 raste kanë përmendur vërshimet, ndërsa 13 raste kanë përmendur thatësinë si problem ekologjik natyror.

Grafiku 18.



## Probleme të ndërlidhura me zhvillimin social

Papunësia  
Varfëria  
Marrëdhëniet problematike familjare  
Feëmijë pa prindër  
Sëmundje  
Invaliditet

Pjesa më e madhe a amvisërive të anketuara janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, gjegjësisht 51 amvisëri marrin ndihmë sociale në para, ndërsa vetëm tre amvisëri janë shfrytëzuese të ndihmës së përhershme në para. Mes shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para, 43.1% janë punëtorë, 27.5% janë amvisëri bujqësore, 5.9% janë nëpunës, 2% teknik, 11.8% pensionerë dhe 7,8% amvis/e. Ka një tendencë relativisht të njëjtë sa i takon shpërndarjes së përgjigjeve sipas gjinisë së kokës në amvisëri. Në amvisëritë ku koka e amvisërisë është mashkull, 53.3% janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para, ndërsa 3.3% janë shfrytëzuese të ndihmës së përhershme në para. Në amvisëritë ku koka e familjes është femër, 25% janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para, ndërsa nuk ka amvisëri ku koka e familjes është femër dhe është shfrytëzuese e ndihmës së përhershme në para.

Grafiku 19.




Shfrytëzues të ndihmës nga mbrojtja sociale dhe fëmimore

Kujdes dhe ndihmë shtëpiake  
Ndihmë sociale në para  
Ndihmë e përhershme në para


Shtesë fëminore  
Tjetër lloj ndihme

Si formë më e përfaqësuar e mbrojtjes fëminore paraqitet shtesa fëminore, gjegjësisht 11 të anketuar kanë theksuar se kanë shfrytëzuar shtesë fëminore, ndërsa asnjë nga të anketuarit nuk ka theksuar se ka shfrytëzuar shtesë të posaçme fëminore.

Grafiku 20.



Grafiku 21.



Për cilat shkaqe amvisëria nuk ka shfrytëzuar ndihmë në para nga mbrojtja sociale

Mungesë e informatave  
ishëm të rrefuzuar  
nuk kemi nevojë

Për cilat shkaqe amvisëria nuk ka shfrytëzuar mbrojtje fëminore

Mungesë e informatave  
Ishëm të rrefuzuar  
Dokumentacion jo i plotë  
Nuk kemi nevojë  
Tjetër

Analiza tregon se 59% nga amvisëritë të cilat nuk kanë realizuar të drejtën e ndihmës në para nga mbrojtja sociale nuk kanë pasur nevojë që ta realizojnë këtë të drejtë, 35% nga amvisëritë kanë qenë të rrefuzuara, ndërsa 6% të drejtën nuk e kanë realizuar për shkak të mungesës së informatave. E njejtja tendencë vërehet edhe në aspekt të shfrytëzimit të drejtës nga mbrojtja fëminore. Gjegjësisht, përqindja e të anketuarve të cilat nuk kanë nevojë që ta shfrytëzojnë këtë të drejtë është 46%, ndërsa të rrefuzuara kanë qenë 37% nga amvisëritë. Brengos fakti që një numër relativisht i lartë i amvisërive (14%) nuk e realizojnë këtë të drejtë për shkak të mungesës së informatave. Vetëm 2% nga amvisëritë nuk e kanë realizuar të

drejtën për shkak të dokumentacionit jo të pakompletuar. Sa i takon shfrytëzimit të formave të mbrojtjes joinstitucionale dhe institucionale, pjesa më e madhe e të anketuarve nuk kanë pasur nevojë (48%), 37% kanë qenë të rrefuzuar, të joinformuar (13%) dhe 2% nuk kanë pasur dokumentacionit të plotë.

### 6.5. Shëndetësi dhe të ushqyerit

Në pjesën më të madhe të rasteve (92%), të anketuarit kanë theksuar se të gjithë anëtarët e familjes së tyre kanë sigurim shëndetësor. Brengos fakti që në 6% të amvisërive sigurim shëndetësor kanë vetëm disa anëtarë të familje, ndërsa në 2% të amvisërive askush nga anëtarët nuk ka sigurim shëndetësor. Analiza e të dhënave tregon se në një nga amvisëritë e cila nuk ka sigurim shëndetësor, koka e amvisërisë është pensioner, ndërsa te tjetra koka e amvisërisë është amvis/e. Të gjitha amvisëritë të cilat nuk kanë sigurim shëndetësor janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

Grafiku 22.



Sigurimi shëndetësor i anëtarëve në amvisëri sipas profesionit aktual të kokës në amvisëri

Amvis/e  
 Profesion i lirë  
 Udhëheqës  
 Nëpunës  
 Bujk

asnjë nuk ka sigurim      pjesërisht – jo të gjithë kanë sigurim      po- të gjithë kanë sigurim

Në 75% nga amvisëritë në të cilat gruaja është kokë e amvisërise të gjithë kanë sigurim shëndetësor. Është evidentuar vetëm një amvisëri në të cilën asnjë nuk është i siguruar, ndërsa në pesë amvisëri anëtarët janë pjesërisht të siguruara. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive pjesa më e madhe (51%) në rast të sëmundjes shfrytëzojnë shërbime shëndetësore publike (shërbime nga institucionet shëndetësore publike dhe shfrytëzojnë barna nga lista pozitive), ndërsa 45% nga amvisëritë shkojnë te mjeku publik mirëpo blejnë barna private. Një numër i vogël (2%) nga numri i përgjithshëm i të anketuarve nuk shkojnë në mjek, gjegjësisht shfrytëzojnë mënyra alternative të mjekimit. Gjithashtu, anëtarët e 2% të amvisërive mjekohen në mënyrë private.

### 6.6. Arsim

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të përfshirë në hulumtim, 89 amvisëri kanë fëmijë të cilët janë në moshë mes gjashtë dhe më tepër vjeç, gjegjësisht fëmijë të cilët janë të përfshirë në procesin arsimor. Prej tyre, 29 amvisëri kanë nga një fëmijë i cili ndjek arsimin fillor. Është e rëndësishme për tu theksuar se një amvisëri e cila ka dy fëmijë, të cilët edhe pse janë në moshë shkollore, nuk e ndjekin arsimin fillor. Gjithashtu, 12 amvisëri kanë nga dy fëmijë të cilët e ndjekin arsimin fillor, 4 amvisëri kanë nga tre fëmijë, ndërsa tre amvisëri kanë nga tre dhe më tepër fëmijë. Janë evidentuar 36 amvisëri me nga një fëmijë në arsimin fillor, ndërsa 13 amvisëri kanë dy fëmijë në arsimin e mesëm, gjashtë amvisëri kanë nga tre fëmijë në arsimin e mesëm. Duhet të theksohet se në 41 amvisëri ka fëmijë të cilët janë të regjistruar në universitet. Pjesa më e madhe e amvisërive (18) jetojnë në largësi jo më të madhe se një kilometër, 9% jetojnë në largësi prej 1,01 deri më 2km dhe 3% në largësi prej 2,01% deri më 4km. Për tu theksuar është ajo se 15% nga amvisëritë jetojnë në largësi prej më tepër se 4km.

Grafiku 23.



Numri i fëmijëve në amvisëri të përfshirë në arsim

Një Dy Tre Katër Pesë

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të cilat kanë fëmijë në moshë shkollore, 46 amvisëri marrin ndihmë në para nga mbrojtja sociale. Prej tyre, 33 amvisëri kanë fëmijë në arsimin fillor, 29 amvisëri kanë fëmijë në arsimin e mesëm, ndërsa 21 amvisëri kanë fëmijë në fakultet. Shpërndarja e përgjigjeve sa i takon profesionit të kokës në amvisëri tregon se fëmijë të përfshirë në procesin arsimor kanë 15.7% nga amvisëritë bujqësore, 52.8% nga familjet punëtore, 6.7% nga nëpunësit, nga 5.6% nga amvisëritë të teknikëve, pensionerëve dhe afaristëve, 4.5% amvise, 2.2% amvisëri ku koka është udhëheqës, si dhe një amvisëri me person me profesion të lirë.

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive fëmijët e të cilave ndjekin arsimin fillor, 14 e kanë shfrytëzuar të drejtën për transport falas dhe prej tyre, 12 amvisëri janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Tek amvisëritë, fëmijët e të cilave ndjekin arsimin e mesëm gjenden nëntë amvisëri të cilat kanë shfrytëzuar transport falas, prej tyre tetë amvisëri janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para. Forma të tjera të parapara për ndihmë arsimore nuk shfrytëzohen nga ana e amvisërive. Nga të gjitha format ndihmëse për arsim të lartë, vetëm shtatë amvisëri janë shfrytëzuese të bursës, nga të cilat pesë janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, ndërsa katër persona janë regjistruar përmes kuotës për regjistrim.

### 6.7. Sport, argëtim dhe kulturë

Të anketuarit nga komuna e Likovës kanë theksuar se në vendbanimin e tyre ka terren sportiv (89), shesh lojërash (5), kafe bar (71), bibliotekë (57)<sup>15</sup>, restorant (96) dhe nga 89 internet kafene dhe bastore sportive. Në 37 amvisëri është theksuar se asnjë anëtarë nga amvisëria nuk shfrytëzon internet. Në 53% të rasteve ku shfrytëzohet internet, të anketuarit kanë theksuar se shfrytëzojnë kompjuter shtëpiak, ndërsa vetëm në nëntë raste kanë shfrytëzuar internet nga internet kafeneja.

## 7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 7.1. Përfundime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	GJENDJA/PROBLEMI
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Veprimtaria kryesore ekonomike është bujqësia, ku është angazhuar 95% nga popullata;</li> <li>□ Industria e mullirit, industria e prodhimit të mobiljeve dhe karrikeve.</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 6 SHFQ;</li> <li>□ 7 shkolla rajonale;</li> <li>□ 1 shkollë e mesme;</li> </ul>

<sup>15</sup> Në komunë nuk ka bibliotekë qendrore, mirëpo ka biblioteka në suazat e shkollave fillore.

<i>Shëndetësi:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 11 ordinanca private me mjekë amë të mjekësisë së përgjithshme;</li> <li>□ 1 ordinancë stomatologjike;</li> <li>□ 2 barnatore;</li> <li>□ Nuk shërbim për ndihmë të shpejtë;</li> <li>□ Nuk ka ordinancë gjinekologjike;</li> <li>□ Nuk ka ambulancë në fshatrat malore.</li> </ul>
<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Njësi e shpërndarë për të dhëna materiale e Qendrës për punë sociale në Kumanovë;</li> <li>□ Rrjet i pazhvilluar i institucioneve sociale: nuk ka kopshte fëmimore, nuk ka shtëpi për persona të moshuar;</li> <li>□ Nuk ka qendër për strehim ditore ose të përkohshëm të shfrytëzuesve</li> <li>□ Nuk ka familje strehuese;</li> <li>□ Nuk ka shtëpi të vogël grupore;</li> <li>□ Nuk ka kuzhinë popullore dhe</li> <li>□ Nuk ka institucion për mbrojtje institucionale.</li> </ul>
<i>Kulturë/ Sport/ Argëtim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rrjeti i institucioneve kulturore në nivel lokal aspak nuk është i zhvilluar;</li> <li>□ Ka një sallë dhe gjashtë terrene sportive;</li> <li>□ Nuk ka media lokale;</li> <li>□ Ka dhjetë shoqata qytetare.</li> </ul>
<i>Subjekte ekonomike:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 900 subjekte ekonomike me seli në territorin e komunës së Likovës, mirëpo 400 prej tyre nuk janë aktive. Prej tyre 37% janë ndërmarrje, 56% janë shoqata tregtare dhe 7% janë të tjerë.</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Probleme dominuese janë: papunësia, varfëria dhe ç'kyçja sociale;</li> <li>□ Në Qendrën për punësim janë regjistruar 4702 persona të papunësuar, nga të cilët 35.6% janë femra;</li> <li>□ Pjesa më e madhe (73%) janë persona të pakualifikuar për punë, ndërsa vetëm një pjesë e vogël (2.1%) janë persona me arsim të lartë apo universitar;</li> <li>□ 30% nga numri i përgjithshëm i personave të papunësuar janë në moshë 20-29 vjeç;</li> <li>□ Një e treta nga personat janë të papunësuar për tetë dhe më shumë vite;</li> <li>□ Në një masë më të vogël paraqitet edhe problemi i shfrytëzimit të drogës dhe substancave të tjera psikotropike dhe sjellja asociale tek fëmijët.</li> </ul>
<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Popullata e cila jeton në vendet e larta malore të komunës;</li> <li>□ Personat e moshuar;</li> <li>□ Personat me invaliditet (për ata nuk ekzistojnë kurrëfar shërbime sociale në komunë);</li> <li>□ Persona të cilët nuk janë evidentuar në librat amë të personave të lindur;</li> <li>□ Familjet me një prind;</li> </ul>

<b>5. Probleme infrastrukture</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Vendbanimet rrafshinore kryesisht janë të lidhura me rrugë të asfaltuara;</li> <li>□ Qasje e keqe deri tek fshatrat malore, posaçërisht gjatë periudhës dimrore.</li> </ul>
	<i>Ujësjellës: Kanalizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Nuk ka sistem ujësjellës.</li> <li>□ Rrjet kanalizues ka vetëm në dy fshatra;</li> <li>□ Të tjerët shfrytëzojnë gropa septike.</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Deponi jo e urbanizuar/ilegale për mbeturina të forta;</li> <li>□ Ujëra nëntokësore të ndotura, gjegjësisht burimet nga ujërat e zeza.</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërkomunal në komunë</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Në përgjithësi ka bashkëpunim të mirë me të gjithë aktorët relevant;</li> <li>□ Nuk ka bashkëpunim të vazhdueshëm mirëpo i njejtë realizohet përmes projekteve;</li> <li>□ Bashkëpunim jo shumë i zhvilluar në sektorin privat;</li> <li>□ Bashkëpunim joformal me organizatat fetare.</li> </ul>
<b>8. Mbrojtja sociale</b>	<i>Nga komuna:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale dhe kompetencat realizohen nga ana e një të punësuarit në Njësinë për punë normativo-juridike dhe publike;</li> <li>□ Nuk ka të punësuar punonjës social;</li> <li>□ Ka Strategji për zhvillim lokal 2009-2011;</li> <li>□ Komuna jep ndihmë të njehershme në para për qytetarët të cilët kanë nevojë për të;</li> <li>□ Për realizimin e kësaj forme ndahen 1.3% nga buxheti i komunës.</li> </ul>
	<i>Nga QPS:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Shfrytëzues të NSP: 2300 amvisëri</li> <li>□ Shfrytëzues të NPP: 80</li> </ul>

## 7.2. Rekomandime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E PROBLEMEVE DHE PËRMIRËSIM TË GJENDJEVE
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		Potencialët për zhvillim kryesisht shihen në zhvillimin e turizmit, shfrytëzimin e tokës pjellore (bujqësi dhe blegtori), si dhe në shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe mineraleve me të cilat komuna është e pasur (antimon, arsen, mermer, granit).
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të zgjerohet rrjeti i shkollave fillore dhe të mesme qendrore, si dhe i atyre rajonale;</li> <li>□ Ulje e ç'kryesjes arsimore të fëmijëve në fshatrat më të larta malore përmes përmirësimit të qasjes dhe hapjes së banimit nëpër internate;</li> <li>□ Të ndërtohen laboratorit dhe salla sportive në shkollat fillore.</li> </ul>
	<i>Shëndetësi:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të zgjerohet oferta e shërbimeve shëndetësore në nivel lokal para së gjithash përmes hapjes së një numri më të madh të ordinancave specialitike dhe barnatoreve;</li> </ul>

<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Fokus i posaçëm të vendoset mbi hapjen e ambulancave në vendet malore;</li> <li>□ Të krijohet shërbim për ndihmë të shpejtë;</li> <li>□ Të hapet spital.</li> <li>□ Të zhvillohet rrejtja e institucioneve sociale në komunë;</li> <li>□ Të hapet Qendër për punë sociale ose të zgjerohen të drejtat nga mbrojtja sociale të cilat do të mund të realizohen në zyrën e cila është e hapur në qendrën komunale në Likovë;</li> <li>□ Përmirësim i mundësive teknike të zyrës duke e paisur atë me veturë, qasje në internet dhe mjete të tjera të nevojshme për punë;</li> <li>□ Të hapen qendra ditore për personat me nevoja të posaçme dhe personat e moshuar;</li> <li>□ Të hapen kopshte fëmimore (qendra ditore në vendbanimet me numër më të madh të fëmijëve);</li> <li>□ Të hapen shtëpi për persona të moshuar.</li> </ul>
<i>Kulturë/ Argëtim/ Sport:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të krijohen institucione bazike kulturore në komunë: kinema, muze, teatër dhe bibliotekë;</li> <li>□ Të promovohet zhvillimi i mediave në komunë (radion, TV stacionit dhe gazetë);</li> <li>□ Të promovohet zhvillimi i sektorit joqeveritar dhe të krijohen shoqata të reja qytetare;</li> <li>□ Të ndërtohet një numër më i madh i terreneve sportive.</li> </ul>
<i>Subjekte ekonomike:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të stimulohet zhvillimi i subjekteve më të mëdha ekonomike të cilat do të mund të absorbojnë një fuqi më të madhe punëtore.</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të promovohen programe për punësim të shfrytëzuesve të ndihmës sociale;</li> <li>□ Të përmirësohet targetimi i masave aktive drejtë të atyre të cilët janë të papunësuar për një kohë më të gjatë dhe efikasiteti lidhur me punësimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale;</li> <li>□ Të drejtohen masat për trajnim, kualifikim dhe rikualifikim drejtë profesioneve deficitare në komunë;</li> <li>□ Të realizohen programe preventive për parandalimin e dukurive të problemeve sociale të ndërlidhura me sjelljen devijante;</li> <li>□ Të përforcohet puna këshillëdhënëse profesionale për amvisëritë të prekura nga këto kategori të problemeve.</li> </ul>
<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të pasurohet rrjeti i shërbimeve sociale për personat e moshuar: të analizohen mundësitë për hapjen e shërbimeve sociale për ndihmë në kushte shtëpiake, qendra ditore, shtëpi të vogla grupore;</li> <li>□ Të hapen qendra ditore për persona me pengesa në zhvillim (fëmijë dhe të moshuar);</li> <li>□ Të shqyrtohen mundësitë për hapjen e serviseve për ndihmë në kushte shtëpiake;</li> <li>□ Të ndërmerre masa për uljen e ç'kyçjes sociale të personave nga</li> </ul>

		fshatrat malore;
		□ Të gjenden module për evidentim në librin amë të personave të lindur për shkak të realizimit të drejtave nga mbrojtja sociale.
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	□ Të përmirësohet infrastruktura rrugore lokale (asfaltimi i rrugëve lokale);
		□ Të përmirësohet qasja deri tek fshatrat malore;
		□ Të rindërtohet rruga regjionale Kumanovë - Likovë – Haraçinë.
	<i>Ujësjellës:</i>	□ Komuna të kyçet në rrjetin ujësjellës;
		□ Të gjenden mekanizma për kontrollë të rregulltë të ujit në të gjitha vendbanimet.
	<i>Kanalizim:</i>	□ Të vendoset kanalizim në të gjitha vendbanimet.
<b>6. Probleme ekologjike</b>		□ Të gjendet zgjidhje për menaxhim të organizuar të mbeturinave të forta me çka do të zgjidhet problemi i deponive të egra dhe ujërave të ndotur.
<b>7. Bashkëpunimi ndërkomunal në komunë</b>		□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës me komunitat fqinje;
		□ Përmirësim i bashkëpunimit mes komunës, QPS dhe Qendrën për punësim përmes zbatimit më intenziv dhe më efikas të punëve publike, masave aktive për punësim për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale, anëtarësimin në trupa të përbashkëta, edukim për munësitë dhe format e bashkëpunimit të tyre në sferën e mbrojtjes sociale, si dhe zbatim praktik i projekteve të përbashkëta;
		□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës me sektorin privat dhe joqeveritar përmes përfshirjes si bashkëpunëtorë në realizimin e programeve nga sfera e mbrojtjes sociale.
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<i>Nga komuna:</i>	□ Përforsim i kapaciteteve të Njësisë për punë normativo-juridike dhe publike duke punësuar një punonjës social;
		□ Edukim i të punësuarve në Njësinë për mundësitë dhe format e zhvillimit të funksioneve socialo-mbrojtëse të komunës;
		□ Edukim për planifikim strategjik dhe përpilim të programeve nga sfera e mbrojtjes sociale;
		□ Zgjerim i formave të mbrojtjes sociale të cilat i realizon komuna (kryesisht ndihmë financiare), me forma të reja të shërbimeve sociale;
		□ Rritje e përqindjes e cila nga buxheti ndahet për mbrojtje sociale dhe rritje e efikasitetit të atyre mjeteve buxhetore.
	<i>Nga QPS:</i>	□ Ulje e numrit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para përmes intenzivimit të aktiviteteve për punësimin e tyre në bashkëpunim me Qendrën për punësim;
		□ Zhvillim i rrjetit të mbrojtjes institucionale dhe jointitucionale në komunë;
		□ Shqyrtim i mundësive për lehtësim të procedurës dhe thjeshtëzim të formulareve për realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale.



# **KOMUNA E RADOVISHIT**

## 1. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË KOMUNËS SË RADOVISHIT

Komuna e Radovishit gjendet në pjesën jug-lindore të Republikës së Maqedonisë dhe e përfshin pjesën veri-perendimore të luginës së Radovishit dhe Strumicës. Me shtrirjen e saj prej 608 m<sup>2</sup>, numërohet mes komunave mesatarisht të mëdha, me dendësi të popullatës prej 41.5 banorë në 1km<sup>2</sup>. Komuna ka lidhje të mira kontaktuese dhe funksionale me komunat fqinje. Qyteti i Radovishit është qendra administrative komunale, me vendqëndrim të mirë për zhvillim të bujqësisë, i cili gjendet në lartësi mbidetare prej 380 metra. Si qendër administrative, qyteti i Radovishit i shërben edhe banorët e komunës së Konçes, për shkak se në të janë të vendosura të gjitha institucionet shtetërore të cilat veprojnë në nivel regional.

Në komunën e Radovishit ka 1 qytet, 22 fshatra dhe 27 bashkësi lokale. Numri i përgjithshëm i banorëve është 28.244, ndërsa numri i amvisërive është 7184. Nga numri i përgjithshëm i popullatës, 66.14% jetojnë në mjedis urban, ndërsa 33.86% në vendbanime rurale. Vetëm dy vendbanime kanë mbi 1000 banorë (Injevo dhe Oraovica), ndërsa në pjesën tjetër numri i banorëve është mes 300 dhe 1000 banorë. Në pesë vendbanime jetojnë më pak se 50 banorë. Trendet demografike në komunën e Radovishit kanë rezultuar në zbrazje complete të më shumë vendbanimeve fshatore: Ali Llobasi, Drzhani, Durutlia, Karallobasi, Karaxhallar, Novo Sello, Papavnica, Sarigjoll, Qoseli, Çeshe Maale, Shaintash dhe Shipkovicë.

Në komunën e Radovishit, 51.3% e popullësisë janë meshkuj, ndërsa 48.7% janë femra. Struktura e popullatës sipas përkatësisë etnike është e ardhshme: maqedonas 82%, turq 16.2%, shqiptarë 0.05%, vllleh 0.08%, romë 1% dhe 0.67% janë të tjerë. Nga aspekti i strukturës moshore, 51.06% e popullësisë është mes 0-14 vjeç, 39.7% të moshës grupore 15-64 vjeç dhe 9.24% mbi 65 vjeç. Vërehet procesi i plakjes së popullatës, përmes rënies së vogël të pjesëmarrjes së popullatës deri me 14 vjeç dhe rritja e pjesëmarrjes së popullatës së moshuar. Struktura arsimore e popullatës tregon se ka nivel të ulët arsimor në komunë. Gjegjësish, deri më 45.7% e popullatës janë me arsim fillor të pambaruar, 27.4% janë me arsim fillor të kryer, 9.8% me arsim të mesëm teknik, 11% me arsim të mesëm të kryer, 0.5% me arsim të lartë të pambaruar dhe 5.6% me arsim të lartë të mbaruar.

Komuna është e pasur me resurse natyrore: ujëra (lumenj dhe burime të ujrave termale), pyje, minerale (bakër, ar, hekur, argjend, cink), si dhe gurë dekorativ për ndërtim, kuarc dhe glinë. Veprimtari të zhvilluara në këtë komunë janë: xehetaria, industria tekstile, bujqësia (prodhimi i duhanit, vneshtaria, kopshtaria, pemtaria) dhe blegtoaria (kryesisht e koncentruar në fshatrat e turqve).

Komuna disponon me potenciale të rëndësishme për zhvillim. Është i nevojshëm investim më i madh në bujqësi dhe blegtori. Edhe pse nuk ka kombinatë më të mëdha në këto veprimtari, një pjesë e madhe e popullatës (edhe të punësuar, edhe të papunësuar) merret me këto veprimtari. Gjithashtu duhet të zhvillohet edhe turizmi malor. Në tërë komunën nuk ka asnjë hotel, vetëm një motel, Panorama. Investimi në teknologji inovative për shfrytëzimin e ujërave minerale do të ndihmojë në zhvillimin e kësaj komune.

## 2. KAPACITETE INSTITUCIONALE

**Arsim:** Në qytetin e Radovishit ka 2 shkolla fillore qendrore. Në fshatra ka 3 shkolla fillore qendrore (Injevo, Podarësh dhe Oraovica). Në 12 fshatra ka shkolla deri në klasën e katërt. Pas mbarimit të klasës së katërt, fëmijët e këtyre shkollave vazhdojnë arsimin në shkollat fillore qendrore në fshatrat në afërsi. Në qytetin e Radovishit ka 1 gjimnaz dhe fakultet të disperzuar elektroteknik të Universitetit të Shkupit. Fëmijët prej fshatrave të cilët vazhdojnë me shkollimin pas mbarimit të shkollës fillore, më së shpeshti udhëtojnë deri në qytetin e Radovishit për shkak se në fshatra nuk ka shkollë të mesme.

Komisioni për kulturë, arsim dhe sport ka përgatitur Strategji për zhvillim të arsimit në komunën e Radovishit.

**Shëndetësi:** Sa u takon fshatrave, gjendja me institucionet shëndetësore është alarmuese. Në qytetin e Radovishit ka një spital dhe 7 ambulanca, nga të cilat asnjëra nuk gjendet në fshat. Ka gjithashtu edhe 4 klinika specialistike dhe 7 barnatore, përsëri të gjitha në qytet. Nga institucionet shëndetësore private ka 15 ordinarca dhe 8 klinika specialistike.

**Institucione sociale:** Në komunë nuk ka rrejt të zhvilluar të institucioneve sociale. Ka vetëm 3 kopshte fëmimore shtetërore dhe asnjë shtëpi për persona të moshuar. Në komunën e Radovishit funksionon Qendra ndërkomunale për punë sociale nën kompetencat e të cilës bie realizimi i të drejtave nga mbrojtja sociale për qytetarët e komunës së Radovishit dhe komunës së Konçes.

**Institucione kulturore:** Në komunën e Radovishit aktive janë dy institucione nga sfera e kulturës: Qendra për kulturë "Aco Karamanov", në suazat e të cilës ka kinema dhe sallë teatri dhe biblioteka kombëtare "Braça Milladinovci". Ka edhe një muze etnologjik. Të njohura janë ansamblet folklorike Buçim dhe Aco Karamanov dhe 3 studio dramatike amatere. Në Radovish gjatë vitit organizohen disa ngjarje kulturore: Vera kulturore e Radovishit, Festivali folklorik fëmimor dhe Takime të poetëve. Mes pasurive kulturore-historike të komunës së Radovishit dhe komunës së Konçes numrohen disa kisha dhe lokalitete arkeologjike: manastir i vjetër – Damjan, Markova Kulla – Podarësh, Isar – Kale.

**Objekte sportive:** Në Radovish janë aktive 7 klube sportive për futboll, mundje, hendboll, shigjetim, çiklizëm, moto sport dhe alpinizëm. Radovishi ka edhe disa objekte sportive: salla sportive "25 maj" me kapacitet prej 1500 vende, kompleksi sportivo-reakreativ "Shampion" me bazen olimpik, stadioni futbollistik i qytetit, më tepër terrene për futboll të vogël, hendboll, voliboll dhe terren për tenis. Në komunë ka vetëm 2 terrene fëmimore të cilat janë të ruinuara.

**Media:** Në komunë aktive janë dy televizione lokale, TV Kobra dhe TV Emi; dy radio lokale: radio Alfa dhe radio Radovish; dhe 2 operatorë kabllorik. Nuk ka media të shkruara.

**Organizata qytetare:** Në komunën e Radovishit janë regjistruar 70 shoqata të qytetarëve (përfshirë edhe klube sportive dhe folklorike të cilat janë në moment aktive). Nga të tjerat të cilat në moment janë aktive janë: 4 shoqata për zhvillim lokal, 3 për persona me invaliditet, 2 shoqata ekologjike, 1 për mbrojtjen e të drejtave të grave, 1 për romët dhe një për bashkëpunim maqedono-rusë.

**Subjekte ekonomike:** Janë regjistruar gjithsej 1230 subjekte ekonomike të vogla, 15 të mesme dhe 1 e madhe, të cilat janë në funksion. Nga subjektet më të mëdha ekonomike jashtë funksionimit është Jaka Tabak AD. Në komunën e Radovishit sektore më të rëndësishme ekonomike janë: ndërtimtaria dhe industria për materiale ndërtimore; industria e drurit; industria metale, maqinerike dhe jometale; metalurgjia e zezë dhe me ngjyra; xehtaria; industria kozmetiko-farmaceutike; bujqësia; gjuetaria dhe peshkataria; turizmi; industria tekstile, ushqimore dhe e duhanit; tregtia; transporti; bankare; e shërbimeve dhe shërbimit publik. Sektori privat është i zhvilluar në degët e ardhshme ekonomike: xehtaria, hotelieria, tekstili, pylltaria, industria e mishit, tregtia e vogël dhe e madhe, mjeshtria, industria për konzervim, industria e qumshtit, industria e jometaleve, industria e duhanit, kozmetiko-farmaceutike, përpunimi i arit dhe argjendit. Veprimtaria private është dominante dhe është rreth 90% nga ekonomia e përgjithshme në komunë.

### 3. PROBLEME DOMINANTE NË KOMUNË

**Probleme sociale:** Probleme sociale dominante në komunë janë papunësia, disfunkcionaliteti i rritur në familje dhe divorcet, si dhe një rritje e devijimeve tek të rinjtë: delikuenca, alkoolizmi, narkomania dhe lojrat e fatit (bastoret sportive). Mes kategorive socialisht më të rrezikuara të populates, veçohen personat e moshuar dhe përfaqësuesit e grupit etnik turk.

Në pajtim me gjendjen e përgjithshme sa i takon punësimit në Republikën e Maqedonisë, edhe në komunën e Radovishit ky problem theksohet si më dominues. Nga popullata e përgjithshme (28.244), persona në moshë mbi 15 vjeç janë 17.956. Prej tyre ekonomikisht aktiv janë 11.071 (59.39% nga personat në moshë mbi 15 vjeç). Nga personat ekonomikisht aktiv, 8701 janë persona të cilët merren me profesionin e tyre (ose 76.46% nga popullata aktive). Pjesëmarrja e personave të cilët punojnë dhe janë në moshë mbi 15 vjeç është 45.41%.

Të punësuar janë 4861 (27% nga personat janë mbi 15 vjeç), nga të cilët 4011 në veprimtari ekonomike, 850 në veprimtari joekonomike; ndërsa të papunësuar janë 6210 (34.6% prej personave janë në moshë mbi 15 vjeç). Pjesa më e madhe e të punësuarve janë të koncentruar në industrinë tekstile, xehtarinë, ndërtimtarinë, industrinë metale dhe elektrike.

Sipas të dhënave të fundit të fituara nga Qendra për punësim në Radovish, numri i të papunësuarve deri më 31.10.2010, është 5812; nga të cilët shumica janë femra (58.12%). Sipas strukturës etnike pjesa më e madhe janë maqedonas (4699), pasatj turq (1154), romë (21), serb (11), vllleh (1), shqiptarë (1) dhe të tjerë (25). Koncentrim më të madh të papunësisë ka në grupin moshor 25 – 29 vjeç (759), nga të cilët 316 janë femra. Nga numri i përgjithshëm i të papunësuarve, shumica pret punësim për tetë dhe më tepër vite (1777, nga të cilët 486 janë femra). Profesione deficitare janë: filologë të diplomuar në gjuhën angleze, inzhinierë informatike, inzhinierë elektrik dhe maqinerik.

Qendra për punësim realizon më tepër masa aktive në bashkëpunim me UNDP-në dhe në pajtim me Planet operative të MPPS, të gjitha në drejtim të uljes së papunësisë siqë janë: trajnime për punë me kompjutera dhe gjuhë të huaja, kualifikim, rikualifikim, vetëpunësim dhe përkrahje të bizneseve të vogla, punësim të subvencionuar për persona të rinj, persona të cilëve puna ju është ndërprerë për shkak të

falimentimit ose likudimit, persona më të moshuar se 55-64 vjeç, persona me nevoja të posaçme, prindër të vetëm, çifte bashkëshortore me shumë fëmijë, viktima të dhunës familjare dhe fëmijë pa prindër. Megjithatë, punësimi i shfrytëzuesve të ndihmës sociale zhvillohet shumë vështirë, para së gjithash për shkak të kualifikimeve të tyre të ulta. Më të rrezikuar nga aspekti i papunësisë janë personat e moshuar të jokuualifikuar, për të cilët është shumë vështirë që të kyçen në tregun e punës.

Në realizimin e masave aktive, Qendra për punësim bashkëpunon me QPS para së gjithash në aspekt të shkëmbimit të të dhënave për grupet e prekshme të cilat përfshihen me masat aktive. Lidhur me masat aktive, Qendra për punësim bashkëpunon edhe me punëdhënësit nga sektori privat. Bashkëpunimi me komunën është i kufizuar dhe ka të bëjë kryesisht me realizimin e punëve publike, të cilat siqë u theksua shumë rallë zbatohen. Bashkëpunimi me shkollat ndodh gjatë punësimit të kuadrit arsimor, ndërsa Qendra për punësim nuk ka rol aktiv sa i takon orientimit profesional të nxënësve për zgjidhjen e profesionit të tyre.

Në kushte të papunësisë së lartë, ende ekziston ekonomia e zezë, mirëpo sipas të dhënave nga terreni ajo po zvoglohet. Si problem gjatë diskutimit me fokus grupet, u theksua problemi me pasigurinë dhe thyerjen e të drejtave të punonjësve nga ana e punëdhënësve. Në këtë drejtim një nga pjesëmarrësit në fokus grup tha:

*“Nuk ka shansa të gjendet punësim i sigurtë në këtë komunë. Edhe punësimi është i politizuar. Edhe atëherë kur kam gjetur ndonjë punë, nuk më kanë paguar mëditje, më kanë regjistruar me shumë minimale ose aspak nuk më kanë paraqitur dhe nuk mi kanë paguar kontributet...”*

Në komunë realisht ekzistojnë mundësi për uljen e papunësisë përmes stimulimit të zhvillimit të bizneseve private, ndërmarrjeve të vogla, shfrytëzimit dhe ripërtrirjen e potencialeve për bujqësi dhe blegtori (ky sektor vuante edhe nga kriza e Svedmillk-ut), si dhe stimulumet për regjistrimin e bujqëve individual të cilët merret me këtë veprimtari.

**Probleme infrastrukturale:** Sa i takon infrastrukturës në komunën e Radovishit, rreth 90% prej rrugëve të qytetit janë të asfaltuara (edhe pse janë mjaft të dëmtuara dhe kanë nevojë për rindërtim), ndërsa në fshatrat, përveç rrugëve regjionale, rreth 80% prej rrugëve tjera janë të paasfaltuara. Përafërsisht 40% prej rrugëve nuk kanë ndriçim rrugor. Në qytetin e Radovishit ka disa parqe, mirëpo të njejtat nuk janë të rregulluara. Si rezultat i vërshimeve, gjithashtu edhe urat janë të dëmtuara dhe duhet të rindërtohen.

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, 90% janë të kyçura në ujësjellsin e qytetit. Ka ujë të pishëm me kualitet të lartë, mirëpo çështja e ujit nuk është zgjidhur në afat të gjatë dhe ende ekzistojnë probleme, posaçërisht gjatë periudhës verore. Në disa prej fshatrave kodrino-malore ka problem me ujin e pishëm, i cili mungon gjatë muajve verore për shkak të problemeve me pompat mu për shkak të vendpozitës së lartë. Kanalizimi nuk është deri në fund i rregulluar dhe me të janë përfshirë rreth 90% prej vendeve urbane dhe 60% prej vendeve rurale. Vetëm 7 prej vendbanimeve rurale kanë kanalizim, para së gjithash në fshatrat më të mëdhenj dhe më të populluar. Problemi më i madh paraqitet për shkak të rrjetit kanalizues paralel, në të cilin janë vendosur kanalizimi fekal dhe gypat për kanalizim atmosferik, të cilat duhet të ndahen veçmas.

**Probleme ekologjike:** Komuna e Radovishit ballafaqohet me disa probleme ekologjike. Problemi kryesor ekologjik ka të bëjë me deponitë ilegale, të cilat mbinë rreth qytetit dhe në të gjitha fshatrat. Kjo për

shkak të asaj se grumbullim të organizuar të mbeturinave të forta ka vetëm në qytet, gjë për të cilën komuna ka formuar 2 ndërmarrje publike. Problem tjetër është ai me ujërat fekal të cilat janë një ndër ndotësit më serioz të mjedisit jetësorë. Për shkak të mungesës së rrjetit kanalizues për trajtim të organizuar të ujërave fekale nga amvisëritë në pjesën më të madhe të fshatrave, ato kryesisht mblidhen në gropa septike dhe ekziston rreziku i ndotjes së ujit të pishëm nga pusët arterike. Ndotja e lumenjve është e tejkualuar me atë që është ndaluar ndotja e lumit Topollnička dhe lumit Madenska nga miniera Buçim. Mirëpo, në këto lumenj ende mund të vërehen gjurmë dhe lloj nga ndotja shumë vjeçare. Në disa vende në komunë ekziston edhe problemi i eriozionit të tokës, posaçërisht mes fshatrave Podaresh dhe Oraovica dhe përgjat rrjedhës së lumenjve Radovishka, Inievska, Oravička dhe Sushica.

#### 4. MBROJTJA SOCIALE NË KOMUNË

**Administrata komunale:** Në komunën e Radovishit ende nuk është formuar njësi e posaçme për mbrojtje sociale. Pjesën e funksioneve komunale në sferën e mbrojtjes sociale të popullatës e realizon Njësia për veprime publike dhe punë të përgjithshme. Nga buxheti i përgjithshëm vjetor i komunës (120.000.000 denarë), vetëm 0.02% ndahen për qëllime të mbrojtjes sociale të qytetarëve.

Komuna e Radovishit deri tani nuk ka përpiluar asnjë dokument strategjik nga sfera e mbrojtjes sociale. Intervenimet e komunës në sferën e mbrojtjes sociale janë intervenime në kerkesë të qytetarëve, të cilët janë në situatë të rrezikut social dhe drejtohen për ndihmë. Zakonisht bëhet fjalë për ndihmë financiare për qytetarët të cilët janë viktimë të fatkeqësive ekologjike.

Decentralizimi i mbrojtjes sociale në suazat e komunës merret me rezervë për shkak të pasigurisë së asaj se si do të vijoj transferi i kompetencave në kushtë të mungesës së resurseve njerëzore, teknike dhe financiare. Kështu që, u theksua nevoja që të punësuarit në komunë të trajnohen për sfidat ekzistuese të cilat i sjell decentralizimi.

**Qendra për punë sociale:** Të drejtat nga mbrojtja sociale, qytetarët i realizojnë përmes Qendrës ndërkomunale për punë sociale në Radovish, e cila në të njëjtën kohë përfshin edhe komunën e Konçes.

Nga masat e mbrojtjes sociale më së shpeshti shfrytëzohet ndihma sociale. Ka 695 shfrytëzues të ndihmës sociale në para (9.7% nga numri i përgjithshëm i amvisërive në Radovish – 7184), 73 shfrytëzues të ndihmës së përhershme në para dhe 260 shfrytëzues të kompenzimit në para për ndihmë dhe kujdes nga personi i huaj. Pjesëmarrësit në fokus grupin e veçuan shumë ulët të kompenzimeve në para, me të cilën shumë nuk mund të mbulojnë nevojat bazike ekzistenciale të amvisërive. Gjithashtu, vështirësi më e madhe për ta janë kërkesat administrative të ndërlydhura me regjistrimin mujor, mirëpo edhe ripërtirja e dokumenteve. Për shkak të kësaj, shfrytëzuesit u janë të ekspozuar shpenzimeve të mëdha financiare dhe problemeve të ndërlydhura me joefikasitetin dhe joqasëshmërinë tek institucionet tek të cilat ato medoemos duhet të drejtohen për ti fituar dokumentet e nevojshme (MPB, Kadastra etj.)

Masat e mbrojtjes jointucionale shfrytëzohen nga 8 persona: 4 persona të vendosur në familje strehuese, 3 persona në shtëpi të vogël grimore, 1 person në njësi banesore (jeton vetë me anë të përkrahjes).

Mbrojtje institucionale shfrytëzojnë 23 persona, të cilët janë të vendosur në Novo Sello në Strumicë, në entin në Demir Kapi, në Banjsko, Çiçino Sello, në shtëpinë për persona të moshuar Zafir Cajto dhe shtëpinë për persona të moshuar në Prilep.

Rrjeti i shërbimeve sociale në komunë është i pazhvilluar. Ka vetëm një qendër ditore për fëmijë më pengesa intelektuale, Poraka. Ekziston nevojë e madhe për zhvillimin e këtij rrjeti me qendra ditore shtesë dhe shërbime sociale të llojeve të tjera.

QPS Radovish deri më qershor të vitit 2010 ka punuar në parim territorial, ndërsa pastaj në mënyrë të kombinuar: territorial dhe kategorial. Në QPS janë të punësuar 9 punonjës profesional (4 punonjës social, 1 pedagog, 1 psikolog, 2 juristë dhe 1 sociolog). QPS disponon me 8 zyra (200-250m<sup>2</sup>), të ekupiara me kompjuter për secilin punonjës profesional dhe një veturë, e cila është në gjendje të keqe dhe teknikisht jo në rregull, dhe e cila shfrytëzohet për vizita të amvisërive. Në QPS shpesh nuk ka telefon, nuk ka higjieniste të punësuar, ka mungesë të mjeteve për mbulimin e shpenzimeve aktuale; gjëra të cilat e vështirësojnë punën e tyre.

QPS ka bashkëpunim të dobët me sektorin joqeveritar, me përjashtim të OJQ-ës Poraka. Me komunat tjera rrallë bashkëpunon edhe atëherë kur bashkëpunon ajo ka të bëjë me zbatimin e punëve publike të cilat nuk praktikohen që nga viti 2010 (numri i personave të angazhuar për zbatimin e punëve publike në vitin 2009 ka qenë 26 shfrytëzues të ndihmës sociale në para, ndërsa në 2010 nuk ka persona të tillë). Bashkëpunimi me shkollat ka të bëjë për fëmijët të cilët janë në rrezik social; me institucionet shëndetësore më së shpeshti bashkëpunohet për foshnjat e sapo lindura; ndërsa me Qendrën për punësim bashkëpunohet në zbatimin e masave aktive për shfrytëzuesit e ndihmës sociale. Bashkëpunimi me sektorin privat dhe organizatat fetare nuk ekziston.

## **5. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS MË AKTORËT LOKAL**

Komuna e Radovishit ka bashkëpunim më të ngushtë me komunën fqinje të Konçes, me të cilën kufizohet në jug-perendim, ndërsa bashkëpunim regional realizon me të gjitha komunat: Berovë në lindje, Vasilevë në jug, Shtip në veri-perendim dhe Karbinci dhe Vinicë në veri. Së bashku me regjionin e Bregallnicës dhe Strumicës është formuar Shoqata për zhvillim ekonomik regional të këtyre komunave.

Në suazat e komunës, bashkëpunim solid dhe shkëmbim i informatave realizohet si me pushtetin qendror, ashtu edhe me BNJVL në takimet e të cilës rregullisht marrin pjesë përfaqësues të komunës, para së gjithash kryetari i komunës. Me QPS bashkëpunimi është shumë i dobët. Zbatimi i punëve publike në bashkëpunim me QPS, aktivitet i cili në të kaluarën më tepër është praktikuar, sot s'është më në zbatim. Për nevojat e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale deri përpara dy viteve komuna ka dhënë certifikata familjare, mirëpo kjo kompetencë më nuk ekziston. Bashkëpunimi me Qendrën për punësim është pak më i mirë. Secilin vit këto institucione bashkëpunojnë në zbatimin e projekteve të ndërlidhura me masat aktive në tregun e punës (vetëpunësim, biznes plane). Bashkëpunimi me OJQ-ët të cilat janë aktive në komunë është i mirë. Më së shpeshti bashkëpunohet me Kryqin e kuq, edhe pse shfrytëzuesit e ndihmës sociale aspak nuk janë të kënaqur dhe nuk mbajnë mend se kur për herë të fundit kanë marrë ndihmë nga kjo organizatë. Me

OJQ-ët e tjera komuna bashkëpunon përmes Njesisë për zhvillim ekonomik lokal me informim të drejtëpërdrejtë, dhënie të ndihmës gjatë procesit të aplikimit me propozim projekte, trajnime dhe partneritete gjatë aplikimeve të përbashkëta me propozim projekte.

Sa i takon sferës së mbrojtje sociale, komuna nuk ka bashkëpunim me sektorin privat dhe i njejti bëhetë vetëm për qëllime donuese për nevojat e komunës (bashkëpunim solid në këtë sferë komuna realizon me Buçim, Alba Inzhinjering, Best Fud, si dhe kompanitë tekstile Super Hit and Mardi). Jo i mjaftueshëm është bashkëpunimi me organizatat fetare, i cili shpesh ndodh vetëm për kërkimin e donacioneve ose dhënien e lejeve të cilat nuk kanë të bëjnë me përmbushjen e nevojave socialo-mbrojtëse të qytetarëve të komunës së Radovishit. Komuna e Radovishit i përfshin qytetarët më së shpeshti në suazat e procesit të planifikimit strategjik përmes diskutimeve publike për planifikimin urban, dhe përmes shpalljeve publike dhe informim për trajnimet, punëtoritë dhe programet ekzistuese.


## 6. REZULTATE NGA HULUMTIMI ANKETUES I AMVISËRIVE NË KOMUNËN E RADOVISHIT

### 6.1. Të dhëna të përgjithshme për amvisëritë e anketuara

Me hulumtimin empirik u përfshinë gjithsej 100 amvisëri nga komuna e Radovishit. Prej tyre, 65% janë amvisëri urbane dhe 35% nga rurale. 50% janë shfrytëzuese dhe 50% prej amvisërive nuk janë shfrytëzuese të ndihmës sociale.

Sipas strukturës etnike, 88% nga të anketuarit i takojnë grupit etnik maqedonas, 7% turq, 4% romë dhe 1% kanë rrefuzuar të përgjigjen sa i takon strukturës së tyre etnike (Grafiku 1).

Grafiku 1.



Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, në 94% koka e amvisërisë është mashkull, ndërsa në 5% është femër (asnjëra prej femrave nuk është kokë në amvisëritë bujqësore), ndërsa 1% kanë rrefuzuar të tregojnë se kush është kokë e amvisërisë. Gjysma e kokave në amvisëri i takojnë grupit moshor 40-59 vjeç (50%), grupit moshor 30-39 i takojnë 20%, 24% i takojnë grupit moshor mbi 60 vjeç, ndërsa 6% i takojnë grupit moshor deri më 39 vjeç.

Në 89% prej amvisërive, koka e amvisërisë është i/e martuar, në 11% janë të tjerë (i/e pamartuar – 4%, bashkësi jomartësores – 1%, i/e divorcuar – 3%, i/e vejë – 3%). Shumica e kokave në amvisëri dinë shkrim-lexim (97%).


Sipas shkallës formale të arsimit, 11% janë me arsim të pakryer fillorë, 32% janë me fillorë, 42% me të mesëm dhe 7% me të lartë dhe 7% me arsim universitar (1% nuk janë përgjigjur).

Në strukturën e profesioneve, numri më i madh u takon punëtorëve dhe pensionerëve: 23% punëtorë, 18% pensionerë, 14% bujq, 6% nëpunës, 4% amvis/e, 4% afarist privat, ndërsa të tjerët u takojnë profesioneve të tjera (ushtarë/policë, nxënës/studentë, udhëheqës dhe të tjerë).

## 6.2. Punësim

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, shumica ose 35% janë me nga 4 anëtarë, 25% janë me 2 anëtarë dhe 22% me 3 anëtarë, ndërsa nga 5-6 anëtarë ka në 16% të amvisërive (1% është vetëm me një anëtar dhe 1% janë pa përgjigje) (Grafiku 2). Prej amvisërive me nga 5-6 anëtarë (16=100%), në shumicën koka e amvisërisë është me arsim fillor jo të plotë ose vetëm me arsim fillor (62.5%).

Grafiku 2.




Pjesa më e madhe e amvisërive në shembullin janë jobujqësore 48% (prej tyre 48=100%, 77.1% janë në mjedise urbane), të përziera janë 35%, bujqësore janë 9%, ndërsa lloj të panjohur të amvisërive ka në 8%. Nga aspekti i përkatësisë etnike, 47.7% nga amvisëritë maqedonase janë jobujqësore, në 71.5% nga amvisëritë turke nuk kryhet punë bujqësore, ndërsa romët janë amvisëri jobujqësore.

Struktura e amvisërive nga aspekti i statusit arsimor të kokës së amvisërisë tregon se nga numri i përgjithshëm i amvisërive bujqësore (9=100%), shumica ose 88.9% janë me arsim fillor jo të plotë ose arsim fillor; tek amvisëritë e përziera (35=100%) gjithashtu një pjesë e amvisërive janë me arsim fillor jo të mbaruar ose të mbaruar (48.6%). Tek amvisëritë jobujqësore vërehet një status më i lartë arsimor tek koka e amvisërisë, gjegjësisht tek shumica e këtyre amvisërive (48=100%) koka e familjes është me arsim të mesëm ose më të lartë se të mesëm (68.7%).

Struktura e amvisërive lidhur me punësimin e tregon seriozitetin e këtij problemi. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, në shumicën nuk ka asnjë të punësuar (38%), në 31% të amvisërive ka vetëm nga një të punësuar, në 26% nga dy të punësuar, ndërsa në 5% tre të punësuar (Grafiku 3).

Grafiku 3.



Analiza lidhur me punësimin sipas gjinisë tregon se gjendja e punësimit të femrave në krahasim me atë të meshkujve është pak më e mirë. Në 60% të amvisërive nuk ka asnjë mashkull të punësuar, në 35% të amvisërive ka nga një mashkull të punësuar, në 4% nga dy meshkuj të punësuar, ndërsa në 1 amvisëri (1%) ka tre meshkuj të punësuar (gjithsej 46 meshkuj të punësuar). Sa u takon femrave, në 50% prej amvisërive nuk ka asnjë femër të punësuar, në 48% prej amvisërive ka nga një femër të punësuar, në 2% prej amvisërive janë të punësuar nga 2 gra (gjithsej 52 gra të punësuar).

Gjendja në aspekt të papunësisë është e ardhshme: në pjesën më të madhe të amvisërive (47%) nuk ka asnjë të papunësuar, në 25% të amvisërive ka nga një të papunësuar, në 19% nga dy të papunësuar, në 9% ka nga 3-4 anëtarë të papunësuar. Ka 11 anëtarë të amvisërive të cilat janë tepriçë teknologjike, nga të cilët 4 janë burra, ndërsa 7 gra.

Nga aspekti i popullatës joaktive në amvisëri, në 28% prej amvisërive ka nga një ose dy pensionerë, në 59% fëmijë/nxënës/studentë, në 7% amvis/e (shumica gra) dhe vetëm në 1% persona jo të aftë për punë.

### 6.3. Standardi jetësor

Në shumicën e amvisërive (61%) janë realizuar të ardhura nga marrëdhënie të rregullta pune në 12 muajt e fundit. Gjendja më të ardhurat nga marrëdhëniet e rregullta pune është më e volitshme tek amvisëritë maqedonase, nga të cilat 68.2% kanë realizuar të ardhura të tilla, ndërsa jo e volitshme tek amvisëritë turke, nga të cilat asnjë amvisëri nuk ka realizuar të ardhura nga marrëdhëniet e rregullta pune në 12 muajt e fundit (Tabela 1).


Tabela 1.

Të ardhura prej marrëdhënieve të rregullta pune në 12 muajt e fundit?

			A keni marrë ju ose ndonjë tjetër nga familja juaj të ardhura nga marrëdhënie të rregullta pune në 12 muajt e fundit?		
			jo	po	gjithsej
Kombësia e kokës së amvisërisë:	Maqedonas/e	Count	28	60	88
		% within përkatësisë etnike të kokës në amvisëri:	31,8%	68,2%	100,0%
		% of Total	28,0%	60,0%	88,0%
	Rom/e	Count	3	1	4
		% within përkatësisë etnike të kokës në amvisëri:	75,0%	25,0%	100,0%
		% of Total	3,0%	1,0%	4,0%
	Turk/e	Count	7	0	7
		% within përkatësisë etnike të kokës në amvisëri:	100,0%	,0%	100,0%
		% of Total	7,0%	,0%	7,0%
	Rrefuzon të përgjigjet	Count	1	0	1
		% within përkatësisë etnike të kokës në amvisëri:	100,0%	,0%	100,0%
		% of Total	1,0%	,0%	1,0%
Gjithsej	Count	39	61	100	
	% within përkatësisë etnike të kokës në amvisëri:	39,0%	61,0%	100,0%	


Mes të ardhurave në amvisëri të cilat janë jashtë marrëdhënieve të rregullta pune, kryesojnë të ardhurat nga pensionet të cilat i kanë realizuar 27% prej amvisërive, pastaj të ardhurat nga bujqësia të cilat i kanë realizuar 15% prej amvisërive, si dhe të ardhura nga ndihma e fëmijëve/prindërve/familjarëve dhe puna sezonale të cilat i kanë realizuar 9% prej amvisërive (Grafiku 4). Në të gjitha amvisëritë të cilat realizojnë të ardhura shtesë nga puna sezonale, koka e amvisërisë është mashkull.

Grafiku 4.



Nga aspekti i shumës së të ardhurave mujore (Grafiku 5), gjendja e amvisërive nuk është alarmuese. Pjesa më e madhe e amvisërive (26%) realizojnë të ardhura mujore prej 5001 deri më 10.000 denarë. Nga 17% prej amvisërive realizojnë të ardhura deri më 5.000 dhe prej 10.001 deri më 14.000 denarë. Të tjerët realizojnë të ardhura më tepër se 14.001 denarë (gjithsej 34% nga amvisëritë).

Grafiku 5.




Prej amvisërive, me të ardhura deri më 5.000 denarë (17=100%), janë të gjitha, gjegjësisht 100% janë shfrytëzuese të ndihmës sociale, gjë e cila tregon për gjendjen e tyre të pafavorshme financiare. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive shfrytëzuese të ndihmës sociale (50=100%), shumica (52%) kanë të ardhura mujore prej 5.001 deri më 10.000 denarë, 34% deri më 5.000 denarë dhe vetëm 14% më tepër se 10.000, 30% kanë të ardhura prej 10.001=14.000 denarë, ndërsa i rëndësishëm është edhe numri i amvisërive me të ardhura mbi 30.000 denarë (20%) (Tabela 2).

Tabela 2. Të ardhura mujore në amvisëri sipas shfrytëzuesve/joshfrytëzuesve të ndihmës sociale

Shfrytëzues/Joshfrytëzues të NS	Të ardhura të cilat amvisëria i ka realizuar në muajin e fundit								Nuk e di	Rrefuzon të përgjigjet	Gjithsej
	deri 5.000 mkd	5.001-10.000 mkd	10.001-14.000 mkd	14.001-18.000 mkd	18.001-23.000 mkd	23.001-30.000 mkd	mad 30.001 mkd				
Po	Count	17	26	2	1	1	1	0	1	1	50
	% within shfrytëzues	34,0%	52,0%	4,0%	2,0%	2,0%	2,0%	,0%	2,0%	2,0%	100,0%
	% within ardhura	100,0%	100,0%	11,8%	14,3%	10,0%	14,3%	,0%	20,0%	100,0%	50,0%
	% of Total	17,0%	26,0%	2,0%	1,0%	1,0%	1,0%	,0%	1,0%	1,0%	50,0%
Jo	Count	0	0	15	6	9	6	10	4	0	50
	% within shfrytëzues	,0%	,0%	30,0%	12,0%	18,0%	12,0%	20,0%	8,0%	,0%	100,0%
	% within ardhura	,0%	,0%	88,2%	85,7%	90,0%	85,7%	100,0%	80,0%	,0%	50,0%
	% of Total	,0%	,0%	15,0%	6,0%	9,0%	6,0%	10,0%	4,0%	,0%	50,0%
	Count	17	26	17	7	10	7	10	5	1	100
	% within shfrytëzues	17,0%	26,0%	17,0%	7,0%	10,0%	7,0%	10,0%	5,0%	1,0%	100,0%
	% within ardhura	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

Analiza e të ardhurave mujore sipas grupeve etnike tregon se më të rrezikuar janë grupi etnik turk. Pjesa më e madhe e amvisërive turke realizojnë të ardhura deri më 5.000 denarë, gjegjësisht 71.4%. Të gjitha amvisëritë rome janë me të ardhura mujore deri më 10.000 denarë (50% në kategorinë me 5.000 denarë dhe 50% në atë prej 5.001-10.000 denarë). Tek përfaqësuesit e grupit etnik maqedonas, pjesa më e madhe janë me të ardhura mujore prej 5.001=10.000 denarë (26.1%), 19.3% janë me të ardhura prej 10.001-14.000 denarë, nga 8% me të ardhura prej 14.001-18.000 denarë dhe prej 23.001-30.000 denarë (Grafiku 6).

Grafiku 6.



Shumica e amvisërive jeton në ndërtime të forta (92%), 7% jetojnë në ndërtime të dobta ose të montuara, ndërsa 1% në ndërtime të improvizuara. Pjesa më e madhe e amvisërive jeton në banesë dy dhomëshe (32%), edhe pse i madh është numri edhe i atyre të cilët jetojnë në banesë katër dhomëshe (30%). Në garsonjerë ose banesë një dhomëshe jetojnë 18 amvisëri (5% në garsonjerë dhe 13% në banesë një dhomëshe).

Prej amvisërive të cilat jetojnë në garsonjerë ose banesë një dhomëshe (18=100%), pjesa më e madhe janë shfrytëzuese të ndihmës sociale (83.3%). Pjesa më e madhe (20 ose 40%) nga joshfrytëzuesit e ndihmës sociale (50=100%) jetojnë në banesa katër dhomëshe dhe më shumë, gjë e cila tregon për gjendjen e tyre të mirë banuese. Nga aspekti i statusit martesor vlen të përmendet se amvisëritë në të cilat koka e amvisërisë është i/e martuar (89=100%), pjesa më e madhe jetojnë vetëm në banesa dy dhomëshe (33.7%).

Pjesa më e madhe e amvisërive jetojnë në sipërfaqe banesore prej 61-89m<sup>2</sup> (26%), në sipërfaqe prej 41-60m<sup>2</sup> jetojnë 20%, në sipërfaqe mbi 80m<sup>2</sup> jetojnë 24% dhe në sipërfaqe deri më 40m<sup>2</sup> jetojnë 28% (2% prej amvisërive kanë rrefuzuar të përgjigjen në këtë pyetje). Prej amvisërive tek të cilat koka e amvisërisë është i/e martuar (89=100%), 48.3% jetojnë në sipërfaqe deri më 60m<sup>2</sup>, 41.6% jetojnë në sipërfaqe prej 61 deri më 100m<sup>2</sup>, ndërsa vetëm 10.1% në banesa me sipërfaqe më të mëdha se 100m<sup>2</sup> (2.2% prej këtyre amvisërive kanë rrefuzuar të përgjigjen).

Sa u takon kushteve sanitare në amvisëri, 79% prej amvisërive kanë tualet me banjo (prej tyre shumica ose 59.5% nuk janë shfrytëzuese të ndihmës sociale). Gjendja sa i takon kanalizimit dhe ujësjellësit është e kënaqshme. Prej numrit të përgjithshëm të amvisërive, 96% kanë kanalizim, ndërsa 98% kanë çeshme në banesë. Forma më e shpeshtë e ngrohjes është me kofator me lëndë djegëse të ngurta dhe praktikohet tek 79% prej amvisërive, ngrohja me kofator paraqitet tek 11% të popullatës, ngrohja me nxemje me avull vetanake tek 7% (3% nuk janë përgjigjur në këtë pyetje). Në muajt dimrorë shumica e amvisërive (51%) ngrohin vetëm një dhomë, 29% dy dhoma, 20% tre dhe më tepër dhoma. Pjesa më e madhe e amvisërive të cilat ngrohin një dhomë (51=100%) janë shfrytëzuese të ndihmës sociale – 72.5%. Nga aspekti i përkatësisë etnike, në të gjitha amvisëritë, pavarësisht të përkatësisë etnike, më së shpeshti ngrohet vetëm

një dhomë: 46.6% tek amvisëritë maqedonase, 100% tek amvisëritë rome dhe 85.7% tek amvisëritë turke (Tabela 3).

Tabela 3. Numri i dhomave të cilat ngrohen në muajt e dimrit sipas nacionalitetit

Nacionaliteti		Sa dhoma nga vendbanimi juaj ngrohni?					Gjithsej
		një	dy	tre	Katër dhe më shumë	Nuk e di	
Maqedonas/e	Count % within nacionalitet	41 46,6%	28 31,8%	13 14,8%	3 3,4%	3 3,4%	88 100,0%
Rom/e	Count % within nacionalitet	4 100,0%	0 ,0%	0 ,0%	0 ,0%	0 ,0%	4 100,0%
Turk/e	Count % within nacionalitet	6 85,7%	1 14,3%	0 ,0%	0 ,0%	0 ,0%	7 100,0%
Rrefuzon të përgjigjet	Count % within nacionalitet	0 ,0%	0 ,0%	0 ,0%	1 100,0%	0 ,0%	1 100,0%
Gjithsej	Count % within nacionalitet	51 51,0%	29 29,0%	13 13,0%	4 4,0%	3 3,0%	100 100,0%

Nga aspekti i veshjes më tepër mungon veshja e ngrohtë dimrore (xhaketa, xhemperë), të cilën si mungesë e kanë theksuar 43% nga amvisëritë, pastaj këpucët (14%), veshja solemne (1%), veshja e brenshme (1%), ndërsa 14% prej amvisërive kanë theksuar se nuk ju mungon veshje (64.3% prej amvisërive të cilave ju mungon veshje janë shfrytëzuese të ndihmës sociale). Ekzistojnë disa dallime lidhur me atë se çfarë prej veshjeve mungon mes amvisërive të përkatësive të ndryshme etnike: amvisërive maqedonase më tepër ju mungon veshje dimrore (44.3%), amvisërive rome më tepër ju mungojnë këpucë (75%), ndërsa amvisërive turke më tepër ju mungon veshja e ngrohtë dimrore (57.1%).

Gjendja me posedimin e aparateve të amvisërisë është e paraqitur në Tabelën 4 më poshtë. Edhe përpos të asaj që rreth 20% të amvisërive nuk kanë dashur të tregojnë për atë se a posedojnë disa aparate shtëpiake për shkak të ndjeshmërisë të kësaj çështje (para së gjithash shfrytëzuesit e ndihmës sociale), më tepër se 90% e amvisërive i posedojnë aparatet bazike në amvisëri: frigorifer (100%), televizor (100%), shporet me lëndë djegëse të ngurta (95%), shporet elektrik (96%), ngrohës uji (93%), makinë për larje të teshave (93%), thithëse pluhuri (91%) dhe celularë (91%). Më pak se 20% e amvisërive posedojnë: video kamerë (12%), motoçikletë (18%) dhe makina bujqësore (11%).

Tabela 4. Posedimi i aparateve në amvisëri

<i>Aparate për amvisëri</i>	Amvisëria ka	Amvisëria nuk ka nevojë	Amvisëria nuk mund ta blejë	Rrefuzon të përgjigjet	Gjithsej
Shporet me lëndë djegëse të ngurta	95	5	/	/	100
Shporet elektrik	96	3	1	/	100
Furrë	76	16	8	/	100
Ngrohës uji	93	4	3	/	100
Frigorifer	100	/	/	/	100

Frigorifer për ngrirje të thellë	77	17	1	/	100
Makinë për larje teshash	93	3	3	1	100
Makinë për larje të enëve	21	46	16	17	100
Thithëse pluhuri	91	7	1	1	100
Klimë	20	47	14	19	100
Radio/gramafon/kaseto fon	83	11	/	6	100
Televizor	100	/	/	/	100
Video kamerë	12	58	10	20	100
Video rekorder/dvd	61	27	2	10	100
Fotoaparati	38	43	6	13	100
Kompjuter	43	28	14	15	100
Telefon	39	39	3	19	100
Celularë	91	5	2	2	100
Biçikletë	65	23	3	9	100
Motoçikletë	18	52	13	17	100
Automobil	43	33	9	15	100
Traktor/ makina bujqësore	11	61	10	18	100
			Σ=119		


Është e rëndësishme të theksohet se nga numri i përgjithshëm i rasteve ku amvisëria nuk mund ti blejë disa nga aparatet e përmendura (119 raste ku nuk mund të blejnë ndonjë aparat të caktuar), shumica janë shfrytëzuese të ndihmës sociale (në 79 raste ose 66%).

#### 6.4. Probleme sociale dhe mbrojtja sociale

Prej problemeve sociale më të theksuara janë problemi me varfërinë, të cilin e kanë nënvizuar 74% prej amvisërive dhe problemi me papunësinë, të cilin e kanë cekur 64% prej amvisërive. Prej problemeve të tjera, sëmundjet theksohen nga 18% të amvisërive, dhuna familjare nga 6%, divorcet tek 5%, dhe marrëdhëniet konfliktuoze dhe invaliditeti në nga 4% të amvisërive. Problemet e ndërlidhura me deviacionet dhe fatëkeqësitë natyrore janë shumë pak të përfaqësuara (me 2% dhe 1%).

Të dhënat për ballafaqimin me varfërinë dhe papunësinë mes amvisërive urbane dhe rurale japin rezultate të cilat flasin për atë se popullata rurale është më tepër e prekur nga këto probleme për dallim të asaj urbane: 71.4% nga amvisëritë rurale kanë theksuar se ballafaqohen me problemin e papunësisë, ndërsa 85.7% me problemin e varfërisë. Prej amvisërive urbane, 60% ballafaqohen me problemin e papunësisë, ndërsa 67.7% me problemin e varfërisë (Grafiku 7).

Grafiku 7.




Shfrytëzimi i masave nga mbrojtja sociale është në nivel shumë të ulët (me përjashtim të ndihmës sociale në para). Shfrytëzimi i formave joinstitucionale të mbrojtjes paraqitet vetëm tek 6% e amvisërive (2% në formë të informimit, punës këshilluese dhe 4% ndihmë profesionale për zgjidhjen e krizave martesore dhe familjare). Mbrojtje institucionale në formë të përforsimit të aktivitetit punueso-prodhues kanë shfrytëzuar 3% nga amvisëritë. Nga beneficionet në para, përpos 50% të cilat janë shfrytëzues të ndihmës sociale në para, paraqiten edhe nga 2% shfrytëzues të ndihmës së përhershme në para, kompenzimit në para për ndihmë dh kujdes nga personi i huaj dhe ndihma e njëhershme në para. Nga masat e mbrojtjes femërore më tepër është shfrytëzuar ndihma e njëhershme në para për foshnjë të sapo lindur - 16%; 2% prej familjeve kanë shfrytëzuar ose shfrytëzojnë shtesë femërore dhe 2% shtesë të posaçme femërore, e cila jepet për kujdes të fëmijut me invaliditet.

Për tu theksuar është ajo se mes arsyeve për joshfrytëzimin e masave të mbrojtjes sociale dhe femërore nga ana e amvisërive, dominon joinformimi për ekzistimin e mundësisë së shfrytëzimit të këtyre të drejtave ligjore (Grafiku 8). Për shembull, shkaku më i shpeshtë për joshfrytëzimin e ndihmës në para nga mbrojtja sociale është rrefuzimi (15%), pastaj joinformimi (9%), mosplotësimi i kushteve (4%), dokumentacioni i pakompletuar (3%), turpi (2%), ndërsa të tjerët janë në kategorinë e atyre të cilët nuk kanë pasur nevojë për këtë lloj ndihmë.

Sa i takon shfrytëzimit të masave nga mbrojtja femërore, gati 42% nuk e kanë shfrytëzuar për shkak të joinformimit për të drejtat, 7% kanë qenë të rrefuzuar, 2% nuk i kanë plotësuar kushtet, dhe nga 1% për shkak se dokumentacionin nuk e kanë pasur në rregull ose nga turpi. Të tjerët nuk kanë pasur nevojë për këto masa.

E ngjajshme është gjendja lidhur me joinformimin e qytetarëve për të drejtat ekzistuese lidhur me shfrytëzimin e formave institucionale dhe joinstitucionale të mbrojtjes sociale: më tepër se gjysma e amvisërive – 63% nuk i kanë shfrytëzuar për shkak të joinformimit, 4% kanë qenë të rrefuzuar, 3% nga turpi, 3% për shkak të mosplotësimit të kushteve, 1% për shkak të dokumentacionit jo në rregull. Të tjerët janë amvisëri të cilat nuk kanë pas nevojë për këto masa.

Grafiku 8.




## 6.5. Shëndetësia dhe të ushqyerit

Gjendja me sigurimin shëndetësor në amvisëri është e mirë. Shumica janë amvisëri në të cilat të gjithë anëtarët kanë sigurim shëndetësor (93%), ndërsa të tjerët pjesërisht kanë sigurim shëndetësor, gjegjësisht jo të gjithë anëtarët e familjes kanë sigurim shëndetësor.

Pjesa më e madhe e amvisërive në rast sëmundje (përveç hospitalizimit) mjekohen në shëndetësinë publike, gjegjësisht shkojnë në mjek dhe marrin barna me recetë – 85%, 11% mjekohen në mënyrë private, (63,6% prej tyre janë shfrytëzuese të ndihmës sociale), ndërsa tek 4% kjo gjendje është e panjohur. Nuk ka raste të mjekimit me mjekësi alternative. Këto të dhëna tregojnë se ka standard të ulët jetësor tek popullata, për shkak të pjesës më të madhe të amvisërive, të cilat nuk mund ti paguajnë shpenzimet për mjekim privat.

Sa i takon largësisë së shtëpisë më të afërt shëndetësore, më tepër se gjysma e amvisërive (51%), kanë nevojë për 15-30 minuta që të arrijnë tek ajo, 39% kanë nevojë për 15 minuta, ndërsa 10% kanë nevojë për më tepër se 30 minuta. Sa i takon qasshmërisë së institucioneve shëndetësore ka dallime mes amvisërive urbane dhe atyre rurale. Gjegjësisht, shumica e amvisërive urbane mund të arrijnë deri tek spitali më i afërt për më pak se 15 minuta (55.4%), ndërsa shumica e amvisërive rurale (74.3%) spitalin më të afërt e kanë në largësi prej 16-30 minuta. Këto të dhëna tregojnë për gjendjen jo të favorshme të popullatës rurale nga aspekti i qasjes tek institucionet e mbrojtjes shëndetësore (Grafiku 9).

Grafiku 9.



Gjendja nga aspekti i gatimit dhe konsumimit të ushqimit të pasur me mish gjithashtu është në nivel. Pjesa më e madhe e amvisërive (33%) përgatit ushqim të ngrohtë me mish dy herë në javë, 26% tre herë në javë, 24% një herë në javë, 11% nga katër dhe më tepër herë në javë, ndërsa vetëm 5% asnjëherë. Megjithatë, nga aspekti i strukturës etnike të dhënat janë të ardhshme: maqedonasit më së shpeshti gatuajnë ushqim të ngrohtë me mish 2 herë në javë (37.5%), ndërsa romët më së shpeshti një herë në javë (75%), turqit gjithashtu një herë në javë (57.1%).

Mes nevojave të amvisërisë për përbushjen e të cilave mungojnë mjete, ushqimi dhe pijet joalkoolike janë në vend të parë, ndërsa higjiena dhe shëndeti (nevoja për barna dhe ndihmesa) janë në vendin e katërt (Shqyrtimi 2). Për tu theksuar është ajo se një numër i madh i amvisërive (26%) i aknë veçur pijet alkoolike dhe duhanin si nevojë për të cilën ju mungojnë mjete dhe sipas rëndësisë janë të vendosura përpara nevojave arsimore, komunikuese, për rekreim dhe kulturë. Kur bëhet fjalë për mungesën e mjeteve për higjienë dhe shëndet (barna dhe ndihmesa), ajo është më e madhe tek amvisëritë rurale në krahasim me ato urbane: 78% prej amvisërive rurale në krahasim me 48% prej atyre urbane kanë theksuar se kanë mungesë të mjeteve për përbushjen e këtyre nevojave.

Tabela 5. Lista e nevojave të amvisërisë për përbushjen e të cilave mungojnë mjete

<b>Nevoja të amvisërisë</b>	<b>Numri i amvisërive të cilat kanë mungesë të mjeteve</b>
1. Ushqim dhe pije joalkoolike	98
2. Banim, ujë, rrymë, karburantë	93
3. Veshje dhe këpucë	83
4. Higjienë dhe shëndetësi (barna dhe ndihmesa)	63
5. Orendi shtëpiake, mobilje	43
6. Komunikacion (transport/automobil)	33
7. Pije alkoolike dhe duhan	26
8. Arsim	24
9. Komunikacion (telefon, internet)	17
10. Rekreim dhe kulturë (gazeta, libra, udhëtime, argëtim...)	10

## 6.6. Arsim

Në 49% prej amvisërive ka fëmijë në moshë shkollore (6 dhe më shumë vjeç). Në 32% prej amvisërive ka fëmijë të cilët ndjekin arsimin fillor, nga të cilët 14% janë larg shkollë fillore 1km, 8% janë larg 1.01km – 2km, dhe 7% janë prej 2.01 – 4 km (3% nuk kanë dhënë përgjigje). Pjesa më e madhe e amvisërive të cilat shkollën e kanë prej 2.01 deri më 4km larg vendbanimit (7=100%) i takojnë grupit të amvisërive rurale (71.4%), ndërsa 92.9% prej amvisërive të cilat shkollën e kanë në largësi deri më 1 km (14=100%) janë amvisëri urbane. Në 18% prej amvisërive fëmijët ndjekin arsim të mesëm, ndërsa në 12%


ka fëmijë të cilët ndjekin arsimin e lartë. Nuk vërehet problem lidhur me rregullshmërinë e fëmijëve në shkollë.

Sa i takon ndihmës të cilën amvisëritë e marrin për arsimimin e fëmijëve, e njëjta është në nivel të ulët. Prej 32 amvisërive me fëmijë të moshës për arsim fillor, 9 shfrytëzojnë transport falas dhe 1 ushqim falas. Nga 18 amvisëri me fëmijë të moshës së shkollës së mesme, 5 shfrytëzojnë transport falas deri tek shkollat e mesme. Prej 12 amvisërive me fëmijë në arsimin e lartë, 3 kanë shfrytëzuar bursa dhe nga 2 kredi dhe regjistrim përmes kuotës.

### 6.7. Sport, argëtim, kulturë

Nga aspekti i qasjes deri tek institucionet dhe objektet sportive, kulturore dhe argëtuese, gjendja tek amvisëritë është relativisht e mirë duke e pasur parasysh atë se qasëshmëria deri tek institucionet/objektet e cekura është më e madhe se 60%. Më e madhe është qasëshmëria deri tek terren sportive – 94% prej amvisërive kanë theksuar se kanë terren sportiv në afërsi të banimit të tyre, ndërsa më e vogël deri tek teatri, kinemaja dhe biblioteka (63%, 64% dhe 64%) (Grafiku 10).

Grafiku 10.



Pjesa më e madhe e amvisërive nuk shfrytëzojnë aspak internet - 42%. Megjithatë e rëndësishme është edhe përqindja e atyre të cilët shfrytëzojnë internet nga kompjuteri shtëpiak (34%) dhe më se shpeshti nga internet kafeneja (19%); 1% më së shpeshti shfrytëzojnë në punë, ndërsa tek 5% gjendja është e panjohur. Nga aspekti i përkatësisë rurale dhe urbane të amvisërive, pjesa më e madhe (58.5%) e amvisërive urbane shfrytëzojnë internet, ndërsa tek amvisëritë rurale gjendja është e kundërt – pjesa më e madhe e amvisërive nuk shfrytëzojnë aspak internet (48.6%).

## 7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 7.1. Përfundime

SFERA	SFERA	GJENDJA/PROBLEME
-------	-------	------------------

**MË E  
NGUSHT  
Ë**

<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Minieri, industria tekstile</li> <li>□ Veprimtaria private është dominuese (90% nga ekonomia)</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 2 SHFQ në qytet</li> <li>□ 3 SHFQ në fshatra</li> <li>□ 12 SHF rajonale (deri tek klasa e 4) në fshatra</li> <li>□ 1 gjimnaz në qytet</li> <li>□ 1 Fakultet i disperzuar Elektroteknik</li> </ul>
	<i>Shëndetësi :</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 1 shtëpi shëndetësore</li> <li>□ 7 ambulanca</li> <li>□ 7 barnatore</li> <li>□ 4 klinika specialistike</li> <li>□ 15 ordinanca private</li> <li>□ 8 klinika specialistike private</li> <li>□ Nuk ka institucione shëndetësore në fshatra</li> </ul>
	<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 3 kopshte fëmimore</li> <li>□ 1 qendër ditore për persona me invaliditet Poraka</li> <li>□ QPS ndërkomunale</li> <li>□ Nuk ka shtëpi për persona të moshuar</li> <li>□ Rrjeti i institucioneve sociale është i pazhvilluar</li> </ul>
	<i>Kulturë/Sport/Argëtim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 1 Qendër kulturore (me kinema dhe sallë teatri)</li> <li>□ 1 bibliotekë kombëtare</li> <li>□ 2 ansamble folklorike</li> <li>□ 3 studio amatere të dramaturgjisë</li> <li>□ 1 sallë sportive</li> <li>□ 1 kompleks sportivo-rekreativ</li> <li>□ 2 terrene fëmimore</li> <li>□ 7 klube sportive</li> <li>□ 2 TV, 2 radio stacione, 2 operatorë kabllovik, nuk ka gazeta</li> <li>□ 7 klube sportive</li> <li>□ 70 shoqata të qytetarëve të regjistruara</li> </ul>
	<i>Subjekte ekonomike :</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të regjistruara janë 1230 subjekte të vogla ekonomike, 15 të mesme dhe 1 i madh.</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Më të theksuara: papunësia, disfunkcionaliteti tek familjet, divorcet; rritja e delikuencës, alkoolizmit, narkomanisë, lojrat e fatit (bastore sportive);</li> <li>□ Papunësia: të papunësuar janë 5812 persona (58.12% prej tyre janë femra);</li> <li>□ Pjesa më e madhe e të papunësuarve presin që të punësohen për 8 dhe më tepër vite;</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Secilin vit, në pajtim me Planet operative të MPPS realizohen masa aktive (punësim i subvencionuar, biznese të vogla, klube të punës);</li> <li>□ Punë publike aspak nuk janë praktikuar në 2010, ndërsa në vitin 2009, 26 shfrytëzues të NSP janë angazhuar për zbatimin e punëve publike.</li> </ul>
	<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Persona të moshuar</li> <li>□ Grupi etnik turk</li> </ul>
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 90% e rrugëve në qytet janë të asfaltuara</li> <li>□ Ka rrugë të paasfaltuara lokale (vetëm 20% janë me asfalt)</li> <li>□ 40% të rrugëve nuk janë të ndriçuara</li> </ul>
	<i>Ujësjellës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 90% janë të kyçura në ujësjellsin e qytetit</li> <li>□ Ka problem me ujësjelljen gjatë periudhës verore, në veçanti në vendbanimet më të larta</li> </ul>
	<i>Kanalizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 90% në qytet janë të përfshirë në kanalizim, 60% në vendet rurale</li> <li>□ Vetëm 7 vendbanime rurale kanë kanalizim</li> <li>□ Problem me rrjetin kanalizues paralel në të cilin ka gypa edhe për kanalizim fekal edhe për atmosferik</li> <li>□ Të tjerët shfrytëzojnë gropa septike</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Deponi ilegale për mbeturina të ngurta (vetëm në qytet ka grumbullim të organizuar)</li> <li>□ Lumenj të ndotur nga mbeturinat e ngurta dhe ujërat e zeza (nga fshatrat pa kanalizim), si dhe mbeturina nga ndotshmëria e lumenjve nga Buçim</li> <li>□ Erozion i tokës</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunim i ndërkomunal në komunë</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Bashkëpunim solid mes komunës dhe pushtetit qendror, BNJVL dhe OJQ-ve</li> <li>□ Bashkëpunim me komunën fqinje të Konçes: me regjionin e Bregallnicës dhe Strumicës është formuar Shoqatë e përbashkët për zhvillim ekonomik regjional</li> <li>□ Bashkëpunim i dobët mes komunës, QPS dhe Qendrës për punësim</li> <li>□ Bashkëpunim i dobët me sektorin privat dhe organizatat fetare</li> </ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<i>Nga komuna:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Funksionet e mbrojtjes sociale janë dobët të zhvilluara</li> <li>□ Nuk ka Njësi për mbrojtje sociale</li> <li>□ Nuk ka punonjës social të punësuar</li> <li>□ Nuk ka programe për mbrojtje sociale ose dokumente strategjike nga kjo sferë</li> <li>□ Nuk janë zhvilluar forma të mbrojtjes sociale për grupet e prekshme të popullatës (përveç ndihmës së përkohshme financiare)</li> <li>□ Për mbrojtje sociale nga buxheti ndahen 0.02%, të cilat janë</li> </ul>

- minimale
- Nga QPS:*
- Shfrytëzues të NSP: 695 (9.7% nga numri i përgjithshëm i amvisërive)
  - Shfrytëzues të NPP: 73
  - Shfrytëzues të KNH: 260
  - Mbrojtje jointucionale: 8 persona (4 në familje strehuese, 3 në shtëpi të vogël grupore, 1 person në njësi banesash (banim të pavarur me përkrahje);
  - Mbrojtje institucionale: gjithsej 23 persona të vendosur në Novo Sello në Strumicë; në Demir Kapi: në Bansko; në Çiçino Sello; në shtëpi për persona të moshuar Zafir Sajto dhe shtëpia për persona të moshuar në Prilep.

## 7.2. Rekomandime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E PROBLEMEVE DHE PËRMIRËSIM TË GJENDJEVE
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Komuna disponon me potenciale të rëndësishme për zhvillim. Është i nevojshëm një investim më i madh në bujqësi dhe blegtori. Duhet të zhvillohet edhe turizmi malor. Në të gjithë komunën nuk ka asnjë hotel dhe vetëm një motel, Panorama. Investimi në teknologji inovative për shfrytëzimin e ujërave termo-minerale (dhe lëndët e tjera të para) do të kontribuojë në zhvillimin e kësaj komune.</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<p><i>Arsim:</i></p> <p><i>Shëndetësi :</i></p> <p><i>Sfera sociale:</i></p> <p><i>Kulturë/Spport/Argëtim:</i></p> <p><i>Subjekte ekonomike :</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të shqyrtohen mundësitë për hapjen edhe të një shkolle të mesme</li> <li>□ Të bëhet një analizë e përshtatshme për nevojat dhe të hapen ambulanca (mjekësi e përgjithshme dhe stomatologji) në fshatra</li> <li>□ Të hapet barnatore në ndonjë vend rural</li> <li>□ Të pasurohet rrjeti i institucioneve sociale në komunë</li> <li>□ Të zgjerohet numri i kopshteve fëmimore</li> <li>□ Të hapen shtëpi për persona të moshuar</li> <li>□ Të themelohen qendra ditore për të rinj me sjellje devijante</li> <li>□ Të zgjerohet numri i kopshteve fëmimore</li> <li>□ Të krijohet gazetë</li> <li>□ Të pasurohet jeta sportive, kulturore dhe argëtuese me përmbajtje të re nëpër fshatra</li> <li>□ Të stimulohet zhvillimi i subjekteve më të mëdha ekonomike të cilat do të mund të absorbojnë fuqi më të madhe punëtore</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të kontribuohet në uljen e papunësisë përmes stimulimit të zhvillimit të bizneseve private, ndërmarrjeve të vogla, shfrytëzimin dhe</li> </ul>

		renovimin e potencialeve për bujqësi dhe blegtori, si dhe stimulimin e regjistrimit të bujqëve individual të cilë merren me këtë veprimtari.
	<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të promovohen programe për punësimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale dhe targetime më të mira të masave aktive.</li> <li>□ Të realizohen programe preventive për parandalimin e dukurisë së devijimit tek të rinjt dhe familjet disfunktionale.</li> <li>□ Te hapen këshillimore për të rinj dhe këshillimore për familje.</li> <li>□ Të pasurohet rrjeti i shërbimeve sociale për personat e moshuar: të analizohen mundësitë për hapjen e shërbimeve sociale për ndihmë në kushte shtëpiake, qendra ditore, shtëpi të vogla grupe</li> <li>□ Te bëhet analizë e nevojave dhe problemeve të popullatës turke dhe të bëhen përpjekje për krijimin e masave dhe programeve për përmirësimin e gjendjes tek ky grup etnik</li> </ul>
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të përmirësohet infrastruktura rrugore lokale (asfaltimi i rrugëve lokale)</li> <li>□ Të investohet në ndriçimin komplet të rrugëve</li> </ul>
	<i>Ujësjellës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të bëhet analizë dhe zgjidhje projektuese për zgjidhjen e problemit me ujësjelljen në muajt verore</li> </ul>
	<i>Kanalizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të vendoset kanalizim në të gjitha vendbanimet</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të gjindet zgjidhje për trajtim të organizuar të mbeturinave të ngurta në fshatra, me çfarë do të zgjidhet problemi me deponitë ilegale dhe lumenjt e ndotur</li> <li>□ Të bëhet vlerësim dhe të përgatitet projekt për zgjidhjen afatgjate të problemit lidhur me erozionin e tokës</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërkomunal i komunës</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit mes komunës, QPS dhe Qendrës për punësim, përmes zbatimit më intenziv dhe më efikas të punëve publike, masave aktive për punësimin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale, pjesëmarrjes në organe të përbashkëta, edukim për mundësitë dhe format e bashkëpunimit të tyre në sferën e mbrojtjes sociale, si dhe zbatim praktik i projekteve të përbashkëta</li> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës me sektorin privat dhe organizatat fetare përmes kycjes së tyre si partnerë në realizimin e programeve nga sfera e mbrojtjes sociale</li> </ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<i>Nga komuna:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të krijohen funksione socialo-mbrojtëse të komunës përmes edukimit të të punësuarve</li> <li>□ Të hapet njësi për mbrojtje sociale</li> <li>□ Të punësohet punonjës social</li> <li>□ Të përforcohen kapacitetet e komunës për planifikim strategjik dhe krijimin e programeve nga sfera e mbrojtjes sociale përmes edukimit</li> <li>□ Zgjerim i formave nga mbrojtja sociale të cilat i realizon komuna (kryesisht ndihmë financiare) me forma të reja të shërbimeve sociale</li> <li>□ Rritje e përqindjes e cila nga buxheti ndahet për mbrojtje sociale dhe planifikim më i detajuar dhe më sistematik i atyre mjeteve buxhetore</li> </ul>

- 
- Nga QPS:*
- Zvoglim i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para përmes intenzivimit të aktiviteteve për punësimin e tyre në bashkëpunim me Qendrën për punësim
  - Zhvillim i rrjetit të tërë të mbrojtjes institucionale dhe jo institucionale në komunë



# **KOMUNA E ÇASHKËS**

## 1. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË KOMUNËS SË ÇASHKËS

Komuna e Çashkës është komunë rurale e cila gjendet ne pjesën e mesme të Republikës së Maqedonisë dhe shtrihet në sipërfaqe prej 825km<sup>2</sup>, me çfarë është një nga komunat më të mëdha në vend. Mirëpo, bëhet fjalë për komunë me dendësi të vogël të popullësisë prej vetëm 6 banorë në km<sup>2</sup>.

Në territorin e komunës së Çashkës funksionojnë gjithsej 29 bashkësi lokale, të cilat përfshijnë 42 vendbanime. Në komunën e Çashkës vërehet shpërngulja e personave të rinj dhe vendosja e personave të moshuar<sup>16</sup>. Vendet rurale në komunë po shkretohen. Vetëm në 4 vendbanime numri i banorëve është më i madh se 700 (Jabollçishtë e Poshtme dhe e Epërme, Çashkë dhe Melnicë), prej 400-500 banorë ka në 2 vendbanime (Bogomillë dhe Izvor), 100-300 banorë ka në 8 vendbanime, deri më 10 banorë ka në 8 vendbanime, pa banorë janë 4 vendbanime. Në vendbanimet e tjera numri i banorëve është prej 10 deri më 100. Selia e komunës është vendbanimi Çashkë, i cili në pesëdhjet vitet e fundit e dikton ritmin e jetës politike dhe ekonomike në komunë, ndërsa sot është i urbanizuar në një nivel solid.

Në komunë jetojnë gjithsej 7673 banorë, në 2185 amvisëri. Nga numri i përgjithshëm i banorëve, 4017 (52.3%) janë meshkuj dhe 3656 (47.7%) janë femra. Struktura e popullatës sipas përkatësisë etnike është e ardhshme: maqedonas 57%, shqiptarë 35%, turq 5%, serbë 1%, boshnjakë 1% dhe 1% të tjerë. Nga popullata e përgjithshme, 1935 (25.2%) i takojnë grup moshës 0-14 vjeç, 4588 (59.8%) grupit moshor 15-64 vjeç, 1150 (15%) i takojnë grupit moshor mbi 65 vjeç. Komuna e Çashkës është një prej komunave ku plakja demografike e popullësisë është më e theksuar, për çfarë flet edhe fakti se deri më 36% e popullatës në moshë mbi 65 vjeç është më e vjetër se 75 vjeç. Nga aspekti i strukturës arsimore të popullatës e cila është në moshë mbi 10 vjeç (6410), 3338 janë meshkuj nga të cilët 97% dinë shkrim-lexim, ndërsa 3% janë analfabetë; 3072 janë femra, nga të cilat 87% dinë shkrim-lexim, ndërsa 13% janë analfabetë. Tregues për nivelin e ulët të arsimit në komunë është struktura arsimore e popullatës 15+ (5738), nga të cilët 8.9% janë pa arsim, 45% me arsim fillor të pambaruar, 30% me arsim fillor, 14.6% me arsim të mesëm, 0.8% me arsim të lartë, 0.4% me arsim universitar dhe 0.2% janë ende në proces të arsimit fillor.

Komuna ka pozitë të mirë gjeografike dhe disponon me resurse të mira natyrore. Në territorin e saj janë krahinat atraktive të maleve Jakupica, Dautica dhe Babuna në perendim, Klepa në lindje, Karaxhica dhe Goleshnica në veri-perendim, si dhe lumenjt Babuna dhe Topollka pranë cilave gjendet një tokë shumë pjellore. Në komunë ka edhe minerale të mermerit, kvarcit dhe argjilit. Ka edhe pendë uji të sapo ndërtuar, Lisiçe e cila është më rëndësi të veçantë për furnizimin me ujë në këtë komunë, por edhe në qytetin e Velesit. Megjithatë, komuna e Çashkës ende nuk furnizohet me ujë nga penda, e cila në ardhmëri mund të shfrytëzohet për furnizim me ujë të një pjese të vendbanimeve në komunë. Sipërfaqja e përgjithshme e përpunueshme bujqësore është 476.00km<sup>2</sup> dhe 48.97km<sup>2</sup> janë livadhe.

Nga kjo, potencialet për zhvillim të komunës duhet të shihen në zhvillimin e bujqësisë (në veçanti e përshtatshme është prodhimtaria e oranxherisë, prodhimtaria e duhanit, prodhimtaria e orizit, si rezultat i numrit të rritur të prodhuesve të përgjat lumit Topollka, si dhe prodhimtaria e patateve malore me kualitet të

<sup>16</sup> Profil i komunës së Çashkës, 2008.

lartë) dhe blegtoia (në moment blegtoia nuk është shumë e zhvilluar; me kultivimin e deleve merret një pjesë e popullatës në fshatrat malore), turizmi malor dhe ai fshatarë, ndërtimi i hidrocentraleve të vogla, si dhe në shfrytëzimin e lëndëve natyrore me të cilat komuna është e pasur.

## 2. KAPACITETE INSTITUCIONALE

**Arsim:** Arsimi fillor në komunën e Çashkës realizohet në 3 shkolla fillore qendrore (në Çashka, Bogomillë dhe Jabollçishtë të Epërme) dhe në 6 shkolla fillore rajonale (shkolla rajonale të SHFQ të Çashkës në: Melnica, SHFQ e Jabollçishtes së Epërme me shkolla rajonale në Jabollçishtë të Poshtme dhe Vranovci të Epërme; si dhe shkolla rajonale të SHFQ nga Bogomilla në Oreshe, Izvor, Teovë dhe Sogli). Nxënësve të fshatrave të cilat gravitojnë rreth Çashkës ju mundësohet qëndrim në internate. Të tjerëve ju sigurohet transport falas nga vendi i banimit deri tek shkolla më e afërt. Internati ka kapacitet deri në maksimum 60 nxënës, të cilëve ju sigurohet ushqim falas. Sipas të dhënave, banimi në internate pas inicimit të transportit falas deri në shkollë, shumë më pak shfrytëzohet. Në komunë nuk ka shkolla të mesme, ndërsa nxënësit të cilët vazhdojnë arsimin pas kryerjes së shkollës fillore, shkollën e mesme më së shpeshti e ndjekin në Veles, ku gjithashtu banimi në internat është i disponueshëm.

**Shëndetësi:** Në komunë nuk ka rrjet të mirë të institucioneve shëndetësore. Ka vetëm 6 ambulanca (punte) në vendbanimet: Çashkë, Melnica, Izvor, Bogomillë, Jabollçishtë e Epërme dhe e Poshtme, 2 ordianca stomatologjike në Çashkë dhe Jabollçishtë të Epërme dhe një klinikë të specializuar për sëmundje të mushkërive të Ministrisë për shëndetësi – Jasenovë, të cilën popullata në vendbanimet në rrethinë e shfrytëzon si ambulancë. Në ambulanca punohet në 2 ndërrime, mirëpo popullata nuk është e përfshirë me kujdesin primar shëndetësor gjatë natës dhe fundjavave. Gjithashtu, nuk ka ndihmë urgjente mjekësore me mjekim shtëpiak dhe shërbim kujdestar dhe e njejta shfrytëzohet në Veles. Megjithatë, largësia e vendbanimeve nga qyteti i Velesit e pamundëson intervenimin në kohë.

**Institucione sociale:** Shumë më pak është i degëzuar rrjeti i institucioneve sociale. Nuk kas asnjë kopsht fëmënor, as po shtëpi për persona të moshuar. Në funksion janë vetëm dy qendra ditore për persona të moshuar në Çashkë dhe Bogomillë, të cilat sipas deklaratve të pjesëmarrësve në fokus grupet nuk janë mjaft atraktive për popullatën e vjetër në komunë, punojnë vetëm gjatë ditës dhe për shkak të kësaj sjanë mjaft të vizituara.

**Institucione kulturore:** Në komunën e Çashkës ka 2 muze, një në Bogomillë dhe një në Vranovcë të Epërme. Në suazat e muzeut në Bogomillë funksionon 1 bibliotekë, si njësi lokale e bibliotekës Goce Dellçev nga Velesi. Nuk ka kinema, teatër, po as edhe shtëpi kulturore funksionale. Ka 6 objekte në të cilat ndonjëherë kanë qenë të vendosura shtëpitë kulturore të mëparshme të vendosura në vendbanimet më të mëdhaja, të cilat janë të zbrazta dhe ruinuara.

Në komunë gjenden disa vende arkeologjike (në afërsi të Çashkës, Gollozinci, Izvor, Otishtinë), si dhe më tepër përmendore kulturore të mbrojtura nga Ministria për kulturë: 2 kisha, 1 xhami – spital i partizanëve, urë guri nga periudha romake mbi lumin Babunë, 1 fshat – Vranovci i Epërm si tërësi, 3 shtëpi

selia të presidencës së ASNOM-it, shtabi qendror dhe shtypshkronjë dhe komiteti qendror në Gorno Vranovci dhe 1 shtëpi e Petar Pop Arsov në Bogomillë.

**Objekte sportive:** Në komunë ka 9 terrene sportive në vendbanimet më të mëdha të cilat kryesisht janë terrene për futboll. Terreni sportiv në Çashka është një stadion i ri dhe i madh. Ka edhe 5 klube sportive futbollistike. Nuk ka objekte dhe klube të tjera sportive.

**Media:** Në komunë nuk ka asnjë medium, as të shtypit as elektronik.

**Shoqata qytetare:** Numri i shoqatave në territorin e komunës është i vogël. Më aktive janë: Shoqata e qytetarëve Galeb, Shoqata për bashkjetesë multietnike dhe të drejtat njerëzore Mozaik, Ambientalisti- një shoqatë ekologjike së shpejti e formuar, Çellarnica dhe Pllavnik. Ka edhe një numër të caktuar të shoqatave tjera qytetare dhe fondacioneve të cilat edhe përpos të asaj se janë të regjistruara në nivel kombëtar ose në komunën fqinje në Veles, një numër të aktiviteteve të tyre i realizojnë në territorin e komunës së Çashkës.

**Subjekte ekonomike:** Në vitin 2005, në komunën e Çashkës janë regjistruar gjithsej 170 subjekte ekonomike, gjë e cila është një rritje e madhe krahasuar me vitin 2003 kur kanë qenë të regjistruara 73. Prej 170 subjekteve ekonomike, 19 janë ndërmarrje, 35 shoqata tregtare, 53 tregtarë individual dhe 63 të tjerë. Subjekte më të mëdha ekonomike të cilat janë aktive janë Kanet Agro (oranzheri) dhe Kame komerc (prodhimi i kuarcit), të cilat për momentin absorbojnë një pjesë të mirë të fuqisë punëtore. Përpos tyre në komunë janë hapur edhe funksionojnë edhe një numër i fermave (e derrave, e shpendëve, e këpurdhave, prodhimtaria e kërmijve etj.). Jashtë funksionit janë disa subjekte ekonomike në të cilat një pjesë e rëndësishme e popullatës në këtë komunë ka qenë e punësuar siç janë: qumshtorja Napredok, oranzheritë Llozar, fabrika Kiro Çučuk për prodhimtarinë e tullave dhe materialeve ndërtimore, Porcellanka nga Veles dhe Svillara gjithashtu nga Velesi.

### 3. PROBLEME DOMINUESE NË KOMUNË

**Probleme sociale:** Probleme më të theksuara sociale në komunë janë papunësia, e cila është në një shkallë të lartë, si dhe varfëria e cila rezulton me një numër të madh të shfrytëzuesve të ndihmës sociale. Probleme të cilat shënojnë rritje në komunë janë edhe delikuenca mes të miturve, dhuna familjare, si dhe martesat mes të miturve (në veçanti e theksuar tek popullata shqiptare). Më e rrezikuar është popullata e moshuar e cila është financiarisht e pasiguar, pa pensione, në veçanti në vendbanimet me pjesëmarrje të madhe të popullatës së moshuar në numrin e përgjithshëm të popullatës (Bogomillë). Në gjendje të pafavorshme sociale janë edhe personat me invaliditet (29), për të cilët nuk ekzistojnë kurrëfar shërbime sociale në komunë. Sipas të dhënave të fituara nga komuna, në vijim është marrëveshja e cila nënshkruhet me MPPS për hapjen e qendrës ditore për personat me invaliditet në territorin e komunës.

Kompetent për zgjidhjen e problemit të papunësisë me komunën e Çashkës është Qendra për punësim e vendosur në Veles. Në të janë të punësuar 17 persona (7 me arsim universitar, 4 me arsim të lartë dhe 6 me arsim të mesëm). Nga numri i përgjithshëm i popullatës në moshën 15 vjeçare dhe më tepër (5553, nga të cilët 2799 janë meshkuj dhe 2754 janë femra), 33.4% janë ekonomikisht aktiv, ndërsa 66.6% janë

popullatë joaktive. Nga popullata ekonomikisht aktive (1857), të punësuar janë 1078 persona (87.4% janë meshkuj dhe vetëm 12.6% femra), ndërsa të papunësuar 779 persona (62.2% janë meshkuj dhe 37.8% femra).

Sipas të dhënave më të reja të marra nga Qendra për punësim, deri më datën 31.10.2010, janë evidentuar 1965 persona të papunësuar, nga të cilët 851 (43.3%) janë femra dhe 114 (56.7%) janë meshkuj. Struktura e personave të papunësuar të paevidentuar sipas shkallës së arsimit është e ardhshme: 1643 (83.6%) nga personat e papunësuar janë të pakualifikuar dhe gjysëm të kualifikuar, 127 (6.5%) janë të kualifikuar, 188 (9.6%) janë me arsim të mesëm të kryer, 1 (0.05%) me arsim të lartë dhe 6 (0.03%) me arsim universitar. Struktura e personave të papunësuar të evidentuar sipas moshës është e ardhshme: 619 (31.5%) janë në moshë deri më 29 vjeç, 525 (26.7%) janë mes 30 dhe 39 vjeç, 399 (20.3%) janë mes 40 -49 vjeç dhe 422 (21.5%) janë në moshë mbi 50 vjeç. Nga këto të dhëna mund të përfundohet se mes të papunësuarve më e përfaqësuar është popullata e re, mirëpo gjithashtu impresionuese është edhe përqindja (21.5%) e të papunësuarve tek popullata më e moshuar mbi 50 vjeç. Sipas asaj se sa gjatë kanë pritur punësimin e parë, struktura është e ardhshme: 264 (13.4%) nga të papunësuarit presin punësim deri më 11 muaj, 602 (30.6%) prej 1 deri më 3 vite, 1099 (55.9%) presin punësim për 4 dhe më tepër vite. Këto të dhëna, të cilat tregojnë se më tepër se gjysma nga të papunësuarit presin punësim 4 dhe më tepër vite janë me të vërtetë alarmuese. Profesione deficitare në komunë janë: ndërtimtarë, mjekë, stomatologë, motra medicinale, ndërsa veprimtari dominuese janë bujqësia dhe blegtoaria. Në gjendje më të pafavorshme nga aspekti i papunësisë janë personat e pakualifikuar dhe gjysëm të kualifikuar, të cilët për shkak të kualifikimeve të ulta të cilat i kanë dhe mungesa e gjatë nga tregu i punës, nga njëra anë vështirë kyçen si kërkues aktiv të punës, ndërsa nga ana tjetër ka kërkesë të vogël për këtë kategori të personave të papunësuar nga ana e punëdhënësve.

Në luftë kundër papunësisë, Qendra për punësim realizon më tepër masa aktive siç janë: punësim i subvencionuar i grupeve të prekshme të popullatës, biznese të vogla, klube punuese, rikualifikim, kualifikim, trajnim dhe të ngjajshme. Punët publike më tepër janë zbatuar në vitin 2009 kur në pajtim me Planin operativ për programe dhe masa aktive për punësim në komunën e Çashkës janë angazhuar 38 persona të papunësuar të evidentuar për punë publike të mirëmbajtjes dhe meremetimin e infrastrukturës publike dhe mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në realizimin e masave aktive kontakti dhe bashkëpunimi me punëdhënësit nga sektori privat është kyç. Megjithatë, bashkëpunimi me QPS dhe me komunën në sferën e punësimit të shfrytëzuesve për mbrojtje sociale, duhet të përmirësohet për shkak se deri tani është vetëm shkëmbim i informatave për shfrytëzuesit ose për gjendjen ekonomiko-sociale në komunë.

Në gjendje të papunësisë se lartë dhe joekzistimit të mundësive për punësim në komunë (nuk ka numër të mjaftueshëm të firmave dhe ndërmarrjeve, përveç oranzherisë e cila është private), gati secila familje kultivon duhan dhe në atë mënyrë e siguron ekzistencën e vetë. Ajo e cila parqet vështirësi për familjen është fakti që një pjesë e madhe e tyre nuk kanë tokën e tyre dhe për shkak të kësaj punojnë në arat e fshatrave tjera, i marrin ato me qira ose paraqiten si shfrytëzues ilegal të tokës. Siqë theksoi një nga pjesëmarrësit në fokus grupet:

*“Çfarë të bëjmë??? Toka në Llozar ju është dhënë vetëm disa njerëzve, një pjesë e madhe prej nesh kemi ardh nga fshatrat në rrethinë të Çashkës. Nuk kemi tokën tonë dhe prandaj shkojmë në fshatrat fqinje për të mbjellë duhan...”*

**Probleme infrastrukturale:** Në komunë ka lidhshmëri të mirë rrugore. Me komunën e Velesit komuna lidhet përmes rrugës regjionale. Në territorin e saj kalon edhe hekurudha e trenit Shkup-Manastirë. Parashihet kyçja e komunës në rrugën magjistrale Veles-Prilep-Manastirë, me çfarë do të përmirësohet lidhshmëria territoriale me pjesët tjera të shtetit. Megjithatë, mbetet aktual problemi me rrugët lokale të paasfaltuara dhe me infrastrukturën e vjetruar rrugore të rrugëve regjionale dhe lokale. Rrjeti i rrugëve lokale është në gjatësi prej 126.7km, nga të cilat 38.9km janë të asfaltuara dhe 87.8km të paasfaltuara (rrugë e tamponuar dhe tokësore).

Qytetarët e komunës së Çashkës furnizohen me ujë të pishëm përmes sistemit për ujësjellje (të ndërtuar me vetkontribut lokal dhe punë vullnetare në vitin 1976), puseve vetanake dhe çeshmeve të fshatit. Përmes rrjetit ujësjellës, me ujë të pishëm furnizohen 22 vendbanime (nga gjithsej 42), ndërsa vendbanimet e tjera përmes çeshmeve dhe bunareve në fshat. Uji sigurohet nga lumenjt Babuna dhe Topollka. Në vendbanimin Çashkë është formuar ndërmarrje publike komunale në interes publik. Kjo NPK financohet nga të ardhurat e shërbimeve të cilave jua siguron shfrytëzuesve. NPK Topollka menaxhon vetëm me 5 ujësjellës (Çashkë, Bogomillë, Izvor, Omorani dhe Teovë). Ujësjellësat e tjerë me vendim të këshillit të komunës ju jepen për shfrytëzim dhe menaxhim bashkësive lokale të atyre vendbanimeve. Në vendbanimet më të mëdha kualiteti i ujit kontrollohet nga 2 herë në muaj (në vendbanimet ku është ndërmarrë ujësjellësi), ndërsa në vendet më të vogla 2 herë në vit. Megjithatë, për shkak se kontrolli i ujit paguhet, i njëjti kontrollohet vetëm në 5 fshatra.

Largimi i ujërave të zeza komunale nga amvisëritë dhe shpenzuesit e tjerë nga komuna bëhet përmes rrjetit kanalizues (i ndërtuar në vitin 1986), i cili ekziston në vetëm 7 vendbanime (vendbanimi Çashkë, Izvor, Teovë, Bogomillë, uikend vendbanim në Vranovcë të Epërm, Mellnica, Martolci), ndërsa të tjerët drejtëpërdrejtë i derdhen në lumenjt Babuna dhe Topollka. Stacion pastrues është ndërtuar në Teovo.

**Probleme ekologjike:** Komuna e Çashkës llogaritet për të qenë një komunë e pastërt ekologjike me ajr kualitativ dhe të pastërt. Megjithatë, për shkak se NPK Topollka nuk menaxhon me numrin më të madh të ujësjellësve dhe grumbullimin e organizuar të mbeturinave, paraqiten deponitë ilegale dhe ndotja e lumenjve, mu për shkak të mbeturinave të ngurta dhe ujërave të zeza. Deponia për mbeturina të ngurta në vendbanimin Çashkë gjendet në Glinishte, në rajonin e fshatit Rakovec. Vendet e tjera rurale ballafaqohen me një sërë problemesh më grumbullimin e mbeturinave, në veçanti në ato ku nuk praktikohet grumbullimi i organizuar i tij.

#### 4. MBROJTJA SOCIALE NË KOMUNË

**Administrata komunale:** Komuna e Çashkës është një nga komunat ku funksione të cilat duhet ti ketë komuna lidhur me mbrojtjen sociale të popullatës janë të rëndësishme. Në komunë është krijuar Njësi për arsim, kulturë, shëndetësi, mbrojtje sociale, sport dhe bashkëpunim me shoqatat qytetare dhe fondacionet. Në suazat e kësaj njësie nuk ka të punësuar punonjës social, mirëpo është angazhuar një jurist dhe një pedagog. Njësia ka përpiluar disa programe edhe atë: Programi për zhvillim të arsimit, sportit, kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale të komunës së Çashkës për periudhën e viteve 2009-2011; Propozim program për aktivitetet e komunës së Çashkës në sferën e mbrojtjes sociale në vitin 2011; si dhe

Program për aktivitetet e shkollave fillore në sferën e mbrojtjes sociale në vitin 2011. Edhe pse programet të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale duhet të pasurohen në pjesën e mbrojtjes së grupeve të prekshme të popullatës, përmes shërbimeve sociale si shtesë e ndihmës financiare dhe ndihmës në naturë, megjithatë iniciativat e kësaj komune në sferën e krijimit të mbrojtjes sociale në nivel lokal duhet të merren si shembull dhe duhet përshëndetur.

Edhe në realizimin praktik të formave të mbrojtjes sociale, komuna shënon rezultate të mira. Në praktikën e deritashme komuna ka intervenuar në strehimin e familjeve të cilat janë socialisht të rrezikuara në objekte komunale (janë strehuar 30 familje socialisht të rrezikuara në një ndërtesë komunale); ndihmë e njëhershme në para për qytetarët të cilët kanë dërguar kërkesë në komunë (në 2009 janë dhënë 140.000 denarë ndihmë financiare); dhënia e dhuratave për vitin e ri për fëmijët me nevoja të posaçme dhe fëmijët nga familjet me një prind; mbulimi i shpenzimeve për transport të nxënësve nga komuna deri tek shkollat e mesme në Veles dhe të ngjajshme.

Decentralizimin e mbrojtjes sociale përfaqësuesit e komunës e shohin me skepticizëm, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të të punësuarve në komunë dhe bazën e dobët financiare për ndërmarrjen e kompetencave. Nga buxheti i përgjithshëm i komunës, i cili në vitin 2010 ka qenë 33.895.963 denarë, për mbrojtje sociale janë ndarë 300.000 denarë, ose rreth 1%.

**Qendra për punë sociale:** Realizimi i të drejtave nga mbrojtje sociale të popullatës në komunën e Çashkës është nën kompetencat e Qendrës ndërkomunale për mbrojtje sociale në Veles, e cila në të njëjtën kohë e mbulon edhe territorin e komunave Veles dhe Gradsko.

Sipas të dhënave për shfrytëzuesit e ndihmës sociale në komunën e Çashkës, më i madh është numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para 267 (ose 12.2% nga numri i përgjithshëm i amvisërive – 2185). Numri më i madh i amvisërive janë shfrytëzues nga fshati Jabollçisht i Epërm, me popullatë dominuese shqiptare – 89 (ose 33.3% nga numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve), dhe nga fshati Mellnica, ku janë të përfaqësuar maqedonasit musliman – 32 (ose 12% nga numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve). Shfrytëzuesit e tjerë (146) janë të shpërndarë nëpër vendbanimet tjera. Ka 33 shfrytëzues të ndihmës së përhershme në para dhe 51 shfrytëzues të kompensimit në para për ndihmë dhe kujdes nga personi i huaj. Pagesa e ndihmës së njëhershme në para është ndaluar nga muaji prill i vitit 2010, për shkak të politikës restriktive të MPPS lidhur me këtë lloj të ndihmës sociale. Marrë në përgjithësi, tek shfrytëzuesit ka pakënaqësi lidhur me shumën e kompensimeve në para, e cila është e pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve bazike për jetesë. Vështirësi e madhe për shfrytëzuesit e ndihmës sociale nga komuna e Çashkës është largësia e QPS. Për shkak të nevojës për regjistrim mujor, ato duhet të udhëtojnë deri në Veles një herë në muaj, ndërsa transport publik ka vetëm në vendbanimin Çashkë. Kjo paraqet problem më të madh për shfrytëzuesit nga fshatrat më të largët.

Nga format e mbrojtjes jointucionale, vetëm 1 i mitur nga kombësia shqiptare është vendosur në familje strehuese. Ka edhe 2 klube për persona të moshuar në vendbanimet Çashkë dhe Bogomillë, në të cilat sipas QPS, si shfrytëzues janë regjistruar 160 persona të moshuar nga Çashka dhe 105 persona të moshuar nga Bogomilla. Në suazat të shkollës fillore funksionon edhe kuzhina popullore. Nga të dhënat në terren, kuzhinën popullore e shfrytëzojnë jo vetëm shfrytëzues të ndihmës së përhershme në para, por edhe

shfrytëzues të ndihmës sociale në para. Pamundësia që të gjithë qytetarët socialist të rrezikuar në komunë ta shfrytëzojnë kuzhinën popullore krijon pakënaqësi mes qytetarëve për atë se janë të ç'kyçur. Në suazat e diskutimit në fokus grupet lidhur me këtë çështje, një nga shfrytëzuesit theksoi:

*“Jam i vejë, i sëmurë, prind i vetëm, kam 3 vajza. Nuk dini se sa e rëndësishme do të jetë për mua që të keshja një ushqim në ditë...ndërsa deri tani nuk e kam shfrytëzuar kuzhinën popullore...Nëse unë nuk e meritoj këtë, atëherë, kush?”*

Forma të mbrojtjes institucionale shfrytëzojnë gjithsej 9 qytetarë në komunë: 2 shfrytëzues të formës jetesë e pavarur me përkrahje në Negotinë, 1 i strehuar në SOS Detsko Sello, 2 në Entin për Rehabilitim të fëmijëve dhe të rinjve në Shkup dhe 4 në institucion për strehimin e personave me invaliditet të mesëm dhe të vështirë në Demir Kapi.

Rrjeti për shërbime komunale në komunë, si dhe mbrojtja jointitucionale dhe institucionale nuk janë të favorshme. Komuna disponon me objekte të cilat mund të shfrytëzohen për hapjen e shtëpive të vogla për persona të moshuar, shelter qendër për viktime të dhunës familjare dhe qendra ditore për personat me invaliditet.

Përndryshe, QPS punon me parim kategorial, mirëpo kushtet për punë janë të vështirësuar. Kuadrin profesional e përbëjnë: 3 juristë, 2 sociologë, 12 punonjës social, 2 psikologë, 1 pedagog dhe 1 defektolog. Në zyrë janë të vendosur nga dy punonjës profesional, gjë e cila nuk është e volitshme nga aspekti i kontaktit me shfrytëzuesit, ndërsa QPS disponon me një veturë të vjetër, e cila përdoret për kontrollë në familje në tre komuna dhe që nga kjo nuk i përmbush nevojat atëherë kur ka më shumë punë.

QPS nga Velesi realizon bashkëpunim kryesisht me Kryqin e kuq, i cili ka njësi të shpërndarë në Çashkë, mirëpo nga puna e të cilit qytetarët nuk janë të kënaqur. Bashkëpunim i mirë realizohet me SHFQ të Çashkës. Gjithashtu bashkëpunim të mirë ka edhe me ambulancën. Mjeku i cili punon në ambulancën në Çashkë, disaherë më ndërmjetësim të QPS angazhohet që të punojë me personat e moshuar në suazat e klubeve (matja e shtypjes, edukim shëndetësor etj). Bashkëpunimi me Qendrat për punësim është i dobët. Përpara dy viteve, përmes formës së punëve publike është ndërtuar edhe klubi për personat e moshuar nga Çashka, mirëpo në vitet e fundit zbatimi i punëve publike po ngecën. Me sektorin privat dhe organizatat fetare, QPS nuk ka kurrëfar bashkëpunimi.

## **5. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS ME AKTORËT LOKAL**

Komuna e Çashkës kufizohet me komunat Veles dhe Gradsko në lindje, Zelenikovë dhe Studeniçan në veri, Makedonski Brod dhe Dollnen në perëndim dhe Prilep dhe Kavadar në jug. Më i theksuar është bashkëpunimi ndërkomunal me Velesin, mu për shkak të lidhjeve administruese. Me Velesin është nënshkruar marrëveshje për administrim të përbashkët (revizor, kontabilist, inspektor ndërtimor dhe për komunikacion). Nuk ka forma të bashkëpunimit për mbrojtje sociale me komunat fqinje.

Komuna ka bashkëpunim të mirë me pushtetin qendror. Bashkëpunimi me BNJVL është solid dhe ka të bëjë me kontakte të rregullta, pjesëmarrje në punëtori, info-bilten, si dhe këshillime për ligjet, pjesëmarrje në takime dhe aktivitete të tjera të ngjajshme.

Bashkëpunimi me QPS ndërkomunale në Veles është kryesisht në shkëmbimin e të dhënave për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale dhe atë para se gjithash për kuzhinën popullore, e cila është e vendosur në objektin e shkollës fillore në vendbanimin Çashkë. Bashkëpunimi me Qendrën për punësim, gati edhe nuk ekziston. Punët publike në komunë, për të cilat zakonisht realizohet bashkëpunim mes këtyre institucioneve, përpara disa viteve janë realizuar më shpesh, mirëpo në kohën e më hershme zbatimi i tyre anëshkalohet për shkak të revoltit i cili paraqitet tek shfrytëzuesit e ndihmës sociale dhe pakënaqësia e tyre, për shkak të asaj se kur kanë qenë të angazhuar nuk kanë marrë kompenzime për shpenzime rrugore ose ushqim.

Bashkëpunimi me sektorin joqeveritar është solid, edhe përpos asaj që numri i organizatave joqeveritare aktive në territorin e kësaj komune është i vogël dhe ka të bëjë para së gjithash me përkrahjen e zbatimit të projekteve. Për dallim të sektorin joqeveritar, bashkëpunimi me sektorin privat dhe fetar në sferën e mbrojtjes sociale nuk ekziston.

Komuna ka kontakte të mira me qytetarët. Bashkëpunimi me qytetarët realizohet përmes përfshirjes së tyre në diskutimet publike gjatë miratimit të buxhetit, si dhe në zbatimin e projekteve të ndryshme.


## **6. REZULTATE NGA HULUMTIMI ANKETUES I AMVISËRIVE NË KOMUNËN E ÇASHKËS**

### **6.1. Të dhëna të përgjithshme për amvisëritë e anketuara**

Me hulumtimin empirik u përfshin gjithsej 100 amvisëri nga komuna e Çashkës. Prej tyre, 47% janë shfrytëzuese të ndihmës sociale, ndërsa 53% nuk janë shfrytëzuese.

Sipas strukturës etnike, 96% nga amvisëritë e anketuara i takojnë grupit etnik maqedonas, nga 1% atij shqiptar dhe turk, dhe 2% grupit etnik serb. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, në 90% koka e amvisërisë është mashkull, ndërsa në 10% është femër (nga këto 10 amvisëri ku femra paraqitet si kokë e amvisërisë, 8 janë amvisëri jobujqësore). Shumica e kokave në familje i takojnë grupmoshës prej 40 deri më 59 vjeç (51%), grupit moshor 30-39 i takojnë 15%, dhe për tu theksuar është përqindja e lartë e kokave në familje të grupit moshor 60 dhe më tepër vjeç (34%) (Grafiku 1).

Grafiku 1.




Në 85% prej amvisërive, koka e amvisërisë është i/e martuar, ndërsa në 9% i/e vejë. Shumica e kokave në amvisëri dinë shkrim-lexim (96%). Sipas shkallës formale të arsimit, 15% janë me arsim fillor të pambaruar, 38% me arsim fillor, 42% me arsim të mesëm dhe 5% me të lartë ose arsim universitar. Në strukturën e profesioneve, pjesa më e madhe u takon punëtorëve dhe pensionerëve: 34% punëtorë, 24% pensionerë, 11% bujq, 8% amvis/e, 5% nëpunës, 4% ushtarë/polic dhe 14% profesion tjetër.

## 6.2. Punësim

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, 38% janë me nga deri në 3 anëtarë, 33% me 4 anëtarë, ndërsa një numër i rëndësishëm (28%) me nga 5-6 anëtarë. Në shumicën e amvisërive (55%) kryhet veprimtaria bujqësore. Amvisërive bujqësore u takojnë 26%, amvisërive të përziera të cilat merren edhe me bujqësi edhe me ndonjë veprimtari tjetër u takojnë 29%, jobujqësore janë 40% prej amvisërive, ndërsa 5% nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Struktura e amvisërive bujqësore nga aspekti i statusit arsimor të kokës në amvisëri, tregon se nga numri i përgjithshëm i amvisërive bujqësore (26=100%), pjesa më e madhe (46.2%) janë me arsim fillor, 11.5% janë me arsim fillor të pambaruar, 38.4% me arsim të mesëm, 3.8% me arsim të lartë dhe 0% me arsim universitar.

Struktura e amvisërive në aspekt të punësimit është brengosëse. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, në shumicën nuk ka asnjë të punësuar (59%). Në 28% prej amvisërive ka vetëm nga 1 të punësuar, në 12% nga 2 të punësuar, ndërsa në 1% tre të punësuar (Grafiku 2).

Grafiku 2.



Analiza në aspekt të punësimit sipas gjinisë tregon gjendje të pafavorshme tek femrat. Në 37% prej amvisërive ka vetëm nga një person i punësuar i cili i takon gjinisë mashkullore, vetëm në 7% nga dy persona të punësuar të gjinisë mashkullore (gjithsej 51 meshkuj të punësuar), ndërsa vetëm në 10 amvisëri ka të punësuar vetëm nga një person të gjinisë femrore (gjithsej 10 femra të punësuar).

Në shumicën e amvisërive (56%) ka më së paku nga një të papunësuar: në 25% prej amvisërive ka nga 1 të papunësuar, në 24% nga 2 të papunësuar, ndërsa në 7% ka nga 3-4 anëtarë të papunësuar. Për tu theksuar janë të dhënat sipas të cilave në 15% prej amvisërive ka anëtarë të cilët kanë mbetur tepriçë teknologjike (punonjës të falimentuar): në 12% prej amvisërive ka nga një anëtar punonjës i falimentuar, në 2% prej amvisërive nga dy anëtarë punonjës të falimentuar dhe në 1% ka nga tre anëtarë të amvisërisë së njejtë të cilët kanë mbetur si tepriçë teknologjike (ose gjithsej 19 persona). Prej tyre, shumica janë meshkuj (14).

Nga aspekti i popullatës joaktive në amvisëri, në 55% prej tyre ka amvis/e, në 33% pensionerë, në 61% fëmijë/nxënës/studentë, dhe vetëm në 1% persona të paaftë për punë.

### 6.3. Standardi jetësor

Papunësia e madhe në amvisëritë në komunën e Çashkës krijon edhe standard të ulët jetësor. Kjo vërtetohet me të dhënat sipas të cilave shumica e amvisërive (56%) nuk kanë fituar të ardhura nga marrëdhënie të rregullta punë në 12 muaj e kaluar. Nga 47=100% shfrytëzues të ndihmës sociale, 74.5% nuk kanë marrë kurrëfar të ardhura nga marrëdhëniet e rregullta pune. Mes joshfrytëzuesve të ndihmës sociale (53=100%) situata është e kundërt, 39.6% nuk kanë marrë kurrëfar të ardhura, ndërsa 60.4% kanë realizuar të ardhura nga marrëdhëniet e rregullta pune në 12 muajt e kaluar.

Mes burimeve të të ardhurave në amvisëri, të cilat realizohen jashtë marrëdhënieve të punës, kryesojnë të ardhurat nga bujqësia, të cilat i kanë realizuar 46% të amvisërive. Prej tyre (46=100%) më tepër se gjysma janë shfrytëzuese të ndihmës sociale, gjegjësisht 52.2%. Kjo tregon për faktin se bujqësia ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e ekzistencës së amvisërive në kushte të varfërisë dhe papunësisë së lartë. Përpos të ardhurave nga bujqësia, një përqindje e rëndësishme e amvisërive realizojnë të ardhura edhe nga pensionet (31%). Në të njejtën kohë, 13% prej amvisërive merren edhe me punë sezonale (prej tyre në 92.3% koka e

amvisërisë është mashkull, ndërsa vetëm 7.7% janë amvisëri ku koka është femër), ndërsa 7% fitojnë të ardhura nga punë e ngarkim-shkarkimit ose transportit.

Tregues më i përshtatshëm për standardin e ulët të jetesës në amvisëri është shuma e të ardhurave mujore. Pjesa më e madhe e amvisërive (24%) jeton me të ardhura mujore prej 5.001-10.000 denarë, ndërsa i rëndësishëm është edhe numri i amvisërive me të ardhura deri më 5.000 denarë (15%). Prej amvisërive me të ardhura deri më 5.000 denarë (15=100%) shumica, gjegjësisht 86.7% janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para, ndërsa 3.8% nuk janë shfrytëzuese. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para (47=100%), tek 59.6% të ardhurat mujore janë deri më 10.000 denarë. Pjesëmarrja e amvisërive të cilat nuk janë shfrytëzuese të ndihmës sociale është më e madhe në krahasim me shfrytëzuesit tek të cilët të ardhurat mujore janë mbi 23.000 denarë (nga 14 amvisëri me të ardhura mbi 23.000 denarë, 11 nuk janë shfrytëzuese të ndihmës sociale) (Tabela 1). Nga numri i përgjithshëm i amvisërive me femër si kokë e familjes (10=100%), tek 60% prej tyre të ardhurat mujore lëvizin mes 5.001-10.000 denarë, tek 20% deri më 5.000 denarë, ndërsa tek të tjerët 20% janë mbi 10.000 denarë.

Tabela 1.

Shfrytëzues/joshfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale sipas shumës së parave të cilën amvisëria e ka realizuar si të ardhura muajin e kaluar?


		Sa është shuma e parave të cilën amvisëria juaj e ka realizuar si të ardhura muajin e kaluar?								Rrefuzon të përgjigjet	Gjithsej
		deri 5.000 mkd	5.001-10.000 mkd	10.001-14.000 mkd	14.001-18.000 mkd	18.001-23.000 mkd	23.001-30.000 mkd	mbi 30.001 mkd	Nuk e di		
Shfrytëzues i ndihmës në para nga mbrojtja sociale	Count	13	15	6	4	4	1	0	2	2	47
	% within shfrytëzues	27,7%	31,9%	12,8%	8,5%	8,5%	2,1%	,0%	4,3%	4,3%	100,0%
	% within shuma	86,7%	62,5%	30,0%	25,0%	44,4%	12,5%	,0%	66,7%	100,0%	47,0%
	% of Total	13,0%	15,0%	6,0%	4,0%	4,0%	1,0%	,0%	2,0%	2,0%	47,0%
Jo	Count	2	9	14	12	5	7	3	1	0	53
	% within shfrytëzues	3,8%	17,0%	26,4%	22,6%	9,4%	13,2%	5,7%	1,9%	,0%	100,0%
	% within shuma	13,3%	37,5%	70,0%	75,0%	55,6%	87,5%	100,0%	33,3%	,0%	53,0%
	% of Total	2,0%	9,0%	14,0%	12,0%	5,0%	7,0%	3,0%	1,0%	,0%	53,0%
Gjithsej	Count	15	24	20	16	9	8	3	3	2	100
	% within shfrytëzues	15,0%	24,0%	20,0%	16,0%	9,0%	8,0%	3,0%	3,0%	2,0%	100,0%
	% within shuma	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%
	% of Total	15,0%	24,0%	20,0%	16,0%	9,0%	8,0%	3,0%	3,0%	2,0%	100,0%

Nga amvisëritë të cilat realizojnë të ardhura deri më 5.000 denarë (15=100%), në pjesën më të madhe, gjegjësisht 46.7% koka e amvisërisë është me arsim fillor ose arsim fillor të pambaruar; ndërsa tek amvisëri me të ardhura 5.001-10.000 denarë (24=100%), 70.8% nga kokat në amvisëri janë gjithashtu me arsim fillor ose me arsim fillor të pambaruar. Kjo gjendje tregon për ndikimin negativ të nivelit të ulët të arsimit mbi standardin jetësor.

Gjendja banuese nuk është brengosëse. Bëhet fjalë për ndërtime të forta, ndërsa gjysma e amvisërive jetojnë në banesë dy dhomëshe (46%) (Grafiku 3). Prej tyre, (46=100%) shumica janë amvisëri në të cilat koka e familjes është në bashkësi martesore (80.4%); 45.6% nga këto amvisëri kanë deri më 3 anëtarë, 37% kanë 4 anëtarë, ndërsa 17.4% kanë nga 5-6 anëtarë. Nga numri i përgjithshëm i atyre të cilët jetojnë në

banesë me katër dhoma ose më të madhe (16=100%), pjesa më e madhe nuk janë shfrytëzues të ndihmës sociale (68.8%), gjë e cila tregon se ka një standard më të mirë jetësor mes joshfrytëzuesve.


Grafiku 3.



Shumica e amvisërive jetojnë në sipërfaqe prej 60m<sup>2</sup> (39%), në sipërfaqe prej 61-80m<sup>2</sup> jetojnë 29%, në sipërfaqe mbi 80m<sup>2</sup> gjithashtu 29%, ndërsa tek 3% prej amvisërive gjendja lidhur me çështjen e banimit është e panjohur. Prej amvisërive në të cilat koka e familjes është në bashkësi martesore (85=100%), shumica jetojnë në banesa më të mëdha me sipërfaqe prej mbi 60m<sup>2</sup> (58.8%), në banime me sipërfaqe deri më 60m<sup>2</sup> jetojnë 37.6%, ndërsa tek 3.5% prej këtyre amvisërive gjendja është e panjohur.

Gjendja lidhur me posedimin e gypit sanitues në banesë tregon se 73% prej amvisërive kanë tualet me banjo në banesë (prej tyre shumica ose 57.5% nuk janë shfrytëzuese të ndihmës sociale). Nga numri i përgjithshëm, tek 93% ka kanalizim, ndërsa 7% shfrytëzojnë gropë septike. Lidhur me paisjen me ujë, gati të gjitha amvisëritë (96%) kanë çeshme në banesë. Forma më e shpeshtë e ngrohjes është me kofitor me lëndë djegëse të ngurta (dru, qymyr...) prezente tek 95% të amvisërive, ngrohje me nxemje me avull ka vetëm tek 3%, 1% ngrohen me kofitor me rrymë dhe 1% me kofitor me lëndë djegëse lëngore. Lidhur me ngrohjen gjatë muajve të dimrit, brengosin të dhënat se më tepër se gjysma e amvisërive (62%) ngrohin vetëm 1 dhomë, në të cilën gjatë këtyre muajve me gjasëshmëri qëndrojnë së bashku të gjithë anëtarët e amvisërisë; 28% prej amvisërive ngrohin 2 dhoma, ndërsa 10% prej amvisërive ngrohin 3 ose më tepër dhoma. Pjesa më e madhe e amvisërive të cilat ngrohin vetëm një dhomë (62=100%) janë shfrytëzuese të ndihmës sociale - 53.2% (Grafiku 4).

Grafiku 4.



Nga aspekti i veshjes më së tepërmi mungon veshja e ngrohtë dimrore (xhaketa, xhempera) të cilën si mungesë e kanë theksuar 57% prej amvisërive, pastaj këpucë (15%), veshje solemne (11%), veshje të brenshme (2%), veshje sportive (1%), lloj tjetër i veshjes (2%), ndërsa 13% prej amvisërive kanë deklaruar se nuk ju mungon veshje (76.9% prej amvisërive të cilëve nuk ju mungon veshje nuk janë shfrytëzuese të ndihmës sociale).

Gjendja me posedimin e aparateve për amvisëri është paraqitur në Tabelën 2 më poshtë. Në shqyrtim shihet se 90% e amvisërive i posedojnë aparatet e ardhshme për amvisëri: shporet me lëndë të ngurta djegëse (99%), televizor (97%), shporet elektrik (92%) dhe makinë për larje të teshave (96%). Më pak se 20% e amvisërive posedojnë: makinë për larje të enëve (3%), video kamerë (9%), klimë (13%) dhe makina bujqësore (13%).

Tabela 2. Posedimi i aparateve për amvisëri

<i>Aparate për amvisëri</i>	Amvisëri a ka	Amvisëria nuk ka nevojë	Amvisëria nuk mund ta blejë	Rrefuzon të përgjigjet	Gjithsej
Shporet me lëndë djegëse të ngurta	99	1	/	/	100
Shporet elektrik	92	6	2	/	100
Koftor	37	38	20	5	100
Ngrohës uji	89	4	6	1	100
Frigorifer	97	1	2	/	100
Frigorifer me ngrirje të thellë	81	11	8	/	100
Makinë për larjen e teshave	96	1	3	/	100
Makinë për larjen e enëve	3	34	60	3	100
Thithëse	88	3	9	/	100
Klimë	13	33	51	3	100
Radio/gramafon/kaset ofon	73	19	7	1	100

Televizor	97	3	/	/	100
Video kamerë	9	49	39	3	100
Video rekorder/dvd	50	30	18	2	100
Aparat fotografik	23	42	33	2	100
Kompjuter	44	22	32	2	100
Telefon	77	15	8	/	100
Celularë	85	8	5	2	100
Biçikletë	50	39	9	2	100
Motoçikletë	21	54	23	2	100
Automobil	49	12	37	2	100
Traktor/makinë bujqësore	13	53	31	3	100
			$\Sigma=403$		

E rëndësishme është të theksohet se nga numri i përgjithshëm i rasteve ku amvisëritë kanë theksuar se nuk kanë mundësi që të blejnë një nga aparatet e amvisërisë (403 raste të cilët nuk mund të blejnë ndonjë aparat të caktuar), shumica janë shfrytëzuese të ndihmës sociale, ose 61%.

#### 6.4. Probleme sociale dhe mbrojtja sociale

Konstatimi është se probleme dominuese sociale në komunën e Çashkës janë para se gjithash papunësia dhe varfëria, ndërsa pastaj me hulumtimin empirik u vërtetuan edhe problemet lidhur me familjet disfunktionale dhe sëmundjet (invaliditeti). Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, 77% kanë theksuar se janë ballafaquar ose ballafaqohen me disfunktionalitet familjar, ndërsa tek 5% problemi me invaliditet të një anëtarit në amvisëri. Problemet e ndërlidhura me devijimet shoqërore nuk janë prezente. Prezenca e disa problemeve të ndërlidhura me fatkeqësitë natyrore, vërshimet dhe thatësitë, është theksuar nga ana e 9% prej amvisërive.


Për atë se sa papunësia është e ndërlidhur me statusin e ulët arsimor, flet fakti se 100% prej amvisërive ku koka e amvisërisë është pa arsim kanë deklaruar se ballafaqohen me problemin e papunësisë. Të njëjtën e kanë deklaruar 71.4% prej atyre ku koka e amvisërisë është me arsim fillor të pambaruar dhe 84.2% prej atyre ku koka e amvisërisë ka kryer arsimin fillor. E njëjtë është situata edhe me problemin e varfërisë, të cilin e kanë theksuar 100% prej atyre amvisërive në të cilat koka është pa arsim, 85.7% prej atyre në të cilat koka është me arsim jo të plotë dhe 89.5% prej atyre amvisërive në të cilat koka e amvisërisë është me arsim fillor.

Edhe përpos problemeve sociale ekzistuese në amvisëri, shfrytëzimi i masave të mbrojtjes sociale është në një nivel shumë të ulët (me përjashtim të beneficioneve në para). Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, 52% kanë shfrytëzuar ose shfrytëzojnë ndihmë sociale në para, 11% ndihmë të përhershme në para dhe vetëm 2% të amvisërive shfrytëzojnë kujdes shtëpiak dhe ndihmë. Nga masat për mbrojtje femërore, 29% familje kanë skfrytëzuar ose shfrytëzojnë shtesë femërore, vetëm 5% ndihmë të njëhershme

në para për fëmi të sapo lindur dhe 3% shtesë të posaçme fëminore e cila jepet për kujdes të një fëmije me invaliditet.

Për tu theksuar është struktura arsimore e amvisërive shfrytëzuese dhe joshfrytëzuese të ndihmës sociale në para. Në Grafikon 5 mund të vërehet se mes shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para, pjesa më e madhe e kokave në familje janë me arsim fillor (38.5%), ndërsa mes joshfrytëzuesve të ndihmës sociale në para në pjesën më të madhe të amvisërive (41.7%), koka e amvisërive ka shkallë më të lartë të arsimit të mesëm teknik.

Grafiku 5.



Mes shkaqeve për joshfrytëzimin e masave të mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes fëminore dominojnë rrefuzimi, mospërbushja e kushteve dhe joinformimi. Sa u takon shkaqeve se përse amvisëritë nuk kanë shfrytëzuar ose nuk shfrytëzojnë ndihmë në para nga mbrojtja sociale, përveç atyre që kanë theksuar se nuk kanë nevojë nga ajo (23%), pjesa më e madhe kanë theksuar se kanë qenë të rrefuzuar (13%), 7% se nuk i përbushin kushtet, 3% për shkak të joinformimit, 2% nga turpi dhe 5% për shkaqe tjera.

Shkaqe dominuese për joshfrytëzimin e mbrojtjes fëminore, përveç mospasjes nevojë për të, të cilët e kanë shprehur 65% prej amvisërive, është rrefuzimi (15%), joinformimi (9%), turpi, dokumentacioni jo i kompletuar dhe mospërbushja e kushteve nga ana e 2% të amvisërive dhe shkaqe të tjera (5%).


Sa i takon mbrojtjes institucionale dhe joinstitucionale, 61% prej familjeve kanë theksuar se nuk kanë nevojë për këto forma të mbrojtjes, 17% se nuk i shfrytëzojnë këto masa për shkak se nuk kanë qenë të informuar se të njejtat ekzistojnë, 14% për shkak se kanë qenë të rrefuzuar, 5% për shkak të mospërbushjes së kushteve, 1% për shkak të dokumentacionit të pakompletuar dhe 2% për shkaqe të tjera.

## 6.5. Shëndetësi dhe të ushqyerit

Gjendja me sigurimin shëndetësor të amvisërive është e favorshme. Shumica janë amvisëri në të cilat të gjithë anëtarët kanë sigurim shëndetësor (83%). Tek 8% prej amvisërive ka një gjendje ku ka sigurim shëndetësor të pjesërishtëm (gjegjësisht jo të gjithë anëtarët kanë sigurim shëndetësor), tek 6% asnjëri nuk ka sigurim shëndetësor, ndërsa tek 3% kjo gjendje është e panjohur. Gjendja me sigurimin shëndetësor është

pak më e dobët tek shfrytëzuesit e ndihmës sociale. Gjegjësisht, 84.9% prej amvisërive joshfrytëzuese kanë sigurim të plotë shëndetësor për dallim të amvisërive shfrytëzuese ku sigurim kanë 80.9%. Për tu theksuar është dallimi i madh mes këtyre dy grupeve të amvisërive nga aspekti i gjendjes ku askush s'është i siguruar në amvisëri. Të tillë janë 10.6% prej amvisërive shfrytëzuese të ndihmës sociale dhe vetëm 1.9% nga amvisëritë joshfrytëzuese (Grafiku 6).


Grafiku 6.



Pjesa më e madhe e amvisërive mjekohen në shëndetësinë publike, gjegjësisht shkojnë në mjek publik dhe marrin barna me recetë - 86%, vetëm 6% mjekohen në mënyrë private, 5% vizitojnë mjek publik mirëpo blejnë barna në mënyrë private, 2% nuk shkojnë në mjek dhe shfrytëzojnë mënyra alternative të mjekimit dhe 1% kanë rrefuzuar që të përgjigjen në këtë pyetje. Këto të dhëna tregojnë për standardin e ulët jetësor mes popullatës për shkak të cilit familjet nuk mund që ti përballojnë shpenzimet për mjekim privat.

Ushqimi i rregullt dhe kualitativ, i pasur me mish nuk është karakteristikë e amvisërive. Pjesa më e madhe e tyre ushqim të ngrohtë me mish gatuajnë një herë në javë (35%), ndërsa e rëndësishme është edhe përqindja e amvisërive (14%) të cilat nuk gatuajnë ushqim të ngrohtë me mish aspak gjatë javës (64.3% prej tyre janë shfrytëzuese të ndihmës sociale) (Grafiku 7).

Grafiku 7.



Mes nevojave të amvisërisë për përmbushjen e të cilave mungojnë mjete, ushqimi dhe pijet joalkoolike janë në vend të dytë, ndërsa higjiena dhe shëndeti (nevoja për barna dhe ndihmesa) janë në vendin e 4 (Tabela 3). Analiza e nevojave në amvisëri për përmbushjen e të cilave mungojnë mjete nga aspekti i shfrytëzuesve dhe joshfrytëzuesve të ndihmës sociale ka nevojë për një kujdes të posaçëm. Për 6 nga nevojat e nënvizuara (ushqim, veshje, banim, orendi shtëpiake, higjienë dhe shëndetësi, rekreim dhe kulturë), përqindja e amvisërive që kanë thënë se ju mungojnë mjete, ndërsa i takojnë grupit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale, është shumë më e madhe se sa përqindja tek amvisëritë të cilat nuk janë shfrytëzuese. Joshfrytëzuesit e NS kanë thënë se më tepër ju mungojnë mjete për nevojat e ardhshme: pije alkoolike dhe duhan, komunikacion dhe transport, komunikim dhe arsim. Shpërndarja e tillë tregon se tek amvisëritë shfrytëzuese paraqitet mungesë më e madhe e mjeteve për përmbushjen e nevojave primare, ndërsa tek amvisëritë joshfrytëzuese për përmbushjen e nevojave sekondare, duke supozuar se nevojat primare nga të cilat varet ekzistenca biologjike janë në shumicë të përmbushura.

Tabela 3. Lista e nevojave të amvisërisë për përmbushjen e të cilave mungojnë mjete

Nevoja të amvisërisë	Numri i amvisërive të cilat kanë theksuar mungesë të mjeteve	% e amvisërive të cilat kanë thënë se ju mungojnë mjete për nevojat e theksuara	
		Shfrytëzues të NS	Joshfrytëzues të NS
1. Veshje dhe këpucë	78	83%	73.6%
2. Ushqim dhe pije joalkoolike	75	83%	67.9%
3. Banim, ushqim, ujë, rrymë, lëndë djegëse	60	63.8%	56.6%
4. Higjienë dhe shëndetësi (barna dhe ndihmesa)	59	63.8%	54.7%
5. Orendi shtëpiake, mobilje	56	61.7%	50.9%
6. Arsim	28	27.7%	28.3%
7. Komunikacion (transport/automobil)	23	19.1%	26.4%
8. Rekreim dhe kulturë (gazeta, libra, udhëtime, aheng)	10	12.8%	7.5%
9. Komunikim (telefon, internet)	9	4.3%	13.2%
10. Pije alkoolike dhe duhan	5	4.3%	5.7%

## 6.6. Arsim

Në 47% prej amvisërive ka fëmijë në moshë shkollore (6 dhe më tepër vjeç). Në 31% të amvisërive ka fëmijë të cilët ndjekin arsim fillor, në 20% prej amvisërive ka fëmijë në arsim të mesëm, ndërsa vetëm në 6% ka fëmijë të cilët ndjekin arsim të lartë. Nuk është vërejtur problem lidhur me rregullshmërinë e fëmijëve në shkollë.


Sa i takon ndihmës të cilën amvisëritë e kanë marrë lidhur me arsimimin e fëmijëve të tyre, e njejtë është në nivel të ulët. Nga 31 amvisëri me fëmijë të moshës për arsim fillor, 8 shfrytëzojnë transport falas

dhe 1 ushqim falas. Prej 20 amvisërive me fëmijë të moshës së shkollës së mesme, 4 shfrytëzojnë transport falas deri tek shkollat e mesme. Mes amvisërive me fëmijë në arsimin e lartë nuk shfrytëzohet asnjë formë e ndihmës, siqë janë bursat, kreditë ose regjistrimi në kuota.

### 6.7. Sport, argëtim, kulturë

Sipas deklaratve të amvisërive të anketuara, asnjë amvisëri nuk ka qasje në kinema dhe teatër, para se gjithash për shkak të faktit që në komunë këto institucione kulturore nuk ekzistojnë. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive: 99% kanë theksuar se kanë qasje në terrene sportive, 95% shesh lojërash, 57% në biblioteka, 74% në kafe bar, 29% në internet kafene, 52% në restorane dhe 39% në internet kafene (Grafiku 8).

Grafiku 8.



Shumica e amvisërive aspak nuk shfrytëzojnë internet - 65%, 31% shfrytëzojnë nga kompjuteri shtëpiak, 2% nga internet kafeneja, ndërsa 2% nuk kanë dhënë përgjigje. Analiza e shfrytëzimit të internetit sipas arsimit formal të kokës në amvisëri tregon se në amvisëritë ku koka e amvisërisë është me shkallë më të lartë të arsimit, interneti shfrytëzohet më shpesh. Nga 31 amvisëri të cilat shfrytëzojnë internet (31=100%), në 20 amvisëri (65%) koka e amvisërisë ka arsim të mesëm ose më të lartë se të mesëm. Nga amvisëritë në të cilat koka e amvisërisë është me arsim jo të plotë fillor, 85.7% nuk shfrytëzojnë internet aspak, ndërsa nga amvisëritë ku koka e amvisërisë është me arsim fillor, 73.7% nuk shfrytëzojnë aspak internet (Tabela 4).

Tabela 4. Shfrytëzimi i internetit sipas shkallës formale të arsimit

Arsimi formal		A përdor së paku një anëtarë i amvisërisë suaj internet?				Gjithsej
		po, më shpesh nga kompjuteri shtëpiak	po, më shpesh nga internet kafeneja	nuk shfrytëzoj internet	Nuk e di	
Pa arsim	Count % within arsim	0 .0%	0 .0%	1 100,0%	0 .0%	1 100,0%
Arsim fillor i pambaruar	Count % within arsim	2 14,3%	0 .0%	12 85,7%	0 .0%	14 100,0%
Arsim fillor	Count % within arsim	9 23,7%	0 .0%	28 73,7%	1 2,6%	38 100,0%
I mesëm teknik	Count % within arsim	16 41,0%	2 5,1%	20 51,3%	1 2,6%	39 100,0%
Gjimnaz	Count % within arsim	1 33,3%	0 .0%	2 66,7%	0 .0%	3 100,0%
Arsim i lartë	Count % within arsim	1 33,3%	0 .0%	2 66,7%	0 .0%	3 100,0%
Arsim universitar	Count % within arsim	2 100,0%	0 .0%	0 .0%	0 .0%	2 100,0%
	Count % within arsim	31 31,0%	2 2,0%	65 65,0%	2 2,0%	100 100,0%

## 7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 7.1. Përfundime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	GJENDJA/PROBLEME
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Bujqësi (oranzheri, prodhimtaria e duhanit dhe prodhimtaria e orizit dhe patateve)</li> <li>□ Blegtori</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 3 SHFQ</li> <li>□ 6 shkolla rajonale</li> <li>□ Nuk ka shkollë të mesme</li> </ul>
	<i>Shëndetësi</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 6 ambulanca për mbrojtje shëndetësore primare (nuk punonjnë në mbrëmje dhe gjatë fundjavës)</li> <li>□ 2 ordianca stomatologjike</li> <li>□ 1 klinikë specialitike për sëmundje të mushkrive</li> <li>□ Ka 1 barnatore</li> <li>□ Nuk ka ndihmë të shpejtë</li> </ul>
	<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 2 klube për persona të moshuar</li> <li>□ 1 kuzhinë popullore</li> <li>□ Rrjet i pazhvilluar i institucioneve sociale: nuk ka kopshte feminare, nuk ka shtëpi për persona të moshuar</li> </ul>
	<i>Kulturë/Sp</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 9 terrene sportive të futbollit</li> </ul>

<i>ort/Argëti m:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Një numër i caktuar i shoqatave qytetare</li> <li>□ Nuk ka kinema dhe teatër</li> <li>□ Nuk ka asnjë medium</li> </ul>
<i>Subjekte ekonomike :</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 170: pjesa më e madhe tregtarë individual dhe shoqëri të vogla tregtare</li> <li>□ Më të mëdhenj: Kanet agro (oranzheri) dhe Kame komerc (prodhimi i kuarcit)</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Më të theksuara: papunësia dhe varfëria (të papunësuar janë 1965 persona; 55.9% prej tyre presin që të punësohen për 4 dhe më tepër vite)</li> <li>□ 83.6% nga të papunësuarit janë të pakualifikuar ose gjysëm të kualifikuar</li> <li>□ Secilin vit, në pajtim me Planet operative të MPPS realizohen masa aktive (punësim i subvencionuar, biznese të vogla, klube pune etj.)</li> <li>□ Punët publike gati aspak nuk praktikohen në vitin 2010, në vitin 2009, 38 të papunësuar të regjistruar nga Çashka janë angazhuar për punë publike</li> <li>□ Profesione deficitare janë: ndërtimtarë, stomatologë, motra medicinale, mjekë</li> <li>□ Në rritje është delikuenca e të miturve, dhuna familjare si dhe martesat mes të miturve</li> </ul>
<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Persona të moshuar</li> <li>□ Persona me invaliditet (për ata nuk ka kurrëfar shërbime sociale në komunë)</li> </ul>
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li><i>Rrugë:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Lidhshmëri e mirë regjionale</li> <li>□ Rrugë të paasfaltuara lokale (vetëm 30% janë me asfalt)</li> </ul> </li> <li><i>Ujësjellës:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Ujësjellës ka në 22 vendbanime</li> <li>□ Prej 22 vendbanimeve NPK menxhon vetëm me 5 ujësjellës</li> <li>□ Uji kontrollohet rregullisht vetëm në 5 vendbanime</li> </ul> </li> <li><i>Kanalizim:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Kanalizim ka në 7 prej 22 vendbanimeve</li> <li>□ Të tjerët shfrytëzojnë gropa septike</li> </ul> </li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Deponi ilegale për mbeturina të forta</li> <li>□ Lumenj të ndotur nga mbeturinat e forta dhe ujërat e zezë</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërinstytucio</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Bashkëpunim solid mes komunës dhe pushtetit qendror, BNJVL dhe OJQ-ve</li> <li>□ Bashkëpunim para se gjithash me komunën e Velesit</li> <li>□ Bashkëpunim i dobët me sektorin privat dhe organizatat</li> </ul>

<b>nal në komunë</b>		fetare
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<i>Nga komuna:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Funksione mirë të zhvilluara të mbrojtjes sociale</li> <li>□ Është hapur Njësi për arsim, kulturë, shëndetësi, mbrojtje sociale, sport dhe bashkëpunim me shoqatat qytetare dhe fondacionet</li> <li>□ Nuk ka punonjës social të punësuar (vetëm jurist dhe pedagog)</li> <li>□ Ka të përpiluar 3 Programe për mbrojtje sociale</li> <li>□ Ka të zhvilluara forma të mira të mbrojtjes sociale të grupeve të prekshme të popullatës</li> </ul>
	<i>Nga QPS:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Nga buxheti i komunës ndahet 1% për mbrojtje sociale</li> <li>□ Shfrytëzues të NSP: 267 (12.2% nga numri i përgjithshëm i amvisërive)</li> <li>□ Shfrytëzues të NPP: 33</li> <li>□ Shfrytëzues të KNH: 51</li> <li>□ Mbrojtje jointucionale: 160 shfrytëzues të regjistruar në klubin për persona të moshuar në Çashkë; 105 shfrytëzues të regjistruar në klubin për persona të moshuar në Bogomillë; kuzhinë popullore në vendbanimin Çashka</li> <li>□ Mbrojtje institucionale: 9 shfrytëzues (2 – banim i pavarur me përkrahje në Negotinë; 1 – SOS Detsko Sello; 2 – Enti për rehabilitim për fëmijë dhe të rinj Shkup; 4 – Demir Hisar)</li> </ul>

## 7.2. Rekomandime

SFERA	SFERA MË E NGUSHT Ë	REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E PROBLEMEVE DHE PËRMIRËSIM TË GJENDJEVE
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Potencialet për zhvillim të komunës duhet të kërkohen në zhvillimin e bujqësisë (prodhimtaria në oranzheri, prodhimtaria e duhanit, orizit dhe patateve) dhe në blegtori, turizëm malor dhe fshatar, ndërtimi i hidrocentraleve të vogla, si dhe në shfrytëzimin e lëndëve të para me të cilat komuna është e pasur (mermer, kuarc, glinë...).</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të zgjerohet rrjeti i shkollave rajonale për tu evituar banimi në internate dhe për tu përmirësuar qasëshmëria</li> <li>□ Të analizohen mundësitë për hapjen e një shkolle të mesme</li> </ul>
	<i>Shëndetësi:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të riorganizohet puna e ambulancave për mbrojtje shëndetësore primare që të njejtat të punojnë gjatë natës dhe fundjavës</li> </ul>

<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të hapen barnatore në komunë</li> <li>□ Të pasurohet rrjeti i institucioneve sociale në komunë</li> <li>□ Të analizohen nevojat dhe të hapen kopshte fëmimore (qendra ditore) në vendbanimet me numër më të madh të fëmijëve</li> </ul>
<i>Kulturë/Sport/Argëtim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të hapen shtëpi për persona të moshuar</li> <li>□ Të ndërtohen terrene sportive edhe për sportet tjera veç futbollit</li> <li>□ Të promovohet zhvillimi i sektorit joqeveritar dhe të krijohen shoqata të reja të qytetarëve</li> <li>□ Të ndërtohet kinema dhe teatër, ose të riparohet një nga shtëpitë e kulturës në suazat e të cilës do të ketë kinema dhe sallë teatri</li> </ul>
<i>Subjekte ekonomike:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të promovohet zhvillimi i mediave në komunë (hapja e radios, TV stacionit dhe gazetës)</li> <li>□ Të stimulohet zhvillimi i subjekteve të mëdha afariste të cilat do të mund të absorbojnë fuqi më të madhe punëtore</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të promovohen programe për punësimin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale</li> <li>□ Të përmirësohet targetimi i masave aktive kah të papunësuarit afatgjatë, si dhe efikasiteti lidhur me punësimin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale</li> <li>□ Të drejtohen masat për trajnim, rikualifikim dhe kualifikim kah profesionet deficitare në komunë (për ato me kualifikime të ulta lidhur me profesionet e ndërtimtarisë)</li> <li>□ Të realizohen programe preventive për ndalimin e dukurisë së delikuencës së mitur, dhunës familjare, si dhe martesave mes të miturve</li> <li>□ Të përforcohet punë këshillëdhënëse me amvisëritë e prekura nga këto kategori të problemeve</li> <li>□ Të hapet shelter qendër për dhunë familjare</li> <li>□ Të pasurohet rrjeti i shërbimeve sociale për personat e moshuar: të analizohen mundësitë për hapjen e shërbimeve sociale për ndihmë në kushte shtëpiake, qendra ditore, shtëpi të vogla grupore</li> <li>□ Të rishqyrtohet puna e klubeve ekzistuese për punë me persona të moshuar në Çashkë dhe Bogomillë, të pasurohen aktivitetet programike të cilat ofrohen në klube, në drejtim të shfrytëzueshmërisë së tyre</li> <li>□ Të hapen qendra ditore për personat me invaliditet (fëmijë dhe të rritur)</li> <li>□ Të shqyrtohen mundësitë për hapjen e serviseve për</li> </ul>
<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	

ndihmë në kushte shtëpiake

<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>□ Të përmirësohet infrastruktura lokale (asfaltimi i rrugëve lokale)</li></ul>
	<i>Ujësjellës:</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>□ Të rregullohet menaxhimi me ujësjellësat në vendbanimet ku nuk menaxhon NPK Topollka</li><li>□ Të gjenden mekanizma për kontrollë të rregulltë të ujit në të gjitha vendbanimet</li></ul>
	<i>Kanalizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>□ Të vendoset kanalizim në të gjitha vendbanimet</li></ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"><li>□ Të gjendet zgjidhje për mbledhjen e organizuar të mbeturinave të ngurta me çfarë do të zgjidhet problemi me deponitë ilegale dhe lumenjt e ndotur</li></ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërinstitucional në komunë</b>		<ul style="list-style-type: none"><li>□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës së Çashkës me të gjitha komunat fqinje</li><li>□ Përmirësim i bashkëpunimit mes komunës, QPS dhe Qendrës për punësim përmes zbatimit më intenziv dhe më efikas të punëve publike, masave aktive për punësim të shfrytëzuesve të ndihmës sociale, anëtarësimit në organe të përbashkëta, edukim për mundësitë dhe format e bashkëpunimit të tyre në sferën e mbrojtjes sociale, si dhe zbatim praktik i projekteve të përbashkëta</li><li>□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës me sektorin privat dhe organizatat fetare përmes kyçjes së tyre si partnerë në realizimin e programeve nga sfera e mbrojtjes sociale</li></ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<i>Nga komuna:</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>□ Përforsim i Sekcionit për arsim, kulturë, shëndetësi, mbrojtje sociale, sport dhe bashkëpunim me shoqatat qytetare dhe fondacionet duke punësuar një punonjës social</li><li>□ Edukim i të punësuarve në Njësi, për mundësitë dhe format e zhvillimit të funksioneve socialo-mbrojtëse të komunës</li><li>□ Edukim për planifikim strategjik dhe krijim të programeve nga sfera e mbrojtjes sociale</li><li>□ Zgjerim i formave të mbrojtjes sociale të cilat i realizon komuna (kryesisht ndihmë financiare) me forma të reja të shërbimeve sociale</li><li>□ Rritje e përqindjes e cila ndahet nga buxheti i komunës për mbrojtje sociale dhe planifikim më i detajuar dhe më sistematik i atyre mjeteve buxhetore</li></ul>
	<i>Nga QPS:</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>□ Ulje e shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para përmes intenzivimit të aktiviteteve për punësimin e tyre në bashkëpunim me Qendrën për punësim</li><li>□ Analizë e mundësive për zgjerimin e përfshirjes së amvisërive shfrytëzuese të ndihmës sociale me shërbimet e kuzhinës popullore</li></ul>

- 
- Zhvillim i rrjetit të mbrojtjes institucionale dhe joinstitucionale në komunë. Komuna disponon me objekte të cilat mund të shfrytëzohen për hapjen e shtëpive të vogla grupore për persona të moshuar, shelter qendra për mbrojtjen e viktimave nga dhuna familjare dhe qendra ditore për personat me invaliditet (fëmijë dhe të rritur).



# KOMUNA E PEHÇEVËS

## 1. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË KOMUNËS SË PEHÇEVËS

Komuna e Pehçevës gjendet në pjesën lindore të Republikës së Maqedonisë, në pjesën veri-lindore të luginës së Maleshevës, në kufi me Republikën e Bullgarisë. Ajo është e vendosur mes komunës së Berovës në jug dhe Dellçevës në veri. Komuna e Pehçevës gjendet në lartësi mbidetare të mesme prej 1000 metrave dhe shtrihet në një territor prej 206,8 km<sup>2</sup>. Konfiguracioni gjeografik i terrenit është kryesisht kodrino-malor me tre rrjedha të vazhdueshme ujore. Në komunë ka një bashkësi urbane Pehçeva dhe gjashtë bashkësi rurale: Nagrevo, Umlena, Robovo, Crnik, Pançarevë, Çiflik (të cilat bien në kategorinë e fshatrave kodrino-malore).

Numri i përgjithshëm i banorëve në komunën e Pehçevës është 5.517 banorë. Pjesa më e madhe e banorëve janë të vendosur në qendrën komunale të Pehçevës (3.237 banorë), ndërsa pjesa tjetër në vendbanimet tjera nëpër fshatra: Nagrevo (170 banorë), Umlena (391 banorë), Robovo (470 banorë), Crnik (752 banorë) dhe Pançarevo (467 banorë). Nga numri i përgjithshëm i banorëve, 51% janë meshkuj ndërsa 49% femra. Sa i takon strukturës etnike të popullatës, dominuese është popullata maqedonase (85.86 %), ndërsa nga bashkësitë e tjera etnike ka turq (6.47 %), romë (7.07 %), vlllehë (0.04 %), serbë (0.22 %) dhe të tjerë (0.34%). Pjesa më e madhe e popullatës (58.7%) jeton në vendbanime urbane, ndërsa një pjesë më e vogël (42.3%) në rurale. Struktura moshore e popullatës në komunë tregon se ka tendencë të plakjes së popullatës. Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2002, 27.8% prej banorëve janë në moshë 0-19 vjeç, 52.3% janë në moshë prej 20 deri më 60 vjeç, ndërsa 19.9% janë mbi 60 vjeç.

Regjioni i Maleshit dhe komuna e Pehçevës disponojnë me resurse të mëdha natyrore, potencial malor dhe mjedis të pastërt dhe të pandotur. Në fazë përfundimtare është përpilimi i Planit të detajuar urbanistik për vendbanimin turistik “Ramna Reka”, - vendbanim me lokacione për 300 objekte për pushim dhe rekreim, dy motele të ndërtruara me bazene peshqish me ujë rrjedhimor dhe dy lokacione të siguruara me dy pulla për ndërtimin e hoteleve, gjë e cila shumë do ta përparojë kualitetin e turizmit dhe ofertës turistike në komunë. Resurse të rëndësishme janë bakri në malin Kadmica dhe qymyri në fshatrat Pançarevë dhe Crnik, të cilat janë hulumtuar mirëpo ende nuk eksploatohen.

Potencialet për zhvillimin e komunës shihen në shfrytëzimin e potencialeve për prodhimin e ushqimit, përpunimit të drurit, prodhimtarisë së materialeve rezistuese ndaj zjarrit, turizëm, si dhe në shfrytëzimin e ujërave nga lumi Bregallnica dhe ndërtimin e katër hidrocentraleve rrjedhëse.

Në territorin e komunës së Pehçevës ka lokalitete të rëndësishme arkeologjike, të cilat jo mjaft janë të hulumtuara dhe të mbrojtura.

## 2. KAPACITETE INSTITUCIONALE

**Arsim:** Në komunën e Pehçevës ka një shkollë qendrore për arsim fillor SHF “Vanço Kitanov”-Pehçevë. Në kuadër të shkollës punojnë edhe tre shkolla fillore deri në klasë të pestë, në fshatrat: Crnik, Robovo dhe Umlena. Në qytetin e Pehçevës nga viti shkollor 2008/09 mësimi për arsimin e mesëm në gjimnaz zhvillohet në gjashtë klasa të disperzuara të SHM “Aco Ruskovski”- Berovë. Nuk ka shkolla të mesme teknike dhe as speciale.

**Shëndetësi:** Mbrojtja primare shëndetësore në komunën e Pehçevës sigurohet në Shtëpinë shëndetësore të vendosur në qytetin e Pehçevës, në të cilën ofrohen shërbime specialistike nga mjekësia interne, radiologji dhe shërbime oftalmologjike. Në territorin e komunës ka dhjetë institucione shëndetësore private, gjegjësisht katër ordinanca për mjekësi të përgjithshme me mjekë amë, pesë ordinanca stomatologjike dhe një ordinancë gjinekologjike. Në Pehçevë punojnë dy barnatore private dhe një barnatore e ambulancës, e cila është e vendosur në shtëpinë shëndetësore të Pehçevës. Në një pjesë të fshatrave nuk ka as ambulanca të disperzuara në të cilat do të ofrohen shërbimet bazike mjekësore. Ka shërbim për ndihmë të shpejtë, mirëpo i njëjti nuk disponon me veturë speciale. Shërbimi ka dy vetura të vjetra të cilat janë në një gjendje relativisht të mirë. Në komunën e Pehçevës nuk ka poliklinikë, as klinikë specialistike, ndërsa banorët në rast nevoje shkojnë në Koçan, Shtip ose Shkup.

**Institucione sociale:** Në komunën e Pehçevës ka një institucion për arsim dhe edukim parashkollor i cili është vendosur në qytetin e Pehçevës. Në vijim është hapja e një dege në fshatin Crnik me ndihmë donuese nga Komisioni Evropian, gjegjësisht nga Fondi Edukues Rom. Nuk ka kopsht fëmënor privat. Në komunën e Pehçevës nuk ka shtëpi publike për persona të moshuar, e as private.

**Institucione kulturore:** Në komunën e Pehçevës institucion më i rëndësishëm në të cilin realizohet një pjesë e ngjarjeve kulturore është shtëpia e kulturës “Jane Sandanski”. Në qytetin e Pehçevës ka bibliotekë amë “Koço Racin”. Nuk ka muze, kinema e as teatër.

**Objekte sportive:** Në komunën e Pehçevës ka dy salla sportive nga të cilat njëra sapo është lëshuar për përdorim. Terrene sportive të llojit të hapur ka edhe në qytet edhe në fshatra.

**Media:** Në komunën e Pehçevës ka një radio lokale private. Nuk ka gazeta lokale e as televizion lokal.

**Shoqata qytetare:** Deri në vitin 2008 janë regjistruar 24 shoqata të qytetarëve, mirëpo aktive janë vetëm disa prej tyre: SHQ “Procrnik” f. Crnik, Organizata e grave Pehçevë, Organizata e grave romë “Dajakere Çave”, SHQ “Biomalesh” Pehçevë, SHE “Kladenec” Pehçevë dhe SHE “Sollza” Pehçevë.

**Subjekte ekonomike:** Degë kryesore ekonomike janë bujqësia, pylltaria, xehetaria, industria tekstile dhe turizmi. Në territorin e komunës së Pehçevë funksionojnë disa objekte më të mëdha ekonomike me mbi njëqind të punësuar (AD Bomeks-Refraktori Pehçevë, AD Napredok-Pehçevë dhe AD Fagus-Pehçevë) dhe disa subjekte më të vogla dhe biznese familjare për përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe prodhimin e materialeve të drurit, pjesëve të mobiljeve dhe mobilje. Pjesa më e madhe e kapaciteteve më të mëdha janë mbyllur gjatë transformimit të kapitalit shoqëror.

### 3. PROBLEME DOMINUESE NË KOMUNË

**Probleme sociale:** Problemet dominuese sociale në komunë janë të ndërlidhura me zhvillimin social: varfëria, papunësia dhe ç’kyçja sociale. Të papunësuar janë gjithsej 1050 banorë, nga të cilët gjysma (518) janë femra. Duke e pasur parasyhë vendosjen e kapaciteteve industriale dhe institucioneve publike në

qendrën komunale, pjesa më e madhe e personave të papunësuar gjendet në vendbanimet rurale. Shkalla e papunësisë është më e lartë tek personat në moshë 50 deri më 50 vjeç dhe është 26.4% (277 persona), pastaj 22.6% (237) papunësi tek personat në moshë mes 35-44 vjeç dhe 20.8% (219 persona) në moshë mes 24-34 vjeç. Posaçërisht brengosëse është shkalla e lartë e papunësisë tek personat e rinj në moshë mes 20 dhe 24 vjeç, gjegjësisht 9.4% (99 persona nga të cilët 50 janë femra) nga numri i përgjithshëm i të papunësuarve. Pjesa më e madhe e personave të papunësuar janë fuqi punëtore me kualifikime të ulta (549 nga të cilët 265 janë femra), pastaj me arsim të mesëm të kryer (229 nga të cilët 125 femra), dhe një pjesë më e vogël (89 nga të cilët 54 femra) janë me arsim të lartë ose universitar të kryer. Nga numri i përgjithshëm i të papunësuarve, 27.6% presin punësim për më tepër se tetë vite.

Në territorin e komunës së Pehçevës nuk ka Qendër për punësim, si institucion përkatës për veprim në rast të papunësisë. Përgjegjës është Qendra për punësim në Berovë, e cila realizon aktivitete dhe programe për vetëpunësim, program për përkrahje të formlizimit të izneseve ekzistuese, punësim i subvencionuar (prindër të vetëm, çifte bashkshortore me tre dhe më tepër fëmijë, persona të cilët kanë mbetur pa punë për shkak të falimentimit, likudimit ose si tepricë teknologjike, persona më të moshuar se 55 vjeç dhe persona të rinj deri më 27 vjeç). Qendra për punësim në vitin 2009 ka realizuar edukime për fillimin dhe krijimin e biznes planeve, trajnim për përforsim ekonomik të grave viktime të dhunës familjare, si dhe anketë për aftësitë dhe dijenitë e nevojshme në tregun e punës në komunën e Pehçevës.

Sipas vlerësimeve të Qendrës lokale për punësim si kategori më e rrezikuar e qytetarëve nga aspekti i punësimit, dallohen personat të cilët kanë kryer arsim të lartë. Tek të njejtit ekziston pajtueshmëri dhe interes për tu punësuar edhe në vende pune për të cilat është paraparë shkallë më e ulët e arsimit dhe për punë për të cilat do të paguhen më pak. Sa u takon shfrytëzuesve të shërbimeve të mbrojtjes sociale është e nevojshme të shqyrtohen mundësitë për stimulimin e punësimit të tyre përmes masave ligjore për kushte të volitshme dhe përkrahje të drejtëpërdrejtë (pagimi i kontributeve për punësim më të gjatë kohor).

Nevoja për fuqi punëtore është shumë e vogël dhe nuk mund të kontribuojë për ulje domethënëse të papunësisë. Në përgjithësi prezente janë të gjitha profesionet dhe kuadrot për të cilat punëdhënësit kanë shprehur nevojë. Megjithatë, e pavolitshme është struktura moshore (për shkak të pjesëmarrjes më të madhe të fuqisë punëtore me moshë më të vjetër).

Si probleme më të rëndësishme, të cilat fitojnë dimesione më serioze në periudhën e fundit veçohen problemet sociale të personave të moshuar. Si rezultat i migrimeve intenzive në Pehçevë, paraqitet një kategori e qytetarëve e cila ka nevojë për ndihmë dhe mbrojtje. Duke e pasur parasysh faktin se në komunën e Pehçevës aspak nuk është zhvilluar rrjeti i shërbimeve sociale lokale për personat e moshuar, ky problem merr edhe në intenzivitet.

Bashkësia rome veçohet si grup i posaçëm etnik, i cili më së tepër ballafaqohet me probleme sociale. Pjesa më e madhe e romëve në komunën e Pehçevës (80%) janë të vendosur në fshatin Crnik. Struktura etnike e këtij fshati përfshin romë (40%), maqedonas (30%) dhe turq (30%). Pjesa më e madhe e tyre, rreth 94%, janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Në një masë të madhe popullata ballafaqohet me problemin e ç'kyçjes shoqërore, sociale dhe kulturore. Vetëm shtatë gra rome në moshë deri më 35 vjeç kanë mbaruar shkollë të mesme.

Në komunën e Pehçevës në një masë më të vogël paraqiten edhe probleme sociale lidhur me sjelljen devijuese dhe probleme sociale lidhur me fatkeqësitë natyrore.

**Probleme infrastrukturale:** Komuna e Pehçevës ka një rrjet infrastrukturual relativisht të mirë. Të gjitha vendbanimet paisen me ujë të pishëm. Një pjesë e fshatrave janë të kyçura në ujësjellsin e ri regjional, ndërsa një pjesë e tyre disponojnë me sisteme vetanake për ujësjellje. Në proces e sipër është ndërtimi i stacioneve pastruese për ujërat e zeza të më shumë objekteve, gjegjësisht ndërtimi i sistemeve të reja për largimin e ujërave të zeza në vendbanimet Umlen, Crnik, Robovo dhe Pançarevo dhe ndryshimi i gypave të vjetruara të azbesta në Pehçevë. Në vitin 2009 është sanuar e vjetra dhe është ndërtuar deponi e re qytetare për deponimin e mbeturinave komunale. Të gjitha vendbanimet kanë lidhshmëri rrugore me qendrën komunale. Edhe pse qasja në dhe nga vendbanimet është e asfaltuar, duhet të theksohet se rrjeti rrugor në vendbanimet fshatare është me rrugë të tamponuara dhe rrugë me bazë dheu.

**Probleme ekologjike:** Në komunën e Pehçevës si probleme më të rëndësishme ekologjike veçohen problemet me trajtimin e mbeturinave komunale, si dhe kualiteti i ujit të pishëm jashtë vendbanimeve dhe në një pjesë të vendbanimeve në fshatra gjatë një periudhe të caktuar kalendarike të viti.

#### 4. MBROJTJA SOCIALE NË KOMUNË

**Administrata komunale:** Në suazat e administratës komunale nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale dhe jurisdikcionet realizohen nga ana e Njësisë për resurse njerëzore dhe Njësisë për urbanizëm, punë komunale dhe zhvillim ekonomik lokal. Nga numri i përgjithshëm i personave të punësuar në administratë, nëntë persona kanë statusin e nëpunësve shtetëror. Me sistematizimin e ri të vendeve të punës parashihet punësimi i një punonjësi social. Komuna nuk ka përgatitur plan veprues ose strategji për zhvillim social. Në fazë të përgatitjes është Rregullorja për strehimin e të pashtëpive dhe parashikimi i mjeteve buxhetore për këtë kategori të qytetarëve. Bashkëpunimi me qytetarët më së shpeshti ndodh përmes tubimit të qytetarëve, radios lokale dhe lajmërimeve, mirëpo deri tani nuk ka pasur iniciativa qytetare, as po referendum lokal. Si formë e ndihmës për popullatën socialisht të rrezikuar, komuna jep ndihmë të njëhershme në para në shumë prej 3000-5000 denarë, për dhënie të cilës kompetent është Këshilli dhe Kryetari i komunës. Nga ana e Këshillit të komunës është miratuar vendim me të cilin parashihet që ushqimi në shkollë, për fëmijët të cilët janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, të mbuloht nga buxheti komunal. Megjithatë, në kornizat e fokus grupeve, nga ana e disa shfrytëzuesve u theksua se ato nuk kanë kurrëfar informata për mundësinë e shfrytëzimit të ushqimit falas dhe se nuk e shfrytëzojnë këtë lloj ndihme.

**Qendra për punë sociale:** Qendra për punë sociale, e cila është vendosur në Berovë është përgjegjëse edhe për banorët në Pehçevë. Në Pehçevë ka vetëm zyrë për të dhëna materiale, në të cilën mund të realizohen format e ndihmës sociale në para, ndihma e përhershme në para dhe ndihma dhe kujdesi nga personi i huaj. Numri i të punësuarve profesionistë në zyrën e QPS është tre persona, nga të cilët dy janë punonjës social dhe një sociolog. Zyrat dhe kapacitetet teknike nuk janë në një nivelin e duhur. Zyra ka në disponim dy dhoma me sipërfaqe prej rreth 35 m<sup>2</sup> dhe tre kompjuterë. Nuk ka veturë.

Zyra për të dhëna materiale në përgjithësi shumë pak bashkëpunon me sektorin joqeveritar, organizatat fetare dhe sektorin privat. Me komunën janë të përfshira në organizimin e edukimeve dhe tribunave të përbashkëta. Duke pasur parasysh se zyra është kompetente për veprim në procesin administrativ gjatë realizimit të të drejtave në para, e njejta nuk ka bashkëpunim me shkollat dhe institucionet shëndetësore.

Si probleme më të rëndësishme të zyrës për të dhëna materiale veçohen mospasja e veturës dhe mungesa e lidhshmërisë rrjetore, me çfarë do të lehtësohet qasja në informata dhe me të vetë procesi. Probleme më të mëdha gjatë punës paraqiten atëherë kur qytetarët do të rrefuzohen në realizimin e një të drejte, si rezultat i përcaktimit të ndonjë gjendje faktike të paraparë me ligj (psh: në bazë të subvencioneve të dhëna për tokë bujqësore ndalohet ndihma sociale në para).

Në komunën e Pehçevës theksohet nevoja për hapjen e një Qendre për punë sociale ose më së paku zgjerim i kompetencave të zyrës së përhershme për të dhëna materiale, me çfarë do të lehtësohet realizimi i të drejtave nga mbrojtja sociale. Situata e tillë e imponon nevojën që banorët e komunës së Pehçevës në rast të nevojës për realizimin e ndonjë të drejtë nga mbrojtja institucionale dhe joinstitucionale, si dhe një pjesë të të drejtave nga ndihma në para nga mbrojtja sociale të cilat nuk realizohen në zyrën për të dhëna materiale, të udhëtojnë në Berovë.

**Numri dhe strukturat e shfrytëzuesve të masave dhe shërbimeve nga mbrojtja sociale:** Analiza e strukturës së shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale në territorin e komunës së Pehçevës tregon se 168 amvisëri janë shfrytëzues të ndihmës sociale në para, 9 familje shfrytëzojnë ndihmë të përheshme në para dhe 136 persona paraqiten si shfrytëzues të ndihmës dhe kujdesit nga personi i huaj. E drejta e ndihmës në para nga mbrojtja sociale më së shpeshti nuk realizohet si rezultat i posedimit të tokës bujqësore, posedimit të veturës motorike dhe shtëpisë në ndërtim.

Në komunën e Pehçevës nuk ka shtëpi për strehim ditor ose të përkohshëm të shfrytëzuesve, nuk ka familje strehuese, as shtëpi të vogël grupore. Institucionalisht janë të strehuar tre fëmijë, nga të cilët një fëmijë në SOS Detsko Sello në Shkup, një në Banja Bansko dhe një në Demir Kapi.

Në komunën e Pehçevës funksionon kuzhina popullore, në të cilën përgatiten 50 ushqime në ditë. Funksionimi i kuzhinës popullore financiarisht përkrahet nga Ministria për punë dhe politikë sociale.

Sa u takon formave të reja të subvencionimit të varfërisë energjetike në suazat e fokus grupeve u theksua problemi i ndërlidhur me përmbushjen e kushteve për realizimin e të drejtave:

*“Na kërkohet fakturë të paguar të rrymës për muajin e kaluar. Unë jetoj me qira dhe prej ku unë t’ju sjell fakturë në emrin tim. E luta pronarin që ta transferojë numresën në emrin tim, mirëpo ai nuk pajtohet ... “*

*„Cili mund ta shfrytëzojë atë të drejtë kur asnjë prej nesh nuk ka paguar rrymë për disa vite me rradhë...“*

## **5. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS ME AKTORËT LOKAL**

Komuna bashkëpunon me BNJVL, megjithatë ai bashkëpunim nuk ka të bëjë me çështjet nga sfera sociale. Në përgjithësi më tepër ka të bëjë me përkrahje teknike dhe nuk paraqet një ndihmë të madhe për komunën. Veçohet nevoja që të paguhet anëtarësim për pjesëmarrje në këtë organizatë.

Komunë e Pehçevës ka krijuar një bashkëpunim regional në veçanti me komunat në rrethinë, siqë është Berova dhe Dellçeva, para së gjithash në projekte infrastrukturale, si dhe në nivel të ndërtimit të planeve strategjike për uljen e problemeve sociale në regjion.

Bashkëpunimi i komunës me Agjencinë për punësim u realizua gjatë përpilimit të Planit lokal veprues për punësim në Berovë dhe Pehçevë 2009-2011, si dhe gjatë angazhimit të shfrytëzuesve për zbatimin e punëve publike. Në dy vitet e fundit, në komunën e Pehçevës nuk janë angazhuar shfrytëzues të ndihmës sociale në para për zbatimin e punëve publike, për shkak se vetë ato rrefuzojnë të marrin pjesë dhe angazhimi i tyre sjell uljen e popullaritetit të pushteteve lokale.

Komuna ka realizuar bashkëpunim me shoqatat qytetare më së shpeshti përmes organizimit të ngjarjeve, projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta. Bashkëpunim të mirë ka me Organizatën e grave të Pehçevës, shoqatën ekologjike "Klladenc", SHQ "Bio Malesh", ndërsa paraqitet edhe si bashkfinancier i disa aktiviteteve të organizatave rome.

Bashkëpunimi me sektorin privat nuk është mjaft i zhvilluar. Në përgjithësi bashkëpunohet kur ka prezantime të kapaciteteve ekonomike të komunës nëpër panaire, çështje të ndërlidhura me urbanizmin, infrastrukturën lokale dhe nxitjen e sipërmarrësisë.

Bashkëpunimi me pushtetin qendror ndodh përmes projekteve të përbashkëta, siqë është kuzhina popullore, si dhe projekte nga sfera e arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës etj. Megjithatë, theksohet nevoja për intenzivim të procesit të decentralizimit dhe ndryshim të sistemit të financimit të njësisive të vetëqeverisjes lokale, me çfarë do të zmadhohen burimet e të ardhurave të komunave.

Në komunë është formuar Këshilli lokal për parandalim, në të cilin marrin pjesë të gjithë aktorët relevant në komunë. Këshilli mban takime të rregullta, në të cilat targetohen disa çështje të caktuara sociale të cilat janë në interes të komunës. Realizimi i këtij aktiviteti financiarisht përkrahet nga OSBE-ja.

## **6. REZULTATE NGA HULUMTIMI ANKETUES I AMVISËRIVE NË KOMUNËN E PEHÇEVËS**

### **6.1. Të dhëna të përgjithshme për amvisëritë e anketuara**

Në komunën e Pehçevës janë anketuar gjithsej 100 amvisëri. Sipas vendbanimit, 63% nga amvisëritë e anketuara jetojnë në vendbanime urbane, ndërsa 37% në vendbanime rurale. Struktura e amvisërive të anketuara sipas llojit të amvisërisë, tregon se numri më i madh i të anketuarave janë jobujqësore (33%),

pastaj bujqësore (15%), të përziera (37%), 13% janë përgjigjur se nuk e dinë se cilit karakteri i takon amvisëria e tyre, ndërsa 2% kanë rrefuzuar të përgjigjen.

Grafiku 1.



Grafiku 2.



Numri i të anketuarve sipas llojit të vendbanimit

Rurale  
Urbane

Pehçevë  
Umlena  
Çiflig


Lloji i amvisërisë

Bujqësore  
Jobujqësore  
E përzier  
Rrefuzon të përgjigjet  
Nuk e di

Shpërndarja e amvisërive sipas përkatësisë etnike, tregon se 92 amvisëri janë deklaruar si maqedonase, shtatë amvisëri janë deklaruar si rome dhe një amvisëri si serbe. Më e madhe është prezenca e amvisërive katër anëtarëshe (35%), ndërsa më e vogël prezenca e amvisërive një anëtarëshe (4%). Në 92 amvisëri koka e familjes është mashkull, në 7 femër, ndërsa në një rast i/e anketuari ka rrefuzuar të përgjigjet. Në shumicën e rasteve koka e amvisërisë është në bashkësi martesore (86%), në 7% të rasteve

bëhet fjalë për persona të cilët janë të pamartuar/a, 2% të divorcuar/a dhe në 5% të rasteve bëhet fjalë për të vejë.

Grafiku 3.



Statusi martesor i kokës në amvisëri

i/e pamartuar  
i/e martuar  
i/e divorcuar  
i/e vejë

Edhe pse 96% të personave të anketuar dinë shkrim-lexim, pjesa më e madhe janë me arsim fillor (27%) dhe me arsim të mesëm (56%), pa arsim janë 2%, ndërsa me arsim të lartë dhe universitar janë 15%. Në shumicën e amvisërive koka e familjes është punëtor (39%), pastaj pensioner (19%), bujk (13%), teknik (7%) dhe amvis (1%). Duhet të veçohet se 11% nga të anketuarit janë deklaruar si të papunësuar, nga të cilët 1% si tepriçë teknologjike, ndërsa 2% punonjës të falimentuar.

Grafiku 4.



Profesioni momental i kokës në amvisëri

Bujk  
Profesionist  
Teknik

Punëtorë  
Udhëheqës  
Të punësuar të tjerë

Nëpunës  
Pensioner  
Tjetër – punonjës i falimentuar

Si shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale janë deklaruar 45 të anketuar. Sipas llojit të amvisërisë, ka një shpërndarje relativisht të barabartë të shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, ku llojit të amvisërive bujqësore ju takojnë 26.7%, jobujqësore ju takojnë 37.8%, ndërsa të përzierave 24.4% të amvisërive. Mes amvisërive të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, tek 80% nuk ka asnjë të punësuar, tek 15.6% ka një të punësuar, ndërsa tek 4.4% dy anëtarë të amvisërisë të cilët janë të punësuar.

Grafiku 5.



Shfrytëzues të ndihmë në para nga mbrojtja sociale sipas llojit të amvisërisë

Po

Jo

Rrefuzon të përgjigjet

Nuk e di

E përzier

Jobujqësore

Bujqësore

## 6.2. Punësim

Duhet të theksohet se tek 38% të amvisërive nuk ka asnjë të punësuar, në 32% të amvisërive ka nga një anëtarë të punësuar, në 27% dy anëtarë të punësuar, ndërsa në tre amvisëri ka nga tre persona të punësuar. Vetëm në një amvisëri është evidentuar vetëm një anëtar i vetëpunësuar. Në 39.1% të amvisërive ku koka e amvisërisë është mashkull nuk ka asnjë të punësuar, në 28.3% ka vetëm një të punësuar, ndërsa në 29.3% ka dy të punësuar. Tendencë e ndryshme paraqitet tek amvisëritë ku koka e amvisërisë është femër. Gjegjësisht, në këto amvisëri në pjesën më të madhe (71.4%) ka nga një anëtar të punësuar, ndërsa në 28.6% asnjë nuk është i punësuar. E rëndësishme është të ceket se nuk gjendet amvisëri ku koka e familjes është femër dhe ka më tepër se një të punësuar.

Grafiku 6.



Numri i të punësuarve sipas gjinisë së kokës në amvisëri

Meshkuj

Femra

Asnjë

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të anketuara, 57 ballafaqohen me problemin e papunësisë. Në pjesën më të madhe të amvisërive ka nga një anëtarë (30%), në 19% ka nga dy të papunësuar, ndërsa në 8% nga tre deri më pesë të papunësuar. Në 7% të amvisërive ka nga një anëtarë, ndërsa në 5% nga dy anëtarë, të cilët janë tepricë teknologjike ose punonjës të falimentuar. Nga numri i përgjithshëm i të papunësuarve 40 janë meshkuj, prej të cilëve 38 janë anëtarë të amvisërive ku koka e familjes është mashkull, ndërsa dy në amvisëri ku koka e amvisërisë është femër. Numri i femrave të papunësuar është më i madh (55), nga të cilët vetëm një person është antarë i amvisërisë ku koka është femër.

Grafiku 7.



Пërfaqësimi gjinor i personave të papunësuar në amvisëri

Meshkuj

Femra

### 6.3. Standardi jetësor

Analiza e të dhënave të fituara tregon se 41 amvisëri nuk kanë realizuar kurrëfar të ardhura nga marrëdhëniet e rregullta pune në 12 muajt e kaluar. Në suazat e familjeve ku femra si koka e amvisërisë paraqitet në përqindje më të madhe, gjegjësisht 71,.% e amvisërive ku janë realizuar të ardhura nga puna për dallim të 57.6% të amvisërive ku koka e familjes është mashkull. Pjesa më e madhe e amvisërive të cilat kanë realizuar të ardhura nga marrëdhënie të punës janë familje punëtore (61%), pastaj pasojnë nëpunës ose profesionistë (17.2%), bujq (3,4%) dhe amvisëri ku koka e amvisërisë është pensioner (5%). Nga gjithsej 45 amvisëri të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, vetëm 8, gjegjësisht 17.8% prej familjeve kanë realizuar të ardhura nga marrëdhëniet e rregullta pune në 12 muajt e fundit.

Grafiku 8.



Sipas cilës baze janë realizuar të ardhurat në 12 muajt e fundit

- Marrëdhënie të rregullta pune
- Marrëdhënie të çrregullta pune
- Pensione
- Të ardhura nga jashtë
- Bujqësi
- Qira/shitje e pronës
- Hua
- Ndihmë nga familjarë

Tërheq vëmendje fakti se në komunën e Pehçevës paraqiten 28 amvisëri të cilat kanë realizuar të ardhura nga marrëdhënie të çrregullta pune dhe atë 16 amvisëri janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Të ardhura nga marrëdhënie të çrregullta pune kanë realizuar 29.3% nga amvisëritë ku koka e është mashkull dhe 14.3% nga amvisëritë ku koka e amvisërisë është femër. Prej tyre, 35.7% janë familje puntorësh, 25% bujqësore dhe 7.1% ku koka e amvisërisë është teknik. Interesant për tu theksuar është se gati gjysma (46.7%) e shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, kanë realizuar të ardhura nga veprimtaria bujqësore. Gjithashtu, për tu veçuar është se një e treta nga familjet punëtore dhe dy të tretat nga familjet e nëpunësve kanë realizuar të ardhura nga veprimtaria bujqësore. I vogël është numri (1%) i amvisërive të cilat kanë realizuar të ardhura nga prona (qira, shitje). Vetëm 8% nga amvisëritë e anketuara, nga të cilat 50% bujqësore, 25% punëtore dhe nga 12.5% të teknikëve dhe të papunësuar kanë marrën ndihmë nga ndonjë familjarë i afërt. E vogël është përqindja e solidaritetit mes shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

Pjesa më e madhe e amvisërive (22%) kanë realizuar të ardhura mes 10001-14000 mkd, ndërsa 18% në muajin e fundit kanë realizuar të ardhura prej 50001 deri më 1000 mkd. Të ardhura në shumë prej 14001 deri më 18001 kanë realizuar 13% nga amvisëritë, 21% kanë realizuar të ardhura prej 18001 deri më 30000 mkd dhe 5% prej amvisërive kanë realizuar të ardhura mbi 30001 mkd. Vëmendje të posaçme tërhekin të dhënat lidhur me amvisëritë të cilat fitojnë 5000 mkd dhe janë 21% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve.

Grafiku 9.



Shuma e të ardhurave të realizuara në amvisëri në muajin paraprak

Deri më 5.000 mkd

Mbi 30.001 mkd

Pjesa më e madhe e tyre (33.3%) janë familje ku koka e amvisërisë është i papunësuar, pastaj amvisëritë bujqësore (28.6%), si dhe nga 9.5% ku koka e amvisërisë është punëtor, pensioner dhe punonjës i falimentuar. Mandej, 42.2% prej amvisërive shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, realizojnë të ardhura nën 5000 denarë. Brengos fakti që në suazat e kësaj kategorie të amvisërive janë identifikuar dy amvisëri, të cilat nuk janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive ku koka e amvisërisë është femër, pjesa më e madhe, 57.1% realizojnë prej 18001 deri më 23000 mkd, ndërsa vetëm 14.3% realizojnë të ardhura deri më 5000 denarë. Për dallim të tyre, në amvisëritë ku koka e amvisërisë është mashkull, ka një shpërndarje relativisht të barabartë në shumatat më të ulta të të ardhurave, me tendencë të uljes së numrit të amvisërive të cilat kanë fituar të ardhura më të larta në muajin e kaluar.

Grafiku 10.



Shumën të cilën amvisëria e ka realizuar muajin e fundit sipas gjinisë

Deri më 5000 mkd

Mbi 30001 mkd


Meshkuj

Femra

Analiza e të dhënave lidhur me amvisëritë ku koka e familjes është i/e pamartuar tregon se 42.9% prej tyre kanë realizuar të ardhura më të vogla se 5000 denarë, ndërsa nga 14.3% kanë realizuar të ardhura në të gjitha intervalet e të ardhurave prej 5001 deri më 23000 denarë. Shpërndarja e të ardhurave në amvisëritë ku koka është i/e vejë është më e lartë (405) tek të ardhurat prej 10001 deri më 14000 denarë, ndërsa tek familjet ku koka e amvisërisë është i/e martuar në tre intervalet e para vërehet një shpërndarje mesatare prej 20.6%.

Sa i takon pyetjes për konsumimin e ushqimit të ngrohtë me mish, amvisëritë në të cilat gatuhet një herë në javë janë dominuese (30%), pastaj amvisëritë në të cilat përgatitet ushqim i ngrohtë me mish dy herë në javë (24%), ndërsa tek 21% të rasteve gatuhet tre herë në javë. Në 15% prej rasteve gatuhet më tepër se tre herë në javë dhe prej tyre 6% çdo ditë përgatisin ushqim të ngrohtë me mish. E rëndësishme është të veçohet përqindja e lartë e amvisërive (10%) në të cilat gjatë javës aspak nuk konsumohet ushqim i ngrohtë me mish. Në këtë kategori pjesa më e madhe (50%) janë amvisëri ku koka e amvisërisë është i/e papunësuar ose punonjës i falimentuar, ndërsa 30% janë punëtor dhe 20% janë pensionerë. Brengos fakti që në amvisëritë me anëtarë i cili është tepërcë teknologjike ose punonjës i falimentuar, ushqim i ngrohtë me mish gatuhet vetëm një herë ose aspak, ndërsa në suazat e familjeve me anëtarë të papunësuar vetëm në 12.5% gatuhet dy herë në javë.

Grafiku 11.



Konsumimi i ushqimit të ngrohtë brenda javës sipas profesionit të kokës në amvisëri

Punonjës i falimentuar  
 Tepriçë teknologjike  
 I papunësuar  
 Amvis/e  
 Pensioner  
 Profesionist  
 Punëtor  
 Bujk


Asnjëherë  
 Një herë  
 Dy herë  
 Tre herë  
 Katër herë  
 Çdo ditë (shtatë ditë)

Në suazat e kategorisë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, ushqim i ngrohtë me mish konsumohet më së shumti një herë (33.3%), gjegjësisht dy herë (28.9%), ndërsa 15.6% nga të

anketuarit kanë theksuar se asnjëherë gjatë javës nuk kanë përgatitur ushqim të ngrohtë me mish. Tendenca e njejtë vërehet edhe lidhur me shpërndarjen e përgjigjeve sipas gjinisë së kokës në familje, ku numri më i madh i amvisërive përgatisin ushqim të ngrohtë me mish një herë ose dy herë në javë (34.4%).

Numri më i madh i të anketuarve kanë theksuar se ju mungojnë para më së shumti për mbulimin e shpenzimeve të regjisë (banim, ujë, rrymë, karburantë) (50), nga 46 për shëndetësi dhe higjienë, për ushqim dhe pije joalkoolike, veshje dhe këpucë (44) dhe komunikacion (41). Një numër më i vogël i të anketuarve kanë theksuar se ju mungojnë para për rekreim dhe kulturë (37), për orendi shtëpiake dhe mobilje (34), komunikim (21), ndërsa më pak (10) kanë theksuar se ju mungojnë para për blerjen e pijeve joalkoolike dhe duhanit.

Grafiku 12.



Frekuenca e përgjigjeve të dhëna për mungesën e parave


- Ushqim dhe pije joalkoolike
- Pije alkoolike dhe duhan
- Veshje dhe këpucë
- Shpenzime të regjisë
- Orendi shtëpiake dhe mobilje
- Higjienë dhe shëndetësi
- Komunikacion
- Komunikim
- Rekreim dhe sport
- Arsim

Në suazat e grupit të shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja , një pjesë e të anketuarve (66.7%) kanë theksuar se ju mungojnë mjete për ushqim dhe pije joalkoolike, si dhe numri i njejtë për


shpenzime të regjisë dhe për higjienë dhe shëndetësi (57.8%). Gjithashtu, në një masë të madhe ju mungojnë mjete për veshje dhe këpucë (53.3%), orendi shtëpiake dhe mobilje (31.1%), komunikacion dhe transport (24.4%). Numri i njejtë i të anketuarve (17.8%) kanë theksuar se ju mungojnë mjete financiare për blerjen e alkoolit dhe duhanit, si dhe për përmbushjen e nevojave arsimore (17.8%). Sa i takon llojit të veshjes e cila ju mungon të anketuarve, më së shpeshti veçohet veshja dimrore (57), këpucë (15) dhe veshja solemne (11).

Pjesa më e madhe e amvisërive të anketuara (95%) jetojnë në banime me ndërtim të fortë. Me hulumtimin janë përfshirë edhe katër familje të cilat jetojnë në shtëpi me ndërtim të dobët/montazh, dhe një amvisëri në banesë të improvizuar. Numri më i madh i amvisërive jetojnë në banesë tre dhomëshe (38%), 28% në dy dhomëshe, 14% në katër dhomëshe, ndërsa 11% në banesë një dhomëshe (6%). Analiza e kushteve banuese sipas numrit të anëtarëve në amvisëri, tregon se pjesa më e madhe e amvisërive nuk ballafaqohen me probleme ambientale, përveç në një rast ku një familje shtatë anvtarëshe jeton na banesë një dhomëshe.

Grafiku 13.



Grafiku 14.



Numri i anëtarve në amvisëri sipas madhësisë së banesës

- Banesë më e madhe
- Katër dhomëshe
- Tre dhomëshe
- Dy dhomëshe
- Një dhomë
- Garsonjerë


Numri i dhomave të cilat amvisëria i ngroh

Një  
Dy  
Tre  
Katër dhe më shumë  
Nuk e di

Sa i takon mënyrës se si amvisëritë e ngrohin shtëpinë, është evidentuar një përndje e lartë e shfrytëzimit të koftorëve me lëndë të ngurta, dru (93), ndërsa një numër më i vogël e ngrohin shtëpinë me nxemje me avull vetanake (4) dhe një amvisëri me koftor me rrymë. Të dhënat për atë se se sa dhoma ngrohen, tregojnë për kualitet të zvogluar gjatë periudhës dimrore. Gjegjësisht, pjesa më e madhe e amvisërive (47%) ngrohin vetëm një dhomë në shtëpi, 29% dy dhoma, ndërsa 23% tre dhe më tepër dhoma.

Pjesa më e madhe e amvisërive (97) janë të kyçur në rrjetin kanalizues, ndërsa vetëm tre amvisëri, të gjitha shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, kanë gropë septike. 86 amvisëri, nga të cilat 34 janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale në shtëpi kanë tualet me banjo, tualet në oborr kanë 22 amvisëri, ndërsa tualet në banesë 6 amvisëri. Rezultatet tregojnë se një pjesë e madhe e amvisërive janë të kyçura në rrjetin ujësjellës, gjegjësisht çeshme në banesë kanë 97 amvisëri, ndërsa dy amvisëri shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, shfrytëzojnë gropë septike. Është evidentuar se tetë amvisëri nuk kanë ngrohës uji, nga të cilat dy nuk kanë nevojë, ndërsa pesë mund të blejnë. Tre nga amvisëritë të cilat nuk mund të blejnë ngrohës uji janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Një pjesë e amvisërive të anketuara kanë mungesë të aparateve bazike për amvisëri siç është shporeti elektrik (8), frigoriferi (3) dhe frigoriferi për ngrirje të thellë (17). Rreth dy të tretat e amvisërive (61) nuk kanë kompjuter, nga të cilat 33 nuk mund të blejnë, ndërsa 28 nuk kanë nevojë. Një pjesë e madhe e shfrytëzuesve (37.8%) nuk mund të blejnë kompjuter. Automobil nuk kanë 72 amvisëri, nga të cilat 52 nuk mund të blejnë.

Grafiku 15



Numri i amvisërive të cilat nuk kanë nevojë ose nuk mund të blejnë ndonjë aparat amvisërie

Shporet elektrik

Furrë

Ngrohës uji

Frigorifer

Frigorifer për ngrirje të thellë

Makinë për larjen e teshave

Makinë për larjen e enëve

Thithëse pluhuri

Klimë

Televizor

Kompjuter

Telefon

Celularë

#### 6.4. Probleme sociale dhe mbrojtja sociale

Analiza e të dhënave lidhur me problemet sociale tregon se më të rëndësishme janë problemet e ndërlidhura me zhvillimin social dhe atë papunësia (63), varfëria (60) dhe sëmundja (34). Gjithashtu, nga ana e amvisërive të anketuara, si probleme të rëndësishme cekën edhe marrëdhëniet problematike familjare (12), invaliditeti (11), ndërsa vërehet edhe nga një rast i delikuencës, divorcit dhe alkoolizmit. Të anketuarit

theksojnë edhe probleme sociale që kanë të bëjnë me proceset natyrore ekologjike: vërshimet (3) dhe zjarri (1).

Pjesa më e madhe e amvisërive të anketuara janë shfrytëzuese të të drejtave nga ndihma në para të mbrojtjes sociale, gjegjësisht 46% nga amvisëritë marrin ndihmë sociale në para, 11% nga amvisëritë marrin ndihmë të përhershme në para dhe 8% kompenzim në para për ndihmë nga personi i huaj. Pjesa më e madhe e amvisërive shfrytëzuese të ndihmës sociale në para, janë amvisëri bujqësore (26.1%), 19,6% punëtoare, 28.3% pensionerë, 2.2% amvis/e, dhe amvisëri ku koka e amvisërisë është anëtarë i papunësuar (19%) nga të cilët 6.5% janë tepriçë teknologjike ose punonjës i falimentuar.

Grafiku 16.



Shfrytëzimi i ndihmës sociale në para sipas profesionit të kokës në amvisëri

Bujk  
Amvise  
Punonjës i falimentuar

Punëtor  
I papunësuar  
Punonjës sezonal

Pensioner  
Tepriçë teknologjike  
Nuk e di

Pjesa më e madhe e personave të cilët fitojnë ndihmë të përhershme në para gjithashtu janë të koncentruara në amvisëritë ku koka është anëtarë i papunësuar (45.4%), amvisëri bujqësore (27.3%) dhe familje punëtore (18.2%). Ka një tendencë relativisht të njëjtë lidhur me shpërndarjen e përgjigjeve sipas gjinisë së kokës në familje, gjegjësisht 46.7% të amvisërive ku koka është mashkull janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, ndërsa 12% shfrytëzuese të ndihmës së përhershme në para. Në amvisëritë ku koka e amvisërisë është femër 42.9% janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para, ndërsa asnjë amvisëri nuk paraqitet si shfrytëzuese e ndihmës së përhershme në para.

Nga format e mbrojtjes jointucionale paraqiten tre amvisëri të cilat shfrytëzojnë të drejtën nga kujdesi dhe ndihma shtëpiake, dhe dy amvisëri të cilat realizojnë të drejtën e strehimit në qendër ditore. Dy të tretat nga amvisëritë të cilat realizojnë të drejtën e kujdesit dhe ndihmës shtëpiake dhe dy amvisëri të cilat shfrytëzojnë shërbime në qendrën ditore, janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Në të gjitha rastet koka e amvisërisë është mashkull. Asnjë amvisëri nuk ka shfrytëzuar mbrojtje sociale institucionale.

Grafiku 17.



Grafiku 18.



Numri i amvisërive të cilat shfrytëzojnë ose ndonjëherë kanë shfrytëzuar

Kujdes shtëpiak

Qendër ditore

Ndihmë sociale në para

Ndihmë e përhershme në para

Kompenzim në para për ndihmë dhe kujdes nga personi i huaj

Ndihmë e njëhershme në para dh ndihmë në naturë

Numri i amvisërive të cilat kanë shfrytëzuar ndonjë nga masat e mbrojtjes feminare

Shtesë feminare

Shtesë e posaçme feminare

Ndihmë e njëhershme në para për fëmijë të sapo lindur

Participim për kopsht feminator

Si formë më e përfaqshuar e mbrojtjes feminare paraqitet shtesa feminare, gjegjësisht 22 të anketuar kanë theksuar se kanë shfrytëzuar shtesë feminare. Vetëm një amvisëri shfrytëzuese e shtesës feminare si kokë të amvisërisë ka femër. Përafërsisht një e katërta (22.7%) janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Si shfrytëzuese të shtesës së posaçme feminare paraqiten katër amvisëri, nga të cilat në një amvisëri koka e familjes është femër. Të gjitha janë shfrytëzuesat të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.


Analiza tregon se pjesa më e madhe e amvisërive të cilat nuk realizojnë të drejtën e ndihmës në para nga mbrojtja sociale, nuk kanë pasur nevojë për këtë të drejtë (33%), 7% janë të painformuar, ndërsa 6% të amvisërive kanë qenë të rrefuzuara. Një pjesë e vogël e familjeve të anketuara theksojnë se si shkak për joshfrytëzimin e kësaj të drejte është turpi nga mjedisi (2%), si dhe 2% e theksojnë shumën e vogël e cila jepet. Tendencë e njejtë vërehet edhe në lidhje me shfrytëzimin e të drejtave nga mbrojtja feminare. Gjegjësisht, përqindja e të anketuarve të cilët nuk kanë nevojë për këtë të drejtë është 24%, të rrefuzuar kanë qenë 3% të amvisërive. Brengos fakti që relativisht i lartë është numri i amvisërive (16%) të cilat nuk e realizojnë këtë të drejtë për shkak të joinformimit. Sa u takon shfrytëzimit të formave të mbrojtjes joinstitucionale dhe institucionale, pjesa më e madhe e të anketuarve kanë theksuar se nuk kanë nevojë (75%), jo të informuar (19%) dhe të rrefuzuar kanë qenë 1%.

## **6.5. Shëndetësia dhe të ushqyerit**

Në numrin më të madh të rasteve (79%) të anketuarit kanë theksuar se të gjithë anëtarët e familjes kanë sigurim shëndetësor. Brengos fakti që në 13% të amvisërive sigurim shëndetësor kanë një pjesë e anëtarëve, ndërsa në 8% prej amvisërive asnjë anëtarë i familjes nuk është i siguruar. Analiza e të dhënave tregon se 46.2% prej amvisërive të cilat parcialisht kanë sigurim shëndetësor janë amvisëri bujqësore, 30.8% janë familje punëtorësh, në 15.4% koka e amvisërisë është nëpunës, gjegjësisht profesionist, ndërsa në 7.7% koka e familjes është pensioner. Gjithashtu, pjesa më e madhe e amvisërive në të cilat asnjëri nga anëtarët nuk ka sigurim shëndetësor janë bujq (37.5%) dhe punëtorë (25%). Në këtë grup të amvisërive të cilat nuk kanë sigurim shëndetësor, në 37.5% të rasteve koka e amvisërisë është person i papunësuar.

Grafiku 19.

### Здравствено осигурување на членовите на домаќинството според моментално занимање на главата на домаќинството



Сигурими shëndetësor i anëtarëve të amvisërisë sipas profesionit momental të kokës në amvisëri

- Punëtor sezonal
- Punonjës i falimentuar
- Tepricë teknologjike
- I papunësuar
- Amvis/e
- Pensioner

Udhëheqës  
Teknik  
Nëpunës  
Punëtor  
Bujk

Asnjë nuk ka sigurim  
Pjesërisht – jo të gjithë kanë sigurim  
Po – të gjithë kanë sigurim


Shumica e personave nga amvisëritë të cilat nuk kanë sigurim shëndetësor, gjegjësisht 87.5% janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Vetëm një amvisëri ku koka e amvisërisë vshtë femër ka sigurim shëndetësor të pjesërishtëm, ndërsa në amvisëritë ku koka është mashkull vetëm në 7.6% asnjë nuk ka sigurim, ndërsa 13% janë pjesërisht të siguruar. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, pjesa më e madhe (79%) në rast sëmundje shfrytëzojnë shërbime shëndetësore publike (shërbime të institucioneve shëndetësore publike dhe blejnë barna nga lista pozitive). Një numër i vogël (4%) nga numri i përgjithshëm i të anketuarve blejnë barna të cilat nuk janë në listën pozitive (50% janë bujqësore dhe 50% punëtore). Në 2% të amvisërive anëtarët mjekohet privat. Në të dy rastet bëhet fjalë për amvisëri shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale në të cilat koka e amvisërisë është person i papunësuar. E rëndësishme është të theksohet se 4% nga të anketuarit vizitojnë mjek dhe shfrytëzojnë mënyra alternative të mjekimit, dhe të gjitha janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

## 6.6. Arsim

Nga numri përgjithshëm i amvisërive të përfshira në hulumtim, 59 amvisëri kanë fëmijë të cilët janë në moshë prej gjashtë dhe më tepër vjeç, gjegjësisht fëmijë të cilët duhet të jenë të përfshirë në procesin arsimor. Prej tyre, 22 amvisëri kanë një fëmijë i cili ndjek arsimin fillor, 14 amvisëri kanë nga dy fëmijë të cilët ndjekin arsimin fillor, 17 amvisëri kanë nga një fëmijë në arsimin e mesëm, ndërsa katër amvisëri dy fëmijë të kyçur në arsimin e lartë. Nga një fëmijë në fakultet kanë nëntë amvisëri, ndërsa tre amvisëri kanë nga dy fëmijë të kyçur në arsimin universitar. Në asnjërin nga amvisëritë e anketuara nuk është evidentuar fëmijë i cili është në moshë shkollore dhe nuk është i përfshirë në proceset e rregullta arsimore.

Grafiku 20.

Grafiku 21.



Numri i fëmijëve në amvisëri të cilat janë të kyçura në procesin arsimor

Një fëmijë  
Dy fëmijë

Arsim fillor  
Arsim i mesëm  
Arsim i lartë

Amvisëritë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale fëmijët e të cilave janë të kyçura në procesin arsimor

Arsim i lartë  
Arsm i mesëm  
Arsim fillor

Një femijë  
Dy fëmijë

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore, 26 amvisëri marrin ndihmë në para nga mbrojtja sociale. Prej tyre, 17 amvisëri kanë fëmijë në arsimin fillor, 9 amvisëri kanë fëmijë në arsimin e mesëm, ndërsa tre amvisëri kanë fëmijë në fakultet. Shpërndarja e përgjigjeve sipas profesionit të kokës në amvisëri tregon se fëmijë të përfshirë në procesin arsmor kanë 71.4% amvisëri ku koka është teknik, 61.5% amvisëri buqësore, 66.7% amvisëri punëtore, gjegjësisht amvisëri ku koka është nëpunës dhe 15.8% e amvisërive ku koka është pensioner.

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të cilat kanë fëmijë në arsimin fillor, 30 amvisëri jetojnë në largësi nga shkolla fillore më të vogël se 2km, ndërsa katër amvisëri janë në distancë prej 1,01 deri më 2 km.

Analiza e të dhënave tregon se gati të gjithë fëmijët e përfshirë në arsimin fillor dhe të mesëm rregullisht e vizitojnë shkollën dhe mësimin, përveç dy fëmijë nga një amvisëri për të cilët varfëria është shkak për jondjekshmërinë e rregullt të shkollës. Kjo amvisëri nuk është shfrytëzuese e ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, fëmijët e të cilave ndjekin shkollën fillore, vetëm një amvisëri, shfrytëzuese e ndihmës në para nga mbrojtja sociale ka realizuar të drejtën e transportit falas. Gjithashtu, paraqitet edhe një amvisëri e cila e ka shfrytëzuar të drejtën e ushqimit falas. Në të dy rastet bëhet fjalë për amvisëri të cilat nuk janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Në nëntë amvisëri është shfrytëzuar e drejta e librave falas, nga të cilat shtatë janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Tek amvisëritë fëmijët e të cilave ndjekin arsimin e mesëm gjenden tre amvisëri të cilat e kanë shfrytëzuar të drejtën e transportit falas, prej tyre dy amvisëri janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para. Nga ana e amvisërive nuk shfrytëzohen forma të tjera të ndihmës për arsim të mesëm. Nga të gjitha format e ndihmës për arsimin e lartë, vetëm një amvisëri e cila është shfrytëzuese e ndihmës sociale në para merr bursë dhe tre amvisëri, nga të cilat dy janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para shfrytëzojnë kredi.

## 6.7. Sport, argëtim, kulturë

Të anketuarit nga komuna e Pehçevës kanë theksuar se në vendbanimin e tyre ka terren sportiv (99), shesh lojërash (87), kafe bar (87), bibliotekë (61), restorant (73), markete (97), internet kafene (76), kinema (48), bastore sportive (63). Nuk ka teatër. Pjesa më e madhe e të anketuarve (53 amvisëri) kanë theksuar se asnjëri prej anëtarëve të tyre në familje nuk shfrytëzon internet. Në 31% të rasteve ku shfrytëzohet internet, të anketuarit kanë theksuar se kanë përdorur kompjuter shtëpiak, ndërsa vetëm nëntë amvisëri kanë shfrytëzuar internet në internet kafene.

## 7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 7.1. Përfundime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	GJENDJE/PROBLEME
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Bujqësi (prodhimtari dhe përpunim)</li> <li><input type="checkbox"/> Pylltari</li> <li><input type="checkbox"/> Xehetari</li> <li><input type="checkbox"/> Industria tekstile dhe</li> <li><input type="checkbox"/> Turizmi</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> 1 SHFQ</li> <li><input type="checkbox"/> 3 shkolla rajonale deri në klasë të pestë</li> <li><input type="checkbox"/> Gjashtë klasa të disperzuara të shkollës së mesme të Berovës</li> </ul>
	<i>Shëndetësi:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Shtëpi shëndetësore</li> <li><input type="checkbox"/> 4 ordianca me mjekë të mjekësisë së përgjithshme</li> <li><input type="checkbox"/> 1 ordiancë gjinekologjike</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 2 barnatore private dhe 1 për nevojat e shtëpisë shëndetësore</li> <li>□ Shërbim për ndihmë të shpejtë</li> <li>□ Zyra për të dhëna materiale e QPS si njësi e shpërndarë e QPS në Berovë</li> <li>□ Një kopsht fëmënor</li> <li>□ 1 kuzhinë popullore</li> <li>□ Nuk ka shtëpi për persona të moshuar</li> <li>□ Nuk ka qendra për strehim ditor ose të përkohshëm</li> </ul>
	<i>Sfera sociale:</i>	
	<i>Kulturë/Argëtim/Sport:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Shtëpi e kulturë</li> <li>□ Bibliotekë amë</li> <li>□ Dy salla sportive</li> <li>□ Terrene sportive në të gjitha vendbanimet</li> <li>□ 24 shoqata qytetare</li> <li>□ Nuk ka kinema e as teatër</li> <li>□ Radio lokale private</li> </ul>
	<i>Subjekte ekonomike:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Disa subjekte më të mëdha ekonomike me mbi njëqind persona të punësuar (Bomeks, AD Napredok, AD Fagus...).</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Më të theksuara: papunësia dhe varfëria</li> <li>□ Pjesa më e madhe e të papunësuarve janë fuqi punëtore e pakualifikuar, të cilët presin punësim për tetë dhe më tepër vite</li> <li>□ Struktura moshore e papunësisë është e pavolitshme për shkak të pjesës shumë të madhe të fuqisë punëtore të moshës mesatare</li> <li>□ Ç'kyçje sociale e romëve</li> </ul>
	<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Personat e moshuar</li> <li>□ Personat me invaliditet (për ata nuk ka kurrëfar shërbime sociale në komunë)</li> <li>□ Romë</li> <li>□ Të papunësuar të rinj dhe persona të papunësuar për një kohë më të gjatë)</li> </ul>
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rrjeti rrugor është vjetruar dhe kualiteti i asfaltit është në gjendje të keqe</li> <li>□ Brenda fshatrave ka rrugë të paasfaltuara tokësore</li> <li>□ Është ndërtuar deponi e re për mbeturina komunale</li> </ul>
	<i>Ujësjellës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Në proces e sipër është ndërtimi i stacionit pastrues në më tepër objekte</li> </ul>
	<i>Kanalizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rrjeti ujësjellës përmirësohet përmes ndërrimit të gypave azbeste</li> <li>□ E gjithë komuna është mbuluar me rrjet kanalizues, ndërsa planifikohet edhe ndërtimi i më tepër stacioneve pastruese të ujërave të zeza nga amvisëritë</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Problemi me kualitetin e ujit të pishëm jashtë vendbanimeve në disa periudha të caktuara gjatë vitit</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunim</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Bashkëpunim i mirë me pushtetin qendror dhe OJQ-ët</li> <li>□ Bashkëpunim i zhvilluar regjional, në veçanti me komunat fqinje në</li> </ul>

<b>i ndërinstytucional në komunë</b>		Berovë dhe Dellçevë <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Bashkëpunim mesatarë mes komunës, QPS dhe Qendrës për punësim</li> <li>□ Bashkëpunim i dobët me sektorin privat</li> </ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<i>Nga komuna:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale dhe kompetencat realizohen nga ana e Njësisë për resurse njerëzore, si dhe nga Njësia për urbanizëm, punë komunale dhe zhvillim ekonomik lokal.</li> <li>□ Nuk ka punonjës social të punësuar (me sistematizimin e ri të vendeve të punës është paraparë punësimi i një punonjësi social)</li> <li>□ Në fazë është përgatitja e Rregullores për strehimin e të pastrehëve</li> <li>□ Komuna jep ndihmë të njëhershme në para në shumë prej 3000 deri më 50000 denarë.</li> </ul>
	<i>Nga QPS:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Shfrytëzues të NSP: 168 amvisëri</li> <li>□ Shfrytëzues të NPP: 9 familje</li> <li>□ Shfrytëzues të KNH: 136</li> <li>□ Mbrojtje joinstitucionale: kuzhina popullore në vendbanimin Pehçevë</li> <li>□ Mbrojtje institucionale: 3 shfrytëzues (1 – SOS Detsko Sello; 1 – Banja Bansko; 1 – Demir Kapi)</li> </ul>

## 7.2. Rekomandime

<b>SFERA</b>	<b>SFERA MË E NGUSHTË</b>	<b>REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E PROBLEMEDHE PËRMIRËSIMIN E GJENDJEVE</b>
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Potencialet për zhvillim të komunës shihen në përmirësimin e veprimtarive të cilat janë tradicionalisht të përfaqësuara: bujqësi, pylltari, industria tekstile dhe turizmi.</li> <li>□ Resurse të rëndësishme janë bakri në malin Kadmica dhe qymyri në fshatin Pançarevë</li> <li>□ Mundësi për zhvillim ka në shfrytëzimin e potencialeve për prodhimin e materialeve rezistuese ndaj zjarrit</li> <li>□ Nxitje e veçantë për zhvillim paraqet shfrytëzimi i ujërave të lumit Bregallnica dhe ndërtimi i katër hidrocentraleve</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të zgjerohet rrjeti i shkollave lokale</li> <li>□ Të analizohen mundësitë për hapjen e një shkolle të mesme në Pançarevë dhe jo klasa të disperzuara nga shkolla e Berovës</li> </ul>
	<i>Shëndetësi:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të riorganizohet puna e ambulancave për mbrojtje shëndetësore primare</li> <li>□ Të hapen ambulanca nëpër fshatra</li> <li>□ Të përforcohen kapacitetet e ndihmës së shpejt</li> </ul>
	<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të pasurohet rrjeti i institucioneve sociale në komunë</li> <li>□ Të hapet Qendër për punë sociale ose të zgjerohen kompetencat e</li> </ul>

		zyrës ekzistuese
	<i>Kulturë/Sport /Argëtim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të hapen qendra ditore për fëmijët të ç'kyçur socialisht ose të ç'kyçur nga arsimi</li> <li>□ Të krijohen shtëpi për persona të moshuar</li> <li>□ Të përforcohet kapaciteti i sektorit joqeveritar</li> <li>□ Të ndërtohet kinema dhe teatër</li> <li>□ Të promovohet zhvillimi i mediave në komunë (hapja e TV stacionit dhe gazetës)</li> <li>□ Të stimulohet zhvillimi i bizneseve të vogla dhe të mesme</li> </ul>
	<i>Subjekte ekonomike:</i>	
<b>3. Probleme sociale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të promovohen programe për punësimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale</li> <li>□ Të përmirësohet targetimi i masave aktive kah të papunësuarit afatgjatë, si dhe efikasiteti i tyre lidhur me punësimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale</li> <li>□ Të realizohen masa preventive për parandalimin e dukurive të problemeve sociale lidhur me sjelljen devijuese</li> <li>□ Të përforcohet puna këshilluese me amvisëritë e prekura me këto kategori të problemeve</li> <li>□ Të promovohen format e familjeve strehuese dhe shtëpive të vogla grupore</li> <li>□ Të krijohen forma për strehim ditor dhe të përkohshëm të grupeve të prekshme të njerëzve</li> <li>□ Të pasurohet rrjeti i shërbimeve sociale për personat e moshuar: të analizohen mundësitë për hapjen e shërbimeve sociale për ndihmë në kushte shtëpiake, qendra ditore dhe shtëpi të vogla grupore</li> <li>□ Të promovohen forma për uljen e ç'kyçjes sociale të romëve</li> <li>□ Të hapen qendra ditore për personat me invaliditet (fëmijë dhe të rritur)</li> <li>□ Të shqyrtohen mundësitë për hapjen e serviseve për ndihmë në kushte shtëpiake</li> </ul>
	<i>Grupe socialisht të prekshme:</i>	
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të përmirësohet kualiteti i infrastrukturës rrugore (asfaltimi i rrugëve lokale)</li> </ul>
	<i>Ujësjellës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i kualitetit të ujit në të gjitha vendbanimet</li> </ul>
	<i>Kanalizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të vendoset kanalizim në të gjitha vendbanimet</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të bëhet kontroll i rregulltë i kualitetit të ujit të pishëm</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërinstytucional në</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit mes komunës, QPS dhe Qendrës për punësim përmes zbatimit më intenziv dhe më efikas të punëve publike, masave aktive për punësimin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale, anëtarësimit në organe të përbashkëta, edukim për mundësitë dhe format e bashkëpunimit të tyre në sferën e mbrojtjes</li> </ul>

<b>komunë</b>	<p>sociale, si dhe zbatim praktik i projekteve të përbashkëta</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës me sektorin joqeveritar duke u përfshirë të dyja anët në realizimin e programeve nga sfera e mbrojtjes sociale</li> <li>□ Inicimi i projekteve të përbashkëta me sektorin privat dhe zhvillimi i përgjegjësive sociale tek subjektet ekonomike</li> </ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<p><i>Nga komuna:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përforsim i Njesisë për resurse njerzore duke punësuar një punonjës social</li> <li>□ Edukimi i të punësuarve në Njësi për mundësitë dhe format për zhvillim të funksioneve socialo-mbrojtëse të komunës</li> <li>□ Edukim për planifikim strategjik dhe përpilim të programeve nga sfera e mbrojtjes sociale</li> <li>□ Zgjerim i formave të mbrojtjes sociale të cilat i realizon komuna (kryesisht ndihmë financiare) me forma të reja të shërbimeve sociale</li> <li>□ Rritje e mjeteve të cilat nga buxheti ndahen për mbrojtje sociale dhe shfrytëzimi i tyre efikas</li> <li>□ Zhvillimi i rrjetit lokal të dhënësve të shërbimeve të mbrojtjes sociale, pjesërisht edhe përmes promovimit të partneritetit publiko-privat</li> </ul>
<i>Nga QPS:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Zvoglim i numrit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para përmes intenzivimit të aktiviteteve për punësimin e tyre në bashkëpunim me Qendrën për punësim</li> <li>□ Analizë e mundësive për zgjerimin e përfshirjes së amvisërive shfrytëzuese të ndihmës sociale me shërbimet e kuzhinës popullore</li> <li>□ Zhvillimi i rrjetit të mbrojtjes institucionale dhe jointitucionale në komunë</li> <li>□ Rishqyrtim i kushteve për realizimin e disa të drejtave të caktuara nga mbrojtja sociale</li> </ul>



# KOMUNA E KONÇES

## 1. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË KOMUNËS SË KONÇES

Komuna e Konçes gjendet në pjesën qendrore lindore të Republikës së Maqedonisë në largësi prej 150km nga qyteti i Shkupit, djathtas nga rruga Radovich-Strumicë. Ajo është komunë tipike rurale, e rrethuar me malin e Konçes dhe Smrdeshinkut. Konfiguracioni gjeografik i terrenit është kryesisht kodrinomaltor. Pjesa rrafshinore gjendet rreth lumit Llakavica. Kufizohet me komunat e Shtipit, Negotinës, Demir Kapisë, Vallandovës, Strumicës, Vasilevës dhe Radovishit.

Komuna e Konçes ka një sipërfaqe prej 225km<sup>2</sup> dhe numrohet mes komuna rurale me madhësi mesatare në Republikën e Maqedonisë. Numri i përgjithshëm i amvisërive është 1057. Dendësia e popullsisë është 15.17 banorë/km<sup>2</sup>. Në komunën e Konçes ka një qendër rurale dhe 13 fshatra me numër të përgjithshëm të banorëve prej 3536. Ka vetëm tre vendbanime me më tepër se 500 banorë dhe atë: Konçe, Dedino dhe Rakitec. Në vendbanimet tjera jetojnë prej 300 deri më 500 banorë. Në tre vendbanime jetojnë më pak se 50 banorë, ndërsa katër vendbanime janë krejtësisht të braktisura. Sa i takon strukturës etnike të popullatës, nga numri i përgjithshëm i popullsisë dominuese është popullata maqedonase me 85.10%, pastaj turq 14.73%, serb 0.08% dhe të tjerë 0.08%. Struktura moshore e popullatës tregon se 21.4% janë në moshë 0-14 vjeç, 67% janë në moshë 15-64 vjeç, ndërsa 11.6% janë mbi 65 vjeç. Pjesa më e madhe e banorëve janë me arsim fillor të pambaruar (50.6%), pastaj me arsim fillor të mbaruar janë 34.5%, arsim të mesëm të mbaruar 14% dhe arsim të lartë dhe universitar 0.9%.

Veprimtari kryesore ekonomike janë bujqësia, pylltaria dhe blegtoria. Pyjet shtrihen në një sipërfaqe prej 75%, për dallim të tokës pjellore e cila është 25%. Nga aspekti hidrografik, në komunë ka dukuri të ujërave nëntokësore, burimeve dhe ujërave mbitokësore, si dhe akumulime më të vogla artificiale. Më i rëndësishëm është akumulimi artificial Mantovo, i cili kap një sipërfaqe prej 365ha nën ujë dhe liqenet artificial Konçe 1 dhe Konçe 3, me të cilat pjesërisht përmbushen nevojat e mëdhaja për ujtje.

Komuna e Konçes është mjedis ekologjik i pastërt dhe i shëndoshë, me resurse dhe potenciale për prodhimin e ushqimit të shëndoshë, duke disponuar me një pasuri të madhe pyjore dhe ujore. Komuna e Konçes disponon edhe me rezerva të mëdhaja të mermerit, argjilit dhe minerale të bakrrit, gjë e cila paraqet potencial edhe për zhvillimin e xehetarisë.

## 2. KAPACITETE INSTITUCIONALE

**Arsim:** Në komunën e Konçes ka një shkollë fillore qendrore SHF „Goce Dellçev" – Konçe, me 4 shkolla rajonale nga klasa e parë deri në klasë të pestë në fshatrat: Gabrevci, Rakitec, Gorni Lipoviq dhe Dollni Lipoviq. Në fshatin Konçe mësimi zhvillohet edhe në gjuhën turke. Nuk ka asnjë shkollë për arsim të mesëm. Nxënësit më së shpeshti ndjekin arsimin e mesëm në komunën fqinje të Radovishit.

**Shëndetësi:** Rrjeti i institucioneve shëndetësore në komunën e Konçes është shumë dobët i zhvilluar. Në të gjithë territorin e komunës ka vetëm dy ambulancë me mjekë amë të mjekësisë së përgjithshme dhe një motër medicinale; nga të cilat ambulanca në Konçe punon çdo , ndërsa ambulanca në Rakitec dy herë në

javë. Nuk ka ordinanca specialistike dhe barnatore. Për shkak të kësaj banorët e komunës janë të detyruar të udhëtojnë në komunat fqinje në rast nevojë të shërbimeve shëndetësore.

**Institucione sociale:** Në komunën e Konçes nuk ka institucion për arsim dhe edukim parashkollor. Nuk ka shtëpi publike e as private për persona të moshuar.

**Institucione kulturore:** Banorët e komunës së Konçes nuk kanë mundësi që ti përmbushin nevojat e tyre kulturore për shkak të mungesës së institucioneve në komunë, me të cilat do të realizohen aktivitete kulturore. Në Konçe nuk ka shtëpi të kulturës, mirëpo ka një sallë më të madhe, e cila shfrytëzohet për ngjarje kulturore dhe takime të qytetarëve. Nuk ka kinema, teatër, muze dhe as bibliotekë.

**Objekte sportive:** Në komunën e Konçes nuk ka sallë sportive dhe as terren sportiv. Ka vetëm një sallë në shkollën fillore qendrore, në të cilën realizohen aktivitete të kulturës fizike. Në katër fshatra ka terrene futbollistike ilegale.

**Media:** Në komunën e Konçes nuk ka radio lokale. Nuk ka televizion lokal dhe as gazetë lokale.

**Shoqata qytetare:** Në komunën e Konçes janë regjistruar më tepër shoqata të qytetarëve, mirëpo aktive janë vetëm disa. Pjesa më e madhe janë shoqëri folklorike, një pjesë janë të drejtuar kah emancipimi i gruas maqedone dhe turke, si dhe një shoqatë e prodhuesve të duhanit.

**Subjekte ekonomike:** Komuna e Konçes është komunë tipike rurale ku bujqësia, blegtoria, energjia hidraulike dhe pylltaria janë drejtëpërdrejtë të kyçura në zhvillimin e komunës. Theks i posaçëm vendoset në prodhimin e duhanit të kualitetit të lartë të llojit Jaka. Në vjet prodhohet rreth 1.000.000 kg duhan, që paraqet 5% nga prodhimtaria e përgjithshme e duhanit në Republikën e Maqedonisë. Në vendbanimet e komunës janë të regjistruara vetëm objekte të vogla tregtare, për transport lokal dhe kapacitete të vogla ekonomike për blerjen dhe përpunimin e mishit.

### 3. PROBLEME DOMINUESE NË KOMUNË

**Probleme sociale:** Probleme dominuese sociale janë varfëria dhe papunësia. Një e treta e banorëve të aftë për punë në komunën e Konçes (32.3%), gjegjësisht 722 persona janë të papunësuar. Struktura gjinore e papunësisë tregon se pjesa më e madhe e personave të papunësuar janë meshkuj, gjegjësisht nga numri i përgjithshëm i të papunësuarve vetëm 23.3% (168) janë femra. Duke e pasur parasyshë strukturën etnike të popullatës, pjesa më e madhe janë maqedonas (604), pastaj turq (112), serb (3) dhe të tjerë. Shpërndarja e papunësisë sipas strukturës moshore tregon se pjesa më e madhe e të papunësuarve (224) janë në moshë 30-39 dhe 189 persona në moshë 20-29 vjeç. Pastaj pasojnë personat në moshë 40-49 (152), 105 persona janë në moshë 50-59 dhe 27 persona në moshë 60-65 vjeç. Analiza e të dhënave tregon se numri më i madh i personave presin punësim më gjatë se tetë vite; gjegjësisht më pak se një vit të papunësuar janë 98 persona, deri më dy vite 93, deri më tre vite 50, deri më katër vitë 44, prej pesë deri më shtatë vite 94 dhe mbi tetë vite 283 persona. Dy të tretat nga personat e papunësuar (488 nga të cilat 130 femra) janë punëtorë të pakualifikuar; me përgatitje të mesme teknike janë 118, nga të cilat 44 femra; me arsim të lartë dhe

universitare janë 8, nga të cilët 7 janë femra. Në Konçe nuk ka industri të zhvilluar, gjegjësisht nuk ka kapacitete për absorbimin e fuqisë punëtore. Në vitin 2009 janë angazhuar 50 shfrytëzues të ndihmës sociale në para për zbatimin e punëve publike në komunë.

Për banorët e Konçes përgjegjëse është Qendra për punësim nga Radovishi. Në Qendër praktikohen masat aktive për punësim, në pajtim me planet operative të MPPS. Si profesione deficitare veçohen profesionet: filologë të diplomuar në gjuhën angleze dhe elektro-inzhinierë.

Si grup më i rrezikuar sa i takon punësimin paraqiten personat më të moshuar të pakualifikuar. Sa i takon shfrytëzimit të të drejtave nga mbrojtja sociale, si më të rrezikuar paraqiten personat e moshuar të cilët nuk janë materialisht të siguruar dhe të paafte për punë, mirëpo për shkak të pronës dhe të drejtave nga prona nuk mund ti realizojnë këto të drejta.

Në komunën e Konçes në një masë më të vogël paraqiten problemet sociale të ndërlidhura me sjelljen devijuese, si dhe probleme sociale lidhur me fatkeqësitë natyrore.

**Probleme infrastrukturale:** Komuna e Konçes ka rrjet infrastuktural relativisht të mirë. Në pjesën më të madhe të fshatrave ka rrjet ujësjellës, gjegjësisht në secilin vendbanim në funksion janë sisteme të posaçme nga të cilat fitohet ujë i pishëm. Vetëm në tre fshatra të cilat kanë numër të vogël të banorëve, gjegjësisht më janë gati të zbraza (Zagorci, Garvan dhe Skorushak) paisja me ujë bëhet përmes puseve. Rrejt kanalizues ka në katër fshatra më të mëdhenj: Konçe, Rakitec, Delino dhe Dollni Mitoviq. Të gjitha vendbanimet kanë lidhshmëri trafikore me qendrën komunale. Edhe pse qasja në dhe nga vendbanimet është e asfaltuar, duhet të theksohet se brenda fshatrave ka rrugë të paasfaltuara, gjegjësisht tokësore. Në këtë kontekst të anketuarit nga fokus grupet theksuan: *"Vetëm rruga kryesore është e asfaltuar, mirëpo për të hy në shtëpinë tona duhet të kalojmë nëpër baltë..."* Për vitin 2011, është paraparë meremtimi i rrugës Radovish-Konçe.

**Probleme ekologjike:** Në komunën e Konçes si problem më i rëndësishëm ekologjik dallohet problemi me deponinë, e cila nuk është ndërtuar sipas standardeve ekologjike, si dhe probleme të vogla me erozionin e tokës.

#### 4. MBROJTJE SOCIALE

**Administrata komunale:** Në suazat e administratës komunale nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale ndërsa kompetencat realizohen nga ana e Njësisë për urbanizëm, punë komunale, mjedis jetësor dhe zhvillim ekonomik lokal. Nuk ka punonjës social të punësuar, mirëpo ka person të emruar i cili në detyrat e punës ka edhe çështje nga sfera e mbrojtjes sociale. Në bashkëpunim me komunën e Radovishit është përgatitur Plani strategjik për zhvillim ekonomik lokal 2007-2011 për Konçen dhe Radovishin, në të cilin janë përpunuar çështje të ndërlidhura me arsimin dhe kualitetin e jetesës. Në vitin 2009 është miratuar Program për mbrojtje sociale për popullatën e komunës së Konçes për vitin 2010, në të cilin fokusi gjeneral vendoset mbi të dhënat materiale. Me planin operativ për zbatimin e Programit për mbrojtje shëndetësore dhe sociale për vitin 2011 janë zgjeruar aktivitetet nga mbrojtja sociale të popullatës. Bashkëpunimi me

qytetarët zhvillohet përmes informimit të qytetarëve, lajmërimit në vende publike, drejtim dhe ndihmë gjatë mbushjes së aplikimeve. Si formë e ndihmës për popullatën socialisht të rrezikuar komuna jep ndihmë të njehershme në para. Për këtë qëllim në vitin 2010 janë ndarë 150.000 denarë, ose 0.5 përqind nga buxheti vjetor në komunë. Për vitin 2011, janë paraparë 200.000 denarë nga buxheti i komunës.

**Qendra për punë sociale:** Qendra për punë sociale e cila është e vendosur në Radovish është përgjegjëse për banorët e Konçes. Në Konçe nuk ka zyrë për të dhëna materiale në të cilën do të mund të realizohen format e ndihmës sociale në para, ndihmës së përhershme në para dhe ndihma dhe kujdesi nga personi i huaj. Numri i të punësuarve profesionistë në QPS është nëntë, nga të cilët katër janë punonjës social, tre juristë dhe nga një sociolog dhe psikolog. QPS ka në disponim nëntë zyra në dy kate. Të gjithë punonjësit profesionistë kanë kompjuterë, mirëpo nuk kanë qasje në internet. Ka vetura, mirëpo asnjëra prej tyre nuk është teknikisht në rregulltë. Gjithashtu, nuk ka mjaft mjete materiale për mbulimin e shpenzimeve për karburantë. Në QPS nuk ka telefon dhe as celularë.

QPS bashkëpunon me administratën komunale të Konçes vetëm në rast nevojë dhe atë më së shpeshti kur paraqitet ndonjë problem lidhur me ndonjë shfrytëzues të ndihmës sociale. Me shköllën bashkëpunohet në rast të delikuencës së mitur, si dhe në rast të dhënies së vërtetimit shkollor për anëtarë të amvisërisë. Gjithashtu, bashkëpunon edhe me institucionet shëndetësore kur duhet të sigurohet ndonjë dokument. QPS ka bashkëpunim të mirë me Agjencinë për punësim. I dobët është bashkëpunimi me OJQ-ët lokale.

Si probleme më të rëndësishme për funksionimin e QPS veçohen mospasja e veturave, mungesa e qasjes në internet dhe telefon, si dhe mungesa e kushteve materiale për funksionimin e pandërprerë të Qendrës. Si kategori më problematike e shfrytëzuesve dallohen kërkuesit e ndihmës sociale në para, në raste kur nuk i plotësojnë kushtet për shfrytëzimin e kësaj të drejte atëherë kur merret parasysh gjendja materiale e amvisërisë.

Për shkak se nuk ka Qendër për punë sociale, në Konçe banorët në rast nevojë të realizimit të ndonjë të drejte nga mbrojtja sociale, janë të detyruar të udhëtojnë në komunën fqinje të Radovishit. Kjo paraqet vështirësi për ato, sepse ato janë persona të varfër të cilët duhet të ndajnë një pjesë të mjeteve të tyre për shpenzime rrugore, ndërsa në një pjesë bëhet fjalë për persona të cilët janë të sëmurë ose persona me pengesa në zhvillim, si dhe fëmijë ose persona të moshuar. Gjendja e tillë e imponon nevojën për hapjen e Qendrës për punë sociale ose më së paku zyrë për të dhëna materiale në Konçe, me çfarë do të lehtësohet realizimi i të drejtave nga mbrojtja sociale.

**Numri dhe struktura e shfrytëzuesve të masave dhe shërbimeve nga mbrojtja sociale:** Analiza e strukturës së shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale në territorin e komunës së Konçes, tregon se 23 amvisëri janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para. Si kokë e familjes paraqiten persona të të gjitha grupeve moshore. Si shfrytëzues të ndihmës së përhershme në para paraqiten 17 familje, nga të cilat pjesa më e madhe (15) e shfrytëzojnë këtë të drejtë në bazë të pleqërisë dhe sëmundjes. Pjesa më e madhe e këtyre familjeve janë të përkatësisë etnike rome. Ndihma e njehershme në para në mesatare u jepet 20 shfrytëzuesve në vit. E drejta e ndihmës në para nga mbrojtja sociale më së shpeshti nuk realizohet si rezultat i realizimit të të ardhurave nga veprimtaria bujqësore, gjegjësisht përpunimi i duhanit. Gjithashtu, kjo e drejtë kufizohet si rezultat i posedimit të tokës bujqësore dhe posedimit të gjithë mekanizmave të nevojshme.

Si problem i madh në suazat e fokus grupeve u theksua shuma e ndihmës sociale në para. *“Unë jetoj me grua të pakurorzuar, e cila është e sëmurë, ndërsa edhe unë jam i sëmurë dhe kam bërë disa operacione... Me paratë e ndihmës nuk mund të mbijetoj, e jo më të blejë barna. Ja vjen dimri, nuk kam dru edhe të dua vetë smundem të mbledh, nuk jam i aftë që të kërrusem...”*

Nga format e mbrojtjes joinstitucionale paraqitet fëmijë pa kujdes prindëror, gjegjësisht fëmijë prindërit e të cilt janë shfrytëzues të ndihmës së përhershme në para, i cili është i vendosur në familje strehuese në Makedonski Brod. Gjithashtu janë evidentuar dy motra të cilat kanë qenë të vendosura në 25 Maj, mirëpo për shkak të moshës ju ka përfunduar e drejta e shfrytëzimit. Në komunën e Konçes nuk ka qendër për strehim ditor ose të përkohshëm të shfrytëzuesve, nuk ka familje strehuese, as shtëpi të vogël grupore. Nuk ka as institucion për mbrojtje institucionale. Si nevojë e veçantë theksohet formimi i qendrës ditore për persona të moshuar.

## **5. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS MË AKTORËT LOKAL**

Komuna në përgjithësi ka bashkëpunim të mirë me BNJVL.

I dobët është bashkëpunimi me Qendrën për punë sociale i cili realizohet vetëm në rast nevoje për ndonjë rast konkret. Nuk ka bashkëpunim lidhur me parandalimin e problemeve sociale dhe çështjeve për pëmirësimin e gjendjes sociale në komunë.

Komuna e Konçes ka bashkëpunim të zhvilluar regjional, në veçanti me komunitat fqinje të Radovishit, Vallandovës dhe Shtipit. Më komunën e Radovishit së bashku punojnë në programe strategjike për zhvillim ekonomik lokal.

Bashkëpunimi i komunës me Agjencinë për punësim vlerësohet si i shkëlqyeshëm. Ndërmjetësiht informohen për trajnime dhe edukime. Administrata komunale është e kënaqur nga puna e Qendrës lokale për punësim dhe dhënia e ndihmës për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe vetëpunësimin.

Komuna realizon bashkëpunim të mirë me shoqatat qytetare, mirëpo potencohet kapaciteti dhe iniciativat e dobta nga ana e OJQ-ve lokale. Në vitin 2010 është miratuar program për zhvillim të OJQ sektorit dhe bashkëpunim me komunën për vitin 2011, për të cilin janë ndarë 100.000 denarë për financimin e aktiviteteve të komunës së Konçes.

Sektori privat është dobët i zhvilluar dhe solidariteti korporativ është në një nivel të ulët.

Bashkëpunimi me pushtetin qendror është i mirë, mirëpo theksohet se të gjitha komunitat nuk kanë kapacitet të njejtë për ndërmarrjen e të gjitha kompetencave. Analoge me këtë, të gjithë komunitat nuk mund të kenë shkallë të njejtë të decentralizimit. Përparësi është decentralizimi fiskal dhe mundësia për realizimin e burimeve vetanake të të ardhurave.

## 6. REZULTATE NGA HULUMTIMI ANKETUES I AMVISËRIVE NË KOMUNËN E KONÇES

### 6.1. Të dhëna të përgjithshme për amvisëritë e anketuara


Në komunën e Konçes u anketuan gjithsej 100 amvisëri. Struktura e amvisërive të anketuara sipas llojit të amvisërisë tregon se numri më i madh i amvisërive të anketuara merren me bujqësi (55%) nga të cilat në 29% ka ndonjë anëtarë në amvisëri i cili merret me ndonjë veprimtari tjetër.

Shpërndarja e amvisërive sipas strukturë etnike tregon se 96 amvisëri janë deklaruar si maqedonase, një amvisëri si shqiptare, dy si serbe dhe një është deklaruar si turke. Më e madhe është prania e amvisërive katër-anëtarëshe (33%). Në 90 amvisëri koka e familje është mashkull, ndërsa në 10 femër. Në shumicën e rasteve koka e amvisërive një-anëtarëshe (66.7%) është mashkull. Gruaja më shpesh paraqitet si kokë e amvisërisë në ato katër-anëtarëshe (30%) dhe pesë-anëtarëshe (30%). Gati në të gjitha amvisëritë me numër më të madh të anëtarëve si kokë e amvisërisë përcaktohet burri. Në shumicën e rasteve koka e amvisërisë është në bashkësi martesore (85%), në 4% të rasteve bëhet fjalë për persona të cilët janë të pamartuar dhe në 9% të rasteve bëhet fjalë për persona të vejë.

Grafiku 1.



Grafiku 2



Lloji i amvisërisë

Bujqësore  
Jobujqësore  
E përzier  
Nuk e di

Statusi martesor i kokës në amvisëri

i/e pamartuar  
i/e martuar

i/e divorcuar  
i/e vejë  
nuk e di

Edhe pse 96% nga personat e anketuar dinë shkrim-lexim, një pjesë e madhe (14%) janë me arsim fillor jo të plotë, 38% me arsim fillor, 42% me arsim të mesëm, ndërsa vetëm 5% me arsim të lartë dhe universitar. Në numrin më të madh të amvisërive koka e amvisërisë është punëtor (34%), pastaj pensioner (25%), bujk (11%), nëpunës (5%), amvis/e (8%) dhe për vërejtje është ajo që 13% nga të anketuarit janë ose të papunësuar, tepricë teknologjike ose punonjës i falimentuar.

Grafiku 3.




Profesioni momental i kokës në amvisëri

Bujk  
Punëtor  
Nëpunës  
Ushtri, polici  
Pensioner  
Amvis/e  
Tjetër – i papunësuar  
Tjetër – tepricë teknologjike  
Tjetër – punonjës i falimentuar  
Nuk e di  
Rrefuzon të përgjigjet

Si shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale janë deklaruar 47 të anketuar. Duhet të theksohet se tek 59 amvisëri nuk ka asnjë të punësuar, ndërsa në pesë familje vetëm nga një anëtarë është i punësuar. Sipas llojit të amvisërisë ka një shpërndarje relativisht të barabartë të shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, gjegjësisht 27% janë bujqësore, 36% jobujqësore, ndërsa 29.8% të përziera.

Grafiku 4.



Grafiku 5.



A është koka e amvisërisë shfrytëzuese e ndihmës në para nga mbrojtja sociale? \*Lloji i amvisërisë

- Bujqësore
- Jobujqësore
- E përzier
- Nuk e di

- Po
- Jo


Shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale sipas llojit të amvisërisë

- Bujqësore
- Jobujqësore

## 6.2. Punësim

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të anketuara, në 59% të rasteve nuk ka asnjë të punësuar. Prej tyre, 96.6% janë amvisëri maqedonase, ndërsa 1.7% janë turke dhe 1.7% janë serbe<sup>17</sup>. Në 63 amvisëri ka vetëm nga një anëtarë të punësuar, nga të cilët 35 janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 28 femrore. Në 11 amvisëri ka nga dy anëtarë të papunësuar, nga të cilët 5 janë të gjinisë mashkullore dhe 6 të asaj femrore. Paraqitet edhe një familje me tre persona të papunësuar, të gjitha të gjinisë femrore. Në 47 amvisëri është evidentuar nga një i punësuar, ndërsa vetëm në 7 amvisëri janë evidentuar nga dy persona të punësuar. Megjithatë, brengosin të dhënat se gjithsej 10 persona të punësuar janë të gjinisë femrore, për dallim të 51 personave të gjinisë mashkullore.

Grafiku 6.



Numri i personave të punësuar në amvisëri sipas gjinisë

Një      Dy      Tre

Meshkuj  
Femra


### 6.3. Standardi jetësor

Analiza e të dhënave të fituara tregon se 56 amvisëri nuk kanë realizuar kurrëfar të ardhura nga marrëdhëniet e rregullta pune në 12 muajt e fundit. Edhe këtu vërtetohet e njejta tendencë, gjegjësisht pjesa më e madhe e amvisërive ku koka e amvisërisë është femër (80%) jetojnë pa të ardhura personale, për dallim

<sup>17</sup> Duhet të ceket se nga numri i përgjithshëm i amvisërive, gati tek 96 amvisëri koka e amvisërisë është maqedonas, një shqiptar, një turk dhe dy serb.

të amvisërive ku koka e familjes është mashkull dhe përqindja atje është 53.3%. Pjesa më e madhe e amvisërive të cilat kanë realizuar të ardhura nga marrëdhëniet e rregullta pune janë familje punëtore (25%) pastaj vijnë nëpunësit, ushtria dhe policia (8%) dhe nga 3% bujq dhe pensionerë. Nga gjithsej 47 amvisëri të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, vetëm 12 familje kanë realizuar të ardhura nga marrëdhëniet e rregullta pune në 12 muajt e fundit. Tërheq vëmendje fakti se në komunën e Konçes paraqiten 27 amvisëri të cilat kanë realizuar të ardhura nga marrëdhënie të çrregullta pune dhe atë 23 amvisëri ku koka e amvisërisë është mashkull dhe 4 amvisëri ku koka e amvisërisë është grua.

Grafiku 7.



Sipas cilës baze janë realizuar të ardhurat në 12 muajt e fundit

- Marrëdhënie të rregullta pune
- Marrëdhënie të çrregullta pune
- Pensione
- Të ardhura nga jashtë
- Bujqësi
- Qira/shitje e pronës
- Mbrojtje sociale
- Ndihmë nga familjarë

Prej tyre, 37% janë familje punëtore, 14.8% bujqësore, njejtë si edhe me amvisëritë ku koka është nëpunës, ushtar ose polic, 11.1% pensionerë dhe 7.4% raste ku koka e amvisërisë është amvis/e. Një e treta e amvisërive (31.9%) shfrytëzuese të ndihmës sociale në para nga mbrojtja sociale, kanë realizuar të ardhura nga marrëdhënie të ç'rregullta pune. Është e rëndësishme të theksohet se më tepër se gjysma (51.1%) e shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, kanë realizuar të ardhura nga veprimtaria bujqësore. Vetëm tre të anketuar, nga të cilët dy amvisëri punëtore dhe një pensionerësh, kanë realizuar të ardhura nga prona (qira, shitje) dhe prej tyre një amvisëri është shfrytëzuese e ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Vetëm katër nga amvisëritë e anketuara, nga të cilat dy janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale dhe dy amvisëri me person të punësuar në ushtri/polici, apo pensionerë, kanë marrë ndihmë nga ndonjë familjarë më i afërt i familjes. Pjesëmarrja e të ardhurave tjera në buxhetin e përgjithshëm të amvisërive është e parëndësishme.

Pjesa më e madhe e amvisërive (24%) në muajin e fundit kanë realizuar të ardhura prej 5001 deri më 10000 denarë, ndërsa 20% kanë realizuar të ardhura prej 10001-14000 denarë, nga të cilat 21 janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

Grafiku 8.



Shuma e të ardhurave të realizuara në amvisëri nv muajin e fundit

Deri më 5.000 mkd

Mbi 30.001 mkd


Nuk e di

Rrefuzon të përgjigjet

Shpërndarja e përgjigjeve tregon se sipas profesionit të kokës së amvisërisë, 15 amvisëri janë pensionerë, 13 amvisëri punëtore, ndërsa 6 bujqësore. Të ardhura në shumë prej 14001 deri më 18001 denarë

kanë realizuar 16% të amvisërive, ndërsa 17% kanë realizuar të ardhura prej 18001 deri më 30000 denarë. Kujdes të posaçëm tërhekin të dhënat të cilat kanë të bëjnë me amvisëritë të cilat fitojnë deri më 5000 denarë dhe janë 15% nga numri i përgjithshëm i amvisërive të anketuara. Pjesa më e madhe e tyre janë familje ku koka e amvisërisë është amivs/e (26.7%), amvisëri punëtorësh janë 20% dhe bujqësore 13.3%. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive ku gruaja paraqitet si kokë e amvisërisë, 20% realizojnë të ardhura deri më 5000 denarë, ndërsa në amvisëritë ku koka e amvisërisë është burrë ajo përqindje është 14%.

Grafiku 9.



Shuma e parave të cilën amvisëria e ka realizuar në muajin e fundit sipas gjinisë

Deri 5000 mkd

Mbi 30001 mkd

Nuk e di

Rrefuzon të përgjigjet

Meshkuj


Femra

Brengos fakti që në suazat e kësaj kategorie të amvisërive, janë identifikuar dy amvisëri të cilat nuk janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Analiza e të dhënave të ndërlidhura me amvisëritë ku koka është i/e pamartuar tregon se 75% prej tyre realizojnë të ardhura më të ulta se 5000 denarë, ndërsa 25% kanë realizuar të ardhura prej 5001 deri më 10000 denarë. E njëjtë është shpërndarja e të ardhurave tek amvisëritë ku koka është i/e vejë, gjegjësisht 77.7% nga amvisëritë realizojnë të ardhura deri më 10000 denarë, ndërsa 11.1% deri më 14000 denarë.

Lidhur me çështjen e konsumimit të ushqimit të ngrohtë me mish, amvisëritë në të cilat gatuhet një herë në javë janë dominuese (35%), pastaj vijojn amvisëritë në të cilat përgatitet ushqim i ngrohtë me mish dy herë në javë (18%), ndërsa në 16 % të rasteve gatuhet tre herë në javë. E rëndësishme është të theksohet përqindja e lartë e amvisërive (14%) në të cilat aspak nuk konsumohet ushqim i ngrohtë me mish gjatë javës.

Në këtë kategori të amvisërive, 14.3% nga të anketuarat janë bujqësore, 14.3% janë punëtorë dhe nga 28.6% janë pensionerë dhe amvis/e.

Grafiku 10.



Консумими i ushqimit të ngrohtë me mish brenda javës sipas profesionit të kokës në amvisëri

Tjetër/i papunësuar

Amvis/e

Pensioner

Udhëheqës

Ushtri/polici

Nëpunës

Punëtor

Bujk

Asnjëherë

Katër herë

Një herë

Pesë herë

Dy herë


Çdo ditë (shtatv ditë në javë)

Tre herë

Rrefuzon të përgjigjet

Në suazat e kategorisë - shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale 19.1% nga të anketuarit kanë theksuar se asnjëherë gjatë javës nuk gatuajnë ushqim të ngrohtë me mish, 36.2% konsumojnë një herë në javë dhe 8.5% dy herë në javë. Brengosin të dhënat se 34.1% nga shfrytëzuesit konsumojnë ushqim të ngrohtë me mish më tepër se tre herë në javë. Shpërndarja e përgjigjeve sipas gjinisë së kokës në familje është e njëjtë, ku në numrin më të madh të amvisërive në të cilat koka e familjes është mashkull, ushqim i ngrohtë konsumohet një herë në javë (34.4%), ndërsa tek amvisëritë në të cilat kokë e amvisërisë është femra ushqim i ngrohtë me mish konsumohet një herë në javë dhe atë në 40% të rasteve. Vërehet përqindje e lartë e amvisërive (20%), në të cilat koka e amvisërisë është femër dhe në të cilat asnjëherë gjatë javës nuk konsumohet ushqim i ngrohtë me mish.

Grafiku 11.



Frekuenca e përgjigjeve të dhëna për mungesën e parave

Ushqim dhe pije joalkoolike

Pije alkoolike dhe duhan

Veshje dhe këpucë

Shpenzime të regjisë

Orendi shtëpiake dhe mobilje

Higjienë dhe shvndetësi

Komunikacion

Komunikim  
Rekreim dhe kulturë  
Arsim

Numri më i madh i të anketuarve kanë theksuar se para ju mungojnë më së shumti për mbulimin e shpenzimeve për veshje dhe këpucë (78) dhe ushqim dhe pije joalkoolike (75); ndërsa për shpenzime të regjisë (banim, ujë, rrymë, karburantë) 60 dhe ushqim dhe higjienë (59). Më tepër se gjysma e të anketuarve kanë theksuar se ju mungojnë para për orendi shtëpiake dhe mobilje (56). Një numër më i vogël i të anketuarve kanë theksuar se ju mungojnë para për arsim (28), komunikim (23), rekreim dhe kulturë (10), ndërsa më pak (5) kanë thënë se ju mungojnë mjete financiare për blerjen e pijeve alkoolike dhe duhanit. Analiza tregon se 50% nga të anketuarit të cilët kanë theksuar se ju mungojnë mjete financiare për mbulimin e shpenzimeve të regjisë, janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. I njejtë relacion është edhe në shpërndarjen e përgjigjeve lidhur me mungesën e mjeteve për ushqim dhe pije joalkoolike (52%), orendi shtëpiake (51.8%), veshje dhe këpucë (50%), higjienë dhe shëndetësi (50.8%) dhe arsim (46.4%). Sa i takon llojit të veshjes e cila ju mungon të anketuarve, më së shpeshti theksohet veshja dimrore (57), këpucët (15) dhe veshja solemne (11). Pjesa më e madhe e të anketuarve, shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, theksojnë se ju mungojnë mjete financiare për kulturë dhe argëtim (60%) dhe për veçim është ajo se tek 40% nga të anketuarit shfrytëzues është theksuar mungesa e mjeteve për pije alkoolike dhe duhan.

Të gjitha amvisëritë jetojnë në banime me ndërtim të fortë. Pjesa më e madhe e familjeve jetojnë në banesë dy dhomëshe (46%) dhe tre dhomëshe (31%), një pjesë më e vogël në banesë një dhomëshe (6%), ndërsa vetëm 16% në banesë katër dhomëshe dhe më të madhe. Analiza e kushteve banuese për jetesë, krahasuar me numrin e anëtarëve të amvisërive, tregon se numri më i madh i amvisërive një anëtarëshe, dy anëtarëshe, tre anëtarëshe dhe katër anëtarëshe jetojnë në banesa dy dhomëshe, ndërsa pesë nga amvisëritë gjashtë anëtarëshe jetojnë në banesa më të mëdha. Një amvisëri pesë anëtarëshe jeton në banesë një dhomëshe, ndërsa pesë në banesa dy dhomëshe. Sa i takon mënyrës se si amvisëritë e ngrohin banimin është evidentuar një përqindje e lartë e shfrytëzimit të kofitorëve me karburantë të ngurtë, dru (95), një numër më i vogël e ngrohin amvisërinë me nxemje me avull vetanake (3) dhe nga një amvisëri me kofitor me rrymë dhe karburantë të lëngshme. Të dhënat për atë se sa dhoma ngrohen tregojnë se kualiteti i jetesës zvoglohet gjatë periudhës dimrore. Gjegjësisht, numri më i madh i amvisërive (62%) ngrohin vetëm një dhomë në shtëpi, 28% dy dhoma, ndërsa tre dhe më tepër dhoma vetëm 10% nga të anketuarit.

Grafiku 12.

Grafiku 13.



Numri i dhomave të cilat ngrohen në amvisëri

Një

Dy

Tre

Katër dhe më shumë

Numri i anëtarëve të amvisërisë krahasuar me madhësinë e banesës

Banesë më e madhe

Katër dhomëshe

Tre dhomëshe

Dy dhomëshe


Një dhomëshe

Garsonjerë

Pjesa më e madhe e amvisërive (93) janë të përfshira në rrjetin kanalizues dhe e njejta tendencë vërehet edhe tek shfrytëzuesit e ndihmës në para nga mbrojtja sociale, gjegjësisht ka vetëm dy amvisëri të cilat kanë gropa septike. 73 amvisëri, nga të cilat 31 janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para në banesë kanë tualet me banjo, tualet në oborr kanë 41 amvisëri, ndërsa tualet në banesë kanë 22 amvisëri. Rezultatet tregojnë se një pjesë e madhe e amvisërive janë të përfshira në rrjetin ujësjellës, gjegjësisht çeshme në banesë kanë 96 amvisëri. Është evidentuar se 11 amvisëri nuk kanë ngrohës uji, gjashtë nga të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Një pjesë e amvisërive të anketuara kanë mungesë të aparateve bazike në amvisëri siç është shporetit elektrik (8), frigorifer (3) dhe frigorifer me ngrirje të thellë (19). Më tepër se gjysma e amvisërive (54) nuk kanë kompjuter, nga të cilat 32 nuk mund të blejnë, ndërsa

22 nuk kanë nevojë. Një pjesë e madhe e shfrytëzuesve (42.6%) nuk mund të blejnë kompjuter. Automobil nuk kanë 49 amvisëri, nga të cilat 37 nuk mund të blejnë.

Grafiku 14.



Numri i amvisërive të cilat nuk kanë nevojë ose nuk mund të blejnë ndonjë parat të caktuar për amvisëri

- Shporet elektrik
- Furrë
- Ngrohës uji
- Frigorifer
- Frigorifer me ngrirje të thellë
- Makinë për larjen e teshave
- Makinë për larjen e enëve
- Thithëse pluhuri
- Klimë
- Televizor
- Kompjuter
- Telefon
- Celularë

- Nuk kam nevojë
- Nuk mund ta blej

#### 6.4. Probleme sociale dhe mbrojtja sociale

Analiza e të dhënave lidhur me problemet sociale tregon se probleme më të rëndësishme janë problemet e ndërlidhura me zhvillimin social edhe atë papunësia (77), varfëria (79) dhe sëmundja (38). Gjithashtu, nga ana e amvisërive të anketuara si probleme të rëndësishme theksohen edhe divorci (4), marrëdhëniet konfliktuoze familjare (3), invaliditeti (5), ndërsa vërehet edhe nga një rast i fëmijës pa prind dhe kujdes prindëror, gjegjësisht shfrytëzues i substancave psikotropike. Të anketuarit veçojnë edhe probleme sociale të ndërlidhura me proceset natyrore ekologjike: vërshime (4), thatsi (5) dhe tërmet (1).

Grafiku 15.



Probleme të ndërlidhura me zhvillimin social

- Papunësi
- Varfëri
- Sëmundje
- Marrëdhënie konfliktuoze familjare
- Invaliditet
- Delikuencë
- Divorc
- Alkoolizëm
- Vërshime
- Zjarre

Pjesa më e madhe e amvisërive të anketuara janë shfrytëzuese të të drejtave nga ndihma në para nga mbrojtja sociale, gjegjësisht 52 amvisëri janë marrëse të ndihmës sociale në para, ndërsa 11 amvisëri të ndihmës së përhershme në para. Mes shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para, 26.9% janë amvisëri

punëtorësh, 15.4% bujqësore, 7.6% janë nëpunës, ushtarë dhe polic, 13.5% pensionerë, 8% amvis/e dhe 17.3% të tjerë. Ka një tendencë relativisht të njëjtë lidhur me shpërndarjen e përgjigjeve sipas gjinisë së kokës në amvisëri. Në amvisëritë ku koka e amvisërisë është mashkull, 51% janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para, ndërsa 11.1% janë shfrytëzuese të ndihmës së përhershme në para. Në amvisëritë ku koka është femër, 60% janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para, ndërsa 10% të ndihmës së përhershme në para.

Grafiku 16.



Shfrytëzues të ndihmës sociale sipas profesionit të kokës në amvisëri


- Bujk
- Punëtor
- Nëpunës
- Ushtri/polici
- Pensioner
- Amvis/e
- Tjetër/i papunësuar
- Nuk e di

Nga format e mbrojtjes jointucionale paraqiten vetëm dy amvisëri të cilat shfrytëzojnë kujdesin dhe ndihmën shtëpiake. Në të dy rastet, koka e amvisërisë është femër. Asnjë prej amvisërive nuk ka shfrytëzuar mbrojtje sociale institucionale.

Si formë më e përfaqësuar e mbrojtjes femënore paraqitet shtesë femënore, gjegjësisht 29 të anketuar kanë theksuar se kanë shfrytëzuar shtesë femënore, ndërsa vetëm tre të anketuar kanë thënë se kanë shfrytëzuar shtesë të posaçme femënore.

Grafiku 17.

Grafiku 18.



Për cilat shkaqe familja nuk ka shfrytëzuar ndihmë në para nga mbrojtja sociale

- Nuk ishëm të informuar
- Ishëm të rrefuzuar
- Për shkak të turpit
- Nuk kemi nevojë
- Tjetër

Për cilat shkaqe amvisëria nuk ka shfrytëzuar ndihmë në para nga mbrojtja fëminore


- Nuk ishëm të informuar
- Ishëm të rrefuzuar
- Kishëm dokumentacion të pakompletuar
- Për shkak të turpit

Analiza tregon se pjesa më e madhe e amvisërive të cilat nuk realizojnë të drejtat e ndihmës në para nga mbrojtja sociale nuk kanë pasur nevojë që ta realizojnë këtë të drejtë (50%), ndërsa 28.3% nga amvisëritë kanë qenë të rrefuzuara. Një numër i vogël i amvisërive të anketuara kanë thënë se shkaqet për joshfrytëzimin e kësaj të drejtë janë joinformimi (6.5%), turpi nga mjedisi (4.35%). E njejta tendencë vërehet edhe me shfrytëzimin e të drejtave të mbrojtjes fëminore. Gjegjesisht, përqindja e të anketuarve të cilët nuk kanë nevojë që ta shfrytëzojnë këtë të drejtë është 53%, ndërsa 22.7% të amvisërive kanë qenë të rrefuzuara. Brengos fakti që një numër relativisht i lartë i amvisërive (13.6%) nuk e realizojnë këtë të drejtë për shkak të joinformimit, 3% nga turpi dhe 3% për shkak të dokumentacionit të pakompletuar. Lidhur me shfrytëzimin e formave të mbrojtjes joinstitucionale dhe institucionale, pjesa më e madhe e të anketuarve nuk kanë pasur nevojë (62.2%), kanë qenë të joinformuar (17.4%), janë rrefuzuar (14.3%) mungesa e dokumentacionit të plotë (15) dhe të tjera (5%).

## 6.5. Shëndetësi dhe të ushqyerit

Në numrin më të madh të rasteve (83%), të anketuarit kanë thënë se të gjithë anëtarët në amvisëri kanë sigurim shëndetësor. Brengos fakti që në 8% prej amvisërive vetëm disa anëtarë kanë sigurim shëndetësor, ndërsa në 6% të amvisërive asnjëri prej anëtarëve nuk ka sigurim shëndetësor. Analiza e të dhënave tregon se 33.3% prej amvisërive të cilat nuk kanë sigurim shëndetësor janë amvisëri bujqësore, 33.3% janë familje punëtorësh, ndërsa nga 16.7% familje ku koka e amvisërisë është pensioner ose amvis/e. Numri më i madh i personave, gjegjësisht 83.3% të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

Grafiku 19.



Sigurimi shëndetësor i anëtarëve të amvisërisë sipas profesionit momental të kokës në amvisëri

- Rrefuzon të përgjigjet
- Nuk e di
- Tjetër/I papunësuar
- Amvis/e
- Pensioner
- Ushtri/polici
- Nëpunës

Punëtor  
Bujk

Asnjëri nuk ka sigurim  
Pjesërisht – jo të gjithë kanë sigurim  
Po – të gjithë kanë sigurim

Në të gjitha amvisëritë ku koka e amvisërisë është femër të gjithë kanë sigurim shëndetësor, ndërsa në amvisëritë ku koka e familjes është mashkull vetëm në 6.7% asnjë nuk ka sigurim shëndetësor, ndërsa në 8.9% kanë sigurim të pjesërishtëm. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, pjesa më e madhe (86%) në rast sëmundje shfrytëzojnë shërbime shëndetësore publike (shërbime të institucioneve shëndetësore publike dhe blejnë barna nga lista pozitive). Një numër i vogël (5%) nga numri i përgjithshëm i të anketuarve blejnë barna të cilat nuk janë në listën pozitive dhe prej tyre 20% janë bujqësore, 60% janë punëtore, 20% bien në kategorinë e tjerëve. Në 6% të amvisërive anëtarët mjekohen privat, nga të cilët nga një e treta bien në kategoritë bujqësore, amvisëri punëtore etj. Gjysma e amvisërive të cilat shfrytëzojnë shërbime nga mjeku privat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. E rëndësishme është të vërehet se 2% nga të anketuarit nuk vizitojnë mjek dhe shfrytëzojnë mënyra alternative të mjekimit dhe të gjithë janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.


## 6.6. Arsim

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të përfshira në hulumtim, 47 amvisëri kanë fëmijë të cilët janë në moshë prej gjashtë dhe më tepër vite, gjegjësisht fëmijë të cilët janë të kyçur në procesin arsimor. Prej tyre, 19 amvisëri kanë një fëmijë i cili ndjek arsimin fillor, 12 amvisëri kanë nga dy fëmijë të cilët ndjekin arsimin fillor, 17 amvisëri kanë një fëmijë në arsimin e mesëm, tre amvisëri dy fëmijë në arsimin e mesëm, pesë amvisëri kanë një fëmijë në fakultet, ndërsa një amvisëri ka dy fëmijë të kyçur në arsimin e lartë.

Grafiku 20.



Grafiku 21.



Numri i fëmijëve në amvisëri të përfshirë në procesin arsimor

Një fëmijë  
Dy fëmijë

Arsim fillor  
Arsim i mesëm  
Arsim i lartë

Amvisëritë të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, fëmijët e të cilave ndjekin procesin arsimor

Arsim i lartë  
Arsim i mesëm  
Arsim fillor

Një fëmijë  
Dy fëmijë

Në asnjërën nga amvisëritë e anketuara nuk është evidentuar fëmijë i cili është në moshë shkollore dhe nuk është i përfshirë në procesin arsimor. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive me fëmijë të moshës shkollore, 24 amvisëri marrin ndihmë në para nga mbrojtja sociale. Prej tyre 10 amvisëri kanë fëmijë në arsimin fillor, 10 amvisëri kanë fëmijë në arsimin e mesëm, ndërsa dy amvisëri kanë fëmijë në fakultet. Shpërndarja e përgjigjeve sipas profesionit të kokës në amvisëri tregon se fëmijë të kyçur në procesin arsimor kanë 81.8% prej amvisërive bujqësore, 61.8% prej amvisërive punëtore, 100% prej amvisërive ku koka e amvisërisë është nëpunës, 12.5% ku koka e amvisërisë është pensioner dhe nga 50% familje amvise ose ushtarë dhe policore.

Në numrin më të madh të rasteve (96.7%), amvisëritë të cilat kanë fëmijë të cilët ndjekin arsimin fillor jetojnë në largësi më të vogël se 1 km nga shkolla fillore, ndërsa në një rast paraqitet një amvisëri e cila është e larguara më tepër se 4 km. Analiza e të dhënave tregon se të gjithë fëmijët e kyçur në arsimin fillor dhe të mesëm rregullisht e ndjekin shkollën dhe mësimin.

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, fëmijët e të cilave ndjekin arsimin fillor, tetë kanë shfrytëzuar të drejtën e transportit falas, gjashtë prej të cilave janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale dhe një amvisëri e ka shfrytëzuar të drejtën e ushqimit falas. Tek amvisëritë fëmijët e të cilave ndjekin shkollën e mesme gjenden katër amvisëri të cilat kanë përdorë transport falas dhe prej tyre tre janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para. Nga ana e amvisërive nuk janë shfrytëzuar forma të tjera të ndihmës për arsim. Nga të gjitha format e ndihmës për arsim të lartë vetëm një amvisëri e cila nuk është shfrytëzuese e ndihmës sociale në para merr bursë.

## **6.7. Sport, argëtim, kulturë**

Të anketuarit nga komuna e Konçes kanë theksuar se në vendbanimet e tyre ka terren sportiv (99), shesh lojërash (95), kafë bar (74), bibliotekë (57), restorant (52), dyqane (49) dhe internet kafene (39).

Mungon kinema, teatër dhe bastore sportive. Pjesa më e madhe e të anketuarve (65 amvisëri) kanë theksuar se asnjë anëtarë i amvisërisë së tyre nuk përdor internet. Në 31% të rasteve ku shfrytëzohet internet, të anketuarit kanë thënë se përdorin kompjuter shtëpiak, ndërsa vetëm në dy raste kanë përdor internet nga internet kafeneja.

## 7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 7.1. Përfundime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	GJENDJA/PROBLEME
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Bujqësi (prodhimi i duhanit)</li> <li><input type="checkbox"/> Pylltari</li> <li><input type="checkbox"/> Blegtori</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> 1 SHFQ</li> <li><input type="checkbox"/> 4 shkolla lokale deri në klasë të pestë</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka shkollë për arsim të mesëm</li> </ul>
	<i>Shëndetësi:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Rrjet i dobët i institucioneve shëndetësore</li> <li><input type="checkbox"/> Dy ordianca me mjekë të mjekësisë së përgjithshme dhe një motër medicinale. Njëra nga ordiancat punon vetëm dy herë në javë</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka ordinancë specialistike</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka shërbim për ndihmë të shpejtë</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka barnatore</li> </ul>
	<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka Qendër për punë sociale në Konçë</li> <li><input type="checkbox"/> Të drejtat e mbrojtjes sociale për banorët e Konçes i realizon QPS në Radovish</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka kopsht fëmijor</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka kuzhinë popullore</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka shtëpi për persona të moshuar</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka qendra për strehim ditor ose të përkohshëm</li> </ul>
	<i>Kulturë/Sport/Argëtim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Rrjet i pazhvilluar i institucioneve kulturore</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka shtëpi kulturore, kinema, teatër, muze dhe bibliotekë</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka sallë sportive as terrene sportive</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka shoqata qytetare</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka media lokale</li> </ul>
	<i>Subjekte ekonomike:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Objekte të vogla tregtare për transport dhe kapacitet i vogël ekonomik për blerjen dhe përpunimin e qumshtit</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Më të theksuara: papunësia dhe varfëria</li> <li><input type="checkbox"/> Një e treta e banorëve në moshë 15-65 vjeç janë të papunësuar. Prej tyre 168 janë femra</li> <li><input type="checkbox"/> Shpërndarja e papunësisë sipas grupeve moshore tregon se pjesa më e madhe e të papunësuarve janë në moshë prej 30 deri më 39 vjeç</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Dy të tretat (67.6%) nga të papunësuarit janë fuqi punëtore e pakualifikuar</li> <li>□ Persona të moshuar</li> <li>□ Persona me invaliditet (për ato nuk ekzistojnë kurrëfar shërbime sociale në komunë)</li> </ul>
	<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Ujësjellës: Kanalizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të gjitha vendbanimet kanë rrugë të asfaltuara</li> <li>□ Brenda fshatrave ka rrugë të paasfaltuara tokësore</li> <li>□ Në secilin vendbanim ka sisteme të posaçme për ujësjellje</li> <li>□ Rrjet kanalizues ka në katër fshatra më të mëdhenj: Konçe, Rakitec, Delino dhe Dollni Mitoviq</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Problemi me deponinë e cila nuk është sipas standareve ekologjike</li> <li>□ Probleme më të vogla me erozionin e tokës</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërkomunal në komunë</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Bashkëpunim i mirë me pushtetin qendror dhe OJQ-ët</li> <li>□ Bashkëpunim i zhvilluar regjional, në veçanti me komunat fqinje Radovish, Vallandovë dhe Shtip</li> <li>□ I dobët është bashkëpunimi me Qendrën për punë sociale dhe realizohet vetëm në rast nevojë për ndonjë rast konkret. Nuk ka bashkëpunim për parandalimin e problemeve sociale dhe çështjet për përmirësimin e gjendjes sociale në komunë</li> <li>□ Komuna ka bashkëpunim të mirë me shoqatat qyetetare, mirëpo theksohet kapaciteti i dobët dhe ndërmarrja e iniciativave nga OJQ-ët lokale</li> <li>□ Bashkëpunim i shkëlqyeshëm me Qendrën për punësim</li> </ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<i>Nga komuna:  Nga QPS:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale, ndërsa kompetencat realizohen nga ana e Njësisë për urbanizëm, punë komunale, mjedis jetësor dhe zhvillim ekonomik lokal</li> <li>□ Nuk ka punonjës social të punësuar, mirëpo është emruar një person i cili ka detyra nga sfera sociale</li> <li>□ Është përgatitur Plan strategjik për zhvillim ekonomik lokal 2007-2011 për Konçe dhe Radovish</li> <li>□ Është miratuar Program për mbrojtje sociale për popullsinë e Konçes për vitin 2010</li> <li>□ Si formë e ndihmës për popullatën socialisht të rrezikuar komuna jep ndihmë të njëhershme në para</li> <li>□ Për këtë ndahen 150.000 denarë, ose 0.5% nga buxheti vjetor i komunës</li> <li>□ Shfrytëzues të NSP: 23 amvisëri</li> <li>□ Shfrytëzues të NPP: 17 familje</li> <li>□ Në vit ndihmë e njëhershme në para ju jepet 20 shfrytëuesve</li> <li>□ Mbrojtje jointucionale: një fëmijë pa kujdes prindëror i vendosur në familje strehuese</li> </ul>

## 7.2. Rekomandime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E PROBLEMEVE DHE PËRMIRËSIM TË GJENDJEVE
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Komuna e Konçes është një mjedis i pastërt dhe ekologjikisht i shëndoshë, me resurse dhe potenciale për prodhimin e ushqimit të shëndoshë, ndërsa disponon edhe me pasuri të madhe pyjore dhe ujore</li> <li>□ Komuna e Konçes disponon edhe me rezerva të mëdha të mermerit, argjilit dhe xehes së bakrrit, gjë e cila paraqet potencial për zhvillimin e xehetarisë.</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të zgjerohet rrjeti i shkollave lokale</li> <li>□ Të analizohet mundësia që një pjesë e shkollave rajonale të jenë deri në klasë të nëntë</li> <li>□ Të hapet shkollë e mesme</li> </ul>
	<i>Shëndetësi:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të zgjerohet rrjeti i institucioneve shëndetësore para së gjithash me ordianca me mjekë amë të mjekësisë së përgjithshme</li> <li>□ Të riorganizohet puna e ordiancave për mbrojtje shëndetësore primare</li> <li>□ Të hapen ambulanca në të gjitha fshatrat</li> <li>□ Të krijohet shërbim për ndihmë të shpejtë</li> <li>□ Të stimulohet hapja e një barnatoreje dhe ordinancë bazike specialistike</li> </ul>
	<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të pasurohet rrjeti i institucioneve sociale në komunë</li> <li>□ Të hapet Qendër për punë sociale ose zyrë e QPS nga Radovishi</li> <li>□ Të krijohen shtëpi për persona të moshuar</li> <li>□ Të hapen qendra ditore për persona me pengesa në zhvillim</li> <li>□ Të hapet kopsht fëmijor</li> </ul>
	<i>Kulturë/Sport/Argëtim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të përforcohet kapaciteti i sektorit joqeveritar</li> <li>□ Të krijohen kushte për përmbushjen e nevojave kulturore</li> <li>□ Gradualisht të fillohet me investime për hapjen e kinemasë, teatrit, muzeut dhe bibliotekës</li> <li>□ Të promovohet zhvillimi i mediave në komunë (hapja e TV, radio stacionit dhe gazetës)</li> </ul>
	<i>Subjekte ekonomike:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të stimulohet zhvillimi i bizneseve të vogla dhe të mesme</li> <li>□ Të stimulohet, përmes lehtësimeve tatimore dhe subvencioneve të tjera, hapja e kapaciteteve më të mëdha industriale</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të promovohen forma për uljen e ç'kyçjes sociale dhe kulturore</li> <li>□ Të promovohen programe për punësimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale</li> <li>□ Të përmirësohet targetimi i masave aktive drejtë të papunësuarve në afat më të gjatë dhe efikasiteti i tyre lidhur me punësimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale</li> <li>□ Të realizohen programa për parandalim të dukurive të problemeve</li> </ul>

		<p>sociale lidhur me sjelljen devijuese</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të përforcohet puna këshilluese me amvisëritë e prekura nga këto kategori të problemeve</li> <li>□ Të zhvillohen format e strehimit ditor dhe të përkohshëm të personave me pengesa në zhvillim</li> <li>□ Të promovohen format e familjeve strehuese dhe shtëpi të vogla grupore</li> <li>□ Të hapen shtëpi dhe qendra për persona të moshuar</li> <li>□ Të pasurohet rrjeti i shërbimeve sociale për personat e moshuar: të analizohen mundësitë për hapjen e shërbimeve sociale për ndihmë në kushte shtëpiake, qendra ditore dhe shtëpi të vogla grupore</li> <li>□ Të promovohen forma për ulje të ç'kyçjes sociale</li> <li>□ Të hapen qendra ditore për personat me invaliditet (fëmijë dhe të rritur)</li> <li>□ Të shqyrtohen mundësitë për hapjen e serviseve për ndihmë në kushte shtëpiake</li> </ul>
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<p><i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i></p> <p><i>Rrugë:</i></p> <p><i>Ujësjellës:</i></p> <p><i>Kanalizim:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të përmirësohet kualiteti i infrastrukturës lokale (asfaltimi i rrugëve lokale)</li> <li>□</li> <li>□ Të vendoset kanalizim në të gjitha vendbanimet</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të zgjidhet problemi me deponinë për mbeturina të forta dhe të ndërmerren masa për uljen e pasojave nga erozioni i tokës</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërinstucional në komunë</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit mes komunës, QPS dhe Qendrës për punësim përmes zbatimit më intenziv dhe më efikas të punëve publike, masave aktive për punësimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale, anëtarësimin në organe të përbashkëta, edukim për mundësitë dhe format e bashkëpunimit të tyre në sferën e mbrojtjes sociale, si dhe zbatim praktik i projekteve të përbashkëta</li> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës me sektorin joqeveritar përmes kyçjes së tyre si partnerë në realizimin e programeve nga sfera e mbrojtjes sociale</li> <li>□ Inicimi i projekteve të përbashkëta me sektorin privat dhe zhvillimi i përgjegjësisë sociale të subjekteve ekonomike</li> </ul>
	<i>Nga komuna:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përforsim i Njesisë për urbanizëm, punë komunale, ambient jetësor dhe zhvillim ekonomik lokal mes të tjerave duke punësuar një punonjës social</li> <li>□ Edukim i të punësuarve në Njësi për mundësitë dhe format e zhvillimit të funksioneve socialo-mbrojtëse në komunë</li> <li>□ Edukim për planifikim strategjik dhe përpilim të programeve nga sfera e mbrojtjes sociale</li> <li>□ Zgjerim i formave të mbrojtjes sociale të cilat i realizon komuna (kryesisht ndihmë financiare) me forma të reja të shërbimeve sociale</li> </ul>

- 
- Rritje e mjeteve të cilat nga buxheti ndahen për mbrojtje sociale dhe shfrytëzimi efikas i tyre
  - Zhvillim i rrjetit lokal të dhënësve të shërbimeve për mbrojtje sociale, pjesërisht edhe përmes promovimit të partneritetit publiko-privat
- 

*Nga QPS:*

- Ulje e numrit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para duke i intenzivuar aktivitetet për punësimin e tyre në bashkëpunim me Qendrën për punësim
- Zhvillim i rrjetit për mbrojtje institucionale dhe joinstitucionale në komunë
- Hapja e kuzhinës popullore



# KOMUNA E NEGOTINËS

## 1. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË KOMUNËS SË NEGOTINËS

Komuna e Negotinës është e pozicionuar në pjesën qendrore të Republikës së Maqedonisë, kah mesi i fushës së Vardarit. I takon regjionit të Vardarit, ndërsa si mjedis i posaçëm natyror i takon regjionit Tikvesho-Vardar. Përfshin pjesën lindore të luginës së Tikveshit, në të dyja anët e Vardarit, ndërsa në jug-lindje kufizohet me Demir Kapinë. Kufizohet me këto komunë: në veri me komunën e Shtipit, në lindje me komunën e Konçes, në jug me Kavadarin, në perendim me Rosomanin dhe në veri-perendim me Gradsko. Komuna e Negotinës gjendet në një lartësi mbidetare prej 150 metrave. Territori i komunës së Negotinës përfshin një sipërfaqe prej 414 km<sup>2</sup>. Komuna si pjesë e regjionit të Tikveshit dhe Vardarit është nën ndikim të klimës mediterane, e cila shtrihet në jug përmes grykës malore të Demir Kapisë dhe klima kontinentale e cila vjen nga veriu, përmes grykës malore të Velesit.

Komunën e Negotinës e përbëjnë qyteti Negotinë dhe fshatrat: Brusnik, Veshje, Vojshanci, Disan i Epërm, Disan i Poshtëm, Dubrovo, Janoshevo, Kallanjevo, Krivollak, Kurija, Lipa, Pepelishte, Timjanik, Peshternica, Tremnik, Crveni Bregovi, Xhidimirci dhe Sheoba. Në komunë ka gjithsej 7.240 amvisëri dhe 9.120 njësi banuese.

Në komunën e Negotinës, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2002, jetojnë 19.212 banorë, që paraqet 0.95% nga popullsia e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë. Dendësia e popullsisë është 46.5 banorë në km<sup>2</sup>. Nga numri i përgjithshëm i banorëve, rreth 13.500 banorë jetojnë në qytetin e Negotinës, i cili është edhe selia administrative e komunës. Numri i popullsisë në vendbanimet e tjera (rurale) është i ardhshëm: Timjanik 1.155 banorë, Pepelishte 1.074, Disan i Poshtëm 930, Krivollak 1.021, Tremnik 829, Vojshanci 443, Kurija 216, Crveni Bregovi 173, Veshje 45, Dubrovo 49, Disan i Epërm 11, Peshternica 3, Lipa 2 dhe Brusnik ka 3 banorë. Fshatrat Janoshevo, Kallanjevo, Xhidimirci dhe Sheoba janë krejtësisht të shpërngulura. Krahasimi i të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 1994 dhe regjistrimi i popullsisë nga viti 2002, tregon se numri i popullatës në kornizat e komunës aktuale të Negotinës është rritur për 871 banorë ose në përqindje për 4.75%. Në nivel të Republikës së Maqedonisë rritja e numrit të banorëve është 3.9%. Shkalla e rritjes në nivel të gjithë komunës është 0.5%. Rritje natyrore e komunës së Negotinës është 783, ndërsa shkalla e mortalitetit është 0,5 (më 1000 banorë). Balansi i migrimin është 88. Sipas regjistrimit të vitit 1994, moshë mesatare e popullsisë në komunën e Negotinës ka qenë 32.7 vjeç me indeks të plakjes prej 0.35, ndërsa sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2002, moshë mesatare e popullsisë në komunë është 35.7%, me indeks të plakjes prej 0.524. Sa i takon strukturës gjinore të popullsisë, 50.89% prej banorëve janë të gjinisë mashkullore (9777 banorë), ndërsa 49.11% janë të gjinisë femrore (9435 banorë). Struktura etnike e popullsisë në komunën e Negotinës është e ardhshme: maqedonas 92.48%, shqiptarë 0.16 %, turq 1.26 %, romë 2.36 %, vllëh 0.07 %, serb 3.26 %, boshnjakë 0.01 %, dhe të tjerë 0.40%. Sa i takon strukturës së popullatës sipas moshës, në komunën e Negotinës 27.6% nga popullsia janë në moshë deri më 9 vjeç, 57.9% janë në moshë prej 20 deri më 60 vjeç dhe 14.5% të popullsisë janë mbi 60 vjeç.

Në komunën e Negotinës nga numri i përgjithshëm i banorëve të cilët janë më të vjetër se 10 vjeç, numri i të cilëve është 16.906, 16.401 banorë dinë shkrim-lexim, ndërsa 505 banorë janë analfabetë ose me përqindje ato janë 2.99% (në nivel të Republikës së Maqedonisë kjo përqindje është 3.62%). Analfabetizmi

është më i theksuar tek banorët e gjinisë femrore, rreth 4.47% (në nivel të Republikës së Maqedonisë kjo përqindje është 5.53%), ndërsa tek banorët e gjinisë mashkullore është 0.75% (në nivel të Republikës së Maqedonisë është 1.71%).

Kur bëhet fjalë për resurset natyrore me të cilat disponon komuna e Negotinës, nga pasuritë minerale në territorin e komunës mund të gjendet një lokacion i xehes në sipërfaqe prej 60 km<sup>2</sup>. Mes resurseve joorganike me të cilat disponon komuna janë guri, rëra, argjili dhe torfa, të cilat shumë shpesh janë të eksploatuara në një mënyrë jo të organizuar dhe stihike.

Rrjedha ujore më të rëndësishme në komunën e Negotinës janë: Vojshaniçka, lumi Timjaniçka, lumi Kurjaçka, lumi Doshnica, lumi Boshavica dhe Vardari i cili kalon nëpër komunën e Negotinës. Në komunën e Negotinës vende për peshkim janë lumi Vardar dhe Doshnica, të cilat disponojnë me llojet e ardhshme të peshqive: siluri, krapi, mrena, kleni dhe bellvica.

Nga kafshër e egra mund të gjenden: derri i egër, lepuri i egër, kaprolli, ujku, dhelpra, fëllanzë, pata e egër dhe lloje të tjera më pak të përfaqësuara. Në komunën e Negotinës ka pesë zona gjuetie dhe një shoqatë gjuetarësh. Në komunë më së shpeshti gjuhen llojet e ardhshme të kafëshve të egra: lepuri i egër, fëllenza, pëllumbi – grivnash, si dhe derri i egër dhe dhelpra.

Rreth Vardarit mund të gjenden shelgu, plepi dhe lloje të tjera të kaçubeve, ndërsa në vendet më të larta gjenden edhe dushku, ahu, shkola dhe frashni. Prodhimet e drurit të cilat fitohen nga rëshina, kora e drurit, tapa, fruta, fara, gjethi, myshku etj; si dhe prodhimet e tjera pyjore: bimë mjekuese dhe industriale, fruta pyjor, këpurdha dhe barë mbilidhen, gjegjësisht shfrytëzohen në mënyrë të pakontrolluar dhe shumë stihike.

Në komunën e Negotinës ka edhe më tepër vende për piknik.

## 2. KAPACITETE INSTITUCIONALE

**Arsim:** Në komunën e Negotinës ka dy shkolla fillore. Në SHF "Goce Dellçev" mësimin ndjekin gjithsej 1097 nxënës të shpërndarë në 55 klasa, nga të cilët 878 nxënës janë në shkollën amë në qytetin e Negotinës dhe janë të shpërndarë në 35 paralele. Klasat e tjera janë shpërndarë në shkolla lokale në vendbanimet Kurija, Tremnik, Timjanik dhe Dollni Disan. Në SHF "Strasho Pinxhur" mësimin ndjekin 907 nxënës nga të cilët në shkollën qendrore e cila gjendet në qytetin e Negotinës mësimin ndjekin 736 nxënës, të shpërndarë në 30 klasa. Shkolla ka edhe katër shkolla rajonale në vendbanimet Crveni Bregovi, Vojshanci, Krivollak dhe Pepelishte.

Në komunë ka një shkollë të mesme SHMQ "Kirill dhe Metodij" e cila përbëhet prej gjimnazit, degës teknologjiko-ushqimore dhe elektrike, dhe gjendet në qytetin e Negotinës.

**Shëndetësi:** Mbrojtja primare shëndetësore në komunën e Negotinës realizohet përmes ISHP Shtëpia shëndetësore në Negotinë e cila është e vendosur në qytetin e Negotinës dhe në suazat e 6 punkteve

shëndetësore. Mbrojtje shëndetësore private realizohet në kornizat e Qendrës medicinale dhe 5 spitaleve të mjekësisë së përgjithshme. Në komunën e Negotinës ka 11 ambulanca private dhe një klinikë specialiste private. Në komunën e Negotinës aktive janë 4 barnatore.

**Institucione sociale:** Në suazat e komunës së Negotinës funksionon një institucion publik për arsim dhe edukim parashkollor të fëmijëve. Nuk ka kopsht fëmijor privat. Në komunë ka vetëm një shtëpi për persona të moshuar, e cila është private.

**Institucione kulturore:** Në komunën e Negotinës ka një shtëpi kulturore "Aco Gjorçev", e vendosur në Negotinë. Objekti i Shtëpisë kulturore "Aco Gjorçev" – Negotinë është ndërtesë me sipërfaqe prej 1200 m<sup>2</sup>, e vënë në përdorim më 1948, si shtëpi kulturore e qytetit të Negotinës, që paraqet qendër e artit, muzikës dhe jetesës së përgjithshme kulturore të qytetarëve të Negotinës. Në komunë ka edhe një sallë kinemaje dhe një sallë teatrore të cilat janë në suazat e shtëpisë kulturore "Aco Gjorçev". Në komunë ka një bibliotekë, "Strasho Pinxhur" edhe atë në qytetin e Negotinës. Në komunën e Negotinës ka muze të qytetit të Negotinës, i cili është i vendosur në vetë qytetin.

**Objekte sportive:** Komuna e Negotinës disponon me një sallë sportive dhe dy terrene sportive.

**Media:** Në komunën e Negotinës ka dy radio lokale. Nuk ka televizion lokal e as gazetë. Komuna aktivitetet e saj i transmeton përmes Info buletinit të komunës së Negotinës katër herë në vit.

**Shoqata qytetare:** Në territorin e komunës së Negotinës janë regjistruar gjithsej 60 shoqata të qytetarëve dhe 26 klube sportive.

**Subjekte ekonomike:** Në territorin e komunës së Negotinës në veçanti është e zhvilluar bujqësia (agrobiznesi, pylltaria...) me theks të posaçëm në vneshtari. Nga veprimtaria prodhuese në veçanti dallohet industria ushqimore, industria tekstile dhe ndërtimtaria. Si potenciale të rëndësishme për zhvillim në suazat e komunës janë vneshtaria, para se gjithash përmes hapjes së fabrikave të reja për prodhim të venës dhe zhvillimin e turizmit alternativ.

### 3. PROBLEME DOMINUESË NË KOMUNË

**Probleme sociale:** Probleme dominuese sociale në komunë janë ç'kryerja sociale dhe papunësia. Nga numri i përgjithshëm i popullatës aktive, 4.865 banorë janë të punësuar, ndërsa 3302 banorë janë të papunësuar. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve 64.6% janë meshkuj, ndërsa 35.4% janë femra; ndërsa nga të papunësuarit 55.5% janë meshkuj, ndërsa 44.5% janë femra dhe këto janë të dhëna të fituara nga Qendra për punësim në Negotinë më 31.10.2010. Në strukturën e personave të papunësuar më të numruar janë ato të papunësuar të cilët janë të pakualifikuar ose gjysëm të kualifikuar (41.2%), të cilët për shkak të kualifikimeve të pamjaftueshme me të cilat disponojnë dhe mungesën e gjatë nga tregu i punës shumë vështirë kyçen si kërkues aktiv të punës në tregun e punës. Gjithashtu edhe personat e papunësuar me arsim të mesëm të kryer kanë një pjesëmarrje relativisht të lartë në numrin e evidentuar të personave të papunësuar në komunën e Negotinës (32%). Nga të papunësuarit, të kualifikuar janë 617 persona (18.7%),

pastaj me arsim të lartë janë 67 persona (2%), ndërsa 201 person (6.1%) nga personat e evidentuar si të papunësuar janë me arsim universitar. Sa i takon moshës, struktura e personave të evidentuar si të papunësuar është e ardhshme: 856 persona (25.9%) janë në moshë deri më 29 vjeç, 675 (20.4%) janë në moshë prej 30 deri më 39 vjeç, 700 persona (21.2%) janë në moshë prej 40 deri më 49 vjeç dhe 1071 persona (32.5%) janë mbi 50 vjeç.

Sa i takon problemit të ç'kyçjes sociale, në komunën e Negotinës veçohet ç'kyçja sociale e popullatës rome, gjegjësisht shkalla e ulët arsimore e romëve, si dhe ç'kyçja sociale e personave të moshuar në komunë. Gjithashtu, këtu theksohet edhe problemi i paqasëshmërisë tek institucionet publike për personat e hendikepuar.

Mes grupeve më të rrezikuara të popullatës së komunës së Negotinës numrohen romët, personat e moshuar, rastet sociale dhe fëmijët nga vendbanimet rurale.

**Probleme infrastrukturale:** Një nga problemet më të rëndësishme infrastrukturale, me të cilat ballafaqohet komuna e Negotinës, është urbanizmi i pamjaftueshëm i mjediseve rurale.

E gjithë komuna është kyçur në rrjetin ujësjellës. Është filluar ndërtimi i kanalizimit në fshatin Tremnik. Nuk ka kanalizim në fshatin Crveni Bregovi.

Lidhshmëri rrugore ka në të gjithë territorin e komunës së Negotinës. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit në qytetin e Negotinës është 25 km, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme është 17.5ha. Në komunën e Negotinës ka 51 km rrugë lokale. Në territorin e komunës së Negotinës kalon autostrada M-1 dhe rruga regjionale P-107. Në komunë nuk ka transport publik të organizuar.

**Probleme ekologjike:** Mes problemeve më të rëndësishme ekologjike, me të cilat ballafaqohet komuna e Negotinës dhe banorët e saj është mungesa e ujit, si dhe mungesa e deponisë në komunë.

#### 4. MBROJTJE SOCIALE

**Administrata komunale:** Në suazat e administratës komunale nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale dhe kompetencat realizohen nga ana e Njësisë për punë publike, ku ka një punonjës social të punësuar.

Komuna ka plan veprues për mbrojtje sociale të përgatitur në vitin 2006. Ka strategji për zhvillim lokal për periudhëm 2007-2011 dhe e njehta bazohet në OZHM. Në programet vjetore planifikimi i zhvillimit social në komunë është pjesë përbërëse e Programit për punë publike

Bashkëpunimi me qytetarët më së shpeshti bëhet duke i informuar qytetarët për aktivitetet e komunës përmes buletinit informativ, ueb faqes dhe përmes mediave. Gjithashtu, për një bashkëpunim më të mirë me qytetarët e komunës së Negotinës, qytetarët një herë në javë kanë takim tek kryetari i komunës.

Komuna e Negotinës ka realizuar bashkëpunim të mirë me komunën e Demir Kapisë, posaçërisht në zbatimin e projekteve të përbashkëta për mjedisin jetësor, me komunën e Kavadarit për formimin e komisioneve të përbashkëta për bujqësi dhe vneshtari, dhe në të njëjtën kohë planifikim të përbashkët për turizëm alternativ.

Si formë e ndihmës për popullatën socialisht të rrezikuar, komuna jep ndihmë të përhershme në para, për dhënien e të cilës vendos këshilli i komunës. Gjithashtu, komuna realizon tribuna të ndryshme për punë parandaluese, edukim, qendër ditore për fëmijët nga familjet socialisht të rrezikuara nga vendet rurale (të cilat momentalisht nuk funksionojnë për shkak se nuk janë vetë të qëndrueshme dhe për shkak të asaj se udhëheqësia paraprake nuk ka sjellë vendim për vazhdimin e tyre). Komuna i jep ndihmë qendrës ditore për persona me nevoja të posaçme Poraka.

Nga buxheti vjetor i komunës, 600.000 denarë ndahen për transfere sociale.

**Qendra për punë sociale:** Qendra për punë sociale e komunës së Negotinës është përgjegjëse për dy komuna: Negotinë dhe Demir Kapi. Numri i të punësuarve në Qendrën për punë sociale është 15, nga të cilët tre punonjës social, një pedagog, një psikolog, një jurist, një defektolog, një sociolog, një ekonomist, tre punonjës administrativ dhe personel ndihmës.

Qendra për punë sociale disponon me dy vetura, nga të cilat njëra përdoret për realizimin e punës terrenike. Qendra disponon me dy ndërtesa (njëra është kuzhinë popullore).

Si grup më problematik për punë veçohen shfrytëzuesit të cilët janë persona me probleme psiqike.

Në komunë ka mungesë të shërbimeve sociale siç janë këshilltoret për divorc, qendra edukative për punë preventive me persona të mitur dhe në veçanti për punë me fëmijë nga familjet me probleme sociale.

Qendra ka bashkëpunim me shoqatat qytetare, më së shpeshti duke ju dhënë ndihmë dhe shkëmbim të të dhënave. Prej organizatave fetare qendra ka realizuar bashkëpunim me organizatën humanitare të kishës evangelistike "AGAPE".

Si probleme më të rëndësishme për funksionimin e Qendrës për punë sociale veçohen mungesa e mjeteve financiare për karburantë për veturat të cilat janë të nevojshme për realizimin e punës terrenike.

**Numri dhe struktura e shfrytëzuesve të masave dhe shërbimeve nga mbrojtja sociale:** Analiza e strukturës së shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale në territorin e komunës së Negotinës, sipas të dhënave për muajin shtator të vitit 2010, tregon se 485 persona janë shfrytëzues të ndihmës sociale në para, 96 janë shfrytëzues të ndihmës së përhershme në para dhe 362 janë shfrytëzues të ndihmës dhe kujdesit nga personi i huaj. Janë regjistruar 4 shfrytëzues të ndihmës së njëhershme në para. Në suazat e kuzhinës popullore, si shfrytëzues janë evidentuar 42 amvisëri, me gjithsej 80 ushqime.

E drejta e ndihmës në para nga mbrojtja sociale më së shpeshti nuk realizohet, si rezultat i punësimit dhe realizimit të të ardhurave nga përpunimi i tokës bujqësore. Gjithashtu, në suazat e fokus grupeve u

theksua problemi me ndalimin e pagesës së ndihmës të njehershme në para. *"Më nuk na e paguajnë ndihmën e njehershme në para, kam bërë operacion dhe ku të gjej para që të shkoj të kontrollohem në Shkup... mjekja mund të më japë në recept vetëm diazepam, për shkak se vetëm atë mund ta blejë, por sëmundja ime nuk mjekohet me diazepam..."*

Nga format e mbrojtjes jointucionale, në territorin e komunës së Negotinës funksionon Qendra ditore për persona me pengesa me zhvillim dhe një kuzhinë popullore.

## **5. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS ME AKTORËT LOKAL**

Komuna e Negotinës në përgjithësi ka bashkëpunim të mirë me BNJVL, i cili kryesisht bazohet në bashkëpunim për trajnime të përbashkëta dhe të ngjajshme.

Sa i takon bashkëpunimit të komunës me Qendrën për punë sociale, bashkëpunimi më së shpeshti realizohet përmes shkëmbimit të informatave, edukimeve dhe trajnimeve të përbashkëta.

Komuna bashkëpunon me Agjencinë për punësim në shkëmbimin e informatave dhe të dhënave. Bashkëpunimi i komunës me shoqatat joqeveritare realizohet përmes aplikimit me dhe realizimit të projekteve të përbashkëta, përgatitjes së dokumenteve strategjike dhe të ngjajshme. Me sektorin privat komuna bashkëpunon vetëm në realizimin e minifestimeve të përbashkëta. Komuna bashkëpunon me pushtetin qendror përmes korrespondencës së ministrive, shkëmbimit të të dhënave dhe realizimin e trajnimeve.

Bashkëpunimi me organizatat fetare, gjegjësisht me organizatën e kishës ortodokse komuna e realizon gjatë menifestimit në nder të shën Trifunit.


## **6. REZULTATE NGA HULUMTIMI ANKETUES I AMVISËRIVE NË KOMUNËN E NEGOTINËS**

### **6.1. Të dhëna të përgjithshme për amvisëritë**

Në komunën e Negotinës u anketuan 100 amvisëri, nga të cilat 70 në vendbanime urbane, ndërsa 30 në vendbanime rurale. Më tepër se gjysma e amvisërive janë jobujqësore (52%), 27% janë të përziera dhe 21% janë amvisëri bujqësore. Sa i takon përkatësisë etnike, 96% janë amvisëri të nacionalitetit maqedonas, 2% romë, nga të cilët të gjithë janë amvisëri jobujqësore dhe 1% të nacionalitetit turk, të cilët janë amvisëri të përziera.

Grafiku 1.

Grafiku 2.



Popullsi rurale/urbane

Rurale

Urbane

Tremnik

Disan i Poshtëm

Tamjanik

Negotinë

Lloji i amvisërisë

Bujqësore

Jobujqësore

E përzier

Tek shumica e amvisërive koka e amvisërisë është punëtor (36%) dhe amvis/e (18%). Pastaj janë amvisëritë ku koka e amvisërisë është pensioner (8%), bujk (7%), i/e papunësuar (6%), nëpunës (5%), i punësuar në ushtri ose polici (5%), dhe në një pjesë shumë të vogël udhëheqës (2%), teknik, nxënës ose student dhe tepriçë teknologjike (me 1% të përfaqësueshmërisë në amvisëri). Në 71% të amvisërive, koka e amvisërisë është person i gjinisë mashkullore. Në 65% të amvisërive koka e amvisërisë është në bashkësi martesore, ndërsa në 25% nuk është i/e martuar.

Sa i takon numrit të anëtarëve në amvisëri, në 31% të amvisërive ka nga katër anëtarë, në 21% nga tre anëtarë, në 20% nga pesë anëtarë (nga të cilët një amvisëri është rome, ndërsa të tjerat maqedonase), ndërsa në 16% nga dy anëtarë. Në 6% të amvisërive ka nga gjashtë anëtarë, nga të cilët një amvisëri është

rome, ndërsa të tjerat maqedonase. Njëra nga amvisëritë është amvisëri me tetë anëtarë të nacionalitetit turk, ndërsa një amvisëri ka dhjetë anëtare dhe është e nacionalitetit maqedonas.

Në pjesën më të madhe të amvisërive, koka e amvisërisë ka kryer shkollën e mesme teknike (43%), pasta janë ato me gjimnaz të kryer (25%), me arsim fillor (14%), me arsim të lartë (8%) dhe me arsim fillor të pakryer (4%). Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve është me arsim të lartë, gjegjësisht 5%, ndërsa 1% janë pa arsim. Gati të gjithë prej të anketuarve dinë shkrim-lexim (99%).

Grafiku 3.



Shkalla e arsimit formal e kokës në amvisëri

- Pa arsim
- Arsim fillor i pambaruar
- Arsim fillor
- Arsim i mesëm teknik
- Gjimnaz
- Arsim i lartë
- Arsim universitar

Gjysma e amvisërive të cilët u anketuan, janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

## 6.2. Punësim

Në 41% prej amvisërive ka nga një anëtarë të punësuar në amvisëri, në 15% nga dy, në 4% nga tre, ndërsa në 1% të amvisërive janë katër anëtarë të punësuar. Në amvisëritë rome dhe turke nuk ka anëtarë të punësuar.

Në 54% prej amvisërive ka të punësuar të gjinisë mashkullore, ndërsa vetëm në 28% anëtarët e punësuar janë të gjinisë femrore. Lidhur me papunësinë, 49% prej amvisërive janë persona të gjinisë femrore, ndërsa 45% janë persona të gjinisë mashkullore.

Grafiku 4.



Grafiku 5.



Shkalla e punësimit sipas gjinisë

- Një
- Dy
- Tre
- Katër

Meshkuj  
Femra

Shkalla e papunësisë sipas gjinisë

- Një
- Dy
- Tre
- Katër

Meshkuj

## Femra

Pensionerë ka në 26% të amvisërive, nga të cilët 13% janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 18% të gjinisë femrore. Në 56% të amvisërive ka nxënës ose studentë; prej tyre në 42% të amvisërive ka nxënës ose studentë të gjinisë femrore, ndërsa në 32% të gjinisë mashkullore. Në 20% të amvisërive ka amvis/e, nga të cilët 20% janë të gjinisë femrore, ndërsa vetëm 2% e amvisërive janë të gjinisë mashkullore. Persona të vetëpunësuar ka në 5% të amvisërive, tepricë teknologjike në 2% (të gjitha të gjinisë mashkullore), ndërsa punëdhënës në 1% të amvisërive (të gjitha të gjinisë mashkullore).

### 6.3. Standardi jetësor

Analiza e të ardhurave tregon se 64% prej amvisërive kanë marrë të ardhura nga marrëdhënie të rregullta punë në 12 muajt e fundit. Prej amvisërive, 44% kanë realizuar të ardhura nga bujqësia, 26% nga pensionet, ndërsa 22% nga puna sezonale. Pastaj vijojnë amvisëritë të cilat kanë realizuar të ardhura nga mbrojtja sociale (12%), në të cilat bëjnë pjesë edhe amvisëritë e nacionalitetit rom. Të ardhura nga ndihma e familjarëve kanë fituar 5% nga amvisëritë, ndërsa të ardhura prej jashtë ka pasur vetëm në 4% të amvisërive.

Grafiku 6.



Sipas cilës bazë janë realizuar të ardhurat në 12 muajt e fundit

- Marrëdhënie të rregullta pune
- Marrëdhënie të çrregullta pune
- Pensione
- Të ardhura nga jashtë

## Bujqësi Ndihmë nga familjarë

Lidhur me shumën e të ardhurave të cilat amvisëritë i kanë realizuar në muajin e fundit, pjesa më e madhe e amvisërive, gjegjësisht 23% kanë realizuar të ardhura prej 5001 deri më 10.000 denarë, dhe të gjitha janë të nacionalitetit maqedonas. Pastaj janë amvisëritë të cilat kanë realizuar të ardhura deri më 5000 denarë (19% e amvisërive), në të cilat bien edhe amvisëritë të nacionalitetit rom dhe turk, të cilët jetojnë në komunë. Të dhëna interesante janë ato se një pjesë e madhe e amvisërive kanë pasur të ardhura prej mbi 18001 denarë. Gjegjësisht, 13% e amvisërive kanë realizuar të ardhura prej 18001 deri më 23000 denarë, 11% të ardhura prej 23001 deri më 30000 denarë, ndërsa 12% të ardhura prej mbi 30001 denarë.

Grafiku 7.



Shuma e parave të cilën amvisëria e ka realizuar muajin paraprak

Deri më 5.000 mkd

Mbi 30.001 mkd


Rrefuzon të përgjigjet

Në 16% të amvisërive nuk konsumohet ushqim i ngrohtë me mish. Prej amvisërive ku konsumohet ushqim i ngrohtë me mish, dominojnë ato në të cilat gatuhet ushqim i ngrohtë tre herë në javë (22%). Pastaj janë amvisëritë në të cilat gatuhet ushqim i ngrohtë me mish dy herë në javë (17%), katër herë (13%), një herë në javë (12%), çdo ditë (9%) dhe pesë herë në javë (8%).

Amvisëritë e nacionalitetit turk kanë deklaruar se konsumojnë ushqim të ngrohtë me mish katër herë në javë. Brengosëse janë të dhënat se amvisëritë e nacionalitetit rom nuk konsumojnë ushqim të ngrohtë me mish asnjëherë gjatë javës.

Nga shfrytëzuesit e ndihmës në para nga mbrojtja sociale, 15% kanë deklaruar se nuk konsumojnë ushqim të ngrohtë me mish aspak gjatë javës, 12% prej shfrytëzuesve konsumojnë dy herë në javë, 8% vetëm një herë, ndërsa 5% katër herë. Vetëm 3% prej shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale konsumojnë ushqim të ngrohtë me mish çdo ditë në javë.

Grafiku 8.



Konsumimi i ushqimit të ngrohtë gjatë javës sipas profesionit të kokës në amvisëri

- Ushtri/polici
- Afarist privat
- I papunësuar
- Amvise
- Pensioner
- Udhëheqës
- Teknik
- Nëpunës

Punëtor  
Bujk

Aspak  
Katër herë


Një herë  
Pesë herë

Dy herë  
Gjashtë herë

Tre herë  
Çdo ditë

Në amvisëritë ku koka e amvisërisë është mashkull më së shpeshti që konsumohet ushqim i ngrohtë me mish është dy herë (19.7%) dhe tre herë në javë (19.7%), ndërsa në amvisëritë në të cilat femra është koka e amvisërisë, ë ushqim i ngrohtë më së shpeshti që konsumohet është tre herë në javë (27.6%) dhe një herë në javë (17.2%). Prej amvisërive ku nuk konsumohet ushqim i ngrohtë me mish, 75% janë ato në të cilat koka e amvisërisë i takon gjinisë mashkullore. Mes amvisërive në të cilat nuk konsumohet ushqim i ngrohtë me mish aspak gjatë javës, më të përfaqësuara janë amvisëritë ku koka është amvis/e dhe atë me 43.8%, pastaj pasojnë ato bujqësore, punëtore dhe amvisëri ku koka është i papunësuar (të gjitha me nga 12.5%). Në amvisëritë në të cilat çdo ditë konsumohet ushqim i ngrohtë me mish, më të numruara janë amvisëritë ku koka është punëtorë (55.6%), si dhe amvisëritë ku koka është nëpunës, teknik, i punësuar në ushtri ose polici dhe i papunësuar (me nga 11.5%).

Grafiku 9.



Frekuenca e përgjigjeve të dhëna për mungesën e parave

Ushqim dhe pije joalkoolike  
 Pije alkoolike dhe duhan  
 Veshje dhe këpucë  
 Shpenzime të regjisë  
 Orendi shtëpiake dhe mobilje  
 Higjienë dhe shëndetësi  
 Komunikacion  
 Komunikim  
 Rekreim dhe kulturë  
 Arsim


Pjesa më e madhe e amvisërive kanë mungesa të parave për mbulimin e shpenzimeve të regjisë - banim, ujë, rrymë, karburantë (75%) dhe për veshje dhe këpucë (72%). Një pjesë e të anketuarve kanë theksuar se ju mungojnë para për orendi shtëpiake dhe mobilje (56%), ushqim dhe pije joalkoolike (52%) dhe nevoja higjienike dhe shëndetësore (29%). Pastaj pasojnë nevojat për komunikacion – transport, automobil (32%) dhe komunikim – telefon, internet (22%). Këtu është interesant të theksohet se në 22% të

amvisërive theksohet mungesa e parave për pije joalkoolike dhe duhan. Në 18% të amvisërive theksohet mungesa e parave për arsim, ndërsa në 11% për kulturë dhe rekretim. Prej amvisërive, 55% kanë kompjuter, ndërsa 26% nuk mund të blejnë. 47% posedojnë automobil, ndërsa 43% nuk mund të blejnë. Gjysma e amvisërive e kanë veçuar mungesën e veshjes dhe këpucëve dimrore.

Grafiku 10.



Grafiku 11.



Madhësia e banimit  
m<sup>2</sup>  
mbi 100m<sup>2</sup>

Numri i anëtarëve në amvisëri sipas madhësisë së banesës në të cilën jetojnë

- Dhjetë
- Tetë
- Gjashtë
- Pesë
- Katër
- Tre
- Dy
- Një


- Një dhomëshe
- Dy dhomëshe
- Tre dhomëshe
- Katër dhomëshe
- Më e madhe
- Rrefuzon të përgjigjet

Kur bëhet fjalë për banimet e amvisërive, pjesa më e madhe kanë theksuar se jetojnë në banesë me më tepër se katër dhoma (33%) dhe në banesë me katër dhoma (29%). Në banesë tre dhomëshe jetojnë 19% prej amvisërive, në dy dhomëshe 16%, ndërsa një pjesë më e vogël, gjegjësisht 2% jetojnë në banesë një

dhomëshe. Amvisëritë e nacionalitetit rom jetojnë në banesë dy dhomëshe, ndërsa amvisëritë e nacionalitetit turk në banesë katër dhomëshe.

Nga shfrytëzuesit e ndihmës në para nga mbrojtja sociale, pjesa më e madhe e amvisërive jetojnë në banesë katër dhomëshe (32%). Në banesë me më tepër se katër dhoma jetojnë 26% të amvisërive, në dy dhomëshe jetojnë 22%, në tre dhomëshe 16%, ndërsa një pjesë më e vogël e shfrytëzuesve, gjegjësisht 4% jetojnë në banesë një dhomëshe.

Grafiku 12.



Numri i dhomave të cilat ngrohen në amvisëri

- Një
- Dy
- Tre
- Katër dhe më shumë

Pjesa më e madhe e amvisërive në shtëpi për ngrohje shfrytëzojnë kofitor me lëndë djegëse të forta (87%), nga të cilat pjesa më e madhe janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale (55.2%). Vetëm 5% prej amvisërive shfrytëzojnë nxemje me avull vetanake, nga të cilat asnjëra prej amvisërive nuk është shfrytëzuese e ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Pjesa më e madhe e amvisërive (47%) ngrohin vetëm një dhomë në shtëpi, nga të cilat 70% janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

#### 6.4. Probleme sociale dhe mbrojtja sociale

Në problemet sociale me të cilat më së shpeshti ballafaqohen amvisëritë numrohen papunësia në 67% dhe varfëria në 53% të amvisërive. Divorcet si problem social janë theksuar nga 13% të amvisërive, marrëdhëniet konfliktuoze familjare në 12% dhe sëmundjet në gjithashtu 12% të amvisërive. Vetëm 3% të amvisërive si problem e kanë theksuar invaliditetin. Një pjesë e amvisërive i kanë veçuar problemet që kanë të bëjnë me proceset ekologjike natyrore, gjegjësisht thatësitë (10%) dhe vërshimet (9%). Sjellja devijuese është theksuar si problem nga ana e disa amvisërive dhe atë tek 4% është veçuar bixhozi, tek 4% endja ruggëve nga ana e të moshuarve, tek 3% alkoolizmi, tek 1% narkomania dhe prostitucioni.

Grafiku 13.




Probleme të ndërlidhura me zhvillimin social

- Papunësia
- Konfliktet familjare
- Varfëria
- Sëmundja
- Divorcet
- Invaliditeti

Asnjëra prej amvisërive nuk ka shfrytëzuar ndonjë prej masave të mbrojtjes institucionale. Vetëm 1 amvisëri ka shfrytëzuar masat e mbrojtjes joinstitucionale edhe atë ndihmë profesionale të familjes dhe bëhet fjalë për amvisëri ku koka e amvisërisë është i/e divorcuar. Në pyetjen se përse nuk kanë shfrytëzuar asnjë nga masat e mbrojtjes institucionale dhe joinstitucionale, 74.4% prej amvisërive kanë theksuar se nuk kanë nevojë, në të cilat bëjnë pjesë edhe të gjitha amvisëritë e nacionalitetit rom. Një pjesë e amvisërive nuk i kanë shfrytëzuar këto masa mbrojtëse për shkak të painformimit (12.1%), një pjesë janë rrefuzuar (8.1%) ndërsa një pjesë nuk kanë pasur dokumentacion të kompletuar (4%). Sa i takon shfrytëzimit të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, 54% e amvisërive shfrytëzojnë ose kanë shfrytëzuar ndihmë sociale në para, mes të cilave përveç amvisërive maqedone, ka edhe amvisëri rome dhe turke. Është evidentuar vetëm një amvisëri e cila ka shfrytëzuar kompenzim në para për ndihmë dhe kujdes të personit të huaj dhe një amvisëri e cila ka shfrytëzuar ndihmë në para për person i cili deri në moshën 18 vjeçare e ka pasur statusin e fëmijës pa prindër dhe kujdes prindëror. Pjesa më e madhe e shfrytëzuesve janë amvisëri ku koka është në bashkësi martesore (64%). Gjysma e amvisërive të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale janë jobujqësore (50%), 32% janë bujqësore, ndërsa 18% janë amvisëri të përziera.

Grafiku 14.

Grafiku 15.



Shfrytëzues të ndihmës nga mbrojtja sociale

Këshilla profesionale  
Ndhmë për fëmijë pa prindër

Ndhmë sociale në para  
Ndhmë dhe kujdes nga personi i huaj

Shfrytëzues të ndihmës nga mbrojtja sociale

Shtesë fëminore  
Shtesë e posaçme fëminore  
Ndhmë në para për fëmijë të sapo lindur

Pjesa më e madhe e amvisërive kanë theksuar se nuk kanë pasur nevojë që të shfrytëzojnë ndihmën në para nga mbrojtja sociale (36%), një pjesë e vogël kanë thënë se kanë qenë të refuzuar (5%), të painformuar (3%), nuk kanë pasur dokumentacion të kompletuar (1%) ose për shkak të turpit (1%).

Grafiku 16.

Grafiku 17.



Për cilat shkaqe amvisëria nuk ka shfrytëzuar ndonjë të drejtë nga mbrojtja sociale

Nuk ishëm të informuar  
 Dokumentacion jo i kompletuar  
 Nuk kemi nevojë

Ishëm të rrefuzuar  
 Për shkak të turpit

Shfrytëzues të ndihmës nga mbrojtja sociale

Shtesë fëmimore  
 Shtesë e posaçme fëmimore  
 Ndihmë në para për fëmijë të sapo lindur

Kur bëhet fjalë për shfrytëzimin e formave të mbrojtjes fëmimore, 28% e amvisërive kanë shfrytëzuar shtesë fëmimore dhe 13% kanë shfrytëzuar ndihmë të njëhershme për fëmijë të sapo lindur, mes të cilave bëjnë pjesë edhe amvisëritë turke. Vetëm 2% e amvisërive kanë shfrytëzuar shtesë të posaçme fëmimore, ndërsa 1% shtesë prindërore për fëmijë. Prej amvisërive të cilat nuk kanë shfrytëzuar ndonjë nga format e mbrojtjes fëmimore, 34% kanë theksuar se nuk kanë nevojë, 12% për shkak të painformimit, 9% kanë qenë të rrefuzuar, ndërsa 5% nuk kanë pasur dokumentacion të kompletuar. Sa i takon shpërndarjes së shfrytëzimit të formave të mbrojtjes fëmimore sipas statusit bashkëshortor, pjesa më e madhe e shfrytëzuesve të shtesës fëmimore dhe ndihmës së njëhershjme në para për fëmijë të sapo lindur janë të martuar, ndërsa shfrytëzuesit e shtesës prindërore janë të divorcuar.


Të gjitha amvisëritë e nacionalitetit rom kanë theksuar se nuk kanë shfrytëzuar asnjë nga masat e mbrojtjes jointucionale dhe institucionale, si dhe as mbrojtje fëmimore mu për shkak të dokumentacionit jo të plotë ose të parregulluar.

Vetëm 1 amvisëri ka deklaruar se deri tani ka marrë ndonjë formë të parave ose ndihmës në natyrë nga ana e personave privat.

### 6.5. Shëndetësi dhe të ushqyerit

Sa i takon sigurimit shëndetësor, pjesa më e madhe e amvisërive kanë thënë se të gjithë anëtarët e amvisërisë së tyre kanë sigurim shëndetësor (90%), nga të cilat gjysma janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Prej amvisërive, 8% kanë theksuar se vetëm një pjesë e anëtarëve të tyre kanë sigurim shëndetësor, ndërsa 2% kanë thënë se asnjë anëtarë në amvisërinë e tyre nuk ka sigurim shëndetësor, prej të cilave gjysma janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Në amvisëritë turke dhe rome sigurim kanë të gjithë anëtarët e amvisërisë.

Grafiku 18.



Grafiku 19.



Sigurimi shëndetësor i anëtarëve në amvisëri

- Po – të gjithë kanë sigurim
- Pjesërisht – jo të gjithë kanë sigurim
- Asnjëri nuk ka sigurim

Numri i shfrytëzuesve të ndihmës nga mbrojtja sociale të cilët kanë sigurim shëndetësor

- Asnjëri nuk ka sigurim
- Pjesërisht – jo të gjithë janë të siguar
- Po – të gjithë kanë sigurim

Pjesa më e madhe e amvisërive, gjegjësisht 90%, kanë thënë se shkojnë në mjek publik dhe shfrytëzojnë barnë në recept, nga të cilët gjysma janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Prej amvisërive, 5% kanë deklaruar se shkojnë në mjek publik, ndërsa blejnë barna privat (nga të cilat 3

amvisëri janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, ndërsa 2 nuk janë). Një pjesë e vogël, gjegjësisht 3% kanë thënë se nuk shkojnë në mjek dhe shfrytëzojnë mënyra alternative të mjekimit, nga të cilat 2 amvisëri janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, ndërsa 1 nuk është shfrytëzuese. Vetëm 1 amvisëri ka deklaruar se mjekohet në mjek privat, ku koka e amvisërisë është e gjinisë femrore me profesion nëpunës.

Amvisëritë turke dhe rome shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore publike.

Sa i takon distancës së shtëpive shëndetësore nga vendbanimi i amvisërive, 80% kanë deklaruar se shtëpia më e afërt shëndetësore gjendet në largësi prej jo më shumë se 15 minuta. Tek 10% e amvisërive shtëpia më e afërt shëndetësore është prej 16 deri më 30 minuta, ndërsa tek 2% e amvisërive më tepër se 30 minuta. Prej amvisërive, 8% kanë deklaruar se nuk ka shtëpi shëndetësore në afërsi të vendbanimit të tyre.

### 6.6. Arsim

Në 47% prej amvisërive ka fëmijë të cilët janë në moshë prej gjashtë dhe më tepër vjeç, gjegjësisht fëmijë të cilët janë të përfshirë në procesin arsimor, nga të cilët 91.5% janë maqedonas, 4.3% romë dhe 2.1% turq.

Në 19% prej amvisërive ka nga një fëmijë, në 6% ka nga dy fëmijë, ndërsa në 3% nga tre fëmijë të cilët ndjekin procesin arsimor. Në 11% të amvisërive ka nga një fëmijë i cili ndjek arsimin e lartë, ndërsa në 4% nga dy fëmijë. Në asnjërën nga amvisëritë e anketuara nuk ka fëmijë të cilët janë në moshë shkollore dhe nuk ndjekin arsimin fillor ose të mesëm.

Grafiku 20.



Numri i fëmijëve në amvisëri të cilët ndjekin procesin arsimor

Një  
Dy  
Tre

Arsim fillor  
Arsim i mesëm  
Arsim i lartë

Prej amvisërive fëmijët e të cilave ndjekin arsimin fillor, 25 amvisëri jetojnë në distancë prej 1km nga shkolla, ndërsa 5 amvisëri jetojnë në distancë prej 2.01 deri më 4km nga shkolla.

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive me fëmijë të moshës shkollore, 48.9% janë amvisëri shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Prej tyre, 29 amvisëri kanë fëmijë në arsimin fillor dhe 5 kanë fëmijë në arsimin e mesëm. Në vetëm 3 amvisëri, të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, ka fëmijë të përfshirë në arsimin e lartë.

Sa u takon formave të ndihmës për arsim, prej amvisërive me fëmijë në arsimin fillor, 4 amvisëri kanë shfrytëzuar transportin falas, nga të cilat 3 amvisëri janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Vetëm 1 amvisëri e nacionalitetit rom dhe në të njejtën kohë shfrytëzuese e ndihmës në para nga mbrojtja sociale ka shfrytëzuar ushqim falas.

Tek amvisëritë fëmijët e të cilave ndjekin arsimin e mesëm, transport falas kanë shfrytëzuar vetëm 2 amvisëri, nga të cilat 1 amvisëri është shfrytëzuese e ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Tek amvisëritë me fëmijë të cilët ndjekin arsimin e lartë, vetëm një amvisëri ka shfrytëzuar bursë dhe bëhet fjalë për amvisëri e cila nuk është shfrytëzuese e ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

Të dhënat e fituara tregojnë se fëmijët e përfshirë në arsimin fillor dhe të mesëm rregullisht e ndjekin shkollën dhe mësimin. Nuk janë evidentuar raste të fëmijëve të cilët jo rregullisht e ndjekin arsimin fillor dhe të mesëm, as po fëmijë të cilët e kanë braktisur shkollën.

Sa i takon profesionit të kokës së amvisërisë, analiza tregon se nga numri i përgjithshëm i amvisërive në të cilat ka fëmijë të moshës shkollore, pjesa më e madhe janë amvisëri ku koka është punëtorë (27.7%) dhe amvis/e (21.3%). Pastaj vijnë amvisëritë ku koka është bujk (10.6%), pensioner dhe person i punësuar në ushtri dhe polici (nga 6.4%) nëpunës (4.3%), i papunësuar, tepriçë teknologjike, nxënës/student dhe udhëheqës (nga 2.1%).

## **6.7. Sport, argëtim, kulturë**

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, pjesa më e madhe kanë thënë se në vendbanimin tyre ka internet kafene (96%), bastore sportive (93%), shesh lojërash (92%), biblioteka (89%), kafe bare (74%), markete (72%), restorane (72%), teatër (72%) dhe kinema (71%). Të gjithë të anketuarit kanë theksuar se në vendbanimin e tyre ka terrene sportive. Sa i takon shfrytëzimit të internetit, pjesa më e madhe e të anketuarve kanë theksuar se shfrytëzojnë internet nga kompjuteri shtëpiak (46%). Një pjesë e vogël e të

anketuarve shfrytëzojnë internet nga internet kafeneja (10%) dhe nga vendi i punës (2%). Në veçanti të rëndësishme janë të dhënat se një pjesë e madhe e të anketuarve aspak nuk shfrytëzon internet (42%).

## 7. PËRDUNSIMET DHE REKOMANDIME

### 7.1. Përfundime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	GJENDJA/PROBLEME
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Bujqësi (vneshtari)</li> <li>□ Industria tekstile</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<p><i>Arsim:</i></p> <p><i>Shëndetësi:</i></p> <p><i>Sfera sociale:</i></p> <p><i>Kulturë/Sport /Argëtim:</i></p> <p><i>Subjekte ekonomike:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ 2 shkolla qendrore fillore</li> <li>□ 8 shkolla fillore rajonale</li> <li>□ 1 shkollë e mesme me drejtimet e ardhshme: gjimnaz, drejtim ushqimoro-teknikologjik dhe elektro-teknik</li> <li>□ Mbrojtje primare shëndetësore: 1 shtëpi shëndetësore, 6 punkte shëndetësore</li> <li>□ Mbrojtje shëndetësore sekondare: 1 shtëpi shëndetësore, 6 punkte shëndetësore</li> <li>□ 11 ambulanca private, një klinikë specialitike private</li> <li>□ 4 barnatore</li> <li>□ 1 kuzhinë popullore</li> <li>□ 1 kopsht fëmënor publik</li> <li>□ 1 shtëpi private për persona të moshuar</li> <li>□ 1 sallë spotive, 2 terrene sportive</li> <li>□ 60 shoqata qytetare</li> <li>□ 26 klube sportive</li> <li>□ 1 shtëpi e kulturës, 1 kinema, 1 teatër, 1 bibliotekë, 1 muze</li> <li>□ 2 radio lokale</li> <li>□</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>	<p><i>Grupe socialisht të</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Më të theksuara: papunësia dhe varfëria (shkalla e papunësisë është 36.2%, ndërsa shkalla e punësisë është 44.4%)</li> <li>□ 3.302 persona të papunësuar (1.471 femra dhe 1.831 meshkuj)</li> <li>□ 41.2% janë persona të pakualifikuar ose gjysëm të kualifikuar</li> <li>□ Ç'kyçja sociale tek popullata rome para së gjithash për shkak të shkallë së ulët arsimore</li> <li>□ Ç'kyçja sociale tek personat e moshuar</li> <li>□ Paqasëshmëria deri tek institucionet publike për personat me hendikep</li> <li>□ Persona të moshuar</li> <li>□ Rom</li> </ul>

	<i>prekshme të popullatës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Fëmijët nga vendet rurale</li> <li>□ Rastet sociale</li> </ul>
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Lidhshmëri e mirë regjionale</li> <li>□ Urbanizim i pamjaftueshëm i vendeve rurale</li> </ul>
	<i>Ujësjellës:</i>	□ Ka sistem ujësjellës
	<i>Kanalizim:</i>	□ Kanalizim nuk ka vetëm në 2 vendbanime
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Mungesë uji</li> <li>□ Mungesë e deponive</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërkomunal në komunë</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Bashkëpunim jo mjaft i zhvilluar mes komunës, BNJVL dhe pushtetit qendror</li> <li>□ Bashkëpunim i mirë mes komunës dhe OJQ-ëve</li> <li>□ Bashkëpunim i mirë mes komunës dhe qytetarëve</li> <li>□ Bashkëpunim i zhvilluar me komunitat fshatare të Demir Kapisë dhe Kavadarit</li> <li>□ Bashkëpunim i dobët mes komunës, QPS dhe Qendrës për punësim</li> <li>□ Bashkëpunim i dobët me sektorin privat</li> </ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<i>Nga komuna:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale dhe kompetencat realizohen nga ana e njësisë për punë publike</li> <li>□ Ka të punësuar një punonjës social</li> <li>□ Komuna ka miratuar Plan veprues për zhvillim social në vitin 2006 dhe Strategji për zhvillim lokal për periudhën 2007-2012. Planifikimi i zhvillimit social në komunë është pjesë përbërëse e Programit për punë publike</li> <li>□ 600.000 denarë komuna ndan për transfere sociale</li> </ul>
	<i>Nga QPS:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Shfrytëzues të NSP: 485</li> <li>□ Shfrytëzues të NPP: 96</li> <li>□ Shfrytëzues të ndihmës dhe kujdesit nga person i huaj: 362</li> <li>□ Shfrytëzues të ndihmës së njëhershme në para: 4</li> <li>□ Mbrojtje jointucionale: një qendër ditore për persona me pengesa në zhvillim dhe një kuzhinë popullore</li> </ul>

## 7.2. Rekomandime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E PROBLEMEVE DHE PËRMIRËSIM TË GJENDJEVE
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Potencialet për zhvillim të komunës duhet të kërkohen në agrikulturë, gjegjësisht vneshtari, si dhe në hapjen e fabrikave të reja për prodhimin e venës dhe zhvillimin e turizmit alternativ dhe shfrytëzimin e mineraleve natyrore me të cilat komuna është e pasur (xehe, rërë, argjil dhe gurë).</li> </ul>

<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	□ Përmirësim i kapaciteteve ekzistuese arsimore
	<i>Shëndetësi</i>	□ /
	<i>Sfera sociale:</i>	□ Të pasurohet rrjeti i institucioneve sociale në komunë
	<i>Kulturë/sp</i>	□ Të promovohet zhvillimi dhe aktivizmi i sektorit joqeveritar
	<i>ort/argëtim</i>	□ Të ndërtohen më tepër terrene sportive dhe sheshe lojërash
	<i>Subjekte ekonomike</i>	□ Të stimulohet zhvillimi i mediave në komunë
		□ Të promovohet zhvillimi i subjekteve më të mëdha ekonomike
<b>3. Probleme sociale</b>		□ Të promovohen programe për punësimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale
		□ Të promovohen programe për punësimin e të rinjve
		□ Të zbatohet masat për trajnim, kualifikim dhe rikualifikim të shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale
		□ Të hapet këshillimore për procesin divorcues
		□ Të hapen qendra edukative për punë preventive me fëmijë të mitur dhe në veçanti për punë me fëmijë nga familjet sociale
	<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	□ Të pasurohet rrjeti i institucioneve sociale për personat e moshuar
		□ Të zbatohen programet për stimulim të arsimit tek personat e nacionalitetit rom
		□ Të zbatohen masat të cilat do të mundësojnë qasje më të mirë të fëmijëve me hendikep në shërbimet publike dhe institucionet
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	□ Përmirësim i infrastrukturës lokale, në veçanti në vendbanimet rurale
	<i>Ujësjellës:</i>	□ /
	<i>Kanalizim:</i>	□ Të vendoset kanalizim në të gjitha vendbanimet
<b>6. Probleme ekologjike</b>		□ Të gjendet zgjidhje për mungesën e ujit në komunë
		□ Të gjendet zgjidhje për deponitë
<b>7. Bashkëpunim i ndërkomunal në komunë</b>		□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës me QPS dhe Qendrën për punësim përmes zbatimit më efikas të punëve publike, masave aktive për punësim të shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale dhe të rinjëve, edukim për mundësitë dhe format e bashkëpunimit të tyre në sferën e mbrojtjes sociale
		□ Thellësim i bashkëpunimit me sektorin e OJQ-ve përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta dhe përfshirje në planifikimin dhe zbatimin e disa aktiviteteve të caktuara nga mbrojtja sociale
		□ Përmirësim i bashkëpunimit të komunës me sektorin privat përmes përfshirjes partnere në realizimin e programeve nga sfera e mbrojtjes

		<p>sociale dhe pjesëmarrje në zbatimin e projekteve të përbashkëta</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit me pushtetin qendror</li> </ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<p><i>Nga komuna:</i></p> <p><i>Nga QPS:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Hapje e njësisë së posaçme në komunë e cila për së afërmi do të merret me planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve për zhvillim social dhe mbrojtje sociale në komunë</li> <li>□ Përpilim dhe zbatim i programeve dhe strategjive të posaçme për zhvillim social të komunës</li> <li>□ Edukim i të punësuarve në njësinë kompetente për planifikim strategjik dhe krijim i programeve nga sfera e mbrojtjes sociale</li> <li>□ Zgjerim i formave të mbrojtjes sociale të cilat i realizon komuna duke inicuar forma të reja të shërbimeve sociale</li> <li>□ Rritje e përqindjes e cila ndahet nga buxheti i komunës për financimin e mbrojtjes sociale dhe planifikim më sistematik i atyre mjeteve buxhetore</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Ulje e numrit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para duke i intenzivuar aktivitetet për punësimin e tyre në bashkëpunim me Qendrën për punësim</li> <li>□ Zhvillim i rrjetit të mbrojtjes joinstitucionale dhe institucionale në komunë</li> </ul>



# **KOMUNA E STUDENIÇANIT**

## 1. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN E STUDENIÇANIT

Komuna e Studeniçanit shtrihet në pjesën jugore dhe jug-perendimore të luginës së Shkupit, si vend i përparshëm i komunës së Kisella Vodës. Në territorin e saj buron Lumi Kadina. Kjo komunë ka strukturë reljefore të llojllojshme, për shkak se pjesa më e madhe e saj është kodrino-malore, e vendosur mes maleve Goleshnica dhe Karaxhica, gjegjësisht i takon masivit malor Jakupica. Kufizohet me komunat: Sopisht, Kisella Voda, Zelenikovë, Çashkë, Makedonski Brod dhe Petrovec. Territori i komunës së Studeniçan shtrihet në një sipërfaqe prej 274 km<sup>2</sup> dhe numrohet mes komunave mesatarisht të mëdha në Republikën e Maqedonisë.

Në përbërje të komunës ka 19 vendbanime (bashkësi lokale) nga të cilat 18 janë ekzistuese, ndërsa një fshat krejtësisht është shpërngulur (Kalldirec). Vendi qendror dhe selia e komunës është Studeniçani, ndërsa vendbanime tjera janë: Batinci, Draçevica, Koliçani i Poshtëm, Koliçani i Epërm, Crvena Voda, Alldinci, Cvetovo, Ellovo, Crn Vrv, Markova Sushica, Vrtekica, Mallçishte, Umovo, Pagarusha, Osinvani, Ramni Gaber dhe Morani.

Numri i përgjithshëm i banorëve është 17.246 banorë. Dendësia mesatare e popullsisë është 62 banorë në 1km<sup>2</sup>. Sa i takon numrit të banorëve në vendbanimet tjera: Draçevica 236, Koliçani i Poshtëm 1516, Koliçani i Epërm 297, Crvena Voda 51, Alldinci 3, Cvetovo 826, Ellovo 256, Crn Vrv 702, Markova Sushica 54, Vrtekica 112, Mallçishte 60, Umovo (gati krejtësisht e shpërngulur), Pagarusha 222, Osinçani 1, Ramni Gaber 40 dhe Morani 11695. Në komunë ka një shpërndarje relativisht të barabartë sa i takon popullatës sipas gjinisë dhe atë 8.910 persona janë të gjinisë mashkullore dhe 8.336 persona janë të gjinisë femrore. Analiza e strukturës etnike të popullatës në komunën e Studeniçanit tregon se pjesa më e madhe janë shqiptarë 68.38%, pastaj turq 19.05%, Boshnjakë 9.64%, Maqedonas 1.79%, Rom 0.42%, Serb 0.08% dhe të tjerë 0.64%. Sa i takon shkallë së arsimit, në komunën e Studeniçanit pa arsim janë 945 persona (7.97%), me rasim fillor të pambaruar 2.004 (16.91%), me arsim fillor 7.360 (62.12%), me arsim të mesëm 1.387 (11.70%), me arsim të lartë 40 (0.34%), me arsim universitar 74 (0.63%) dhe 38 persona (0.33%) janë ende të përfshirë në procesin e arsimit fillor. Nga popullata e përgjithshme në moshë mbi 10 vjeç që dinë shkrim-lexim janë 93.12% (12.711), ndërsa 6.88% (938) janë analfabetë.

Në territorin e komunës ka një shpërndarje relativisht të barabartë sipas gjinisë, gjegjësisht 8.910 persona janë të gjinisë mashkullore dhe 8.336 persona janë të gjinisë femrore.

Në territorin e komunës së Studeniçanit ka shumë resurse natyrore siqë janë reurset malore dhe pyllore. Me ato ende menaxhon pushteti qendror. Komuna e Studeniçanit ka 6.815 hektarë tokë të përpunueshme, 6.072 hektarë livadhe, ndërsa pyjet kapin një hapsirë prej 10.153 hektarë. Ka kushte të shkëlqyeshme për zhvillimin e ekonomisë pyllore, ndërsa në fshatrat rrafshinore ka kushte të mira për bujqësi.

Tepër e rëndësishme për zhvillimin e komunës së Studeniçanit është ndërtimi i zonës industriale, ndërtimi i katër hidrocentraleve të vogla, investimi në prodhimtarinë dhe përpunimin e prodhimeve primare

bujqësore, tregti dhe ndërtimtari. Gjithashtu, potencialet për zhvillim të komunës së Studeniçanit duhet të kërkohen në zhvillimin e turizmit malor dhe turizmit fshatar.

## 2. KAPACITETE INSTITUCIONALE

**Arsim:** Në komunën e Studeniçanit funksionojnë tre shkolla fillore, nga të cilat SHF “Naim Frashëri” në fshatin e Studeniçanit, SHF “Mustafa Qemal Atatürk” në fshatin Koliçan i Poshtëm dhe SHF “Alija Avdoviq” në fshatin Batinci. Ka 9 (nëntë) shkolla rajonale (një nga klasa e 1 deri në të 5 dhe 8 shkolla lokale nga klasa 1 deri në të 9). Shkolla të mesme dhe shkolla specialistike nuk ka.

**Shëndetësi:** Mbrojtja primare shëndetësore në komunën e Studeniçanit realizohen në ISH “Emergenca”, ISH “Melem” dhe ISH “Neron” të cilat gjenden në fshatin Studeniçan dhe në ISHP “Avicena” dhe ISHP “Intra Vitam Medikus” të cilat janë të vendosura në fshatin Batinci. Në suazat e komunës funksionojnë edhe tre barnatore.

**Institucione sociale:** Rrjeti i institucioneve sociale është krejtësisht i pazhvilluar. Nuk ka as edhe një kopsht fëmënor, shtëpi për persona të moshuar ose institucione të tjera sociale.

**Institucione kulturore:** Rrjeti i institucioneve kulturore aspak nuk është i zhvilluar, nuk ka muze, teatër dhe kinema. Ka tre biblioteka të cilat funksionojnë në suazat e shkollave.

**Objekte sportive:** Nuk ka sallë sportive të llojit të mbyllur. Në komunë ka disa terrene sportive të llojit të hapur.

**Media:** Nuka ka media të shtypura ose elektronike.

**Shoqata qytetare:** Janë regjistruar dy shoqata qytetare: Fondacioni "Eko Centar" dhe "Artizani" – shoqara e parë e grave shqiptare.

**Subjekte ekonomike:** Në territorin e komunës së Studeniçanit degë ekzistuese ekonomike janë prodhimitaria dhe përpunimi i prodhimeve bujqësore dhe tregtia (kryesisht ekonomia e zezë).

## 3. PROBLEME DOMINUESE NË KOMUNË

**Probleme sociale:** Një nga problemet sociale me të cilin ballafaqohen banorët e komunës së Studeniçanit është problemi i papunësisë. Në pajtim me të dhënat Agjencisë për punësim, numri i të papunësuarve në komunën e Studeniçanit në nëntor të vitit 2010 ka qenë 1722 persona, nga të cilët 451 (26,2%) janë persona të gjinisë femrore. Nga personat e papunësuar të evidentuar, pa arsim dhe me arsim fillor të kryer janë 1.330 persona, me arsim të mesëm të pambaruar 156 persona, me arsim të mesëm të pambaruar 218 persona, ndërsa me fakultet të kryer 15 persona. Analiza e tillë tregon se numri më i madh i të papunësuarve është 0.9% nga numri i përgjithshëm i personave të papunësuar të cilët paraqiten në

Agjencinë për punësim. Pjesa më e madhe e personave të papunësuar në komunë janë persona të rinj mes moshës 20 dhe 29 vjeç (595 persona).

Mes grupeve socialisht më të rrezikuara të popullatës, në komunën e Studeniçanit theksohet një grup i banorëve të cilët deklarohen si turq, mirëpo mënyra e jetesës së tyre dhe tradita është e afërt me atë të grupit etnik rom. Gjithashtu, si grupe të prekshme veçohen fëmijët me nevoja të posaçme, fëmijët e gjinisë femrore (në veçanti ato në moshë prej 13 deri më 15 vjeç), si dhe bujqit me veprimtari të parregulluar bujqësore.

**Probleme infrastrukturale:** Infrastruktura rrugore në të gjitha vendbanimet është në një gjendje shumë të keqe. Rrjeti kryesor rrugor është parcialisht i asfaltuar. Gjithashtu, një pjesë e rrugëve brenda vendbanimeve janë tokësore, rrugë të paasfaltuara. Transport publik të organizuar ka vetëm në Studeniçan, Batinci, Morani, Koliçan i Poshtëm dhe Koliçan i Epërm. Në qendrën komunale Studeniçan rrjeti lokal rrugor është parcialisht i asfaltuar, mirëpo edhe ajo për shkak të ndërtimit të kanalizimit fekal gjatë vitit 2004 krejtësisht është dëmtuar.

Një numër i vogël i vendbanimeve (Studeniçan, Batinci dhe Morani) paisen me ujë nga ujësjellësi i qytetit, i cili është ndërtuar para 30 viteve. Ai parcialisht i kënaq nevojat e popullatës lokale, për shkak të cilës para paraqitet nevoja për zgjerimin e tij dhe ndërtimin e një stacioni të ri dhe ndërtimin e një rezervoari për ujë. Rrjeti lokal ujësjellës është ndërtuar në Cvetovo me donacion nga qeveria japoneze. Paisja me ujë për vendbanimet tjera bëhet përmes kaptazhës së burimeve lokale (Koliçan i Poshtëm, Koliçan i Epërm dhe Pagarusha) dhe përmes çeshmeve dhe burimeve lokale.

Në vendbanimet nuk ka rrjet kanalizues të ndërtuar dhe prandaj shfrytëzohen gropa septike. Përrjashtim është qendra komunale e Studeniçanit, ku rrjeti kryesor kanalizues është ndërtuar me donacion nga “Agjencia evropiane për rindërtim”. Mbetet të ndërtohet rrjeti sekondarë dhe të kyçen amvisëritë.

Deponi për mbeturina në Studeniçan dhe për vendbanimet e tjera është “Drislla”.

**Probleme ekologjike:** Në territorin e komunës së Studeniçanit në disa vende ka rrezik nga erozioni i tokës, ndërsa përveç deponisë Drislla, e cila është bombë ekologjike, gjithashtu ka edhe deponi ilegale të krijuara nga vetë qytetarët. Në vendbanimet e Studeniçanit dhe Moranit kalon “Kanali i kuq” i cili rrjedh nga Pintija dhe Draçeva, si kanal i cili parimisht ka qenë i dedikuar për ujëra atmosferike. Mirëpo, në të ilegalisht janë të kyçura ujërat fekale të cilat shpesh derdhen në tokat bujqësore.

#### 4. MBROJTJA SOCIALE NË KOMUNË

**Adiministrata komunale:** Në suazat e administratës komunale nuk ka njësi të posaçme për mbrojtje sociale, si dhe person të punësuar si punonjës social. Nuk plan strategjik ose program për mbrojtje sociale. Komuna ka përgatitur Strategji për zhvillim lokal dhe Strategji për zgjidhje afatgjate të problemit të papunësisë së gruas shqiptare. Buxheti vjetor i komunës është 151.000.000 denarë, ndërsa përqindja për transfere sociale është minimale (të dhëna të sakta për shumën nuk u bënë të disponueshme). Në komunë

nuk ka forma të ndihmës për grupet socialisht të prekshme përveç për gratë shqiptare me çfarë janë filluar aktivitete për përforsimin e tyre ekonomik.

**Qendra për punë sociale:** Qendra për punë sociale e cila është e vendosur në komunën e Kisella Vodës është përgjegjëse edhe për komunën e Studeniçanit. Përveç Kisella Vodës dhe Studeniçanit, qendra është kompetente edhe për komunat e Zelenikovës dhe Sopishtes. Qendra disponon me dhjetë zyra dhe dymbëdhjetë kompjutera. Si probleme më të rëndësishme sa i takon funksionimit të Qendrës për punë sociale numrohen mospasja e veturës për qasje në terren dhe mungesa e paisjeve teknike (telefona).

Qendra për punë sociale bashkëpunon me komunën, mirëpo bashkëpunimi është më tepër formal dhe realizohet vetëm gjat punës terrenike. Bashkëpunimi me sektorin joqeveritar, organizatat fetare dhe sektorin privat vlerësohet si i dobët. E rëndësishme është të theksohet braktisja e bashkëpunimit të praktikës së bashkëpunimit me komunën. Me institucionet shëndetësore bashkëpunon vetëm në raste kur ka nevojë për mendim profesional për shkak të realizimit të të drejtës së kujdesit nga personi i huaj.

**Numri dhe struktura e shfrytëzuesve të masave dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale:** Analiza e strukturës së shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale në territorin e komunës së Studeniçanit tregon se 1100 amvisëri janë shfrytëzues të ndihmës sociale në para, 140 familje shfrytëzojnë ndihmë të përhershme në para. Rreth 10 persona paraqiten si shfrytëzues të ndihmës së njëhershme në para në vitin e fundit. Gjithashtu në muajin nëntor janë evidentuar 101 shfrytëzues të shtesës feminare, 86 të shtesës së posaçme feminare, 170 shfrytëzues të shtesës prindërore dhe 12 shfrytëzues të ndihmës së njëhershme.

E drejta e ndihmës në para nga mbrojtja sociale më së shpeshti nuk realizohet për shkak të mosposedimit të dokumentacionit të plotë, si dhe përcaktimit të prezantimeve të rrejshme të gjendjes nga ana e disa shfrytëzuesve gjatë realizimit të kontrollës dhe vlerësimit të gjendjes.

Si grup më problematik i shfrytëzuesve për punë, veçohet puna me shfrytëzuesit e ndihmës së përhershme në para dhe ndihmës sociale në para, para së gjithash për shkak të agresivitetit të tyre kur bëhet fjalë për përcaktimin e gjendjes së vërtetë të familjes e cila është shfrytëzuese, kur shfrytëzuesi ka shkuar jashtë shtetit dhe të ngjajshme.

## **5. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS ME AKTORËT LOKAL**

Komuna e Studeniçanit ka bashkëpunim të dobët me institucionet/organizatat relevante në nivel lokal në sferën e mbrojtjes sociale. Me BNJVL realizohen kontakte dhe takime më të shpeshta, ndërsa bashkëpunimi i komunës me Qendrën për punë sociale, Qendrën për punësim, shoqatat private, fetare dhe joqeveritare gati më se nuk ekziston. Me qytetarët komuna bashkëpunon përmes ftesave publike dhe takimeve me grupet e interesuara të qytetarëve. Në vitet e fundit në komunë është intenzivuar bashkëpunimi me organizatat dhe ambasadat ndërkombëtare.

## 6. REZULTATE NGA HULUMTIMI ANKETUES I AMVISËRIVE NË KOMUNËN E STUDENIÇANIT

### 6.1. Të dhëna të përgjithshme për amvisërite

Në komunën e Studeniçanit u anketuan 100 amvisëri, nga të cilat të gjitha nga vendbanimet rurale. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, 43% janë jobujqësore, 35% të përziera ndërsa 14% janë amvisëri bujqësore. Sa i takon përkatësisë etnike të amvisërive dominojnë amvisëritë e nacionalitetit shqiptarë (96%, ndërsa 2% janë amvisëri turke dhe 1% të nacionalitet boshnjak).

Më e madhe është përfaqësia e amvisërive pesë anëtarëshe (35%), gjashtë anëtarëshe (24%) dhe 13% amvisëri katër anëtarëshe.

Grafiku 1.



Numri i anëtarëve në amvisëri

Një  
Pesë  
Nëntë

Dy  
Gjashtë  
Njëmbëdhjetë

Tre  
Shtatë  
Katërbëdhjetë

Katër  
Tetë

Tek 85% e amvisërive si kokë e amvisërisë paraqitet burri. Në 82% koka e amvisërisë është në bashkësi martesore, në 12% bëhet fjalë për të vejë, në 3% për të pamartuar, ndërsa në 2% për të divorcuar. Në pjesën më të madhe të amvisërive numri i anëtarëve në amvisëri koka e amvisërisë është mes 40 dhe 49 vjeç (35%). Në shumicën e amvisërive numri i antarëve është 5 anëtarë (35%), ndërsa në disa 6 anëtarë (24%).

Grafiku 2.



Grafiku 3.



Lloji i amvisërisë

Bujqësore  
Jobujqësore

Statusi martesor i kokës në amvisëri

i/e pamartuar  
i/e martuar  
i/e divorcuar

Në pjesën më të madhe të amvisërive koka e amvisërisë është punonjës (35%), pastaj i papunësuar (18%), bujk (14%), pensioner dhe amvis/e (me nga 10%) dhe nëpunës (6%).

Grafiku 4.



Profesioni momental i kokës në amvisëri

bujk  
punëtor  
nepunës  
udhëheqës  
afarist privat

Edhe pse 98% prej personave të anketuar dinë shkrim-lexim, vetëm gjysma e të anketuarve kanë kryer arsimin fillor, gjegjësisht vetëm 52%. Me shkollë të mesme janë 19%, 18% janë me arsim të mesëm teknik, me arsim fillor të pakryer janë 5%, me arsim të kryer të lartë janë vetëm 4% dhe 2% me arsim universitar.


Gjysma e amvisërive të cilat u anketuan janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

## 6.2. Punësim

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të anketuara, në 48% nuk ka asnjë person të punësuar, prej të cilëve 46 amvisëri janë të kombësisë shqiptare dhe nga një amvisëri turke dhe një e kombësisë boshnjake. Në 40% ka nga një anëtarë të punësuar në amvisëri, në 10% nga dy anëtarë (9 amvisëri shqiptare dhe 1 turke), ndërsa në 1% të amvisërive nga tre dhe katër anëtarë. Brengosëse janë të dhënat për grupën gjinore lidhur me punësimin, gjegjësisht në 49% prej amvisërive të punësuar janë personat e gjinisë mashkullore, ndërsa vetëm në 7% të gjinisë mashkullore.

Grafiku 5.

Grafiku 6.



Numri i personave të punësuar sipas gjinisë

Meshkuj

Femra

Rrefuzon të përgjigjet

Numri i personave të papunësuar në amvisëri sipas gjinisë

Një

Dy

Tre

Katër

Pesë

Meshkuj

Femra

Në amvisëri ku koka e amvisërisë është amvis/e, vetëm në 1% koka është e gjinisë mashkullore. Pensionerë ka në 19% të amvisërive, nga të cilat vetëm në 1% të amvisërive koka është e gjinisë femrore. Në 87% ka nxënës, studentë ose fëmijë, nga të cilët në 78% të amvisërive ka fëmijë të gjinisë mashkullore, ndërsa në 57% të gjinisë femrore. Në asnjërën prej amvisërive nuk ka punëdhënës. Në 3% të amvisërive ka persona të cilët janë punonjës të falimentuar ose tepriçë teknologjike, ndërsa në 2% ka anëtarë të cilët nuk janë të aftë për punë dhe në të dy rastet personat janë të gjinisë femrore.

### 6.3. Standardi jetësorë


Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, 51% kanë deklaruar se kanë marrë të ardhura nga marrëdhënie të rregullta pune në 12 muajt e fundit, prej të cilave 96.1% janë amvisëri shqiptare, ndërsa 2% amvisëri turke; ndërsa prej atyre të cilët nuk kanë realizuar të ardhura 95.9% janë të kombësisë shqiptare dhe nga 2% të kombësisë turke dhe boshnjake. Të ardhura ndryshe nga marrëdhëniet e punës kanë thënë se

marrin 27% të amvisërive, ndërsa 25% kanë realizuar të ardhura nga bujqësia. Nga 19% të amvisërive kanë fituar të ardhura prej pensioneve dhe të ardhura nga mbrojtja sociale (17 amvisëri të kombësisë shqiptare dhe nga një e kombësisë turke dhe bosnjake). Vetëm 3% prej amvisërive kanë realizuar të ardhura prej jashtë, nga të cilat të gjitha janë të kombësisë shqiptare. Prej amvisërive, 6% kanë marrë ndihmë financiare prej familjarëve, 4% kanë realizuar të ardhura prej pronës, ndërsa vetëm 1% kanë marrë hua. Në veçanti e rëndësishme është të ceket se 38.8% prej shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale kanë realizuar të ardhura nga bujqësia.

Grafiku 7.



Grafiku 8.



Sipas cilës baze janë realizuar të ardhurat në 12 muajt e fundit

- Marrëdhënie të rregullta pune
- Pensione
- Të ardhura nga jashtë
- Bujqësi
- Qira/shitje e pronës
- Hua
- Ndihmë nga ndonjë familjarë

Të ardhurat e realizuara në 12 muajt e fundit sipas profesionit

- Bujk
- Punonjës
- Nëpunës
- Afarist privat
- Nxënës/student
- Pensioner
- Amvise

## I papunësuar

Sipas analizave, 27% prej amvisërive në muajin e fundit kanë realizuar të ardhura deri më 5000 denarë, nga të cilët pjesa më e madhe (88.9%) janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Prej amvisërive, 25% kanë realizuar të ardhura prej 5001 deri më 10000 denarë (nga një amvisëri turke dhe boshnjake, ndërsa të tjerat të gjitha shqiptare) nga të cilat shumica (72%) janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Vetëm 8% e amvisërive, të gjitha të nacionalitetit shqiptarë, kanë realizuar të ardhura mbi 30.001 denarë.

Grafiku 8.



Shuma e të ardhurave në amvisëri në muajin e fundit

Deri më 5.000 mkd

Mbi 30.001 mkd

Në gjysmën e amvisërive konsumohet ushqim i ngrohtë me mish, në të cilat mbisundojnë ato në të cilat përgatitet ushqim i ngrohtë me mish një herë në javë (36%) dhe dy herë në javë (29%). Në 20% prej amvisërive ushqim i ngrohtë me mish konsumohet tre herë në javë, ndërsa tek 12% e amvisërive ushqim i ngrohtë me mish nuk konsumohet asnjëherë në javë. Prej shfrytëzuesve të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, 91.7% kanë thënë se konsumojnë vetëm një herë në javë. Prej personave të cilët kanë deklaruar se asnjëherë brenda javës nuk konsumojnë ushqim të ngrohtë me mish veçohen të papunësuarit me 41.7%, pastaj amvisëritë ku koka është amvis/e me 33.3% dhe amvisëritë bujqësore me 16.7%. Vetëm në familjet punëtore konsumohet ushqim i ngrohtë me mish më tepër se tre herë brenda javës.


Grafiku 9.



Tek pjesa më e madhe e amvisërive ku koka është burrë konsumohet ushqim i ngrohtë njëherë (32.9%), dy herë (30.6%), dhe tre herë në javë (23.5%). Në amvisëritë ku koka është grua e amvisërisë, gjegjësisht në 60% prej tyre ushqim i ngrohtë më mish konsumohet një herë në javë, tek, dy herë në javë tek 10% ose asnjëherë gjatë javës tek 30%.

Pjesa më e madhe e të anketuarve (79%) kanë theksuar se ju mungojnë para më së shumti për mbulimin e shpenzimeve të regjisë (banim, ujë, rrymë, karburantë...), ushqim dhe pijë joalkoolike (59%) dhe veshje dhe këpucë (58%). Një pjesë më e vogël e të anketuarve kanë thënë se ju mungojnë para për orendi shtëpiake dhe mobilje (38%) dhe komunikim – telefon, internet (16%). Vetëm 12% e të anketuarve kanë thënë se ju mungojnë para për arsim. Pjesa më e vogël e të anketuarve kanë thënë se ju mungojnë para për kulturë dhe rekreim (4%) dhe për pijë alkoolike dhe duhan (2%).

Grafiku 10.



Frekuenca e përgjigjeve të dhëna për mungesën e parave

- Ushqim dhe pije joalkoolike
- Pije alkoolike dhe duhan
- Veshje dhe këpucë
- Shpenzime të regjisë
- Orendi shtëpiake dhe mobilje
- Higjienë dhe shëndetësi
- Komunikacion
- Komunikim
- Rekreim dhe kulturë
- Arsim

Kur bëhet fjalë për shfrytëzuesit e ndihmës në para nga mbrojtja sociale, pjesa më e madhe, gjegjësisht 76.3% kanë thënë se ju mungojnë para për ushqim dhe pije joalkoolike, 67.2% për veshje dhe këpucë, ndërsa 50.6% për shpenzime të regjisë.

Prej amvisërive vetëm 24% posedojnë kompjuter, ndërsa me tepër se gjysma (56%) nuk mund të blejnë. 39% kanë automobil, ndërsa 45% nuk mund të blejnë.

Grafiku 11.

Grafiku 12.



Madhësia e banimit

Deri më 10m<sup>2</sup>

Mbi 101m<sup>2</sup>

Rrefuzon të përgjigjet

Numri i anëtarëve në amvisëri krahasuar me madhësinë e banesës

Banesë më e madhe

Katër dhomëshe

Tre dhomëshe

Dy dhomëshe

Një dhomë

Garsonjerë

Një

Katër

Shtatë

Njëmbëdhjetë

Dy

Pesë

Tetë


Katërmëdhjetë

Tre

Gjashtë  
Nëntë

Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë thënë se jetojnë në banesë dy dhomëshe (35%), prej të cilëve 74.3% janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Tepër e rëndësishme është ajo që 30% e amvisërive jetojnë në banim me katër dhoma, prej të cilëve 26.7% janë shfrytëzuese të ndihmës sociale në para. Prej të anketuarve, 19% jetojnë në banim me tre dhoma, 8% në banim më të madh me katër dhoma, 6% në banim me një dhomë dhe 1% në garsonierë. Prej amvisërive, 97% kanë thënë se kanë kanalizim në vendbanimin e tyre. Sa i takon ngrohjes së vendbanimit të tyre të gjithë të anketuarit kanë thënë se si burim kryesor për energji shfrytëzojnë kofitorin me karburantë të fortë, mirëpo një numër më i madh i amvisërive (77%) ngrohin vetëm një dhomë, ndërsa një numër më i vogël i amvisërive (21%) nga dy dhoma. Kur bëhet fjalë për veshjen, pjesa më e madhe e të anketuarve (50%) kanë thënë se më tepër ju mungon veshja dimrore.

Grafiku 13.



Numri i dhomave të cilat amvisëria i ngroh

Një

Dy


Tre

Nuk e di

#### 6.4. Probleme sociale dhe mbrojtja sociale

Probleme më të shpeshta sociale me të cilat ballafaqohen amvisëritë janë papunësia (71%) dhe varfëria (75%). Si probleme të tjera me të cilat ballafaqohen amvisëritë veçohen: sëmundja tek 15% e amvisërive, konfliktet në marrëdhëniet familjare tek 7%, invaliditeti tek 6%, fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror tek 4%, si dhe delikuenca e mitur tek 4% e amvisërive. Në një pjesë të vogël të amvisërive si problem paraqiten divorcet (2%), sjellja asociale tek fëmijët (2%) dhe një pjesë e problemeve lidhur me proceset ekologjike natyrore (vërshime 2% dhe zjarri 1%).

Grafiku 14.




Probleme të ndërlidhura me zhvillimin social

- Papunësia
- Varfëria
- Sëmundja
- Invaliditeti
- Fëmijë pa prindër
- Delikuenca
- Divorci
- Sjellja asociale

Amvisëritë tregojnë se nuk kanë shfrytëzuar asnjë prej formave të mbrojtjes jointitucionale dhe institucionale edhe atë më së shpeshti për shkak të painformimit (65%), si dhe për shkak të asaj se nuk kanë pasur nevojë nga lloji i tillë i ndihmës (33%) dhe kanë pasur dokumentacion jo të plotë (2%).

Kur bëhet fjalë për ndihmën në para nga mbrojtja sociale, gjysma e amvisërive shfrytëzojnë ose kanë shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes sociale në para, mes të cilave një është amvisëri turke dhe 1 është amvisëri boshnjake, ndërsa të tjerat të gjitha shqiptare. Vetëm 10% e amvisërive kanë shfrytëzuar ndihmë të përhershme në para. Nga 1% e amvisërive kanë shfrytëzuar kompensim në para për ndihmë dhe kujdes nga personi i huaj dhe ndihmë të njëhershme në para dhe ndihmë në naturë, prej të cilave koka e amvisërisë është i/e vejë. Si shkaqe më të shpeshta për joshshfrytëzimin e ndihmës në para nga mbrojtaj sociale theksohen mospasja e nevojës për një lloj të tillë të ndihmës (27%), pastaj painformimi (8%), kanë qenë të rrefuzuar (5%), dokumentacion jo të plotë (4%) dhe turpi (1%).

Grafiku 15.



Shkaqe për joshfrytëzimin e të drejtës nga mbrojtja sociale

- Nuk ishëm të informuar
- Ishëm të rrefuzuar
- Dokumentacion jo i plotë
- Për shkak të turpit
- Nuk kemi nevojë

Sa u takon të drejtave nga mbrojtja feminare, 13% e amvisërive kanë shfrytëzuar shtesë feminare, nga numri i përgjithshëm i të cilave 69.2% janë persona në bashkësi martesore, 15.4% të vejë dhe 7.7% të divorcuar. Shtesë të posaçme feminare kanë shfrytëzuar vetëm 9% prej amvisërive, prej të cilave 88.8% janë në bashkësi martesore, ndërsa 11.1% të vejë. Shkaqet për joshfrytëzimin e të drejtave nga mbrojtja feminare amvisëritë i gjejnë tek painformimi (34%), mospasja nevojë (25%), rrefuzimi (10%) ose dokumentacioni i pakompletuar (8%).

Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve kanë theksuar se deri tani kanë marrë ndonjë lloj të ndihmës nga shoqatat joqeveritare (2%), nga komuna (2%) dhe nga organizatat fetare dhe humanitare (2%).

### 6.5. Shëndetësi

Në pjesën më të madhe të rasteve, gjegjësisht 80% e të anketuarve kanë thënë se të gjithë anëtarët e amvisërisë kanë sigurim shëndetësor, në të cilat përpos amvisërive të kombësisë shqiptare numrohen edhe të gjitha amvisëritë e kombësive tjera të cilat jetojnë në komunë (turq dhe boshnjakë). Në 17% të amvisërive,

anëtarët kanë sigurim parcial, ndërsa tek 3% prej amvisërive asnjë prej anëtarëve nuk ka sigurim dhe kjo dukuri është prezente vetëm tek amvisëritë e kombësisë shqiptare, të cilat në të njëjtën kohë janë edhe shfrytëuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

Grafiku 16.



Sigurimi shëndetësor i anëtarëve në amvisëri

Asnjë nuk ka sigurim

Pjesërisht – jo të gjithë kanë sigurim

Po – të gjithë kanë sigurim

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive, pjesa më e madhe (87%) në rast sëmundje shfrytëzojnë shërbime shëndetësore publike (shërbime të institucioneve shëndetësore publike dhe blejnë barna nga lista pozitive), ndërsa vetëm 1% e amvisërive mjekohen tek mjeku publik, ndërsa blejnë barna privat. Asnjëra prej amvisërive nuk mjekohet tek mjeku privat. Gjysma e amvisërive të cilat shfrytëzojnë shërbimet e institucioneve shëndetësore publike janë shfrytëzuese të ndihmës në para, ndërsa amvisëritë të cilat blejnë barna privat nuk janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Prej të anketuarve, 6% nuk vizitojnë mjek dhe shfrytëzojnë mënyra alternative të mjekimit, nga të cilat gati të gjitha janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Amvisëritë e kombësisë turke dhe boshnjake i shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore publike.

Tek amvisëritë të cilat blejnë barna privat koka e amvisërisë është person i papunësuar. Nga numri i përgjithshëm i amvisërive të cilat shfrytëzojnë mënyra alternative të mjekimit, 50% janë amvisëri ku koka e amvisërisë është amvis/e.

Pjesa më e madhe e amvisërive (80%) janë të larguara për më tepër se 15 minuta në këmbë nga spitali më i afërt, 16% nga të anketuarit kanë nevojë për 15-30 minuta, ndërsa 1% prej amvisërive kanë nevojë për më tepër se 30 minuta për të arritur deri tek shtëpia më e afërt shëndetësore.

### 6.6. Arsim

Në 62% ka fëmijë të cilët janë në moshë prej gjashtë dhe më tepër vjeç, gjegjësisht fëmijë të cilët janë të kyçur në arsimin fillor. Në 18% të amvisërive ka nga një fëmijë, në 26% nga dy fëmijë, ndërsa në 8% nga tre fëmijë të cilët vizitojnë shkollën fillore. Në 22% të amvisërive ka nga një fëmijë i cili viziton shkollën e mesme, 9% kanë nga dy fëmijë dhe në 2% nga tre fëmijë të cilët ndjekin shkollën e mesme. Në më tepër se gjysmën e amvisërive (59%) nuk ka fëmijë të moshës për arsim të lartë, vetëm tek 2% të amvisërive ka nga një fëmijë, ndërsa tek 1% nga dy fëmijë të cilët ndjekin arsimin e lartë.

Grafiku 17.



Numri i fëmijëve në amvisëri të cilat janë të kyçura në procesin arsimor

- Një
- Dy
- Tre
- Katër

- Arsim fillor
- Arsim i mesëm
- Arsim i lartë

Në 7% prej amvisërive janë evidentuar fëmijë të cilët janë të moshës shkollore dhe nuk janë të përfshirë në proceset e rregullta arsimore dhe të gjitha janë të nacionalitetit shqiptarë. Në 42% prej amvisërive të cilat kanë fëmijë të cilët ndjekin arsimin fillor jetojnë në distancë më të vogël se 1km nga shkolla fillore, ndërsa 5% e amvisërive jetojnë në distancë prej 1.01 deri më 2km dhe vetëm 1% në distancë prej 2.01 deri më 4km.

Amvisëritë me fëmijë të cilët ndjekin arsimin fillor nuk kanë shfrytëzuar kurrëfar forma ndihmë për arsim, përveç 10 amvisërive me fëmijë në shkollën fillore të cilat kanë shfrytëzuar libra falas dhe nga të cilat 3 janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Vetëm 11 amvisëri fëmijët e të cilave ndjekin arsimin e mesëm kanë shfrytëzuar transport falas, prej të cilave 7 janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Tek amvisëritë fëmijët e të cilave vizitojnë arsimin e lartë vetëm 1 amvisëri ka shfrytëzuar libra falas.

Sipas të dhënave të fituara, fëmijët e përfshirë në arsimin fillor dhe të mesëm, rregullisht e ndjekin mësimin. Tek fëmijët e arsimit fillor vetëm 1% e fëmijëve nuk e ndjek rregullisht mësimin për shkak të sjelljes së çrregulluar sociale, 3% - 1% për shkak të varfërisë dhe 2% për shkak të sjelljes së çrregulluar sociale dhe këto amvisëri janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Mes fëmijëve të shkollës së mesme vetëm 6% mësimin nuk e ndjekin rregullisht dhe atë 1% për shkak të sëmundjes dhe 5% për shkak të asaj se ju ndihmojnë prindërve që të sigurojnë ekzistencë dhe të gjitha janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Në të njëjtën kohë edhe 6% e fëmijëve nuk ndjekin mësim për shkak të sëmundjes (1%), punës sezonale (1%), varfërisë (3%), sjelljes së çrregulluar sociale (1%) nga të cilët gjysma janë shfrytëzues të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive me fëmijë të moshës shkollore, 48.4% prej amvisërive janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale. Prej tyre, 25 amvisëri kanë fëmijë në arsimin fillor dhe 20 amvisëri kanë fëmijë në arsimin e mesëm. Asnjëra prej amvisërive të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale nuk kanë fëmijë në fakultet. Tek 6 amvisëri të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës në para nga mbrojtja sociale janë evidentuar fëmijë të cilët janë të moshës shkollore mirëpo nuk janë të përfshirë në proceset e rregullta arsimore.

Sa i takon profesionit të kokës në amvisëri, analiza tregon se nga numri i përgjithshëm i amvisërive të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore, pjesa më e madhe janë amvisëri punëtorësh (41.9%). Pastaj vijojnë amvisëritë ku koka e amvisërisë është bujk (17.7%), person i papunësuar (14.5%), pensioner (9.7%) amvis/e (6.5%) dhe nëpunës (4.8%).

## **6.7. Sport, argëtim, kulturë**

Të anketuarit kanë theksuar se në komunë nuk ka biblioteka, teatre, kinema dhe bastore sportive. Më tepër se gjysma e të anketuarve kanë theksuar se në komunë ka terren sportiv, shesh lojërash, restorant, kafe bar dhe internet kafe. Pjesa më e madhe e të anketuarve, gjegjësisht 60% kanë theksuar se asnjëri prej anëtarëve të tyre nuk shfrytëzon internet. Vetëm 19% e të anketuarve kanë shfrytëzuar internet nga kompjuteri shtëpiak, ndërsa 16% kanë shfrytëzuar nga internet kafeneja.

## 7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 7.1. Përfundime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	GJENDJE/PROBLEME
<b>1. Veprimtari dominuse</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Bujqësi</li> <li><input type="checkbox"/> Ndërtimtari</li> <li><input type="checkbox"/> Tregti</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> 3 SHFQ</li> <li><input type="checkbox"/> 9 shkolla rajonale (1 shkollë prej në klasë të 1 deri në të 5, 8 shkolla prej në klasë të parë deri në të 9)</li> <li><input type="checkbox"/> Shkolla të mesme nuk ka</li> </ul>
	<i>Shëndetësi :</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Mbrojtja shëndetësore primare: 3 institucione shëndetësore publike dhe 2 private</li> <li><input type="checkbox"/> 3 barnatore</li> </ul>
	<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka institucione sociale në komunë</li> </ul>
	<i>Kulturë/sp</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka kinema e as teatër</li> </ul>
	<i>ort/argëtim :</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Nuk ka media lokale</li> </ul>
	<i>Subjekte ekonomike :</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> /</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Problem më i theksuar është papunësia (numri i të papunësuarve në komunë është 1722)</li> <li><input type="checkbox"/> Prej të papunësuarve, 1333 persona janë pa arsim dhe me arsim fillor të kryer</li> <li><input type="checkbox"/> Prej personave të papunësuar 595 janë meshkuj në moshë prej 20 deri më 29 vjeç</li> </ul>
	<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Gratë shqiptare</li> <li><input type="checkbox"/> Romët</li> <li><input type="checkbox"/> Fëmijët me nevoja të posaçme</li> <li><input type="checkbox"/> Bujqit me veprimtari bujqësore të parregulluar</li> </ul>
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Rrjeti rrugor është në gjendje të keqe</li> </ul>
	<i>Ujësjellës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Rrjet ujësjellës ka vetëm në pesë vendbanime, ndërsa paisja me ujë në vendet tjera bëhet përmes kaptazhës së burimeve lokale dhe çeshmeve në fshatra.</li> </ul>

- Kanalizim:* □ Rrjet kanalizues ka vetëm në qendrën komunale të Studeniçanit ku ekziston nevoja për ndërtimin e rrjetit sekondarë dhe kyçja e amvisërive. Në të gjitha vendbanimet tjera shfrytëzohen gropa septike.

<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Ndotje nga deponia për mbeturina të cilët e shfrytëzon komuna – "Drislla"</li> <li>□ Ndotje nga deponitë ilegale</li> <li>□ Erozion i tokës</li> <li>□ "Kanali i zezë"</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërinstitucional në komunë</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ bashkëpunimi mes komunës dhe pushtetit qendror nuk është mjaft i zhvilluar</li> <li>□ bashkëpunimi i dobët mes komunës dhe QPS</li> <li>□ bashkëpunimi i dobët me sektorin joqeveritar (është në fillim), sektorin privat dhe organizatat fetare</li> </ul>
<b>8. Mbrojtja sociale</b>	<p><i>Nga komuna:</i></p> <p><i>Nga QPS:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Nuka ka njësi për mbrojtja sociale</li> <li>□ Nuk ka punonjës social të punësuar</li> <li>□ Nuk ka plane dhe programe për mbrojtja sociale</li> <li>□ Nuk ka forma të zhvilluara të mbrojtjes sociale të popullatës në komunë</li> <li>□ Ndarje minimale për mbrojtje sociale nga buxheti i komunës</li> <li>□ Shfrytëzues të NSP: 1100 amvisëri</li> <li>□ Shfrytëzues të NPP: 140 familje</li> <li>□ Shfrytëzues të NNJP: 10 persona</li> <li>□ Shfrytëzues të shtesës feminare: 101</li> <li>□ Shfrytëzues të shtesës së posaçme: 86</li> <li>□ Shfrytëzues të shtesës prindërore: 170</li> <li>□ Zbatim i dobët i masave nga mbrojtja joinstitucionale dhe institucionale</li> </ul>

## 7.2. Rekomandime

SFERA	SFERA MË E NGUSHTË	REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E PROBLEMEVE DHE PËRMIRËSIM TË GJENDJEVE
<b>1. Veprimtari dominuse</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Tepër e rëndësishme për zhvillimin e komunës është ndërtimi i zonës industriale, ndërtimi i katër hidrocentraleve të vogla, investimi në prodhimin dhe përpunimin e prodhimeve primare bujqësore. Gjithashtu, potencialet për zhvillim të komunës së Studeniçanit duhet të kërkohen në zhvillimin e turizmit malor dhe turizmit fshatarë.</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Hapja e shkollave fillore rajonale në vendbanimet e komunës ku nuk ka shkolla fillore</li> <li>□ Meremetim i ndërtesave ekzistuese shkollore (instalim, ndryshim i çatave</li> </ul>

		abeste, nxemje etj.)
		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rritje e kapaciteteve ekzistuese për një përfshirje më të përshtatshme të fëmijëve në klasat me numër më të vogël të nxënësve</li> <li>□ Hapja e shkollave për arsim të lartë.</li> </ul>
	<i>Shëndetësi</i>	□ Zgjerim i rrjetit të institucioneve shëndetësore
	:	
	<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Themelimi i institucioneve sociale në komunë</li> <li>□ Zbatim i analizës për nevojat dhe hapja e formave jointucionale dhe institucionale të mbrojtjes së popullatës</li> </ul>
	<i>Kulturë/sport/argëtim</i>	□ Hapja e institucioneve kulturore, sportive dhe ahengëse
	:	
	<i>Subjekte ekonomike</i>	□ Investim në zhvillimin e subjekteve ekonomike në komunë
	:	
<b>3. Probleme sociale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të promovohen programet për punësimin e personave të rinj</li> <li>□ Të zbatohen masa për trajnim, kualifikim dhe rikualifikim të personave të papunësuar me kualifikime të ulta</li> <li>□ Të promovohet bashkimi i prodhuesve të vogël bujqësorë me çfarë do të mundësohet një plasman më i organizuar, çmim më i lartë dhe informim më i mirë për mundësitë e shfrytëzimit të subvencioneve dhe burimeve të tjera shtesë.</li> <li>□ Të promovohet sipërmarrësia dhe të stimulohet vetëpunësimi.</li> </ul>
	<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të zbatohen programe për stimulimin e përfshirjes sociale të personave të popullsisë rome</li> <li>□ Zhvillim i formave të përkrahjes jointucionale për fëmijët me nevoja të posaçme</li> <li>□ Zbatim i programeve për përmirësimin e gjendjes dhe përfshirje sociale të gruas shqiptare</li> </ul>
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të punohet në përmirësimin e gjithë infrastrukturës rrugore</li> <li>□ Qasje e asfaltuar në fshatrat më të lartë malor dhe asfaltimi i rrugëve tokësore brenda fshatrave</li> <li>□ Të riparohet infrastruktura rrugore ekzistuese e cila është e dëmtuar</li> </ul>
	<i>Ujësjellës:</i>	□ Të vendosen rrjete ujësjellëse në të gjithë vendbanimet
	<i>Kanalizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të ndërtohet rrjeti kanalizues në të gjitha vendbanimet</li> <li>□ Të mbarohet formimi i rrjetit sekondarë në qendrën komunale të Studeniçanit</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të vlerësohen dhe të gjindet zgjidhje për deponitë ilegale në komunë si dhe për erozionin tokësor</li> <li>□ Të gjendet zgjidhje teknike për pastrimin dhe rregullimin e rrjedhës së “Kanalit të zezë” që mos të vijë deri tek derdhja e tij</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunim</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Të krijohet bashkëpunim i komunës me QPS, Qendrën për punësim</li> <li>□ Përmirësim i bashkëpunimit me pushtetin qendror</li> </ul>

**i ndërinstitucional në komunë**

- Krijim i bashkëpunimit me sektorin joqeveritar, sektorin privat dhe organizatat fetare

**8. Mbrojtje sociale** *Nga komuna:*

- Hapja e njësisë për mbrojtje sociale dhe punësim i një punonjësi sociale
- Edukim i të punësuarve për planifikim strategjik në mbrojtjes sociale dhe përgatitja e programeve dhe planeve
- Edukim i të punësuarve për format e mbrojtjes sociale të cilat mund të realizohen në nivel lokale
- Rritje e % së buxhetit e cila ndahet për mbrojtje sociale
- Vlerësim i nevojave për shërbime sociale dhe zhvillim i marrëdhënieve partnere me sektorin joqeveritar dhe privat në dhënien e shërbimeve sociale lokale

*Nga QPS:*

- Ulje e numrit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para duke i intenzivuar aktivitetet për punësimin dhe aktivizimin e tyre
- Zbatim më i madh i punëve publike

### III. ANALIZA, PËRFUDNIMET DHE REKOMANDIMET PËRMBLEDHËSE

#### 1. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI ANKETUES NË KOMUNA

##### 1.1. Punësim

Gjendja lidhur me varfërinë dhe ç'kyvjen sociale në komunat e përfshira në hulumtim është e njejtë sipas shumicës së treguesve të analizuar. Ç'kyçja nga tregu i punës është një nga më të theksuarat. Nga gjithsej 800 amvisëri të anketuara, tek 350 ose 43.8% nuk ka anëtarë të papunësuar mes anëtarëve të aftë për punë. Mirëpo, në 204 (25.5%) prej amvisërive i papunësuar është një person, ndërsa në 178 (22.3%) të papunësuar janë dy persona. Në 68 amvisëri (8.6%) të papunësuar janë 3 ose më tepër anëtarë të amvisërisë. Nga 800 amvisëritë e anketuara, në 450 (56.2%) ka më së paku nga një anëtarë i cili është i aftë për punë dhe është i papunësuar (Tabela 1).

Tabela 1. Amvisëritë sipas numrit të personave të papunësuar dhe komunat

Komuna	STATUSI PUNUES: Sa anëtarë në amvisërinë tuaj momentalisht janë të papunësuar?							Gjithsej
	asnjë	1	2	3	4	5	6	
Radovish	Count 47	25	19	5	4	0	0	100
	% of Total 5,9%	3,1%	2,4%	,6%	,5%	,0%	,0%	12,5%
Negotinë	Count 35	27	28	3	3	4	0	100
	% of Total 4,4%	3,4%	3,5%	,4%	,4%	,5%	,0%	12,5%
Berovë	Count 42	22	33	3	0	0	0	100
	% of Total 5,3%	2,8%	4,1%	,4%	,0%	,0%	,0%	12,5%
Pehçevë	Count 43	30	19	5	2	1	0	100
	% of Total 5,4%	3,8%	2,4%	,6%	,3%	,1%	,0%	12,5%
Konçe	Count 44	25	24	5	2	0	0	100
	% of Total 5,5%	3,1%	3,0%	,6%	,3%	,0%	,0%	12,5%
Likovë	Count 53	19	14	5	6	0	3	100
	% of Total 6,6%	2,4%	1,8%	,6%	,8%	,0%	,4%	12,5%
Studenica	Count 42	31	17	3	6	1	0	100
	% of Total 5,3%	3,9%	2,1%	,4%	,8%	,1%	,0%	12,5%
Çashkë	Count 44	25	24	5	2	0	0	100
	% of Total 5,5%	3,1%	3,0%	,6%	,3%	,0%	,0%	12,5%
	Count 350	204	178	34	25	6	3	800
	% of Total 43,8%	25,5%	22,3%	4,3%	3,1%	,8%	,4%	100,0%

## 1.2. Standardi jetësorë

Prej 800 amvisërive të ardhura nga marrëdhënie të rregullta pune në 12 muajt e kaluar kanë realizuar 435 (54.4%), 285 (35.6%) kanë realizuar të ardhura nga veprimtaria bujqësore, 224 (28%) kanë realizuar të ardhura jashtë marrëdhënieve të rregullta pune, 209 (26.1%) kanë realizuar të ardhura nga pensionet, 49 (6.1%) kanë fituar të ardhura prej jashtë, 46 (5.8%) kanë marrë ndihmë nga fëmijët, prindërit, familjarët, 25 (3.1%) kanë realizuar të ardhura nga prona (qira, shitje), ndërsa 4 (0.5%) nga të huaj. Të ardhura më të shpeshta jashtë marrëdhënieve të rregullta pune vijnë nga puna sezonale të cilën e praktikojnë 107 (13.4%) prej amvisërive, ndërsa përafërsisht 5% prej amvisërive realizojnë të ardhura jashtë marrëdhënieve të rregullta pune siç janë: punë nëpër shtëpi, ngarkim-shkarkim-transport, ndërtimtari, tregti dhe rishtije. Këto të dhëna, në veçanti të dhënat për realizimin e të ardhurave jashtë marrëdhënieve të rregullta pune, tregojnë se në raste të varfërisë, amvisëritë kanë nevojë që ta sigurojnë ekzistencën e tyre përmes burimeve të ndryshme.

Prej 800 amvisërive, pjesa më e madhe kanë të ardhura mes 5001-10.000 denarë (180 ose 22.5%), ndërsa i rëndësishëm është edhe numri i amvisërive me të ardhura deri më 5.000 denarë (162 ose 20.3%) (Tabela 2).

Tabela 2. Të ardhurat mujore në amvisëritë

Të ardhura mujore	Numri i amvisërive	%
deri 5.000 mkd	162	20,3
5.001-10.000 mkd	180	22,5
10.001-14.000 mkd	119	14,9
14.001-18.000 mkd	82	10,3
18.001-23.000 mkd	87	10,9
23.001-30.000 mkd	66	8,3
mbi 30.001 mkd	67	8,4
Nuk e di	13	1,6
Rrefuzon të përgjigjet	24	3,0
Gjithsej	800	100,0

Pjesa më e madhe e amvisërive jetojnë në banim me dy dhoma - 255 (31.9%), në sipërfaqe banuese prej 61-80m<sup>2</sup> - 201 ose 25.1% prej amvisërive, dhe në ndërtim të fortë - 759 ose 94.9% prej amvisërive. Në 145 amvisëri (18.1%) nuk ka tualet me banjo në banesë, 53 amvisëri (6.6%) shfrytëzojnë gropë septike, 38 amvisëri (4.8%) nuk janë të kyçura në kanalizimin vendor. Nga aspekti i paisjes me ujë 4 amvisëri (0.5%) shfrytëzojnë ujë nga çeshmja publike, ndërsa 28 (3.5%) nuk kanë aspak ujë brenda në shpi. Pjesa më e madhe e amvisërive 731 (91.4%) ngrohen me kofitor me karburantë të fortë, ndërsa vetëm 31 (3.9%) kanë nxemje me avull vetanake. Për tu veçuar është ajo se shumica e amvisërive ngrohin vetëm një dhomë gjatë dimrit - 427 amvisëri (53.4%), që do të thotë se përafërsisht në 1/3 e vitit të gjithë anëtarët janë të detyruar që të jetojnë se bashku në një dhomë.

Prej aparateve bazike të cilat shfrytëzohen në amvisëri, shporet elektrik kanë 739 (92.4%), ngrohës uji - 731 (91.4%), frigorifer - 784 (8%), makinë për larjen e teshave - 714 (89.3%), thithëse pluhuri - 677 (84.6%), televizor - 769 (96.1%), ndërsa telefon - 459 amvisëri (57.4%). Amvisëritë më së paku posedojnë: makinë për larjen e enëve (87 ose 10.9%), video kamerë (93 ose 11.6%) dhe klimë (108 ose 13.5%). Për tu veçuar është përqindja e lartë e amvisërive të cilat edhe përpos të standardit të ulët jetësorë kanë celularë (682 amvisëri ose 85.3%; përqindje e cila është edhe më e lartë se përqindja e amvisërive të cilat posedojnë telefon të thjeshtë - 57.4%) dhe video rekorder (402 amvisëri ose 50.3%).

Amvisërive nga veshja më së tepërmi u mungon: veshja e ngrohtë dimore (xhaketa, xhmpera...) të cilën si nevojë e kanë veçuar 347 amvisëri (43.4%), pastaj këpucët - 114 amvisëri (14.3%) dhe veshja për raste solemne - 85 amvisëri (10.6%).

### 1.3. Problemet sociale dhe mbrojtja sociale

Nga aspekti i problemeve sociale, në të gjitha komunat si më të theksuara veçohen papunësia (555 ose 69.4% nga numri i përgjithshëm i amvisërive - 800) dhe varfëria (546 ose 68.3%). Të dyta sipas prezencës janë problemet sociale lidhur me proceset ekologjike natyrore. Më të shpeshta janë vërshimet (50 amvisëri ose 6.3%), tërmetet (40 amvisëri ose 5.0%) dhe thatësitë (33 amvisëri ose 4.1%). Probleme sociale të ndërlidhura më devijimet (delikuenca, bixhozi, kriminaliteti, sëmundje prej varësive, endacakët...) paraqiten tek 29 amvisëri (3.6% nga numri i përgjithshëm i amvisërive).

Për tu veçuar është niveli shumë i ulët i shfrytëzimit të masave nga mbrojtja social institucionale dhe joinstitucionale në të gjitha komunat. Prej 800 amvisërive, vetëm 22 (2.7%) kanë shfrytëzuar masa të mbrojtjes joinstitucionale, dhe vetëm 3 (0.4%) masa të mbrojtjes institucionale. Për dallim të tyre, shumë më i madh është shfrytëzimi i beneficioneve në para. Mes tyre, më së shpeshti shfrytëzohen: mbrojtje sociale në para të cilën e kanë shfrytëzuar 388 amvisëri (48.5%), ndihma e përhershme në para - 49 amvisëri (6.1%), dhe kompenzimi në para për kujdes dhe ndihmë nga personi i huaj - 12 amvisëri (1.5%).

Nga masat e mbrojtjes feminare më së shpeshti shfrytëzohen: shtesa feminare (168 amvisëri ose 21%), ndihma e njëhershme për fëmijë të sapo lindur (93 ose 11.6%), participimi (29 ose 3.6%) dhe shtesa e posaçme feminare (23 ose 2.9%).

Ndihmë nga burime të tjera (nga organizata joqeveritare, komuna, organizata fetare dhe humanitare dhe persona privat) kanë marrë vetëm një pjesë e vogël e amvisërive - 25 ose 3.1%. Këto të dhëna tregojnë se funksionet e mbrojtjes sociale lokale nga ana e të gjitha aktorëve relevant në të gjitha komunat nuk janë mjaft të zhvilluara.

Mes **shkaqeve për joshfrytëzimin** e masave të mbrojtjes sociale, përpos të mospasjes nevojë për një lloj të tillë ndihme, kryesojnë painformimi dhe rrefuzimi i aplikantëve nga ana e institucioneve relevante. Shkaqe më të shpeshta për joshfrytëzimin e ndihmës në para nga mbrojtja sociale janë: mospasja nevojë (235 ose 29.4%); rrefuzimi (87 ose 10.9%) dhe painformimi (39 ose 4.9%). Mbrojtje feminare më së shpeshti nuk shfrytëzohet për shkak të: mospasjes nevojë (242 ose 30.3%), painformimit (140 ose 17.5%) dhe rrefuzimit (117 ose 14.6%). Amvisëritë nuk shfrytëzojnë mbrojtje institucionale dhe joinstitucionale më


së shpeshti për shkak të: mospasjes nevojë (422 ose 52.8%), painformimit (221 ose 27.6%) si dhe rrefuzimit (102 ose 12.8%).

Mes shkaqeve më pak të përfaqësuara për mosrealizimin e masave nga mbrojtja sociale theksohen: dokumentacioni i pakompletuar, mospërmbushja e kushteve të nevojshme për aplikim, si dhe turpi nga rrethi.

#### 1.4. Shëndetësi dhe të ushqyerit

Sa i takon **sigurimit shëndetësor**, në 688 amvisëri (86%) anëtarët e amvisërisë kanë sigurim shëndetësorë, në 71 të amvisërive (8.9%) anëtarët e amvisërisë kanë sigurim shëndetësorë parcial, në 31 amvisëri (3.9%) asnjë nuk ka sigurim shëndetësor dhe në 10 amvisëri (1.3%) gjendja nuk dihet (Grafiku 1). Në rast sëmundje, 659 amvisëri (82.4) shkojnë në mjek publik dhe blejnë barna me receipt, ndërsa 31 (3.9%) kanë theksuar se mund të mjekohen privat. Të dhënat për **afërsinë e shtëpisë shëndetësore** tregojnë për shpërndarjen relativisht të mirë të këtyre institucioneve në nivel lokal. Gjegjësisht, prej 800 amvisërive, 617 (77.1%) jetojnë në distancë prej 15 minutave nga shtëpia më e afërt shëndetësore edhe pse i rëndësishëm është edhe numri i atyre që kanë nevojë për 16-30 të mbërrinë deri tek ai (141 amvisëri ose 17.6%) ose më tepër se 30 minuta - 30 amvisëri (3.8%). Edhe përpos të qasshmërisë, këto të dhëna duhet të mbështetet me të gjeturat nga terreni sipas të cilave një numër i madh i shtëpive shëndetësore (në vevanti punktet në vendbanimet rurale) janë me orarë punë të kufizuar dhe nuk ofrojnë mbrojtje shëndetësore të tërësishme për qytetarët.

Grafiku 1.



Në amvisëritë e anketuara mungon **të ushqyerit** i pasur me mish. Prej 800 amvisërive të anketuara, pjesa më e madhe ushqim të ngrohtë me mish gatuajnë vetëm një herë gjatë javës (213 ose 26.6%), ndërsa 98 amvisëri (12.3%) asnjëherë gjatë javës. Në pyetjen për të numruar 5 nga nevojat e dhëna në amvisëri për të cilat ju mungojnë mjete financiare, janë fituar të dhënat që tregojnë se ka mungesë më të madhe mjeteve për banim, ujë, rrymë, karburantë (është theksuar nga ana e 562 amvisërive ose 70.3%) dhe për ushqim dhe pije joalkoolike (gjithashtu theksuar nga 500 amvisëri ose 62.5%) (Tabela 1).

Tabela 1. Lista e nevojave në amvisëri, për përmbushjen e të cilave mungojnë mjete

Nevoja të amvisërisë	Numri i amvisërive	% nga numri i
----------------------	--------------------	---------------

		<b>përgjithshëm i amvisërive (800)</b>
1. Banim, ujë, rrymë, karburantë	562	70.3%
2. Ushqim dhe pije joalkoolike	500	62.5%
3. Veshje dhe këpucë	491	61.4%
4. Higjienë dhe shëndetësi (barna dhe ndihmes)	372	46.5%
5. Komunikacion (transport/automobil)	250	31.3%
6. Arsim	184	23%
7. Rekretim dhe kulturë (gazeta, libra, udhëtime, argëtim)	139	17.4%
8. Komunikim (telefon, internet)	132	16.5%
9. Pije alkoolike dhe duhan	78	9.8%

### 1.5. Arsim

Rezultatet nga hulumtimi i bërë në tetë komunat sa i takon arsimin tregojnë se ka tendenca të ngajshme. Prej 800 amvisërive, në 442 (55.3%) ka fëmijë të moshës shkollore (6 dhe më tepër vjeç). Prej tyre, në 285 amvisëri ka fëmijë të cilët ndjekin arsimin fillor, në 193 amvisëri ka fëmijë të cilët ndjekin arsimin e mesëm ndërsa në 110 amvisëri ka fëmijë të cilët janë të përfshirë në arsimin e lartë. Sa i takon rregullshmërisë në shkollë, vërehet një përfshirje e kënaqëshme tek të tre shkallët e arsimin (parregullshmëria lëviz mes 0.3-1.0%). Gjendja e tillë me siguri ka të bëjë me interventimet e vonta ligjore lidhur me domosdoshmërinë e dy shkallave arsimore (fillore dhe të mesme, promovimin e arsimin të lartë në suazat e politikës arsimore në vend mirëpo në një masë edhe për shkak të faktit që bashkësia etnike rome tek e cila ç'kyçja nga sistemi arsimor si problem është më e theksuar është e përfaqësuar me vetëm 29 amvisëri ose 3.6% nga numri i përgjithshëm i amvisërive (800).

Nga format e ndihmës për arsim fillor më së shpeshti janë shfrytëzuar transporti falas (49 amvisëri) dhe ushqimi falas (5 amvisëri); për arsim të mesëm më së shpeshti janë shfrytëzuar transporti falas (41 amvisëri); ndërsa për arsimin e lartë më së shpeshti janë shfrytëzuar bursat (16 amvisëri), kreditë (8 amvisëri) dhe regjistrimi me kuota (7 amvisëri). Në përgjithësi, vetëm një numër i vogël i amvisërive kanë arritur që të realizojnë qasje deri tek format e ndihmës dhe përkrahjes për përmbushjen e nevojave të tyre arsimore.

### 1.6. Sport, argëtim, kulturë

Nga aspekti i qasëshmërisë deri tek institucionet sportive, zbavitëse dhe kulturore ç'kyçja më e madhe vërehet tek teatret dhe kinematë, ndërsa më e vogël tek kafe baret dhe terrent sportive. Pjesëmarrja në përqindje e amvisërive nga aspekti i mundësisë për të realizuar qasje deri tek ky lloj i institucioneve në vendbanimin e tyre është dhënë në Tabelën 2 më poshtë.


Tabela 2. Qasje deri tek institucionet sportive, zbavitëse dhe kulturore

<b>Lloji i institucionit</b>	<b>Numri i amvisërive të cilat kanë qasje deri tek këto</b>	<b>% nga numri i përgjithshëm i</b>
------------------------------	---	-------------------------------------

	<b>institucione</b>	<b>amvisërive (800)</b>
1. Teatër	135	16.9%
2. Kinema	233	29.1%
3. Bastore sportive	364	45.5%
4. Bibliotekë	378	47.3%
5. Shesh lojërash	524	65.5%
6. Internet kafene	533	66.6%
7. Restorant	561	70.1%
8. Kafe bar	646	80.8%
9. Terren sportiv	721	90.1%

Nga numri i përgjithshëm i amvisërive (800), shumica aspak nuk shfrytëzojnë internet (436 ose 54.5%) (Grafiku 2).

Grafiku 2.



## 2. PËRFUNDIME

<b>SFERA</b>	<b>SFERA MË E NGUSHTË</b>	<b>GJENDJE/PROBLEME</b>
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Në komunat urbane dominojnë veprimtari të cilat absorbojnë shumë pak nga fuqia e kualifikuar punëtore</li> <li>□ Përfaqësi e madhe e industrisë tekstile dhe xehetarisë</li> <li>□ Përfaqësi dominuese e bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë dhe prodhimit të duhanit në komunat rurale</li> <li>□ Prezenca e bujqësisë dhe blegtorisë në komunat urbane</li> <li>□ Zhvillimi i turizmit në disa komuna</li> </ul>
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Në komunat urbane ka rrjet të zhvilluar më mirë të institucioneve arsimore dhe qasje më të mirë tek to</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rrjeti i shkollave të mesme teknike nuk është mjaft mirë i zhvilluar në komunat urbane</li> <li>□ Rrjeti i institucioneve arsimore në komunë nuk është mjaft i zhvilluar (në komunat rurale nuk ka shkolla të mesme)</li> <li>□ Më të ç'kyçura nga institucionet arsimore janë vendbanimet rurale të cilat gjendet në vendet më të larta malore</li> </ul>
<i>Shëndetësi</i> :	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rrjeti i institucioneve shëndetësore në komunat urbane është i kënaqëshëm</li> <li>□ Rrjeti i institucioneve shëndetësore në komunat rurale është dobët i zhvilluar (në shumicën e komunave rurale nuk ka barnatore, ordianca specialistike, shërbim për ndihmë të shpejtë, ndërsa numri i vogël i ambulancave nuk janë të qasëshme për qytetarët gjatë fundjavës)</li> <li>□ Rrjeti i institucioneve shëndetësore në vendbanimet malore aspak nuk është i zhvilluar</li> </ul>
<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Numër i pamjaftueshëm i kopshteve fëmimore</li> <li>□ Nuk ka asnjë shtëpi për persona të moshuar</li> <li>□ QPS janë të paqasëshme për banorët e komunave rurale për shkak se nuk ka njësi lokale të QPS përgjegjëse</li> <li>□ Qasja me e kufizuar deri tek QPS është për banorët e vendbanimeve malore</li> <li>□ Rrjeti i institucioneve për mbrojtje joinstitucionale është dobët i zhvilluar</li> <li>□ Rrjet i pazhvilluar i institucioneve për mbrojtje institucionale</li> <li>□ Kuzhina popullore ka në shumicën e komunave</li> </ul>
<i>Kulturë/sp ort/argëtim</i> :	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rrjeti i institucioneve kulturoro-zbavitëse në vendbanimet urbane është dobët i zhvilluar</li> <li>□ Rrjeti i objekteve dhe organizatave sportive në vendbanimet urbane është mirë i zhvilluar</li> <li>□ Rrjeti i institucioneve kulturoro-zbavitëse dhe objekteve sportive në mjediset rurale është i pazhvilluar</li> <li>□ Rrjeti i mediave lokale është dobët i zhvilluar</li> <li>□ Një numër i madh i shoqatave qytetare nga të cilat vetëm një numër i vogël janë aktive</li> </ul>
<i>Subjekte ekonomike</i> :	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Mbizotëron zhvillimi i ekonomisë së vogël</li> <li>□ Ka mungesë të subjekteve më të mëdha ekonomike me çfarë do të absorbohet fuqi punëtore më e madhe</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Dominuese janë problemet e ndërlidhura me zhvillimin social – papunësia dhe varfëria</li> <li>□ Standardi jetësorë është më i lartë në komunat urbane krahasuar me ato rurale</li> <li>□ Në komunat rurale, varfëria në aspekt të sigurimit të nevojave kryesore ekzistenciale është më pak e theksuar në krahasim me</li> </ul>

		komunat urbane
		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Në rritje një problemet e ndërlidhura me disfunkcionet dhe devijimet familjare</li> <li>□ Në komunat urbane ka resurse më të mira për përparimin e zhvillimit njerëzor</li> <li>□ Edhe në komunat urbane edhe në ato rurale ka një pabarazi të madhe sociale</li> <li>□ Papunësia është më e ulët në qendrat komunale</li> <li>□ Persona të moshuar</li> <li>□ Persona me invaliditet</li> <li>□ Shfrytëzues të NPP</li> <li>□ Grupi etnik turk</li> <li>□ Grupi etnik rom</li> <li>□ Banorë nga vendbanimet malore</li> </ul>
	<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Infrastruktura rrugore është më e mirë në komunat urbane për dallim nga ato rurale</li> <li>□ Infrastruktura e vjetruar rrugore</li> <li>□ Rrugë tokësore të paasfaltuara në vendbanimet rurale</li> <li>□ Qasja më e keqe është tek vendbanimet malore</li> </ul>
	<i>Ujësjellës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përfshirje më të madhe të rrjetit ujësjellës ka në komunat urbane, gjegjësisht vendbanimet,</li> <li>□ Problem me paisjen me ujë në veçanti në vendet e më larta</li> </ul>
	<i>Kanalizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përfshirje më e madhe e rrjetit kanalizues në komunat urbane në karahsim me komunat rurale</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Deponi ilegale për mbeturina (më së shpeshti vetëm në qendrat komunale ka mbledhje të organizuar të mbeturinave)</li> <li>□ Lumenj të ndotur nga mbeturinat e forta dhe ujërat fekal (në vendbanimet ku nuk ka kanalizim)</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërinstytucional në komunë</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Bashkëpunim formal mes komunës dhe pushtetit qendror</li> <li>□ Bashkëpunim relativisht i mirë me BNJVL</li> <li>□ Bashkëpunim jo mjaft i zhvilluar me OJQ-ët</li> <li>□ Bashkëpunim regjional më së shpeshti me komunën më të afërt fqinje me të cilën ekziston lidhshmëri administrative, komunikuese dhe tradicionale</li> <li>□ Bashkëpunim i dobët mes komunës, QPS dhe Qendrës për punësim</li> <li>□ Bashkëpunim i dobët me sektorin privat dhe organizatat fetare</li> <li>□ Aktiviteti dhe iniciativat nga ana e popullatës në komunë janë të pakta</li> </ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<i>Nga komuna:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Funksione dobët të zhvilluara nga mbrojtja sociale</li> <li>□ Nuk ka njësi të posavme për mbrojtje sociale</li> <li>□ Nuk ka trend të përpilimit të programeve për mbrojtje sociale dhe plane strategjike për punësim</li> <li>□ Programet për mbrojtje sociale në përgjithësi fokusohen në ndihmën</li> </ul>

<i>Nga QPS:</i>	<p>financiare dhe nuk i përmbushin kriteret bazike metodologjike dhe metodike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Nuk ka planifikim strategjik në sferën e mbrojtjes sociale</li> <li>□ Nuk ka formë të mbrojtjes sociale për grupet e prekshme të popullatës</li> <li>□ Nga buxheti ndahen mjete minimale për mbrojtje sociale (rreth 1%)</li> <li>□ Numri më i madh janë shfrytëzues të NSP</li> <li>□ Përqindja më e madhe e shfrytëzuesve të NSP nëpër komunë janë popullata shqiptare</li> <li>□ Standard më i ulët jetësorë tek shfrytëzuesit e ndihmës sociale në krahasim me joshfrytëzuesit</li> <li>□ Masat për mbrojtje institucionale dhe joinstitucionale të banorëve në komuna jo mjaft zbatohen</li> <li>□ Shkaqe më të shpeshta për joshfrytëzimin e të drejtave nga mbrojtja sociale janë painformimi, mospërmbushja e kushteve, rrefuzimi dhe turpi</li> <li>□ Në luftën kundër papunësisë si problem më dominues social jo mjaft zbatohen dhe dobët targetohen masat aktive</li> <li>□ Punët publike gati edhe aspak nuk realizohen në vitin 2010 (në disa komuna kjo masë merret si degraduese dhe për shkak të kësaj realizimi i saj ndikon mbi popullaritetin e pushteteve lokale).</li> </ul>
-----------------	---

### 3. REKOMANDIME

SFERA	SFERA MË E NGUSHT Ë	GJENDJA/PROBLEME
<b>1. Veprimtari dominuese</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Promovimi mënyrave moderne të prodhimit bujqësorë dhe blegtorisë përmes edukimit dhe subvencionimit të prodhuesve të vogël në bujqësi dhe blegtori</li> <li>□ Stimulimi i bashkimit të bujqëve dhe blegtorëve në korporata për të siguruar plasman të përshtatshëm dhe në kohë të prodhimeve, mbrojtjen e të drejtave të tyre, informimit më të mirë dhe të ngjajshme.</li> <li>□ Zhvillim i mëtutjeshëm i industrisë tekstile duke e përforcuar kontrollin mbi punën e subjekteve ekonomike tekstile dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve</li> <li>□ Investim në zhvillimi e turizmit në pajtim me potencialet dhe resurset e çdo komune</li> <li>□ Zhvillim i degëve të tjera ekonomike përmes një analize thelbësore për resurset dhe kapacitetet e disponueshme në komunë, inicimi i drejtimeve strategjike për zhvillim dhe realizim të qëndrueshëm dhe</li> </ul>

		të denjë
<b>2. Kapacitete institucionale</b>	<i>Arsim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Zhvillim i rrjetit të shkollave të mesme teknike në komunat urbane</li> <li>□ Zhvillim i rrjetit të institucioneve arsimore në komunat rurale</li> <li>□ Përmirësim i qasjes deri tek institucionet arsimore në vendbanimet rurale të vendosura në vendet më të larta malore</li> </ul>
	<i>Shëndetësi :</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Zhvillim komplet i institucioneve shëndetësore specialistike në komunat urbane</li> <li>□ Zhvillim i rrjetit të institucioneve shëndetësore në komunat rurale të cilat do të jenë të qasëshme edhe gjatë natës edhe gjatë fundjavës</li> <li>□ Krijim i kushteve për hapjen e barnatoreve në komunat rurale</li> <li>□ Përforcim i kapaciteteve dhe mënyrës së funksionimit të ndihmës së shpejtë</li> <li>□ Inicimi i ambulancave mobile për shkak të qasëshmërisë së vendbanimeve rurale më të larguara dhe dobët të popullsuara</li> <li>□ Subvencionim i funksionimit të ordinancave të përgjithshme dhe specialistike në komunat ku paraqitet nevoja për disa shërbime të caktuara shëndetësore</li> </ul>
	<i>Sfera sociale:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Te hapen kopshte fëmimore në komunat ku ka nevojë dhe në veçanti në komunat rurale</li> <li>□ Hapja e shtëpive për persona të moshuar si dhe forma të tjera të mbrojtjes institucionale dhe jointitucionale për mbrojtje e personave të moshuar</li> <li>□ Analizë e mundësive për hapjen e zyrave lokale të qendrave për punë sociale kompetente në komunat më të mëdha rurale</li> <li>□ Zhvillim i të gjitha formave të mbrojtjes institucionale edhe në komunat urbane edhe në ato rurale (qendra ditore për persona me nevojë të posaçme, persona të moshuar, klube, këshillimore etj.)</li> <li>□ Analizë e nevojave për zhvillimin e mbrojtjes institucionale (shtëpi të vogla grupore, banim i mbrojtur etj.)</li> <li>□ Hapja e kuzhinave popullore në komunat në të cilat nuk ekziston kjo formë dhe zgjerim i shfrytëzuesve në kuzhinat ekzistuese</li> </ul>
	<i>Kulturë/sp ort/argëtim :</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Pasurim i institucioneve kulturoro-zbavitëse në mjediset urbane</li> <li>□ Zhvillim i rrjetit të institucioneve kulturoro-zbavitëse dhe objekteve sportive në vendbanimet rurale</li> <li>□ Përkrahje nga ana e komunës për zhvillimin e rrjetit lokal të mediave</li> <li>□ Përforcim i kapaciteteve të OJQ sektorit në nivel lokal</li> </ul>
	<i>Subjekte ekonomike :</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Stimulim i zhvillimit të mëtutjeshëm të ekonomisë së vogël</li> <li>□ Analizë e potencialeve të komunave për hapjen e subjekteve më të mëdha ekonomike të cilat do të absorbojnë fuqi më të madhe puntore</li> </ul>
<b>3. Probleme sociale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Zhvillim i planeve lokale strategjike, programeve dhe masave për zhvillim social dhe luftë kundër papunësisë dhe varfërisë</li> <li>□ Zhvillim i masave strategjike për ta zgjidhur varfërinë urbane</li> <li>□ Përforcim i aktiviteteve të qendrave për punësim, në veçanti në</li> </ul>

		<p>fushën e masave aktive</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Rritje e vetëdijes së popullatës për njohjen dhe reagimin e formave të devijimeve familjare përmes masave parandaluese</li> <li>□ Zhvillimi i shërbimeve këshilluese për përforcim të strukturës familjare dhe menaxhim të disfeksioneve familjare</li> <li>□ Masa për lehtësimin e pabarazisë sociale mes banorëve nga komunat urbane dhe ato rurale</li> <li>□ Përgatitja e strategjisë për arritje të një zhvillimi lokal më të balansuar të komunës</li> </ul>
	<i>Grupe socialisht të prekshme të popullatës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Persona të moshuar: krijim i formave institucionale dhe jointucionale për mbrojtje (shtëpi, qendra ditore, klube, spitale ditore, shërbime për ndihmë në kushte shtëpiake, mbrojtje në familje strehuese etj.)</li> <li>□ Persona me invaliditet: krijimi i formave institucionale dhe jointucionale të mbrojtjes (qendra ditore, banim i mbrojtur, shtëpi të vogla grupore, familje strehuese, punësim i subvencionuar, qasje e lehtësuar tek institucionet etj.)</li> <li>□ Shfrytëzues të NPP: përkrahje më e madhe nga QPS për NPP, rritje e shumës së NPP, qasje e lehtësuar deri tek institucionet, sigurimi i ndihmës së vazhdueshme në para dhe ndihmë në natyrë nga ana e komunave</li> <li>□ Grupi etnik rom: masa për veprim afirmativ, programe dhe masa për përmirësimin e statusit arsimor, kyçje në masat aktive për punësim, përmirësim i kushteve banuese</li> <li>□ Grupi etnik turk: masa për përmirësimin e statusit arsimor, zhvillim të programeve për emancipimin e gruas turke, kyçje në masat aktive për punësim</li> <li>□ Banorët nga vendbanimet malore: masa të posaçme për përfshirje sociale të banorëve nga vendbanimet rurale me qëllim që të ketë qasje më të mirë deri tek: shërbimet arsimore, shëndetësore, kulturore, sociale dhe të tjera</li> </ul>
<b>5. Probleme infrastrukturale</b>	<i>Rrugë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përfundim i ndërtimit të infrastrukturës rrugore në komunat rurale</li> <li>□ Meremetim i infrastrukturës rrugore në komunat urbane</li> <li>□ Përmirësim i qasëshmërisë deri tek vendbanimet malore</li> </ul>
	<i>Ujësjellës:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përfshirja graduale e të gjitha vendbanimeve në komunat urbane dhe rurale me rrjet ujësjellës, në veçanti në vendbanimet më të larguara malore</li> <li>□ Inicimi i mekanizmit për kontrollë të kualitetit të ujit të pishëm në komunat rurale</li> </ul>
	<i>Kanalizim:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përfshirja graduale e të gjitha vendbanimeve në komunat urbane dhe rurale në rrjetin kanalizues</li> </ul>
<b>6. Probleme ekologjike</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Gjetja e zgjidhjeve për deponitë ekzistuese ilegale për mbeturina të forta dhe ndërtimi i deponive në lokacione të përshtatshme sipas</li> </ul>

		standadeve të përcaktuara
		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Formimi i ndërmarrjeve komunale për mbledhjen e organizuar të mbeturinave dhe zgjerim i kapaciteteve të ndërmarrjeve ekzistuese që ti përfshijnë të gjitha vendbanimet (më shpesh vetëm në qendrat komunale ka grumbullim të organizuar të mbeturinave)</li> <li>□ Analiza e mundësive për zbatim të modelit të partneritetit publiko-privat për zgjidhje të problemeve ekologjike</li> <li>□ Gjetja e zgjidhjeve për ndalimin e burimeve të ndotësive të ujërave</li> </ul>
<b>7. Bashkëpunimi ndërkomunal në komunë</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përmirësim i formave të bashkëpunimit mes komunave dhe pushtetit qendror</li> <li>□ Zhvillim i formave të ndryshme të bashkëpunimit me OJQ-ët</li> <li>□ Përforsim i bashkëpunimit mes komunës, QPS dhe Qendrës për punësim duke inicuar organe tematike shumësektorale formale dhe joformale</li> <li>□ Zhvillim i përgjegjësisë korporative të subjekteve ekonomike</li> <li>□ Nxitje e funksioneve sociale të organizatave fetare</li> <li>□ Zhvillim i formave të reja të bashkëpunimit mes qytetarëve dhe komunave dhe promovim i rëndësisë së iniciativës dhe veprimit qytetarë në zgjidhjen e probleme lokale dhe zhvillimin e komunave</li> </ul>
<b>8. Mbrojtje sociale</b>	<i>Nga komuna:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Zhvillim i funksioneve për mbrojtje sociale</li> <li>□ Formimi i njësisë të posaçme për mbrojtje sociale</li> <li>□ Në sistematizimin e vendeve të punës në komunë të parashihet vendi i punës për një punonjës social</li> <li>□ Përpilim dhe përfundim sistematik, i koordinuar dhe i informuar i dokumenteve strategjike të komunës</li> <li>□ Organizim dhe zbatim i edukimit për planifikim strategjik të të punësuarve në administratën komunale</li> <li>□ Përpilimi i strategjive për zhvillim lokal të mbrojtjes sociale</li> <li>□ Targetim i grupeve të prekshme të popullatës dhe zhvillim të masave të përshtatshme për mbrojtje sociale</li> <li>□ Rritje e shumës për mbrojtje sociale të cilën komuna jua jep grupeve të prekshme të qytetarëve duke vendosur kritere të qarta për dhënien e saj (krijimi i rregulloreve)</li> <li>□ Zhvillim i rrjetit lokal të bashkëpunimit për shfrytëzim optimal të resurseve lokale në sigurimin e mbrojtjes sociale të popullatës (komuna, institucione arsimore, shëndetësore, kulturore dhe sportive, sektori privat, OJQ dhe organia fetare dhe humanitare)</li> <li>□ Edukim i aktorëve relevant lokal për format e mundshme të dhënies së shërbimeve sociale: kofinancim, kontraktim dhe të ngjajshme</li> </ul>
	<i>Nga QPS:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Targetim më i mirë i NSP</li> <li>□ Rritje e mundësive për punësimin e shfrytëzuesve të NSP duke përmirësuar bashkëpunimin mes QPS dhe QO në zbatimin e masave aktive</li> </ul>

- Zgjerim i përfshirjes së amvisërive të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës sociale me shërbimet e kuzhinës popullore dhe krijim i kuzhinave popullore në të gjitha komunat
- Zhvillim i rrjetit të mbrojtjes jointucionale dhe analizë e mundësive për zhvillimin e mbrojtje sociale institucionale në nivel regjional
- Shfrytëzim i kapaciteteve infrastrukturale komunale për krijimin e shërbimeve të posaçme sociale (shtëpi të vogla grupe për persona të moshuar, shellter qendra, qendra ditore, kuzhina popullore dhe të ngjajshme)
- Informim më i madh i popullatës për të drejtat nga mbrojtja sociale
- Zbatim i programeve për zhvillim të vetëdijes për popullatën socialisht të prekshme dhe tejkalimin e paragjyqimeve dhe praktikave stigmatizuese
- Zbatim më intenziv, joselektiv dhe i denjë i rregullave ligjore për angazhim të shfrytëzuesve të NSP në zbatimin e punëve publike në komunë

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Амицис, Г. (2004). Систем на социјална заштита во Република Македонија. F. 11-12. Shkup.

Enti shtetëror statistikor (2002). Regjistrimi i popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë.

Ligji për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 50/97, 16/2000, 17/2003, 65/2004).

Ligji për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/09).

Komuna e Berovës, UNDP (2006). Strategji për zhvillim të qëndrueshëm të komunës së Berovës 2006-2001.

Komuna e Konçes (2010). Program për mbrojtje sociale të popullatës së komunës së Konçes për vitin 2010. Gazeta zyrtare e komunës së Konçes nr. 05/2010.

Komuna e Likovës (2009). Profili i komunës së Likovës. Grafoteks. Kumanovë.

Komuna e Likovës, USAID (2009). Strategjia për zhvillim ekonomik lokal për komunën e Likovës 2009-2011.

Komuna e Studeniçanit (2010). Strategjia për zhvillim ekonomik lokal të komunës së Studeniçanit 2010-2014. EVROCENTAR Konsllating.

Komuna e Çashkës (2008). Profil i komunës së Çashkës.

Komuna e Çashkës (2008). Program për zhvillimin e arsimit, sportit, kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në komunën e Çashkës për periudhën e viteve 2009-2013.

Komuna e Çashkës, USAID (2008). Plan strategjik për zhvillimin ekonomik lokal të komunës së Çashkës.

Komuna e Çashkës (2010). Propozim program për aktivitetet e komunës së Çashkës në sferën e mbrojtjes sociale në vitin 2011.

Пејановиќ, С. (1995). Појам потреба и социјалне потребе. Социјална мисао. Nr. 5-6. Beograd.

Këshilli i komunës së Berovës dhe Pehçevës (2008). Plan lokal veprues për punësim në Berovë dhe Pehçevë 2009-2011.

Сулејманов, З., Стојановски, Н. (2002). Социјална патологија. F. 21. Shkup.

UNDP (2004). Raport për analizën e dallimeve socialo-ekonomike mes komunave maaqedonase. Shkup.

USAID (2010). Strategji për zgjidhje afatgjate të problemit të papunësisë së gruas shqiptare. Studim rasti në komunën e Studeniçanit dhe Tearces.

Fond për investime sociale (2005). Manual për identifikim e problemeve sociale dhe bashkëpunim me bashkësinë lokale. Projekt për zhvillimin e komunave dhe Qendra për arsim të vazhdueshëm për zhvillim social. Shkup.

[www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk)

[www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

<http://epp.eurostat.ec.europa.eu>

<http://www1.oecd.org/cer/obj5/docs.htm>

<http://www.berovo.gov.mk/>

<http://www.pehcevo.gov.mk/>

<http://www.radovis.gov.mk/>

<http://www.caska.gov.mk/>

<http://www.negotino.gov.mk/>

<http://www.lipkovo.gov.mk/>

<http://www.studenicani.gov.mk/>

<http://www.konce.gov.mk/>

Shtojca 1

**PYETËSORË**  
**HULUMTIM I GJENDJES SOCIALE TË QYETARËVE NË RM**

**Numri i pyetësorit:** \_\_\_\_\_  
**Komuna:** \_\_\_\_\_  
**Emri i vendbanimit:** \_\_\_\_\_  
**Lloji i vendbanimit:** 1. Urbane      2. Rurale      3. Periferi  
**Data e anketimit:** \_\_\_\_\_  
**Emri dhe mbiemri i anketusit:** \_\_\_\_\_  
**Kodi i supervizorit:** \_\_\_\_\_

**A. INFORMATA PËR KOKËN E AMVISËRISË**

**P1. Gjinia e kokës në amvisëri:**

- a. Mashkull
- b. Femër

**999. Rrefuzon të përgjigjet (moslexo)**

**P2. Moshë e kokës në amvisëri:**

- a. 15 – 19
- b. 20 – 29
- c. 30 – 39
- d. 40 - 49

- e. 50 - 59
- f. 60 - 64
- g. 65 dhe më tepër

**99. Nuk e di (*mos lexo*)**

**999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)**

**P3. Përkatësia etnike e kokës në amvisëri:**

- 1. Maqedonas/e
- 2. Shqiptar/e
- 3. Rom/e
- 4. Turk/e
- 5. Serb/e
- 6. Vlleh/e
- 7. Boshnjak/e
- 8. Tjetër (shkruaj)\_\_\_\_\_

**9. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)**

**P4. Statusi martesor i kokës së amvisërisë:**

- 1. i/e pamartuar
- 2. i/e martuar
- 3. bashkësi jomartësore
- 4. i/e divorcuar
- 5. i/e vejë

**99. Nuk e di (*mos lexo*)**

**999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)**

**P5. Shkrim-leximi i kokës në amvisëri:**

- 1. Shkrim=lexim (di të shkruaj dhe lexoj)
- 2. Analfabet (nuk di të shkruaj dhe lexoj)

**99. Nuk e di (*mos lexo*)**

**999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)**

**P6. Shkalla e arsimit formal të kokës së amvisërisë:**

- 1. Pa arsim
- 2. Arsim fillor i pambaruar (deri në klasë të katërt)
- 3. Arsim fillor
- 4. Arsim i mesëm teknik
- 5. Arsim i mesëm-gjimnaz

- 6. Arsim i lartë
- 7. Arsim universitarë (diplomë)
- 8. Nivel i dytë i arsimit universitarë (Magjistër)
- 9. Post nivel universital (doktorat, specializim)
- 99. Nuk e di (*mos lexo*)
- 999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)

P7. Profesion i momental i kokës në amvisëri:

**INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! VETËM NJË PËRGJIGJE!**

- a. Bujk
- b. Punëtorë
- c. Nëpunës
- d. Teknik
- e. Udhëheqës
- f. Afarist privat
- g. Profesion i lirë (artsist, gazetarë, avokat etj.)
- h. Ushtri, polici
- i. Nxënës/student
- j. Pensioner
- k. Amvis/e
- l. Tjetër (*shëno*)\_\_\_\_\_

99. Nuk e di (*mos lexo*)

999. Rrefuzon të përgjigjet

P8. A është koka e amvisërise shfrytëzuese e ndihmës në para nga mbrojtja sociale?

**INSTRUKSION: VETËM NJË PËRGJIGJE!**

- a. Po
- b. Jo

99. Nuk e di (*mos lexo*)

999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)

**B. INFORMATA PËR AMVISËRINË**

P9. Sa anëtarë kë amvisëria juaj? Si anëtarë i amvisërisë nënkuptohet personi i cili është me vendbanim të përhershëm në adresën e amvisërisë suaj. Numrohen edhe personat të cilat momentalisht qëndrojnë jashtë (deri më 12 muaj), ndërsa zyrtarisht jetojnë në këtë adresë.

**INSTRUKSION: SHKRUAJ NË KATRORIN!**

1. Numri i anëtarëve në amvisëri:

99. Nuk e di (*mos lexo*)

999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)

P10. Lloji i amvisërisë:

**INSTRUKSION: VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. Bujqësore (amvisëria mirëmbahet nga veprimtaria bujqësore)
2. Jobujqësore (nëse asnjëri prej anëtarëve nuk merret me veprimtari bujqësore)
3. E përzier (mirëmbahet edhe nga veprimtaria bujqësore dhe jobujqësore)

99. Nuk e di (*mos lexo*)

999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)

P11. Sa anëtarë të amvisërisë suaj në moment janë:

**INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! NGA NJË PËRGJIGJE NË SECILËN RRADHË!**

Statusi punues	Asnjë	Një	dy	tre	Katër	Pesë	Gjash të	Shtatë	Tetë dhe më tepër
<b>Të punësuar</b>									
Të punësuar	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Punëdhënës	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
I vetëpunësuar	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
<b>Të papunësuar</b>									
Të papunësuar	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Falimentues/ tepricë teknologjike	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
<b>Persona joaktiv</b>									
Pensionerë	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Nxënës/student/fëmijë	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Të paaftë për punë	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Amvis/e	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Tjetër	0	1	2	3	4	5	6	7	8+

**P12. Sa anëtarë nga paraprakisht të cekurit në statusin pun ues janë meshkuj dhe sa femra?**

**INSTRUKSION: PËR SECILIN STATUS PUNE NË PYETJE PARAPRAKE RRETHO SA JANË MESHKUJ DHE SA FEMRA**

Statusi punues	Meshkuj								Femra									
<b>Të punësuar</b>																		
Të punësuar	0	1	2	3	4	5	6	7	8+	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Punëdhënës	0	1	2	3	4	5	6	7	8+	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
I vetëpunësuar	0	1	2	3	4	5	6	7	8+	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
<b>Të papunësuar</b>																		
Të papunësuar	0	1	2	3	4	5	6	7	8+	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Falimentues/tepricë teknologjike	0	1	2	3	4	5	6	7	8+	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
<b>Persona joaktiv</b>																		
Pensioner	0	1	2	3	4	5	6	7	8+	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Nxënës/student/fëmijë	0	1	2	3	4	5	6	7	8+	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Të paaftë për punë	0	1	2	3	4	5	6	7	8+	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Amvise	0	1	2	3	4	5	6	7	8+	0	1	2	3	4	5	6	7	8+
Tjetër	0	1	2	3	4	5	6	7	8+	0	1	2	3	4	5	6	7	8+

**B.  
STANDAR  
DI  
JETËSOR  
Ë**

**P13. A keni marrë ju ose ndonjë tjetër në amvisërinë tuaj ndonjë nga llojet e ardhshme të të ardhurave në 12 muajt e fundit?**

**INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! Për çdo element të tabelës rretho nëse i anketuari përgjigjet me konfirmim ose jo! Vetëm një përgjigje për secilin rresht!**

Burime të të ardhurave në amvisëri:	Po	Jo	Nuk e di (mos lexo)	Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)
Të ardhura nga marrëdhënie të rregullta pune	1	0	99	999
Të ardhura jashtë marrëdhënieve të rregullta pune	1	0	99	999
Të ardhura nga pensionet	1	0	99	999
Të ardhura nga jashtëрмања од странство	1	0	99	999
Të ardhura nga bujqësia	1	0	99	999
Të ardhura nga prona (qira, shitje)	1	0	99	999
Hua	1	0	99	999
Ndihmë nga fëmjet/prindërit/familjarët	1	0	99	999
Të ardhura nga mbrojtja sociale	1	0	99	999
Burime të tjera të të ardhurave (shkruaj):				

**VETËM NËSE NË P13 janë rrethuar të ardhura jashtë marrëdhënieve të rregullta pune**

P14. Cilat nga veprimtaritë e cekura ka sjellë të ardhura jashtë marrëdhënieve të rregullta pune në 12 muajt e fundit? **INSTRUKSION: LEXO MODALITETET!** Për secilin element të tabelës rretho nëse i anketuari është përgjigjur me konfirmim apo jo! Vetëm një përgjigje në secilin rresht!

Veprimtari	Jashtë marrëdhënieve të rregullta pune	
	Po	Jo
Tregti/rishitje	1	0
Ndërtimtari	1	0
Ngarkim=shkarkim-transport	1	0
Punë nëpër shtëpi	1	0
Punë sezonale	1	0
Tjetër (shkruaj):		

P15. Sa është shuma të cilën amvisëria juaj e ka realizuar si të ardhura muajin e fundit?

**INSTRUKSION: MOS LEXO. VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. deri 5.000 mkd
2. 5.001-10.000 mkd
3. 10.001-14.000 mkd
4. 14.001-18.000 mkd
5. 18.001-23.000 mkd
6. 23.001-30.000 mkd
7. mbi 30.001 mkd
99. Nuk e di (*mos lexo*)
999. Rrefuzon të përgjigjet

#### Ç. SHËNDETËSI DHE TË USHQYERIT

P16. A kanë anëtarët e amvisërisë suaj sigurim shëndetësor?

**INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! VETËM NJË PËRGJIGJE!**

Sigurimi shëndetësor i anëtarëve të amvisërisë:

1. Të gjithë kanë sigurim
2. Pjesërisht – jo të gjithë janë të siguruar
3. Asnjë nuk ka sigurim
99. Nuk e di (*mos lexo*)
999. Rrefuzon të përgjigjet(*mos lexo*)

P17. Në rast të sëmundjes (veç hospitalizimit) më së shpeshti:

**INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. Shkoj në mjek publik dhe blej barna me reçetë
2. Shkoj në mjek privat dhe blej barna në mënyrë private
3. Mjekohem tek mjek privat
4. Nuk shkoj në mjek, shfrytëzoj mënyra alternative të mjekimit
5. Tjetër (*shkruaj*) \_\_\_\_\_

99. Nuk e di (*mos lexo*)

999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)

P18. Sa kohë keni nevojë që të mbrini tek shtëpia më e afërt shëndetësore në vendbanimin tuaj?

**INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. deri 15 minuta
2. 16 – 30 minuta
3. më tepër se 30 minuta
4. nuk ka shtëpi shëndetësore në vendbanimin tim

99. Nuk e di (*mos lexo*)

999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)

P19. Sa herë në javë zakonisht gatuhet ushqim i ngrohtë me mish në amvisërinë tuaj?

**INSTRUKSION: MOS LEXO! VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. Asnjëherë
2. Një herë
3. Dy herë
4. Tre herë
5. Katër herë
6. Pesë herë
7. Gjashtë herë
8. Çdo ditë (shtatë herë)

99. Nuk e di (*mos lexo*)

999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)

P20. Nga të theksuarat, ju lutemi tregoni deri më 5 gjëra për të cilat më së tepërmi ju mungojnë para?

**INSTRUKSION:** Lexo listën komplete. **VETËM NJË PËRGJIGJE** në secilin rresht! Maksimum 5 njësi në kolonën „e veçuar“, për të gjitha tjerat rrethoni 0 në kolonën „nuk është veçuar“

Për çfarë më së tepërmi ju mungojnë para (rretho 5):	E veçuar	Jo e veçuar
Ushqim dhe pije joalkoolike	1	0
Pije joalkoolike dhe duhan	1	0
Veshje dhe këpucë	1	0
Banim, ujë, rrymë, karburantë	1	0
Orendi shtëpiake dhe mobilje	1	0
Higjienë dhe shëndet (barna, ndihmesa)	1	0
Komunikacion (transport, automobil)	1	0
Komunikim (telefon, internet)	1	0
Rekreim dhe kulturë (gazeta, libra, udhëtime, aheng)	1	0
Arsim	1	0
Tjetër ( <i>shkruaj</i> )		

### Ç. ARSIM

P21. A ka në amvisërinë tuaj fëmijë të cilët janë të moshë shkollore për tu përfshirë në arsim (në 6 dhe më tepër vjeç)?

**INSTRUKSION:** **VETËM NJË PËRGJIGJE!**

- Po
- Jo >>>> *shko në P27*

P22. Ju lutemi tregoni sa prej tyre vizitojnë rregullisht arsimin fillor, të mesëm ose të lartë, dhe sa nuk e ndjekin?

**INSTRUKSION:** **SHKRUAJ NUMRIN E FËMIJËVE NË KOLLONËN DHE SHKRUAJ NUMRIN TORAL NË „GJITHËSEJ FËMIJË“!**

Lloji i arsimit	Numri i fëmijëve (shkruaj)	<i>Nuk e di (mos lexo)</i>	<i>Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)</i>
Në arsim fillor		99	999
Në arsim të mesëm		99	999
Në arsim të lartë (fakultet)		99	999
Asnjëherë nuk janë përfshirë në procesin arsimor dhe janë në moshë shkollore për të ndjekur arsim (fillor ose të mesëm)		99	999

GJITHËSEJ fëmijë:

**VETËM NËSE në P22 është dhënë numri i fëmijëve në ARSIMIN FILLOR**

P23. Sa është larg shkolla fillore në të cilën mësojnë fëmijët e amvisërisë suaj?

**INSTRUKSION: VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. Deri më 1 kilometër
2. 1.01km - 2 km
3. 2.01 - 4 km
4. më tepër se 4 km

99. *Nuk e di (mos lexo)*

999. *Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)*

**VETËM NËSE në P22 është dhënë numri i fëmijëve në arsim FILLOR DHE/OSE TË MESËM**

P24. Sa prej fëmijëve ndjekin rregullisht jorregullisht ose aspak mësimin (vetëm për fëmijë në arsimin fillor dhe të mesëm)?

**INSTRUKSION: PYET VEÇMAS PËR ATO TË ILLORES DHE TË MESMES! SHKRUAJ NUMRIN E FËMIJËVE DHE THEKSOE NËN „GJITHËSEJ FËMIJË“!**

Rregullshmëria	Fëmijë në arsimin fillor			Fëmijë në arsimin e mesëm		
	Numri i fëmijëve (shkruaj)	<i>Nuk e di (mos lexo)</i>	<i>Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)</i>	Numri i fëmijëve (shkruaj)	<i>Nuk e di (mos lexo)</i>	<i>Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)</i>
Rregullisht		99	999		99	999
Jorregullisht		99	999		99	999
Është ndaluar		99	999		99	999
<b>GJITHSEJ fëmijë:</b>						

**VETËM NËSE në P24 se mësimi nuk ndiqet rregullisht ose aspak nuk ndiqet**

P25. Sa prej fëmijëve nuk ndjekin ose jorregullisht ndjekin arsimin për shkak të ndonjëres nga shkaqet e ardhshme?

**INSTRUKSION: PYET VEÇMAS PËR ATË FILLOR DHE TË MESËM! LEXO SHKAOET DHE SHKRUAJ NUMRIN E FËMIJËVE TË CILËT JORREGULLISHT OSE ASPAK NUK NDJEKIN MËSIMIN DHE SHKRUAJ NUMRIN E PËRGJITHSHËM NËN „GJITHSEJ“!**

Fëmijë në arsimin fillor

fëmijë në arsimin e mesëm

SHKAQE	Jorregul lisht për shkak të:	Nuk ndjeki n për shkak të:	<i>Nuk e di</i> ( <i>mos lexo</i> )	<i>Rrefuzon të përgjigjet</i> ( <i>mos lexo</i> )	Jorregu llisht për shkak të:	Nuk ndjek për shkak të:	<i>Nuk e di</i> ( <i>mos lexo</i> )	<i>Rrefuzon të përgjigjet</i> ( <i>mos lexo</i> )
Sëmundje			99	999			99	999
Punë sezonale			99	999			99	999
U ndihmon prindërve për të siguruar ekzistencë			99	999			99	999
Varfëri (nuk ka veshje, para)			99	999			99	999
Sjellje e çrregulluar sociale			99	999			99	999
tradita			99	999			99	999
Tjetër ( <i>shkruaj</i> ) _____			99	999			99	999
<b>GJITHSEJ</b>								

**VETËM NËSE në P22 është cekur se ka fëmijë të përfshirë në procesin arsimor**

**P26. A keni shfrytëzuar ndonjë prej formave të ndihmës për asrim?**

***INSTRUKSION: Lexo një nga një. VETËM NJË PËRGJIGJE një përgjigje në secilin rresht!***

Forma ndihme për asrim	Po	Jo	<i>Nuk e di</i> ( <i>mos lexo</i> )	<i>Rrefuzon të përgjigjet</i> ( <i>mos lexo</i> )
<b>Arsim fillor</b>				
Transport falas	1	0	99	999
Ushqim falas	1	0	99	999
Bursë	1	0	99	999
Kredi	1	0	99	999
Regjistrim me kuotë	1	0	99	999
Tjetër ( <i>shkruaj</i> ) _____				
<b>Arsim i mesëm</b>				
Transport falas	1	0	99	999
Ushqim falas	1	0	99	999
Bursë	1	0	99	999
Kredi	1	0	99	999
Regjistrim me kuotë	1	0	99	999
Tjetër ( <i>shkruaj</i> ) _____				
<b>Arsim i lartë</b>				
Transport falas	1	0	99	999
Ushqim falas	1	0	99	999
Bursë	1	0	99	999
Kredi	1	0	99	999
Regjistrim me kuotë	1	0	99	999
Tjetër ( <i>shkruaj</i> ) _____				

## D. PROBLEME SOCIALE DHE MBROJTJA SOCIALE

P27. A është ballafaquar ndonjëher ose balafaqohet amvisëria juaj me ndonjë nga problemet e theksuara sociale?

**INSTRUKSION:** Lexo me radhë. E mundshme është VETËM NJË PËRGJIGJE në secilin rresht!

	Po	Jo	Nuk e di (mos lexo)	Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)
<b>Probleme të ndërlidhura me zhvillimin social:</b>				
Papunësi	1	0	99	999
Varfëri	1	0	99	999
Divorcë	1	0	99	999
Marrëdhënie familjare konfliktuozë	1	0	99	999
Fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror	1	0	99	999
Sëmundje	1	0	99	999
Invaliditet	1	0	99	999
Dhunë familjare	1	0	99	999
Konflikte/luftëra etnike	1	0	99	999
<b>Probleme të ndërlidhura me devijimet:</b>				
Sjellje asociale ( ikje nga shkolla, vrasje, endje e fëmijëve)	1	0	99	999
Delikuenca e mitur	1	0	99	999
Delikuenca tek të moshuarit (bixhozi)	1	0	99	999
Delikuenca tek të moshuarit (kriminaliteti)	1	0	99	999
Alkoolizmi	1	0	99	999
Narkomania	1	0	99	999
Prostitucioni	1	0	99	999
Endja e të rriturve	1	0	99	999
Vrasje/vetëvrasje	1	0	99	999
<b>Probleme të ndërlidhura me proceset ekologjike natyrore:</b>				
Zjarr	1	0	99	999
Vërshime	1	0	99	999
Thatësi	1	0	99	999
Tërmet	1	0	99	999
Tjetër ( <i>shkruaj</i> )				

P28. A ka shfrytëzuar ndonjëherë amvisëria juaj ose shfrytëzon ndonjë nga masat e mbrojtje sociale?

**INSTRUKSION:** Lexo me rradhë. E mundshme është VETËM NJË PËRGJIGJE në secilin rresht!

Masa të mbrojtjes sociale	Po	Jo	Nuk e di (mos lexo)	Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)
<b>Mbrojtje joinstitucionale:</b>				

Punë informuese dhe këshilluese në QPS	1	0	99	999
Ndihmë profesionale e familjes për zgjidhjen e krizave martesore, familjare, marrëdhëniesve prind-fëmijë	1	0	99	999
Kujdes shtëpiak dhe ndihmë	1	0	99	999
Qendër ditore	1	0	99	999
Vendosje në familje strehuese	1	0	99	999
Shtëpi e vogël grupore	1	0	99	999
Jetesë e pavarur me përkrahje	1	0	99	999
<b>Mbrojtje institucionale:</b>				
Aftësim për aktivitet pune-prodhues	1	0	99	999
Strehim në institucion për mbrojtje sociale	1	0	99	999
<b>Ndihmë në para nga mbrojtja sociale:</b>				
Ndihmë sociale në para	1	0	99	999
Ndihmë e përhershme në para	1	0	99	999
Ndihmë në para për person i cili deri në moshën 18 vjeçare ka pasur statusin e fëmijut pa prindër dhe kujdes prindëror	1	0	99	999
Kompenzim në para për ndihmë dhe kujdes nga personi i huaj	1	0	99	999
Ndihmë e njëhershme në para dhe ndihmë në natyrë	1	0	99	999
Kompenzim i rrogës për kohë të shkurtuar pune për shkak të kujdesit të fëmijës me pengesa fizike ose pengesa mentale në zhvillim	1	0	99	999
Ndihmë në para për banim social	1	0	99	999
<b>Shtesë fëminore:</b>				
Shtesë fëminore	1	0	99	999
Shtesë e posaçme fëminore	1	0	99	999
Ndihmë e njëhershme në para për fëmijë të sapolindur	1	0	99	999
Participim (kopsht fëminor)	1	0	99	999
Shtesë prindërore për fëmijë	1	0	99	999
<b>Lloj tjetër i parave ose ndihmës në natyrë kemi marrë nga:</b>				
OJQ	1	0	99	999
Komuna	1	0	99	999
Organizata fetare/humanitare	1	0	99	999
Persona privat	1	0	99	999
Tjetër ( <i>shkruaj</i> )				

**VETËMNËSE në P28 është theksuar se nuk kanë shfrytëzuar asnjë nga masat e mbrojtjes sociale nga nëngrupi "Ndihmë në para nga mbrojtja sociale"**

**P29. Përse nuk keni shfrytëzuar ndihmë në para nga mbrojtja sociale?**

***INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! VETËM NJË PËRGIJJE!***

1. Për shkak të painformimit
2. Ishëm të refuzuar

3. Kishëm dokumentcion të paplotë/parregulluar
4. Për shkak të turpit
5. Nuk kemi nevojë
6. Tjetër (*shkruaj*) \_\_\_\_\_

**VETËMNËSE në P28 është theksuar se nuk kanë shfrytëzuar asnjë nga masat e mbrojtjes sociale nga nëngrupet "mbrojtje fëminore"**

P30. Përse nuk keni shfrytëzuar mbrojtje fëminore?

**INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. Për shkak të painformimit
2. Ishëm të rrefuzuar
3. Kishëm dokumentcion të paplotë/parregulluar
4. Për shkak të turpit
5. Nuk kemi nevojë
6. Tjetër (*shkruaj*) \_\_\_\_\_

**VETËMNËSE në P28 është theksuar se nuk kanë shfrytëzuar asnjë nga masat e mbrojtjes sociale nga nëngrupet "institucionale" dhe/ose "mbrojtje joinstitucionale"**

P31. Përse nuk keni shfrytëzuar forma të tjera të mbrojtjes sociale (mbrojtje institucionale dhe joinstitucionale)?

**INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. Për shkak të painformimit
2. Ishëm të rrefuzuar
3. Kishëm dokumentcion të paplotë/parregulluar
4. Për shkak të turpit
5. Nuk kemi nevojë
6. Tjetër (*shkruaj*) \_\_\_\_\_

## **DH. SPORT, ARGËTIM, KULTURË**

P32. Ju lutemi më tregoni se a i keni lokalitetet e ardhshme në vendbanimin tuaj?

**INSTRUKSION: Lexoni me rradhë. E mundshme është VETËM NJË PËRGJIGJE në secilin rresht!**

	Po	Jo	<i>Nuk e di (mos lexo)</i>	<i>Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)</i>
Kinema	1	0	99	999
Teatër	1	0	99	999
Bibliotekë	1	0	99	999
Terren sportiv	1	0	99	999
Luhatëse	1	0	99	999
Restorant	1	0	99	999
Markete	1	0	99	999
Internet kafene	1	0	99	999
Kafe bar	1	0	99	999
Bastore sportive	1	0	99	999

**P33. A shfrytëzon më së paku një anëtarë i amvisërisë suaj internet?**

**INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. Po, më shpesh nga kompjuteri shtëpiak
2. Po, më shpesh nga internet kafeneja
3. Po, më shpesh në punë
4. Nuk shfrytëzoj internet
5. Tjetër (*shkruaj*) \_\_\_\_\_

**99. *Nuk e di (mos lexo)***

**999. *Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)***

#### **E. BANIM**

**P34. Sa dhoma ka vendbanimi juaj (pa kuzhinë, tualet ose banjo)?**

**INSTRUKSION: VETËM NJË PËRGJIGJE!**

**Numri i dhomave në shtëpi:**

1. Garsonjerë
2. Njëdhomëshe
3. Dydhomëshe
4. Tredhomëshe
5. Katërdhomëshe
6. Banesë më e madhe

**999. *Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)***

**P35. Sa është madhësia e përafërt e banimit tuaj (bodrumi, tavani, punëtorja, garazha nuk numrohen)?**

**INSTRUKSION: VETËM NJË PËRGJIGJE!**

**Sipërfaqja e banimit**

1. deri 10m<sup>2</sup>
2. 11-20m<sup>2</sup>
3. 21-40m<sup>2</sup>
4. 41-60m<sup>2</sup>
5. 61-80m<sup>2</sup>
6. 81-100m<sup>2</sup>
7. mbi 101m<sup>2</sup>

**99. Nuk e di (*mos lexo*)**

**999. Rrefuzon të përgjigjet (*mos lexo*)**

**P36.A ka banimi në të cilin jetoni:**

**INSTRUKSION: Lexo me rradhë. Një përgjigje në secilin rresht!**

	Po	Jo	Rrefuzon të përgjigjet
<b>Gropë sanituese</b>			
Tualet në oborr	1	2	999
Tualet në banesë	1	2	999
Tualet me banjo në banesë	1	2	999
<b>Kanalizim</b>			
Nuk ka	1	2	999
Gropë septike	1	2	999
I qytetit	1	2	999
<b>Paisje me ujë</b>			
Shfrytëzon nga vendi tjetër (psh. Çeshmja publike)	1	2	999
Çeshme në oborr	1	2	999
Çeshme në banesë	1	2	999

**P37.Si e ngrohni banimin gjatë dimrit? Theksoni burimin kryesor të energjisë të cilën shfrytëzoni?**

**INSTRUKSION: VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. Nxemje me avull qendrore
2. Nxemje me avull vetanake
3. Nxemje me koftor me rryme
4. Nxemje me koftor me karburantë të ngurtë
5. Nxemje me koftor me karburantë të lëngshme
6. Tjetër (*shkruaj*) \_\_\_\_\_

99. Nuk e di (*mos lexo*)

999. *Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)*

P38. Sa dhoma ngrohni në banimin tuaj?

**INSTRUKSION: VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. Një
2. Dy
3. Tre
4. Katër dhe më shumë

99. Nuk e di (*mos lexo*)

999. *Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)*

P39. Cili lloj veshje më së shumti i mungon amvisërisë suaj?

**INSTRUKSION: LEXO MODALITETET! VETËM NJË PËRGJIGJE!**

1. Këpucë
2. Veshje verore
3. Veshje dimrore (xhaketa, xhemperë)
4. Veshje solemne
5. Veshje të brenshme
6. Amvisërisë sonë nuk i mungon veshje
7. Tjetër (*shkruaj*) \_\_\_\_\_

99. Nuk e di (*mos lexo*)

999. *Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)*

P40. Do të lexoj disa aparate të caktuara të cilat një amvisëri mund ti posedojë. Ju lutem të më tregoni nëse amvisëria juaj i:

1. i posedon
2. nuk i posedon për shkak se nuk ka nevojë ose
3. nuk i ka për shkak se nuk mund ti blejë?

***INSTRUKSION: Lexo me rradhë. E mundshme është VETËM NJË PËRGJIGJE në secilën radhë!***

<i>Aparat për amvisëri</i>	Amvisëria ka	Amvisëria nuk ka nevojë	Amvisëria nuk mund ta blejë	<i>Rrefuzon të përgjigjet (mos lexo)</i>
Shporet me karburantë të ngurtë	1	2	3	999
Shporet elektrik	1	2	3	999
Furrë	1	2	3	999
Ngrohës uji	1	2	3	999
Frigorifer	1	2	3	999
Me ngrirje të thellë	1	2	3	999
Makinë për larje të teshave	1	2	3	999
Makinë për larje të enëve	1	2	3	999
Thithëse pluhuri	1	2	3	999
Klimë	1	2	3	999
Radio/gramafon/kasetofon	1	2	3	999
televizor	1	2	3	999
Video kamerë	1	2	3	999
Video rekorder/dvd	1	2	3	999
Aparat fotografik	1	2	3	999
Kompjuter	1	2	3	999
Telefon	1	2	3	999
Celularë	1	2	3	999
Biçikletë	1	2	3	999
Motoçikletë	1	2	3	999
Automobil	1	2	3	999
Traktor/makina bujqësore	1	2	3	999

***MBUSHE PASIQË TË LARGOHESH NGA BANIMI!!!***

**P41.Lloji i ndërtimit:**

***INSTRUKSION: VETËM NJË PËRGJIGJE!***

1. I improvizuar
2. I dobët/montazhë
3. Ndërtim i fortë
4. Tjetër (*shkruaj*) \_\_\_\_\_